VENDIM
Nr. 145, datë 11.3.2026

PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË POLITIKAVE PRIORITARE 2027–2029
(Ndryshuar me VKM nr. 602, datë 30.7.2026)
(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 5, të vendimit nr. 887, datë 27.12.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI**:**

1. Miratimin e Dokumentit të Politikave Prioritare 2027–2029, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Financave, Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës dhe të gjitha institucionet e tjera të administratës shtetërore, që janë pjesë e procesit të buxhetimit, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

DRAFTDOKUMENTI I POLITIKAVE PRIORITARE
2027–2029

KRYEMINISTRIA
AGJENCIA SHTETËRORE E PROGRAMIMIT STRATEGJIK DHE KOORDINIMIT TË NDIHMËS
Mars 2026

Tabela e përmbajtjes

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE
HYRJE
A. STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZHVILLIM DHE INTEGRIM EVROPIAN 2022–2030
B. STRATEGJIA E SPECIALIZIMIT INTELIGJENT (S3) 2025 - 2030
C. KUADRI STRATEGJIK (STRATEGJITË SEKTORIALE/NDËRSEKTORIALE)
D. PRIORITETET POLITIKE TË BASHKIMIT EVROPIAN 2024-2029
KREU I
1.1 REFORMAT AFATMESME DHE AFATGJATA TË QEVERISË SHQIPTARE
1. Integrimi në Bashkimin Evropian
2. Plani i ri i Rritjes, Instrumenti për Reforma dhe Rritje dhe Agjenda e Reformave.
3. Reforma në Drejtësi
4. Siguria në Komunitet
5. Specializimi Inteligjent dhe Avantazhi krahasues
6. Strategjia Kombëtare e Specializimit Inteligjent (S3) 2025–2030

KREU II
2.1 PËRPARËSITË AFATSHKURTRA DHE AFATMESME TË QEVERISË
1. Menaxhimi i Financave Publike
2. Reforma në Administratën Publike
3. Lufta kundër Korrupsionit
4. Digjitalizimi
5. Bujqësia
6. Turizmi
7. Energjia
2.2 PROGRAMET IPA 2022–2027 DHE FUSHAT PRIORITARE TE TYRE
2.3 BASHKËPUNIMI PËR ZHVILLIM ME DONATORË TË TJERË
KREU III
3.1 KUADRI MAKROEKONOMIK DHE FISKAL
1. Vështrim i përgjithshëm i objektivave ekonomikë
2. Zhvillimet e fundit ekonomike
3. Politika Fiskale
4. Skenari makroekonomik e fiskal afatmesëm
5. Përshkrimi i Risqeve financiare
KREU IV
4.1 PROGRAME PRIORITARE PËR PERIUDHËN 2027–2029
1. Programi i garancisë rinore
2. Programi i nxitjes së kodimit
3. Fuqizimi i strukturave rinore në nivel qendror dhe vendor
4. Standardizimi i qendrave rinore
5. Garancia Rinore
6. Mbrojtja e Natyrës
KREU V
LISTA UNIKE E PROJEKTEVE ME RËNDËSI KOMBËTARE
Akronime dhe shkurtime
Legjenda

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Hartimi i Dokumenti të Politikave Prioritare është i parashikuar në kalendarin e menaxhimit të shpenzimeve publike për vitin 2026 (miratuar në janar 2026), dhe i referohet vendimit nr. 9, datë 15.1.2026 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Kuadrit Makroekonomik e Fiskal për periudhën 2027–2029", si pjesë e Sistemit të Planifikimit të Integruar.

Hartimi i Dokumentit të Politikave Prioritare (DPP), është koordinuar nga Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës, në bashkëpunim me ministritë e linjës dhe agjencitë e aparatit të Kryeministrisë, me qëllim orientimin e përgjithshëm e racional të procesit të shpërndarjes së burimeve financiare midis sektorëve.

Dokumenti i Politikave Prioritare 2027–2029 për nga përmbajtja e tij është dokumenti që përcakton drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe është një nga elementet më të rëndësishme të planifikimit të integruar strategjik. Përmes këtij dokumenti, procesi i hartimit të buxhetit afatmesëm dhe i alokimit të burimeve financiare orientohet drejt përmbushjes së prioriteteve të përcaktuara.

Lista Unike e Projekteve me Rëndësi Kombëtare është pjesë integrale kyçe e dokumentit. Lista Unike ka për qëllim forcimin e procesit të menaxhimit të financave publike, procedurave mbi propozimin dhe miratimin e projekteve të investimeve publike të klasifikuara si projekte strategjike, si dhe adresimin e kërkesave të institucioneve ndërkombëtare partnere dhe të institucioneve ndërkombëtare financiare që mbështesin financimin e projekteve të investimeve.

Bazat referenciale për draftimin e Dokumentit të Politikave Prioritare 2027–2029 janë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 100 dhe 102;
- Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 16;
- Programi i Qeverisë 2025–2029;
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030;
- Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal 2027–2029;
- Strategjia e Specializimit Inteligjent (S3) 2025–2030;
- Strategjia e Sigurisë Kombëtare 2024;
- Ligji nr. 19/2025 datë 13.3.2025, "Për ratifikimin e Marrëveshjes së Facilitetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Bashkimit Evropian, të përfaqësuar nga Komisioni për rregullimet specifike për zbatimin e mbështetjes së Bashkimit Evropian për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të Facilitetit për Reforma dhe Rritje";
- Vendimi nr. 252 datë 2.5.2025, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësive e të marrëdhënieve midis autoriteteve dhe strukturave përgjegjëse për koordinimin dhe raportimin, sipas parashikimeve të Marrëveshjes së Facilitetit, ratifikuar me ligjin nr. 19/2025";
- Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027, miratuar me vendimin nr. 621, datë 10.10.2024, të Këshilli të Ministrave;
- Udhërrëfyesi për Shtetin e së Drejtës 2023–2030;
- Udhërrëfyesi për Reformën në Administratën Publike 2023–2030;
- Udhërrëfyesi për Funksionimin e Institucioneve Demokratike 2024–2030;
- Vendimi nr. 887, datë 27.12.2022, i Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike", i ndryshuar;
- Udhëzimi nr. 11, datë 28.5.2025, "Për përcaktimin e kufirit financiar të vlerës së plotë të projektit në përputhje me specifikat e sektorit, mbi bazën e të cilit përcaktohet mënyra dhe procedura e vlerësimit të projektit të investimit publik";
- Udhëzimi nr. 22, datë 15.9.2025, "Për përcaktimin e metodologjisë së përgatitjes së studimit të plotë të fizibilitetit dhe studimit të thjeshtuar të fizibilitetit";
- Dokumentet e Kuadrit Strategjik Kombëtar (Strategjitë Sektoriale dhe Ndërsektoriale, Planet e Veprimit, dokumentat e politikave të miratuara deri në dhjetor 2025 etj.);
- Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2022–2026;
- Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2021–2030;
- Strategjia për Modernizimin dhe Harmonizimin e Sistemeve të Informacionit Doganor Shqiptar në Përputhje me Sistemet e Informacionit Doganor të Bashkimit Evropian, për periudhën 2025-2030 dhe të Planit të Veprimit;
- Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike 2025–2030, Pani i Veprimit 2025-2027 dhe Pasaportës së Treguesve;
- Dokumenti Politik Kombëtar për Moshimin 2025–2030, dhe plani i veprimit për zbatimin e tij;
- Dokumenti Politik për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe Plani i Veprimit 2025–2030;
- Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe planit të veprimit 2025–2030;
- Strategjia Afatgjatë e Rinovimit të Stokut të Ndërtesave;
- Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit 2025–2030;
- Strategjia Kombëtare për Mospërhapjen e Armëve të Dëmtimit në Masë 2026–2028 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj;
- Strategjia Kombëtare Kundër Mashtrimit për Mbrojtjen e Interesave Financiarë të Bashkimit Evropian, 2025-2030 dhe Planit të Veprimit;
- Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2024–2030;

- Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024–2030;
- Strategjia Kombëtare e Ujitjes dhe Kullimit 2019-2031 dhe Plani i veprimit;
- Strategjia Kombëtare e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2023–2030;
- Strategjia Sektoriale e Menaxhimit të Financave Publike 2023–2030;
- Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Sipërmarrjes Inovative 2024–2030;
- Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë, Plani i Veprimit 2024–2030;
- Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018–2027;
- Strategjia për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve 2021–2027 dhe të Planit të saj të veprimit;
- Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit 2026–2030;
- Strategjia Kombëtare për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2025-2030 dhe të Planit të veprimit 2025–2028;
- Strategjia e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021–2027;
- Strategjia Kombëtare e Rinisë dhe Plani i veprimit 2022–2029;
- Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018–2030;
- Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023–2030;
- Strategjia Sektoriale e Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë 2023–2030;
- Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023–2030;
- Strategjia Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030;
- Strategjia Kombëtare e Sigurisë Ushqimore 2023–2027;
- Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024–2030;
- Dokumenti i Kontributit Kombëtar të Përcaktuar 2021–2030;
- Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës 2022–2030;
- Vendimi nr. 594, datë 10.9.2014, Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strategjisë kombëtare për cilësinë e ajrit të mjedisit";
- Vendimi nr. 412, datë 19.6.2019, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e planit kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit";
- Korniza e Partneritetit me Bankën Botërore 2023–2027;
- Dokumenti i Përgjigjes Strategjike Kombëtare IPA III 2021–2027 – Shqipëria (2022);
- Dokumenti i Përgjigjes Strategjike Kombëtare për IPA 2025-2027 – Shqipëria (2024);
- Prioritetet e Programit IPA 2024 dhe 2027;
- Kuadri i Bashkëpunimit për Zhvillimin e Qëndrueshëm me Kombet e Bashkuara 2022-2026;
- Prioritetet e Programit IPARD III (Instrumenti për Asistencën e Paraanëtarësimit për Zhvillimin Rural) 2021-2027;
- Prioritetet e Marrëveshjes së Huas (2022) midis Këshillit të Ministrave dhe Agjencisë Franceze për Zhvillim për Mbështetjen e Barazisë Gjinore në Aksesin ndaj Mundësive Ekonomike;
- Programi i Bashkëpunimit Zviceran 2022-2025;
- Programi i Reformave Ekonomike ERP 2026-2028;
- Dakordësimet e Komitetit të Planifikimit Strategjik, janar 2025 – janar 2026.

Dokumenti i Politikave Prioritare (DPP) përbën një fazë të ndërmjetme midis kuadrit makro-fiskal trevjeçar dhe përcaktimit të tavaneve buxhetore përkatëse. Tavanet e shpenzimeve për vitet 2027 dhe 2028 janë përcaktuar gjatë PBA 2026-2028. Megjithatë është e vetëkuptueshme, që gjatë kësaj periudhe kohore mund të dalin në pah disa prioritete, të cilat duhet të shqyrtohen nga Komiteti i Planifikimit Strategjik (KPS), përpara se të përfshihen në tavanet e PBA-së.

HYRJE

Përmbajtja e Dokumentit të Politikave Prioritare bazohet në vizionin dhe objektivat e disa dokumenteve qendrore politikash, si: Programi Politik i Qeverisë 2025–2029, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030, Strategjia e Specializimit Inteligjent (S3) 2025-2030, Agjenda Kombëtare e Reformave (AKR) 2024–2027, Programi i Reformave Ekonomike (ERP) 2026–2028, PKIE 2025–2027, Kuadri Kombëtar i strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale, Kuadri i Bashkëpunimit për Zhvillimin e Qëndrueshëm me Kombet e Bashkuara 2022–2026 dhe angazhimet në përmbushjen e OZHQ-ve.

A. STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZHVILLIM DHE INTEGRIM EVROPIAN 2022–2030

SKZHIE III është përgatitur nga Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës në bashkëpunim me institucionet e tjera të vendit. Ky dokument përbën kuadrin e politikave afatgjata më të rëndësishme të Qeverisë Shqiptare, që parashtron vizionin e zhvillimit dhe prioritetet strategjike të Shqipërisë, si një ekonomi në nivelin e sipërm të grupit të vendeve me të ardhura mesatare.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030 shtrihet në harkun kohor 2022–2030 dhe vijon zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2016-2020 (SKZHI II) në të gjitha fushat strategjike të zhvillimit të Shqipërisë dhe procesit të integrimit të saj në Bashkimin Evropian. Në dallim nga ciklet e mëparshme të kuadrit strategjik, SKZHIE 2030 synon të pasqyrojë prioritetet e zhvillimit në një periudhë relativisht më të gjatë kohore, duke konsideruar:

- Harmonizimin e zbatimit të SKZHIE 2030 me arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), pjesë e Agjendës 2030, për të cilat Shqipëria është plotësisht e angazhuar deri në përfundimin e procesit në vitin 2030;
- Ndërtimin dhe zbatimin e një vizioni afatgjatë për zhvillimin e vendit;
- Shtrirjen deri në vitin 2030 të disa prej strategjive të rëndësishme sektoriale të miratuara, apo në proces përgatitjeje;
- Dobinë e ndërtimit të një kuadri strategjik afatgjatë që ndihmon procesin e integrimit të Shqipërisë në BE brenda një kornize të qartë e të qëndrueshme strategjike;
- Mbështetjen e procesit të buxhetimit afatmesëm (PBA) duke ndërtuar projeksione afatgjata të shpenzimeve buxhetore për arritjen e synimeve strategjike dhe objektivave të politikave për zhvillimin e vendit.

Procesi i hartimit të SKZHIE 2030 është realizuar përmes koordinimit nga ana e Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës dhe angazhimit të një numri të konsiderueshëm institucionesh shtetërore ku përfshihen të gjitha ministritë, institucionet e pavarura, agjenci të rëndësishme zbatuese të politikave sektoriale, përfaqësues të qeverisjes vendore dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm të përfshirë.

Përgjatë këtij procesi, SKZHIE III është shoqëruar me konsultime me palët e interesit, shoqërinë civile, përfaqësuesit e biznesit, akademinë dhe organizatat ndërkombëtare të pranishme në Tiranë, mbi çdo fushë politike zhvillimi.

SKZHIE III është dokumenti kryesor strategjik që jep drejtimet dhe përcakton përparësitë e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik e shoqëror të vendit duke përcaktuar vizionin për zhvillimin e demokracisë, zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të vendit gjatë periudhës 2022–2030: “Shqipëria 2030: “Një ekonomi dinamike, pjesë e Bashkimit Evropian dhe rajonit, që ofron kushte të barabarta për rritjen e mirëqenies së të gjithë qytetarëve të saj mbështetur në një demokraci funksionale që garanton të drejtat themelore dhe liritë e njeriut”.

SKZHIE III paraqet se si ky vizion do të arrihet përmes politikave dhe përparësive të mëposhtme:

- Nxitjen e ritmeve të zhvillimit të vendit, duke gjeneruar rritje ekonomike të qëndrueshme, me fokus të qartë të zhvillimit të gjelbër dhe digjital, përmes një stabiliteti makroekonomik dhe financiar;

- Arritjen e standardeve që u shërbejnë qytetarëve, rritjes së mirëqenies dhe sigurimit të mbrojtjes së të drejtave të tyre, veçanërisht të rinjve/të rejave dhe vajzave e grave;
- Transformimin e Shqipërisë në një vend me standarde që i përgjigjen anëtarësimit të plotë në Bashkimin Evropian;
- Ndërtimin e politikave që rrisin konkurrueshmërinë dhe rritjen ekonomike të vendit, duke e integruar denjësisht atë me vendet e rajonit dhe Bashkimit Evropian.

Mbështetur në vizionin për zhvillimin e vendit, SKZHIE III bazohet në një qëllim parësor që synon integrimin e plotë të vendit në Bashkimin Evropian dhe tri shtylla kryesore:

1. Demokracia e fuqizimi i institucioneve dhe qeverisjes së mirë;
2. Agjenda për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, ndërlidhjen dhe rritjen e gjelbër;
3. Kohezioni social.

SKZHIE 2030 përcakton përparësitë kryesore të kësaj strategjie në fushat e mëposhtme:

- Integrimi evropian;
- Lufta ndaj korrupsionit;
- Energjia;
- Bujqësia;
- Turizmi;
- Digjitalizimi.

Në vitin 2025 ka përfunduar Raporti i Progresit për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE) 2022–2030, i cili paraqet një vlerësim gjithëpërfshirës të ecurisë së Shqipërisë në realizimin e objektivave strategjikë kombëtarë dhe avancimin e procesit të integrimit evropian. Strategjia vijon të shërbejë si dokumenti kryesor udhëzues për planifikimin strategjik dhe koordinimin e politikave publike, duke siguruar koherencë ndërmjet prioriteteve kombëtare, procesit të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe angazhimeve ndërkombëtare të Shqipërisë, përfshirë Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm. Raporti evidenton se gjatë periudhës së zbatimit janë konsoliduar mekanizmat institucionalë të monitorimit dhe raportimit, ndërsa bashkëpunimi ndërinstitucional është forcuar, duke kontribuar në një vlerësim më të strukturuar dhe të bazuar në rezultate të progresit sektorial dhe ndërsektorial.

Në lidhje me objektivin gjithëpërfshirës të integrimit evropian, raporti konstaton progres të rëndësishëm në vijimin e negociatave për anëtarësim dhe në përafrimin gradual të legjislacionit dhe politikave me *Acquis* të Bashkimit Evropian. Hapja e grup-kapitujve negociuese dhe përparimi në kapitujt kyç, veçanërisht në fushat e sundimit të ligjit, administratës publike, prokurimit publik dhe të drejtave themelore, dëshmojnë angazhimin e qëndrueshëm politik dhe institucional për realizimin e reformave të kërkuara. Raporti thekson gjithashtu përmirësimin e koordinimit të procesit të integrimit, përfshirë forcimin e rolit të institucioneve përgjegjëse dhe rritjen e transparencës dhe komunikimit me publikun dhe partnerët.

Në kuadër të shtyllës së parë, "Demokracia, fuqizimi institucional dhe qeverisja e mirë", raporti evidenton përparime të qëndrueshme në konsolidimin e reformës në drejtësi dhe forcimin e institucioneve të pavarura. Funksionimi i plotë i organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, vijimi i procesit të vlerësimit kalimtar dhe rritja e efikasitetit të strukturave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar kanë kontribuar në përmirësimin e integritetit institucional dhe besimit publik. Gjithashtu, janë shënuar përmirësime në kuadrin ligjor dhe institucional për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, barazinë gjinore dhe përfshirjen sociale, megjithëse raporti nënvizon nevojën për forcimin e mëtejshëm të zbatimit praktik të legjislacionit dhe kapaciteteve administrative, veçanërisht në nivel vendor.

Në shtyllën e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik, raporti pasqyron progres në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik dhe fiskal, përmirësimin e menaxhimit të financave publike dhe rritjen e lidhjes ndërmjet prioriteteve strategjike dhe Programit Buxhetor Afatmesëm. Janë evidentuar investime të rëndësishme në infrastrukturën e transportit, energjisë dhe ndërlidhjes,

si dhe hapa konkretë drejt tranzicionit të gjelbër dhe përmbushjes së objektivave të Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor. Raporti vlerëson gjithashtu përparimin në digjitalizimin e shërbimeve publike dhe zhvillimin e ekonomisë digjitale, duke kontribuar në rritjen e efikasitetit administrativ dhe përmirësimin e klimës së biznesit. Megjithatë, sfida të rëndësishme vijojnë të mbeten, përfshirë rritjen e produktivitetit, diversifikimin ekonomik, uljen e informalitetit dhe rritjen e qëndrueshmërisë ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike dhe zhvillimeve demografike.

Në shtyllën e kohezionit social, raporti evidenton përmirësime në aksesin dhe cilësinë e shërbimeve publike në arsim, shëndetësi dhe mbrojtje sociale, si dhe në politikat aktive të tregut të punës. Janë ndërmarrë masa për fuqizimin e grupeve vulnerabël, përfshirë gratë, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara dhe komunitetet në nevojë, duke kontribuar në uljen e pabarazive sociale dhe territoriale. Raporti vlerëson progresin në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe në forcimin e mekanizmave të përfshirjes sociale, por thekson nevojën për një qasje më të integruar dhe të qëndrueshme, të mbështetur në të dhëna të ndara dhe tregues të matshëm, për të garantuar ndikim afatgjatë të politikave sociale.

Raporti i progresit 2025 rekomandon vijimin e pandërprerë të reformave në të gjithë sektorët, pavarësisht arritjes së parakohshme të disa objektivave të SKZHIE 2030. Në funksion të objektivit për përfundimin e negociatave të anëtarësimit në BE deri në vitin 2027, rekomandohet formalizimi i objektivave afatmesëm (të ndërmjetëm) të SKZHIE-së për vitin 2027, të shoqëruar me tregues të qartë performance dhe të harmonizuara me programin qeveritar 2025–2029. Paralelisht, kërkohet rishikimi i SKZHIE 2030 për të reflektuar ritmin e përshpejtuar të integrimit evropian, për të shmangur mbivendosjet, për të identifikuar risqe të reja dhe për të integruar mësimet e nxjerra në planifikimin strategjik.

Një theks i veçantë vihet në forcimin e arkitekturës së monitorimit dhe të të dhënave, përmes funksionimit efektiv të sistemeve të menaxhimit të informacionit (MIS) dhe trajtimit të treguesve të SKZHIE-së si prioritet kombëtar në ekosistemin e të dhënave. Raporti rekomandon një qasje të integruar vlerësimi, që kombinon treguesit sasiorë me analiza cilësore të reformave dhe rezultateve të politikave publike, si dhe harmonizimin e plotë të treguesve strategjikë (KPI) me procesin e integrimit në BE dhe Agjendën 2030.

Sipas vlerësimit të OECD-së (2025) në kuadër të Partneritetit Global për Bashkëpunim Efektiv për Zhvillimin (Raundi i katërt i Monitorimit, 2023–2026), cilësia e planifikimit strategjik kombëtar të zhvillimit në Shqipëri vlerësohet si e lartë *("high"),* me një rezultat 0.8 nga 1. Ky vlerësim pasqyron ekzistencën e një strategjie kombëtare gjithëpërfshirëse dhe të orientuar drejt rezultateve, të harmonizuar me Agjendën 2030 dhe prioritetet e integrimit evropian, si dhe përdorimin e saj si instrument referues për dialogun mbi prioritetet dhe rezultatet e zhvillimit. OECD thekson përparimin në koherencën ndërsektoriale dhe respektimin e hapësirës së politikave kombëtare, ndërkohë që rekomandon forcimin e mëtejshëm të lidhjes midis planifikimit strategjik, programimit buxhetor dhe mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit për të rritur efektivitetin dhe llogaridhënien e politikave publike.

Vlerësimi i OECD-së konfirmon gjithashtu një nivel të lartë të funksionit mbikëqyrës të Kuvendit në Shqipëri, duke e konsideruar atë një element kyç të qeverisjes së mirë dhe të llogaridhënies publike. Sipas rezultateve të monitorimit, mbikëqyrja parlamentare mbi bashkëpunimin për zhvillim vlerësohet si e lartë, me një rezultat prej 0.89 nga 1, që reflekton rolin aktiv të Kuvendit në miratimin e buxhetit, aksesin në informacion mbi flukset e financimit dhe përfshirjen në dialogun mbi prioritetet dhe arritjet e politikave zhvillimore. Ky vlerësim i lartë dëshmon se mekanizmat ekzistues të raportimit dhe kontrollit parlamentar kontribuojnë në rritjen e transparencës, forcimin e llogaridhënies së ekzekutivit dhe përputhjen më të mirë të politikave publike me angazhimet kombëtare dhe ndërkombëtare të vendit.

Gjeopolitika – Sfidë strategjike e SKZHIE 2030

Rëndësia gjeopolitike e vendit tonë, si dhe ajo e Ballkanit Perëndimor në arkitekturën e sigurisë evropiane dhe euroatlantike, është rritur ndjeshëm si pasojë e dinamikave globale, rivlerësimit të politikave të zgjerimit dhe interesit të shtuar të partnerëve strategjikë për të garantuar sigurinë dhe kohezionin në kufijtë lindorë të Evropës. Shqipëria, si vend anëtar i NATO-s dhe aktor i përgjegjshëm rajonal, mbetet një partner i rëndësishëm në ruajtjen e këtij ekuilibri. Integrimi i përshpejtuar i Shqipërisë në Bashkimin Evropian është një aspiratë kombëtare, dhe një interes i drejtpërdrejtë strategjik i BE-së, pasi kontribuon në konsolidimin e kufirit juglindor të Evropës dhe në mbylljen e një hapësire historikisht të ekspozuar ndaj ndikimeve që shpesh bien ndesh me vlerat demokratike evropiane.

Përgjatë dhjetë viteve të fundit, politika e jashtme e Shqipërisë është ndërtuar mbi parimin e një aleance të patjetërsueshme me Bashkimin Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si dhe mbi angazhimin aktiv në NATO dhe organizatat shumëpalëshe. Ky orientim strategjik ka forcuar ndjeshëm profilin ndërkombëtar të vendit, duke u reflektuar në role të rëndësishme si kryesimi i OSBE-së, anëtarësimi në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara dhe kontributi aktiv në struktura kyçe të sistemit multilateral, përfshirë UN Women, UNESCO dhe Këshillin e të Drejtave të Njeriut. Ky kapital diplomatik nuk është vetëm tregues i besueshmërisë ndërkombëtare, por shndërrohet në një avantazh politik konkret që rrit peshën negociuese të Shqipërisë në procesin e integrimit evropian.

Pjesëmarrja aktive në nisma rajonale, së bashku me organizimin e Samitit të Komunitetit Politik Evropian në Tiranë (maj 2025), Samitit të Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor – "Rruga jonë drejt Bashkimit Evropian" (nëntor 2025), si dhe pritjen e Samitit të ardhshëm të NATO-s në Tiranë (2027), kanë konsoliduar pozicionimin e Shqipërisë si faktor i besueshëm bashkëpunimi në Ballkanin Perëndimor dhe si promotor i agjendës evropiane dhe euroatlantike. Këto zhvillime e përkthejnë angazhimin diplomatik në ndikim politik, duke krijuar kushte më të favorshme për avancimin e prioriteteve kombëtare në tryezat evropiane dhe transatlantike.

Në këtë kontekst, roli i Bashkimit Evropian dhe rrugëtimi i Shqipërisë drejt anëtarësimit marrin një rëndësi të veçantë strategjike dhe gjeopolitike. Zgjerimi i BE-së drejt Ballkanit Perëndimor nuk është vetëm një proces teknik reformash, por një instrument i rëndësishëm për forcimin e sigurisë, qëndrueshmërisë institucionale dhe reziliencës së vetë Evropës. Plani i Rritjes për Ballkanin Perëndimor përfaqëson një mekanizëm përshpejtues të këtij procesi, duke lidhur reformat kombëtare me investime konkrete, integrimin gradual në tregun e përbashkët dhe përfitime të prekshme për qytetarët.

Për Shqipërinë, ky plan krijon një dritare strategjike për përshpejtimin e konvergjencës ekonomike dhe forcimin e kapaciteteve shtetërore, ndërsa për Bashkimin Evropian garanton konsolidimin e kufirit të tij juglindor dhe ndërtimin e një hapësire demokratike, funksionale dhe të orientuar drejt vlerave evropiane. Në këtë kuptim, integrimi i Shqipërisë nuk është vetëm një objektiv kombëtar, por një interes reciprok strategjik që kontribuon në sigurinë afatgjatë dhe në peshën gjeopolitike të Evropës.

Rikonfirmimi i vëmendjes ndërkombëtare ndaj rajonit reflektohet edhe në zhvillimet e fundit politike. Raporti i publikuar nga New Diplomacy Project, përpara Samitit të Procesit të Berlinit në Londër (22 tetor 2025), me titull "Restoring British Leadership in the Western Balkans", si dhe projektakti amerikan i propozuar në shtator 2025, "Western Balkans Democracy and Prosperity Act" (në shqyrtim nga Kongresi Amerikan), dëshmojnë se partnerët kryesorë euroatlantikë e konsiderojnë Ballkanin Perëndimor vendimtar për reziliencën demokratike dhe për mbrojtjen e arkitekturës së sigurisë së kontinentit, një vlerësim që reflektohet edhe në përpjekjet evropiane për konsolidimin e unitetit dhe qëndrueshmërisë së brendshme, shmangies së fragmentimit dhe rritjes së përgjegjësisë së vetë Evropës për sigurinë e saj afatgjatë.

Projektligji amerikan, në veçanti, parashikon një paketë investimesh dhe instrumentesh zhvillimore që synojnë mbështetjen e demokracisë, rritjen ekonomike dhe integrimin e rajonit në ekonominë euroatlantike. Kjo përfshin financime për infrastrukturën kritike, veçanërisht rrjetet energjetike dhe korridoret e transportit që rrisin ndërlidhjen rajonale. Mbështetja shtrihet gjithashtu në sigurinë kibernetike, modernizimin e kapaciteteve të mbrojtjes dhe forcimin e instrumenteve kundër ndërhyrjeve të huaja, duke synuar krijimin e një mjedisi institucional më të mbrojtur dhe më elastik ndaj presioneve të jashtme.

Komponentët ekonomikë të këtij projektligji adresojnë drejtpërdrejt nevojat strukturore të tregjeve të Ballkanit Perëndimor. Investimet synojnë rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit privat, mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, digjitalizimin e zinxhirëve të vlerës dhe nxitjen e inovacionit teknologjik. Përmes instrumenteve të Korporatës Financiare Amerikane të Zhvillimit (DFC), krijohen mundësi për financime të konsiderueshme në energjinë e pastër, infrastrukturën e gazit të lëngshëm, prodhimin e qëndrueshëm, logjistikën dhe teknologjitë e gjelbra. Një dimension qendror lidhet me investimet në sundimin e ligjit, duke përfshirë programe për forcimin e pavarësisë së gjyqësorit, luftën kundër korrupsionit, rritjen e transparencës fiskale dhe mbrojtjen e proceseve demokratike nga ndërhyrjet politike.

Pozicionimi i Shqipërisë si një partner serioz i Shteteve të Bashkuara dhe Mbretërisë së Bashkuar rrit mundësinë që vendi të përfitojë drejtpërdrejt nga këto paketa investimesh, veçanërisht në sektorë ku ekziston potencial i lartë zhvillimi: energjia e rinovueshme, turizmi i qëndrueshëm, teknologjitë digjitale dhe logjistika strategjike në korridoret Adriatiko-Joniane. Investimet infrastrukturore dhe energjetike, të kombinuara me transformimin digjital të administrimit publik, mund ta pozicionojnë Shqipërinë si një nyje ekonomike rajonale, duke rritur rolin e saj në zinxhirët evropianë të furnizimit dhe përshpejtuar konvergjencën me standardet e BE-së.

Në nivelin politik, mbështetja britanike dhe amerikane për Ballkanin Perëndimor e vendos Shqipërinë në një trekëndësh strategjik ku interesat e BE-së, SHBA-ve dhe MB-së konvergojnë rreth objektivit të përbashkët të reformave, sigurisë dhe integrimit. Ky konvergim përfaqëson një moment unik që kërkon kapitalizim përmes avancimit të reformave të thella në sundimin e ligjit, administratën publike, mbrojtjen kibernetike dhe menaxhimin e financave publike.

Zbatimi konsistent i standardeve të BE-së, forcimi i sigurisë së brendshme dhe rritja e reziliencës ekonomike krijojnë kushtet për një integrim më të shpejtë dhe më të besueshëm. Shfrytëzimi i kësaj dritareje historike do të përforcojë rolin e Shqipërisë si faktor kyç bashkëpunimi në rajon dhe si pjesë integrale e arkitekturës së re evropiane.

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030

Shqipëria ka përgatitur, miratuar dhe po zbaton një strategji të integruar kombëtare dhe afatgjatë për zhvillimin e vendit – Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030 (SKZHIE 2030) – e cila shtrihet deri në vitin 2030, duke përcaktuar qartë vizionin afatgjatë për zhvillimin e vendit, prioritetet e zhvillimit të vendit, fokusin në procesin e integrimit evropian, si dhe hapat e investimet që do të kryhen deri më 2030-n në të gjithë sektorët e rëndësishëm për zhvillimin e vendit. SKZHIE 2030 harmonizon zbatimin me arritjen e OZHQ-ve, si pjesë e Agjendës 2030, për të cilat Shqipëria është plotësisht e angazhuar deri në përfundimin e procesit në vitin 2030.

Po kështu, 16 nga 50 treguesit (KPI) e monitorimit të SKZHIE 2030 janë njëkohësisht dhe tregues globalë të OZHQ ndërkohë që rritja e numrit të treguesve me objektiva të përcaktuar do të ndihmojë në procesin e hartimit të strategjive të tjera sektoriale për vitin 2030.

Integrimi evropian dhe OZHQ-të janë të ndërlidhura, me një fokus të përbashkët në zhvillimin e qëndrueshëm, përmirësimin e mirëqenies, reformat për forcimin e sundimit të ligjit dhe përmirësimin e qeverisjes dhe mbrojtjen e të drejtave dhe mjedisit. Agjenda e Gjelbër e Ballkanit Perëndimor dhe Plani Ekonomik dhe i Investimeve për Ballkanin Perëndimor

2021–2027 kanë një rol tepër të rëndësishëm në adresimin e sfidave të Shqipërisë dhe rajonit për përmbushjen e angazhimeve të Agjendës 2030 dhe procesit të integrimit evropian.

Për procesin e negociatave për anëtarësimin në BE, pikëlidhjet midis OZHQ-ve dhe kapitujve dhe *clusters* të integrimit evropian për rastin e Shqipërisë, si dhe shtyllave të SKZHIE 2030, paraqiten në mënyrë skematike në tabelën e mëposhtme, e cila përcakton, gjithashtu, edhe prioritetet përkatëse të procesit të integrimit sipas OZHQ-ve:



Draftudhërrëfyesi për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030 është pranë fazës së miratimit në Këshillin e Ministrave. Ai bazohet në:

i. Analizën e progresit të deritanishëm të Shqipërisë në zbatimin e Agjendës 2030 duke marrë si pikënisje të procesit Raportin Bazë të hartuar në vitin 2017, të dhënat e siguruara nga institucionet shtetërore, përfshirë INSTAT-in, si dhe publikimet ndërkombëtare që monitorojnë ecurinë e zbatimit të Agjendës 2030 nga të gjitha vendet pjesëmarrëse në proces.

ii. Përcaktimin e synimeve *(targets)* të matshme për vitin 2030 për të gjithë treguesit e disponueshëm të OZHQ sipas metodologjisë së miratuar nga Kombet e Bashkuara për çdo tregues global dhe bazuar në vlerësimet apo parashikimet e institucioneve sipas fushave përkatëse si dhe përcaktimet e këtyre objektivave në dokumente politikash sektoriale të miratuara ose në proces miratimi. Gjatë procesit të përgatitjes së këtij udhërrëfyesi, në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha institucionet e përfshira në të, u arrit të përcaktohen synimet për vitin 2030 për 66 tregues globalë të OZHQ – ose 26.6% të treguesve globalë OZHQ, të shpërndarë për secilin OZHQ, sipas grafikut të mëposhtëm:

iii. Treguesit për të cilët janë përcaktuar objektiva të matshëm për vitin 2030, u përkasin 52 synimeve OZHQ, nga 169 të tilla, ose për 31% të tyre.

iv. Konsiderimin e metodologjive alternative që mundësojnë vlerësimin e treguesve globalë të rëndësishëm për kontekstin shqiptar për rastet kur kjo nuk mund të realizohet si më sipër.

v. Analizën e strategjive sektoriale dhe dokumenteve të politikës sipas sektorëve përkatës, si dhe lidhjet me procesin e integrimit evropian.

vi. Vlerësimin e lidhjeve midis synimeve dhe treguesve të OZHQ deri në vitin 2030.

vii. Përparësitë në objektivat e përcaktuar.

viii. Vlerësimin e përgjithshëm financiar mbi arritjen e synimeve të përcaktuara për vitin 2030.

ix. Përcaktimin e afateve kohore dhe përgjegjësive institucionale për objektivat e përcaktuar.

Pjesë e analizës në udhërrëfyes është dhe Raporti i Zhvillimit të Qëndrueshëm i vitit 2024, si një instrument i paanshëm monitorimi global që tregon se Shqipëria përgjithësisht ka kryer një progres të dukshëm në ndjekjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Rezultati i përgjithshëm i Indeksit të OZHQ-ve për Shqipërinë është 75/100. Gjatë vitit të fundit ka pasur një përmirësim të ndjeshëm në renditjen globale të Shqipërisë, me një rritje prej 12 vendesh në vendin e 42-të nga 163 vende (viti paraardhës gjithashtu kishte një rritje prej 7 vendesh). Në rajonin e Ballkanit Perëndimor, progresi i kryer e vendos Shqipërinë përpara Maqedonisë së Veriut, Bosnjë-Hercegovinës dhe Malit të Zi.

Pavarësisht progresit të kryer, mbeten ende sfida në OZHQ 2 (Zero uri), OZHQ 4 (Arsim cilësor) dhe OZHQ 8 (Punë e denjë dhe rritje ekonomike). Këta objektiva kërkojnë vëmendje dhe përpjekje të përbashkëta për të përshpejtuar progresin. Progres i mirë raportohet në OZHQ 3 (Shëndet i mirë dhe mirëqenie), OZHQ 5 (Barazia gjinore) dhe OZHQ 6 (Ujë i pastër dhe sanitet). Për sa i përket dinamikës, sipas raportit, Shqipëria është në rrugën e duhur për të përmbushur OZHQ-të 1, 7, 9 dhe 10, por sfida mbeten ende veçanërisht në OZHQ 11, 12, 13,14, 15, 16 dhe 17.

B. STRATEGJIA E SPECIALIZIMIT INTELIGJENT (S3) 2025–2030

Shqipëria nisi procesin e përgatitjeve të saj për S3 në 2016 dhe u regjistrua në platformën e Qendrës së Përbashkët të Kërkimit (JRC) për S3 të Komisionit Evropian në 2017. S3 është një komponent integral i angazhimeve të Shqipërisë në lidhje me integrimin në BE, si pjesë e tre kapitujve: kapitulli 20 "Ndërmarrjet dhe Politikat Industriale", kapitulli 22 "Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore" dhe kapitulli 25 "Shkenca dhe Kërkimi". Gjithashtu, S3 është pjesë e Agjendës së Inovacionit të BE-së për Ballkanin Perëndimor 2021–2027.

S3 shtrihet në periudhën 2025–2030 dhe ka në fokus mbështetjen e sektorëve prioritarë ku investimi në inovacion përbën vlerë të shtuar për ekonominë shqiptare, si dhe rrit kompetitivitetin dhe rritjen e saj me objektiv integrimin në BE. S3 është një strategji ombrellë nën SKZHIE dhe mbi strategjitë sektoriale, e cila shërben si referencë dhe orientim për këto të fundit me qëllim konvergjencën e prioriteteve dhe investimeve drejt prioriteteve të S3.

Procesi i përgatitjes së S3 është udhëhequr politikisht nga Komiteti Ndërministror i S3 i drejtuar nga Zëvendëskryeministri dhe teknikisht nga Ekipi Kombëtar i S3. Ky i fundit përgatiti një udhërrëfyes S3 sipas kornizës së JRC-së mbi bazën e të cilit finalizoi hapat e parë të analizës

së kontekstit, nëpërmjet hartëzimit sasior dhe cilësor të potencialit ekonomik, inovativ, shkencor dhe teknologjik të vendit, të ndjekur nga një konsultim të (EDP) një vjeçar me aktorët e helikës së katërfishtë (qeverisja qendrore dhe vendore, akademia, biznesi dhe shoqëria civile), ku më shumë se 1600 përfaqësues të sektorëve të ndryshëm morën pjesë aktivisht, duke pasur kështu një impakt të jashtëzakonshëm dhe duke gjeneruar propozime konkrete për t'u përfshirë në strategji, si dhe duke u konsideruar si një hap i rëndësishëm drejt bashkëpunimit dhe rrjetëzimit ndërsektorial midis aktorëve kryesorë në fushat prioritare.

Gjetjet e EDP-së, vizioni dhe prioritetet, të strukturuara në dokumentin e S3 nga Ekipi Kombëtar i S3 u diskutuan dhe miratuan nga Komiteti Ndërministror i S3 dhe shërbyen si bazë për mbi 120 takime individuale ose në grup me palët e interesuara e përfaqësues të qeverisë për të diskutuar masa specifike që u përfshinë në planin e veprimit. Drafti përfundimtar i S3 u konsultua me aktorët kryesorë të përfshirë në hartimin e planit të veprimit, si dhe në Bllokun e Ekonomisë së Qeverisë dhe u përditësua më pas. Versioni përfundimtar iu dërgua JRC-së dhe komentet u pasqyruan në dokumentin e S3, i cili iu nënshtrua konsultimit publik dhe u miratua me vendim të Këshillit të Ministrave në 26.12.2024.

Prioritetet vertikale të parashikuara në S3:

- Energjia e rinovueshme dhe burimet natyrore.

Nënsektorët:

- Energjia e rinovueshme
- Lëndët e para (kërkim, shfrytëzim dhe përpunim), pjesë e zinxhirit të furnizimit të BE-së
- Ruajtja e mjedisit

- Zinxhiri ushqimor i shëndetshëm dhe i qëndrueshëm.

Nënsektorët:

- Bujqësia organike e qëndrueshme dhe certifikimi
- Përpunimi i ushqimit dhe produktet me vlerë të shtuar
- Peshkimi dhe akuakultura e qëndrueshme
- Prodhimi i bimëve aromatike mjekësore, vajrave dhe ekstrakteve
- Turizmi i qëndrueshëm dhe i larmishëm.

Nënsektorët:

- Trashëgimia dhe traditat kulturore
- Turizmi shëndetësor
- Kulinaria (e kombinuar me bujqësinë, ushqimin, sigurinë ushqimore)
- Turizmi natyror dhe rural (agroturizëm, turizmi i aventurës dhe sportiv etj.).

Parakushtet për një S3 të suksesshëm:

- Përmbysja e tendencës drejt emigrimit dhe braktisjes së zonave rurale nga të rinjtë
- Përmirësimi i kontekstit për akses në financa dhe kredi
- Forcimi i infrastrukturës së rrjetit: aksesi në internet *broadband,* infrastruktura e transportit, transporti publik, logjistika dhe shërbimi shëndetësor

Masat/prioritetet horizontale/ndërsektoriale:

- Kapitali njerëzor
- Angazhimi i diasporës
- Mbajtja e talenteve
- Edukimi dhe aftësitë (rishikimi i kurrikulës, ngritja e aftësive, rikualifikimi)
- Ekonomia blu dhe jeshile
- Tranzicioni i gjelbër
- Ruajtja e burimeve natyrore
- Gjurmë e reduktuar e karbonit
- Shërbime teknologjike digjitale të avancuara
- Përparimet në AI dhe *machine learning*
- Transformimi digjital i ekonomisë lokale

- Rritja e kapaciteteve eksportuese

Masat horizontale/ndërvepruese në lidhje me përmirësimin e ekosistemit kombëtar të inovacionit:

- Korniza e politikave industriale/inovative
- Kuadri legjislativ/rregullator sipas standardeve të BE-së
- Skema nxitëse, mbështetje biznesi, derregullim
- Forume, panaire dhe diplomaci ekonomike
- Bashkëpunimi me helikën e katërfishtë
- Strategjia e informimit dhe komunikimit
- Platformat që mundësojnë bashkëpunimin, *cluster*-at
- Praktikat dhe proceset ekologjike/të qëndrueshme
- Transferimi i teknologjisë
- Rritja e rolit institucional të agjencive shtetërore
- Mbështetja e produkteve *"Made in Albania"*.
- Integrimi në zinxhirët globalë të vlerës

Gjatë gjithë këtij procesi, Shqipëria ka marrë mbështetje të vazhdueshme nga stafi i JRC-së, si dhe në formën e sesioneve trajnuese dhe ekspertizës ndërkombëtare, që ka qenë thelbësore për procesin S3.

C. KUADRI STRATEGJIK (STRATEGJITË SEKTORIALE/NDËRSEKTORIALE)

Prioritetet e zhvillimit të vendit përcaktohen dhe institucionalizohen përmes kuadrit strategjik, i cili konsiston në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian, S3 dhe strategjitë sektoriale/ndërsektoriale.

Kostoja e zbatimit të S3 për 2025–2030 është në vlerën 1.183.685.896 euro.

Tabela: Kostoja e zbatimit të dokumenteve strategjike 2027–2029 (në mijë lekë)

Nr	Strategjia	2027	2028	2029	Totali 2027-2029 (000)
1	Strategji a Ndërsektoriale e Reformës së Administratës Publike 2025-2030, Plani i Veprimit 2025-2027	1,854,692	1,854,692	1,854,692	5,564,076
2	Strategji a Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030	330,587	330,587	330,587	991,761
3	Strategji a Kombëtare e Shëndetësisë 2021-2030	44,897,500	44,897,500	44,897,500	134,692,500
4	Strategji a Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2024-2030	40,769,730	40,769,730	40,769,730	122,309,190
5	Strategji a Kombëtare e Rinisë 2022-2029	795,726	795,726	795,726	2,387,178
6	Strategji a Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023-2030	3,445,161	3,445,161	3,445,161	10,335,483
7	Strategji a Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030	285,714	285,714	285,714	857,142
8	Strategji a Kombëtare e Energjisë 2018-2030	48,604,000	48,604,000	48,604,000	145,812,000
9	Strategji a Kombëtare e Ujitjes dhe Kullimit 2019-2031 dhe Plani i Veprimit	7,940,910	7,940,910	7,940,910	23,822,730
10	Strategji a Sektoriale e Punësimit dhe Aftësive 2023-2030	9,439,233	9,439,233	9,439,233	28,317,699
11	Strategji a Sektoriale e Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030	23,259,160	23,259,160	23,259,160	69,777,480
12	Strategji a Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030	3,353,686	3,353,686	3,353,686	10,061,058
13	Strategji a e Specializimit Inteligjent (S3) 2025-2030	20,703,321	20,703,321	20,703,321	62,109,963
14	Strategji a Kombëtare e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve 2023-2030	17,081,326	23,457,655	17,557,825	58,096,806
15	Strategji a Sektoriale e Menaxhimit të Financave Publike 2023-2030	3,310,594	3,310,594	3,310,594	9,931,782
16	Strategji a Kombëtare e Zhvillimit të Sipërmarrjes Inovative 2024-2030	262,408	262,408	262,408	787,224
17	Strategji a Ndërsektoriale e Drejtësisë, Plani i Veprimit 2024-2030	638,264	638,264	638,264	1,914,792
18	Dokumenti Politik Kombëtar për Moshimin 2025-2030	1,449,935	1,644,557	1,782,997	4,877,489
19	Dokumenti Politik për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe Plani i Veprimit 2025-2030	119,379	125,363	125,363	370,105
20	Strategji a Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2025-2030 dhe Plani i Veprimit 2025-2027	171,509	171,509	171,509	514,527
21	Strategji a Afatgjatë e Rinovimit të Stokut të Ndërtesave	760,000	760,000	760,000	2,280,000
22	Strategji a Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit 2025-2030	422,446	188,967	128,011	739,424
23	Strategji a Kombëtare për Mospërhapjen e Armëve të Dëmtimit në Masë 2026-2028 dhe Plani i Veprimit	4,000	4,000	4,000	12,000
24	Strategji a Kombëtare Kundër Mashtrimit për Mbrojtjen e Interesave Financiarë të Bashkimit Evropian, 2025-2030 dhe Planit të Veprimit	6,510	6,510	6,510	19,530
25	Strategji a për Modernizimin dhe Harmonizimin e Sistemeve të Informacionit Doganor Shqiptar në Përputhje me Sistemet e Informacionit Doganor të Bashkimit Evropian, për periudhën 2025-2030 dhe të Planit të Veprimit	274,400	196,000	235,200	705,600
27	Strategji a Kombëtare për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2025-2030 dhe të Planit të Veprimit 2025-2028	1,038,151	1,038,151	1,038,151	3,114,452
Strategji të sektoriale që janë akoma në proces dhe që përfundojnë në 2027					
26	Strategji a Kombëtare e Sigurisë Ushqimore 2023-2027	481,088			481,088
27	Strategji a e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2027	21,882,600			21,882,600
28	Strategji a për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve 2021-2027 dhe të Planit të saj të Veprimit	1,200,942			1,200,942
				Totali 000 (ALL)	723,966,621
				Totali 000 (€)	7,387,414

Totali i fondeve të nevojshme për të financuar aktivitetet/masat specifike të strategjive të mësipërme sektoriale të cilat do të kontribuojnë drejtpërdrejtë në realizimin e objektivave specifikë dhe atyre strategjikë kap vlerën e afro 723 miliardë lekëve ose rreth 7,38 mld euro.

D. PRIORITETET POLITIKE TË BASHKIMIT EVROPIAN 2024-2029

Prioritetet e BE-së për ciklin institucional 5-vjeçar janë të përshkruara në Agjendën Strategjike të Këshillit Evropian. Më pas, Komisioni Evropian përcakton prioritetet e tij në Udhëzimet Politike të Presidentit, të cilat janë hapi i parë në funksionalizimin e prioriteteve të BE-së të përshkruara në Agjendën Strategjike.

Pas zgjedhjeve Evropiane në qershor 2024, BE-ja vendosi një sërë prioritetesh që formësojnë agjendën politike dhe atë të politikëbërjes deri në vitin 2029. Ato shërbejnë për të adresuar sfidat kryesore me të cilat përballen BE-ja dhe qytetarët e saj.

Prioritetet derivojnë nga një dialog ndërmjet liderëve të BE-së, ministrave kombëtarë, institucioneve të BE-së dhe grupeve politike të zgjedhura në Parlamentin Evropian. Në qershor 2024, Këshilli Evropian përcaktoi prioritetet e tij në Agjendën Strategjike të BE-së 2024-2029.

-Agjenda Strategjike e BE-së për 2024-2029

Në Agjendën Strategjike 2024-2029, të miratuar nga Këshilli Evropian më, liderët e BE-së përcaktuan 3 fusha prioritare për të udhëhequr punën e institucioneve të BE-së gjatë këtyre 5 viteve. Në vitet e fundit, BE-ja është përballur me shumë kriza, nga lufta kundër ndryshimeve

klimatike deri te pandemia COVID-19 dhe mbështetja e Ukrainës pas agresionit Rus. Duke u fokusuar në fusha të reja prioritare, BE-ja do të ndihmojë që Evropa të jetë më sovrane dhe më e përgatitur për t'u përballur me sfidat e ardhshme.

3 Prioritetet janë:

Një Evropë e lirë dhe demokratike:

- Ruajtja e vlerave evropiane brenda BE-së;
- Mbështetja te vlerat e BE-së në nivel global.

Një Evropë e fortë dhe e sigurt:

- Sigurimin e veprimit të jashtëm koherent dhe me ndikim;
- Forcimin e sigurisë dhe mbrojtjes së BE-së dhe mbrojtjen e qytetarëve të BE-së;
- Përgatitja për një bashkim më të madh dhe më të fortë;
- Ndjekja e një qasjeje gjithëpërfshirëse ndaj migracionit dhe menaxhimit të kufijve.

Një Evropë e begatë dhe konkurruese:

- Duke forcuar konkurrencën e BE-së;
- Duke arritur sukses me tranzicionin e gjelbër dhe atë digjital;
- Promovimi i një mjedisi miqësor ndaj inovacionit dhe biznesit;
- Duke përparuar së bashku.

- Prioritetet e Komisionit Evropian për 2024–2029

Presidenti i Komisionit përcaktoi 7 prioritete (udhëzime politike) për mandatin 2024–2029 të Komisionit Evropian. Ato bazohen në Agjendën Strategjike të Këshillit të BE-së dhe diskutimet me grupet politike të Parlamentit Evropian.

Prioritetet janë:

Një plan i ri për prosperitetin dhe konkurrencën e qëndrueshme të Evropës

Lehtësimi i të bërit biznes për të nxitur rritjen ekonomike, duke mbështetur industritë konkurruese të BE-së dhe duke krijuar vende pune cilësore, duke zhvilluar një ekonomi rrethore dhe elastike që vendos kërkimin dhe inovacionin në qendër dhe përshpejton investimet, duke trajtuar hendeqet e aftësive dhe të punës dhe duke udhëhequr drejt inovacionit të teknologjisë digjitale.

Një epokë e re për Mbrojtjen dhe Sigurinë Evropiane

Duke siguruar që qytetarët evropianë të jenë më të sigurt duke ndërtuar një Bashkim Evropian të Mbrojtjes, duke adresuar të gjitha kërcënimet *online* dhe *offline* dhe duke qenë të përgatitur për të reaguar ndaj krizave. Forcimi i kufijve tanë të përbashkët dhe administrimi i migracionit në mënyrë të drejtë dhe të vendosur.

Mbështetja e njerëzve, forcimi i shoqërive tona dhe modelit tonë social

Mbajtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës që gëzojmë sot në Evropë, duke promovuar drejtësinë sociale në ekonominë moderne, duke forcuar solidaritetin midis qytetarëve duke ribashkuar shoqëritë tona dhe duke mbështetur të rinjtë dhe duke siguruar mundësi të barabarta për të gjithë.

Mbështetja e cilësisë së jetës sonë: Siguria ushqimore, uji dhe natyra

Ndërtimi i një sistemi bujqësor dhe ushqimor konkurrues dhe elastik dhe ruajtja e biodiversitetit për të mbështetur fermerët tanë dhe për të mbrojtur ushqimin tonë të shëndetshëm. Përshtatja dhe përgatitja për një klimë në ndryshim për të qenë gati dhe për të ndihmuar të prekurit.

Mbrojtja e demokracisë sonë, ruajtja e vlerave tona

Mbrojtja e demokracisë dhe rritja e elasticitetit dhe gatishmërisë shoqërore, forcimi i shtetit të së drejtës për një shoqëri të drejtë dhe mirëfunksionale, përkrahja e angazhimit dhe pjesëmarrjes qytetare për të sjellë idetë e qytetarëve në zemër të politikëbërjes.

Një Evropë globale: Duke amplifikuar fuqinë dhe partneritetet tona

Puna për zgjerimin e BE-së për të rritur ndikimin tonë në skenën globale; duke u fokusuar në fqinjësinë tonë më të gjerë për të promovuar paqen, partneritetet dhe stabilitetin ekonomik;

ndjekja e një politike të re ekonomike të jashtme dhe reformimi i sistemit ndërkombëtar për ta bërë atë të përshtatshëm për botën e sotme.

Jetësojmë së bashku objektivat dhe e përgatisim unionin tonë për të ardhmen

Zhvillimi i një buxheti më të thjeshtë dhe me ndikim të BE-së për të ofruar fondet aty ku ato kanë më shumë rëndësi; zbatimin e reformave për të garantuar funksionimin e duhur të një bashkimi më të madh dhe forcimin e partneritetit midis Komisionit Evropian dhe Parlamentit Evropian për të na ndihmuar të jetësojmë objektivat në mënyrë më efektive së bashku.

Për shkak të ndryshimeve në realitetin gjeopolitik gjatë viteve të fundit, prioritetet politike vënë theksin më të madh në rolin e jashtëm të BE-së, veçanërisht në lidhje me mbrojtjen dhe zgjerimin. Politika e jashtme në përgjithësi tani influencon mbi të gjitha fushat e politikave dhe, në rastin e Agjendës Strategjike të Këshillit Evropian, politika e brendshme dhe e jashtme ndërthuren sistematikisht.

Fokusi në sovranitetin dhe sigurinë ekonomike, është një risi në prioritetet politike afatgjata të BE-së. Ndërsa më parë përdorej vetëm në kontekstin e politikave digjitale, fokusi mbi sovranitetin përdoret tani më gjerësisht në sektorë të ndryshëm strategjikë, veçanërisht në mbrojtje, energji, ushqim dhe në politikat ekonomike.

Kjo pasqyron mësimet e nxjerra nga BE-ja nga pandemia COVID-19 dhe lufta në Ukrainë. Një thirrje për sovranitet në këta sektorë strategjikë është përmendur në konkluzione të shumta të Këshillit Evropian gjatë viteve të fundit dhe tani përdoret për herë të parë në prioritetet strategjike afatgjata.

KREU I

1.1 REFORMAT AFATMESME DHE AFATGJATA TË QEVERISË SHQIPTARE

1. Integrimi në Bashkimin Evropian

Procesi i negociatave

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian është synimi politik dhe strategjik i Shqipërisë dhe i sistemeve të saj ligjore, ekonomike dhe institucionale. Procesi i anëtarësimit në BE përfaqëson një mbështetje për demokratizimin e Shqipërisë, konsolidimin e institucioneve dhe të sundimit të ligjit dhe proceseve të vazhdueshme të reformave themelore në drejtim të Bashkimit Evropian dhe anëtarësimit. Qeveria shqiptare në programin e saj qeverisës ka përcaktuar se "*Evropa e Bashkuar është busulla jonë dhe familja natyrale të cilës i përkasim, por ku ende mungojmë*".[1]

Qeveria është e vendosur të kryejë përpjekje të qëndrueshme në lidhje me prioritetet kyçe që kanë të bëjnë me reformën gjyqësore, politikën kundër korrupsionit, luftën kundër krimit të organizuar, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe reformën në administrimin publik (administrata publike në veçanti), të cilat mbeten prioritete edhe në kuadër të procesit të negociatave (sidomos në lidhje me grup-kapitujt themelorë si dhe kapitullin 23 dhe 24).

Me vendimin nr. 424, datë 22.6.2022 u miratua Deklarata Hapëse e Republikës së Shqipërisë, Pozicioni i Përgjithshëm, në kuadër të Konferencës së Parë Ndërqeveritare për Anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Më 19 korrik 2022 u zhvillua Konferenca Ndërqeveritare për negociatat e anëtarësimit me Shqipërinë, ku Shqipërisë iu dha formalisht korniza e përgjithshme dhe kuadri negociues për anëtarësimin.

Komisioni filloi menjëherë procesin e shqyrtimit analitik të *Acquis* të BE-së *(screening),* i cili u kontretizua në 2 faza nëpërmjet: i. takimeve shpjeguese – ku shërbimet e Komisionit Evropian paraqitën zhvillimet e legjislacionit dhe politikave të Bashkimit Evropian, dhe ii. takimet bilaterale – ku pala shqiptare analizon dhe paraqet situatën aktuale ku ndodhet vendi

[1] https://kryeministria.al/wp-content/uploads/2021/10/Programi_Qeverises_2021-2025.pdf

përkundrejt kërkesave të *Acquis* së BE-së, përmes prezantimeve për çështje të ndryshme sipas kapitujve dhe kritereve.

Ky proces intensiv maratonë përgjatë 14 muajve, nga 15 shtatori 2022 deri në 24 nëntor 2023, ku u angazhuan mbi 1,800 zyrtarë publikë, që përfaqësonin 157 institucione shtetërore dhe 32 institucione të pavarura. U zhvilluan 67 takime dypalëshe BE-Shqipëri, ku u prezantuan sipas agjendave të përcaktuara nga Komisioni Evropian 777 prezantime nga pala shqiptare.

Pas përfundimit të procesit të shqyrtimit analitik të *Acquis* me Komisionin Evropian *(screening),* bazuar në letrën e Presidencës Spanjolle datë 30.11.2023, Shqipëria përgatiti dy piketat hapëse të negociatave për grup-kapitullin I "Themelorët":

- Udhërrëfyesi "Shteti i së drejtës"[2]
- Udhërrëfyesi "Reforma në administratën publike"[3]

Piketat hapëse u miratuan me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 736 datë 13.12.2023, "Për miratimin e Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës", si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 737, datë 13.12.2023 "Për miratimin e Udhërrëfyesit për Reformën në Administratën Publike 2023–2030" dhe u dorëzuan zyrtarisht pranë Bashkimit Evropian, nga Republika e Shqipërisë, më datë 13.12.2023.

Gjithashtu, sipas metodologjisë së zgjerimit të Bashkimit Evropian, Republika e Shqipërisë hartoi edhe Udhërrëfyesin "Funksionimi i Institucioneve Demokratike"[4], si një kërkesë e Bashkimit Evropian në këtë metodologji, edhe pse nuk përbën kusht për procesin e negociatave. Ky udhërrëfyes u miratua nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 611, datë 2.10.2024 "Për miratimin e Udhërrëfyesit Për Funksionimin e Institucioneve Demokratike".

Pas marrjes së letrës zyrtare nga Presidenca Hungareze më datë 25.9.2024 mbi dorëzimin e Pozicionit Negociues të Republikës së Shqipërisë për grup-kapitullin I "Themelorët", Këshilli i Ministrave miratoi në datë 2.10.2024. Pozicionin Negociues për grup-kapitullin I "Themelorët", i cili iu përcoll po në këtë ditë Presidencës Hungareze si dhe Komisionit Evropian, me qëllim hapjen e negociatave për grup-kapitullin I.

Pozicioni Negociues trupëzon në mënyrë integrale masat e përcaktuara në piketat hapëse - udhërrëfyesi "Shteti i së drejtës" dhe udhërrëfyesi "Reforma në Administratën Publike", por edhe ato në Udhërrëfyesin "Për Funksionimin e Institucioneve Demokratike", si dhe përcakton masa për përafrimin gradual dhe të plotë për çdo kapitull tjetër të *Acquis* të Bashkimit Evropian, të përfshirë në grup-kapitullin I "Themelorët", drejt përmbushjes së kritereve për anëtarësim, deri në vitin 2030.

Në këtë dokument, Shqipëria ka ndërmarrë gjithashtu reforma dhe masa të domosdoshme për të përmbushur kërkesat dhe standardet evropiane në fushat kyçe për çdo kriter dhe kapitull, si më poshtë:

-Sa i përket Funksionimit të Institucioneve Demokratike, Shqipëria angazhohet që në të ardhmen:

- Të modernizojë procesin zgjedhor, duke zbatuar plotësisht identifikimin biometrik të votuesve dhe numërimin elektronik të votave për të siguruar një proces votimi të saktë dhe transparent;
- Të përmirësojë përfaqësimin gjinor në listat e kandidatëve dhe të sigurojë depolitizimin e komisioneve zgjedhore, duke krijuar, gjithashtu, kushte të favorshme për votimin e diasporës;
- Të thellojë proceset e digjitalizimit të Kuvendit, duke lehtësuar përfshirjen e qytetarëve dhe shoqërisë civile në proceset legjislative përmes konsultimit publik;

---

[2] https://www.qbz.gov.al/eli/vendim/2023/12/13/736/a53e6796-bf25-47e7-b157-0607b1aab777;q=udh%C3%ABrr%C3%ABfyes

[3] https://www.qbz.gov.al/eli/vendim/2023/12/13/737/01303320-3536-4f02-991f-7f59fcde80b3;q=udh%C3%ABrr%C3%ABfyes

[4] https://www.qbz.gov.al/eli/vendim/2024/10/02/611/a556637f-882f-4a0c-9eaa-ac6bbd350ba4;q=udh%C3%ABrr%C3%ABfyes

- Të përmirësojë transparencën në Kuvend përmes përditësimit të Kodit të Sjelljes për Deputetët dhe garantimit të integritetit në takimet me grupet e interesit.

- Sa i përket **kapitullit 23, "Gjyqësori dhe të drejtat themelore"** Shqipëria synon të:

- Sigurojë pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit përmes reformave të vazhdueshme që përmirësojnë cilësinë dhe eficiencën e gjykatave.

-Thellojë strategjitë kundër korrupsionit, duke forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar duke përmirësuar mekanizmat ligjorë për parandalimin dhe ndjekjen penale të korrupsionit.

- Sa i përket **kapitullit 24, "Drejtësia, liria dhe siguria"** Shqipëria është e angazhuar për të:

- Forcuar luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikimit të qenieve njerëzore, përmes bashkëpunimit të vazhdueshëm me agjenci të BE-së, si Europol dhe Frontex.

- Intensifikuar hetimet financiare dhe luftën kundër pastrimit të parave, duke forcuar strukturat e zbatimit të ligjit dhe përmirësuar sistemet e kontrollit të transaksioneve financiare.

- Përmirësuar politikat e migracionit dhe azilit, duke respektuar standardet evropiane dhe duke u angazhuar për një trajtim të drejtë dhe të ligjshëm të azilkërkuesve dhe emigrantëve.

- Sa i përket **"Kriterit ekonomik",** Shqipëria synon të forcojë stabilitetin ekonomik, të forcojë konkurrencën në tregun e brendshëm dhe të përmirësojë klimën e biznesit përmes lehtësirave ligjore dhe rregullatore.

- Sa i përket **kapitullit 5, "Prokurimi publik"** Shqipëria synon të rrisë transparencën në proceset e prokurimit publik, duke përdorur teknologji moderne si inteligjenca artificiale dhe digjitalizimi i plotë të tenderimeve për të minimizuar rreziqet e korrupsionit.

- Sa i përket **kapitulli 18, "Statistikat"** Shqipëria do të vijojë të standardizojë metodologjitë e mbledhjes së të dhënave sipas normave dhe metodologjive ndërkombëtare për të siguruar transparencë dhe besueshmëri.

- Sa i përket **kapitullit 32, "Kontrolli financiar",** Shqipëria angazhohet të vijojë përmirësimin e kontrollit të brendshëm financiar dhe auditimin publik për të rritur llogaridhënien dhe eficiencën e shpenzimeve publike.

Në pozicionin negociues të grup-kapitullit I "Themelorët", **Republika e Shqipërisë e pranon plotësisht dhe angazhohet për përfarimin dhe zbatimin e plotë të *Acquis* së Bashkimit Evropian të grup-kapitullit I "Themelorët", që hyn në fuqi nga data e dorëzimit të Pozicionit Negociues**.

Në këtë kuptim, **Republika e Shqipërisë nuk kërkon të negociojë me Bashkimin Evropian masa/periudha transitore gjithashtu nuk parashikon të paraqesë kërkesa ndaj Bashkimit Evropian për "shmangie" *(derogation)* të mundshme në përafrimin me *Acquis* të BE-së për këtë grupim kapitujsh.**

Pas vlerësimit të Pozicionit Negociues të Shqipërisë, strukturat e Bashkimit Evropian zhvilluan Konferencën e 2-të Qeveritare datë 15.10.2024, për hapjen e negociatave për grup-kapitullin I "Themelorët".

Hapja e negociatave për grup-kapitullin I "Themelorët" është një hap i rëndësishëm që pasqyron angazhimin e vendit për të përmbushur standardet evropiane dhe për të siguruar një të ardhme më të qëndrueshme dhe më të sigurt për qytetarët e tij.

Në vijim të Konferencës së Dytë Ndërqeveritare, nga ana e shërbimeve të Komisionit Evropian u përcoll dokumenti i Qëndrimit të Përbashkët të Bashkimit Evropian i cili shpreh qëndrimin e përgjithshëm në kuadër të Konferencës së Anëtarësimit me Shqipërinë. Dokumenti, i hartuar bazuar në Pozicionin Negociues të Shqipërisë, përcakton **piketat e ndërmjetme si në nivel horizontal për grup-kapitullin I, ashtu edhe në mënyrë të veçantë për kapitullin 23 "Gjyqësori dhe të drejtat themelore" dhe 24 "Drejtësia, liria dhe siguria", por dhe piketa mbyllëse për kapitujt 5 "Prokurimi publik", 18 "Statistikat" dhe 32 "Kontrolli financiar".**

Ky dokument u nënshtrohet parimeve të negocimit të miratuara gjatë kësaj Konference. Asnjë kapitull nuk mund të mbyllet pa përmbushjen e Piketave të Ndërmjetme, të cilat janë kusht për të vijuar më tej me diskutimin mbi Piketat Mbyllëse të grup-kapitullit I.

Në vijimësi të procesit të negociatave gjatë vitit 2024, Shqipëria arriti t'i hapë ato edhe për grup-kapitullin VI "Marrëdhëniet me jashtë".

Në datë 25 nëntor 2024, Presidenca Hungareze e Këshillit të BE-së dërgoi zyrtarisht letrën për paraqitjen e dokumentit të Pozicionit Negociues për grup-kapitullin VI "Marrëdhëniet me jashtë" për çeljen e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian të Republikës së Shqipërisë.

Dokumenti i Pozicionit Negociues të grup-kapitullit VI "Marrëdhëniet me jashtë" u miratua me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 747 datë 4.12.2024, dhe iu përcoll po në këtë ditë Presidencës Hungareze si dhe Komisionit Evropian, me qëllim hapjen e negociatave për grup-kapitullin VI.

Pozicioni Negociues shpreh qëndrimin politik dhe politikbërës, strategjik, por edhe teknik të Republikës së Shqipërisë lidhur me çështjet e përfshira në kapitullin 30 "Marrëdhëniet me Jashtë" dhe kapitullin 31 "Politika e jashtme, siguria dhe mbrojtja", përmes nismave dhe masave që përcakton, si dhe parashikueshmërinë kohore për përmbushjen e tyre, afatet e përafrimit gradual dhe të plotë me *Acquis* të Bashkimit Evropian, bazuar në një analizë të detajuar të situatës ekzistuese të kuadrit strategjik, atij të politikave publike, atij ligjor dhe institucional, të kapaciteteve etj., si dhe sfidat e zbatimit të *Acquis* të BE-së në vendin tonë, duke ofruar një vizion të qartë për procesin e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Republika e Shqipërisë, sa i përket grup-kapitullit VI "Marrëdhëniet me jashtë", nuk ka parashikuar të paraqesë kërkesa ndaj Bashkimit Evropian për "shmangie" *(derogation)* të mundshme të përafrimit të *Acquis* të BE-së.

Në dokumentin e Pozicionit Negociues, Republika e Shqipërisë ka ndërmarrë gjithashtu angazhimet për masa të domosdoshme për të përmbushur kërkesat dhe standardet evropiane në fushat kyçe për çdo kriter dhe kapitull si më poshtë:

- Sa i përket politikës së përbashkët tregtare, Republika e Shqipërisë, nëpërmjet përafrimit të vazhdueshëm me standardet e OBT-së dhe pjesëmarrjes aktive në nismat shumëpalëshe, synon të forcojë lidhjet e saj ekonomike dhe të nxisë rritjen e qëndrueshme të tregtisë. Deri në datën e anëtarësimit në BE. Shqipëria është e angazhuar që në kontekstin shumëpalësh dhe dypalësh të jetë në përputhje me qëndrimin e BE-së në politikën e përbashkët tregtare.

- Sa u përket rregullave specifike të tregtisë, në lidhje me kontrollet e eksporteve me përdorim të dyfishtë, Republika e Shqipërisë është e angazhuar për të harmonizuar kuadrin e saj legjislativ dhe rregullator me *Acquis* të BE-së për transferimin ndërkombëtar të mallrave me përdorim të dyfishtë.

- Sa u përket investimeve, Republika e Shqipërisë është e angazhuar të rrisë përpjekjet e saj në tri fusha kryesore:

- në tërheqjen e investitorëve që kryejnë investime me përfitime të konsiderueshme ekonomike dhe kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm;
- në rritjen e përpjekjeve për t'u angazhuar me investitorët potencial dhe për të zgjeruar programet ekzistuese, duke synuar të tërheqë dhe mbajë një spektër më të gjerë investimesh; dhe
- të përmirësojë bazat e Investimeve të Huaja Direkte (IHD-ve), duke përditësuar dhe modernizuar kuadrin ligjor për të krijuar një mjedis më të favorshëm për investime.

- Politika humanitare: Angazhimi për krijimin e një strukture formale të dedikuar për ndihmën humanitare, duke krijuar një njësi të specializuar, duke caktuar një buxhet të dedikuar,

duke zhvilluar një strategji gjithëpërfshirëse të ndihmës humanitare dhe duke vendosur protokolle të qarta për koordinim dhe bashkëpunim.

- Sa u përket institucioneve dhe proceseve vendimmarrëse, Republika e Shqipërisë do të rrisë më tej angazhimin e saj në Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë të Bashkimit Evropian (CFSP), duke kontribuar në takimet e Këshillit të BE-së të Çështjeve me Jashtë (FAC) dhe takimet e Shërbimit Evropian të Veprimit të Jashtëm (EEAS) – Ballkani Perëndimor në nivele të larta zyrtare. Republika e Shqipërisë do të vazhdojë të zbatojë vendimet e Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë të Bashkimit Evropian (CFSP) për masat kufizuese nëpërmjet vendimeve zyrtare të Këshillit të Ministrave, duke siguruar që sanksionet dhe masat kufizuese të BE-së të zbatohen me saktësi brenda vendit.

Dialogu politik, Republika e Shqipërisë angazhohet të ketë një dialog politik me partnerë të ndryshëm ndërkombëtarë, në përputhje me prioritetet e politikës së jashtme dhe objektivat strategjikë.

Politika e përbashkët e jashtme dhe e sigurisë, Republika e Shqipërisë është gjithashtu e përkushtuar të përafrohet me kornizat ndërkombëtare të mospërhapjes dhe të adoptojë praktikat më të mira të BE-së për zbatimin dhe vlerësimin efektiv të masave kufizuese. Ky përafrim me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë të BE-së (CFSP) pasqyron përpjekjet e vazhdueshme të Shqipërisë për të rritur rolin e saj në sigurinë rajonale dhe globale dhe për të siguruar përputhjen me standardet ndërkombëtare të sanksioneve.

Politika e përbashkët e sigurisë dhe e mbrojtjes, Republika e Shqipërisë është thellësisht e angazhuar në bashkëpunimin ndërkombëtar të mbrojtjes për ruajtjen e interesave kombëtare dhe për të promovuar paqen dhe stabilitetin global.

Pas vlerësimit të Pozicionit Negociues të Shqipërisë më datë 17 dhjetor 2024, u zhvillua Konferenca e 3-të Ndërqeveritare për hapjen e grup-kapitullit VI "Marrëdhëniet me jashtë". Kjo konferencë rikonfirmon angazhimin serioz të të gjitha institucioneve tona, si dhe vërteton vullnetin politik për të qenë pjesë e familjes evropiane.

Pas zhvillimit të dy konferencave ndërqeveritare, dhe hapjen e 7 kapitujve dhe 3 kritereve, vijon procesi për përgatitjes së draftpozicioneve negociuese edhe për 4 grup-kapitujt e tjerë me synimin ambicioz për hapjen e tyre brenda vitit 2025.

Progresi i reformave themelore të integrimit

Komisioni Evropian, publikoi më datë 30 tetor 2024[5] Raportin për Shqipërinë për vitin 2024, ku vlerëson se "Në Shqipëri, autoritetet kanë deklaruar vazhdimisht angazhimin e vendosur politik për integrimin në BE si prioritetin strategjik të vendit dhe kanë ruajtur një nivel të lartë ambicie për të ecur përpara në negociatat e anëtarësimit. **Shqipëria ka vazhduar të bëjë progres në reformat nën grup-kapitullin I "Themelorët", veçanërisht në reformën gjithëpërfshirëse në drejtësi dhe procesin e rivlerësimit kalimtar**, përfundimi i të cilit është i pashmangshëm, nëpërmjet rezultateve të mira në çështjet antikorrupsion, duke rritur kapacitetet e saj në hetimet financiare kundër krimit të organizuar. Angazhimi aktiv i Shqipërisë gjatë mandatit të saj si anëtare jo e përhershme në Këshillin e Sigurimit të OKB-së deri në fund të vitit 2023, si dhe të dhënat e saj të përafrimit të plotë me politikën e përbashkët dhe të jashtme të sigurisë së BE-së, dëshmojnë për zgjedhjen e saj strategjike për anëtarësimin në BE dhe rolin e një partneri të besueshëm ndërkombëtar...".

Gjithashtu, në raport Komisioni rikonfirmon mbështetjen në rrugëtimin e vendit drejt anëtarësimit në BE "...Qeveria shqiptare sinjalizoi objektivin e saj për mbylljen e negociatave të anëtarësimit deri në fund të vitit 2027 dhe Komisioni është i gatshëm ta mbështesë këtë objektiv ambicioz. Për këtë qëllim, është thelbësore që autoritetet të shtojnë ritmin e reformave të orientuara nga BE-ja, veçanërisht në shtetin e së drejtës, duke konsoliduar historikun në zbatimin e ligjit, në luftimin efektiv të korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe në promovimin

[5] https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024_en

e të drejtave themelore, përfshirë lirinë e medias, të drejtave pronësore dhe pakicave". Komisioni ka vlerësuar linjëzimin e plotë ka Shqipëria ka arritur në politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të BE-së. Gjatë mandatit të saj si një anëtare jo e përhershme e Këshillit të Sigurimit të OKB-së ndërmjet viteve 2022 dhe 2023, Shqipëria u angazhua në mënyrë aktive si bashkëmbajtëse e rezolutave që dënojnë luftën e agresionit të Rusisë kundër Ukrainës, në përputhje me qëndrimin e BE-së, duke përfshirë masat kufizuese dhe sanksionet kundër Rusisë. Qëndrimi i Shqipërisë dërgon një sinjal të fortë për zgjedhjen strategjike të anëtarësimit në BE dhe për rolin e saj si një partner i besueshëm.

Reforma e sistemit të drejtësisë dhe çdo veprim i ndërmarrë nga Qeveria në funksion të sundimit të ligjit ka për qëllim përfundimtar krijimin e një sistemi gjyqësor të pavarur, efikas dhe llogaridhënës në Shqipëri, i cili është në gjendje të ofrojë drejtësi në mënyrë të drejtë dhe transparente, si dhe për të zbatuar legjislacionin e përafruar me *Acquis* e BE-së. Strukturat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar janë ngritur dhe janë funksionale.

Miratimi i **Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës 2023–2030** është një përpjekje kyçe e qeverisë për konsolidimin e mëtejshëm të arritjeve të reformës në fushën e gjyqësorit në mënyrë të qëndrueshme dhe konsistente, që synon që të rrisë më tej pavarësinë, llogaridhënien, cilësinë dhe efikasitetin e drejtësisë. Ky Udhërrëfyes planifikon vazhdimin më me intensitet të kryerjes së kontrolleve të rregullta të përshtatshmërisë ligjore si dhe miratimin e ndryshimeve ligjore të nevojshme për konsolidimin, pavarësinë, integritetin, efikasitetin dhe rritjen e besimit të qytetarëve, në përputhje me *Acquis* të BE-së dhe standardet evropiane duke përforcuar në vazhdimësi parimet e reformës se vitit 2016.

Sistemi gjyqësor ka shënuar përmirësime të rëndësishme, duke filluar me përzgjedhjen e plotë të anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të cilët tashmë funksionojnë me strukturat e tyre të plota dhe me drejtues të rinj. Procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve ka arritur një rezultat të jashtëzakonshëm, me 99.9% të çështjeve të përfunduara. Njëkohësisht, janë hedhur hapa të rëndësishëm për digjitalizimin e drejtësisë, përmes zhvillimit të një Sistemi të Menaxhimit të Çështjeve, i cili synon modernizimin e gjykatave. Për më tepër, janë hartuar strategji të reja ndërsektoriale, si ajo për drejtësinë dhe kundër korrupsionit për periudhën 2024–2030, duke përfshirë konsultime të gjera publike. Ndryshimet në rregulloren e Shkollës së Magjistraturës, në përputhje me standardet më të larta të BE-së, sigurojnë një proces më të drejtë dhe më cilësor për pranimet.

Udhërrëfyesi për "Funksionimin e Institucioneve Demokratike", i miratuar nga Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 611, datë 2 tetor 2024, përcakton masat për përmirësimin e funksionimit demokratik të institucioneve në Shqipëri. Një arritje kyçe deri më tani në zbatimin e tij është miratimi i ndryshimeve në Kodin Zgjedhor në korrik 2024, të cilat mundësojnë votimin e shtetasve shqiptarë që banojnë jashtë vendit, duke përmbushur një detyrim të përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese. Ky zhvillim përfaqëson një hap të rëndësishëm në forcimin e pjesëmarrjes demokratike dhe përfshirjen e diasporës në proceset vendimmarrëse.

Përparim është arritur edhe në **Reformën në Administratën Publike** dhe zbatimin e kuadrit strategjik dhe atij ligjor. Vlerësimi periodik rajonal i kryer në vitin 2024 nga OECD/SIGMA mbi performancën e administratës publike, si monitorimi më reputativ i fushës, rikonfirmon performancën e Shqipërisë si lider rajonal në funksionimin e administratës publike në disa fusha tematike, duke përfshirë menaxhimin e financave publike, shërbimin publik dhe menaxhimin e burimeve njerëzore dhe zhvillimin dhe koordinimin e politikave. Në total, Shqipëria shënon vlera më të larta se mesatarja rajonale për 5 nga 6 parimet e administratës publike, mbi bazën e të cilave kryhet vlerësimi.[6]

[6] Parimet e OECD/SIGMA për Administratën Publike janë:
a) Kuadri Strategjik;
b) Zhvillimi dhe koordinimi i politikave;
c) Shërbimi Civil dhe Menaxhimi i Burimeve Njerëzore;



Në pjesën e strategjive të fushës së RAP-së (PAR), 5 (pesë) Strategjitë janë miratuar nga Këshilli i Ministrave; Strategjia Ndërsektoriale e Decentralizimit dhe Qeverisjes Vendore 2023–2030, Agjenda Digjitale 2022–2026, Strategjia për Menaxhimin e Financave Publike 2023–2030; Strategjia Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2025-2030 dhe Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024–2030, kjo e fundit i përket grup dokumenteve strategjikë të rëndësisë se veçantë, miratimi i të cilit është kusht për avancimin e reformës në fushën e luftës kundër korrupsionit në vlerësimin e raportit *Screening* për grup-kapitullin e parë, si dhe Raportit Vjetor të Komisionit Evropian, si dhe mbetet kyç në avancimin e zbatimit të Agjendës së Reformave në kuadër të Planit të Rritjes 2024–2027, ndërsa Strategjia Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2025–2030, Plani i veprimit 2025–2027 dhe pasaporta e indikatorëve është miratuar me vendimin nr. 472, datë 31.7.2025, të Këshillit të Ministrave. Të gjitha strategjitë e reja në fushën e Reformës në Administratën Publike kanë kohëzgjatje deri në vitin 2030, në harmonizim të plotë me agjendën kombëtare për integrimin evropian. Kostimi i të gjitha strategjive aplikohet në bazë të metodologjisë së buxhetit afatmesëm dhe afatshkurtër që parasheh kostimin e aktiviteteve, rezultateve dhe objektivave të programeve buxhetore.

Përmes vendimit nr. 522 të Këshillit të Ministrave, datë 25.9.2025, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin", u rikonfirmua pozicioni i Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin. Konfigurimi i kabinetit qeveritar me pozicionin e Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, i cili njëkohësisht ushtron edhe kompetencat e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, konsiderohet gjithashtu një dëshmi e vëmendjes së shtuar ndaj prioriteteve të deklaruara, në drejtim të luftës kundër korrupsionit për të sinergjizuar punën e institucioneve të ekzekutivit në raport me politikat antikorrupsion të qeverisë dhe zbatuar të gjitha zotimet, në përputhje me standardet më të larta të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies.

Krahas pasjes së rolit të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, ky funksion udhëheq edhe angazhimin qeveritar për:

---

d) Organizimi, llogaridhënia dhe mbikëqyrja;
e) Shërbimet publike dhe digjitalizimi;
f) Menaxhimi i Financave Publike.

- Zbatimin e parimeve të qeverisjes së mirë, dhe
- Udhëheqjen dhe koordinimin e punës për propozimin e akteve dhe politikave për menaxhimin, energjezimin dhe trajnimin e burimeve njerëzore të administratës publike.

Në vlerësimin e fundit të vitit 2024, OECD/SIGMA e vlerëson emërimin e Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin si një tregues të qartë të përkushtimit të Qeverisë Shqiptare për garantimin e drejtimit politik të Reformës në Administratën Publike.

Udhërrëfyesi për Reformën në Administratën Publike 2023–2030 është miratuar nga Qeveria Shqiptare në Dhjetor 2023, si piketë hapëse e grup-kapitujve I "Themelorët", në kuadër të negociatave për anëtarësim në BE. Udhërrëfyesi shërben si dokumenti kyç udhëheqës i prioriteteve për politikat shtetërore dhe masat në nivel ligjor dhe rregullator që do të duhet të ndërmerren deri në vitin 2030 për avancimin e Reformës në Administratën Publike drejt përafrimit me standardet evropiane. Mes parimeve kryesore që karakterizojnë masat e parashikuara në Udhërrëfyes janë garantimi i harmonizimit midis planifikimit të buxhetit dhe politikave publike, mirëpërcaktimi, monitorimi dhe vlerësimi i objektivave të politikave, transparenca dhe qëndrueshmëria e planifikimit të financave publike, si edhe zhvillimi i politikave publike përmes një procesi të hapur, të bazuar në evidenca dhe analiza solide, koherente dhe të mirëkoordinuara në të gjitha nivelet e qeverisjes. Përmes këtyre masave të ndërmarra në kuadër të agjendës kombëtare për integrimin evropian, synohet ngritja në një nivel të ri të performancës së qeverisjes së integrimit evropian për "Themelorët" drejt përafrimit me standardet evropiane.

Gjashtë institucione themelore përbëjnë **Qendrën e Qeverisjes** *(Centre of Government):* Zyra e Kryeministrit, Agjencia Shtetërore për Programimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndihmës, Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministri i Shtetit dhe Kryenegociator dhe Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin. Komiteti i Planifikimit Strategjik (KPS) drejtohet nga Kryeministri dhe përfshin ministrat si anëtarë. Ai drejton procesin e reformave dhe merr vendime.

Strategjia Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike (SNRAP) 2025-2030 u miratua në korrik 2025, duke përmbyllur një proces gjithëpërfshirës dyvjeçar pune me një vizion të qartë afatgjatë, prioritete të strukturuara dhe të bazuar në një proces të konsoliduar konsultimi publik. Me miratimin e saj, Shqipëria tashmë ka në fuqi një kornizë të plotë dhe të konsoliduar të reformës në administratën publike, në koherencë me strategjitë për Menaxhimin e Financave Publike, Decentralizimin, Antikorrupsionin dhe Agjendën Digjitale. Strategjia, e shoqëruar nga Plani i Veprimit 2025–2027 dhe Pasaporta e Treguesve, u miratua zyrtarisht me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 472, datë 31.7.2025, është në fuqi dhe e botuar në Fletoren Zyrtare.

Kjo paketë strategjike përcakton vizionin afatgjatë për modernizimin dhe fuqizimin e plotë të administratës publike, me synim përgatitjen e saj për kërkesat e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Angazhimet e saj janë plotësisht të harmonizuara me kuadrin e strategjive të tjera ndërsektoriale në fuqi, me kuadrin kombëtar të integrimit evropian dhe me angazhime të tjera ndërkombëtare, përfshirë Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE) dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ).

Në mënyrë thelbësore, Strategjia, Plani i saj i Veprimit dhe Pasaporta e Treguesve reflektojnë dhe harmonizohen me angazhimet e marra nga autoritetet shqiptare në Udhërrëfyesin për Reformën në Administratën Publike 2023–2030, si dhe adresojnë gjetjet dhe rekomandimet e vlerësimit më të fundit të OECD/SIGMA mbi "Parimet e Administratës Publike në Shqipëri", të zhvilluar gjatë periudhës shkurt–tetor 2024. Ky proces vlerësimi përbënte edhe arsyen kryesore për shtyrjen e miratimit të paketës strategjike nga viti 2024 në vitin 2025.

Strategjia strukturohet rreth fushave kryesore të mëposhtme:

- Menaxhimi i burimeve njerëzore mbi bazën e meritës, duke garantuar procese transparente dhe objektive për rekrutimin, promovimin dhe vlerësimin e performancës.

- Transformimi digjital, përmes përdorimit sistematik të mjeteve digjitale që rrisin aksesueshmërinë, eficiencën dhe përfshirjen në ofrimin e shërbimeve publike.

- Transparenca dhe llogaridhënia, përmes forcimit të mekanizmave të integritetit, qartësimit të kuadrit të remunerimit, rregullave më të forta për konfliktin e interesit dhe garancive gjithëpërfshirëse kundër korrupsionit.

- Shërbime të orientuara drejt qytetarit, duke lidhur performancën e ofrimit të shërbimeve me kënaqësinë e qytetarëve dhe mekanizma të strukturuar *feedback*-u.

- Monitorim i fuqishëm dhe menaxhim adaptiv, përmes instrumenteve të vlerësimit në kohë reale që mundësojnë përshtatje të politikave mbi bazë evidencash.

- Administratë e Gjelbër Publike, duke integruar qëndrueshmërinë në planifikimin dhe funksionimin e sektorit publik."

Në vitin 2024 Këshilli i Ministrave miratoi paketën e re strategjike kundër korrupsionit, e cila përfshin **Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024–2030** dhe Planin e veprimit 2024-2026, së bashku me Pasaportën e Indikatorëve. Si një nga 5 strategjitë përbërëse të kuadrit gjithëpërfshirës strategjik të Reformës në Administratën Publike, dhe njëherësh si një nga dokumentet kyçe për koordinimin e politikave për thellimin e luftës kundër korrupsionit. Përmes masave dhe aktiviteteve të parashikuara, strategjia e re adreson gjetjet dhe rekomandimet e raporteve të vlerësimit për Shqipërinë të identifikuara nga Komisioni Evropian, GRECO dhe vlerësime të organizatave lokale. Strategjia 2024–2030 ruan të njëjtën strukturë organizimi në tri Qëllime Politikash në përputhje me 3 qasjet e mirëkonsoliduara të luftës kundër korrupsionit: i. Parandalimi; ii. ndëshkimi; dhe iii. edukimi e ndërgjegjësimi për luftën kundër korrupsionit.

Risitë kryesore të paketës strategjike synojnë thellimin e luftës kundër korrupsionit në drejtimet e mëposhtme:

Kryerja e vlerësimeve të riskut me synim parandalimin e korrupsionit në sektorë me rrezik të lartë korrupsioni, si të drejtat pronësore, tatimet, doganat, shëndetësia, arsimi dhe prokurimi publik. Këta sektorë janë identifikuar bazuar në gjetjet e Raporteve të Progresit Vjetor dhe të Raportit të Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit për Grup-Kapitujt e Themelorëve;

Rishikimi i legjislacionit kombëtar me synim përafrimin me *Acquis* të BE-së dhe standardet evropiane të kuadrit ligjor për konfliktin e interesit, sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, lobimin, financimin e partive politike dhe luftën kundër përfshirjes së zyrtarëve të huaj në ryshfet në transaksionet ndërkombëtare;

Forcimi i mekanizmave për parandalimin e korrupsionit në qeverisjen vendore;

Thellimi i partneritetit me sektorin privat për promovimin e integritetit dhe rritje të ndërgjegjësimit dhe bashkëveprimit proaktiv të grupeve të ndryshme shoqërore në luftën kundër korrupsionit;

Investimi i shtuar për edukimin e të rinjve për integritetin dhe sundimin e ligjit;

Forcimi i strukturave ligjzbatuese me synim krijimin e një historiku të fortë për hetimin, ndjekjen penale, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive që lidhen me korrupsionin;

Përmirësimi i koordinimit ndërinstitucional në luftën kundër korrupsionit.

Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024–2030 dhe Plani i veprimit 2024–2026 (i pari në zbatim të saj) ka një kosto prej ALL 1.033 miliardë, për zbatimin e masave dhe aktiviteteve të parashikuara për periudhën 3-vjeçare 2024–2026, të cilat do të kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në realizimin e objektivave specifikë dhe atyre strategjikë të DPP-së për vitet 2027–2029.

Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike 2023–2030 dhe Plani i veprimit 2023-2026 është hartuar dhe miratuar me vendimin nr. 390, datë 12.6.2024, të Këshillit të Ministrave. Ky dokument merr në konsideratë zhvillimet dhe progresin e rezultuar nga zbatimi

i strategjisë së MFP 2019-2022, reformat përkatëse të kryera, si dhe adreson mangësitë e identifikuara gjatë zbatimit dhe monitorimit të strategjisë dhe sfidat e hasura. Strategjia ka marrë në konsideratë edhe gjetjet dhe rekomandimet e raporteve të vlerësimit në fushën e financave publike, si ato kombëtare ashtu edhe ato ndërkombëtare. Në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030, qëllimi i përgjithshëm i strategjisë është të krijojë një sistem të menaxhimit të financave publike që garanton transparencë, llogaridhënie, disiplinë fiskale, efikasitet dhe barazi në përdorimin e burimeve publike për ofrimin e shërbimeve publike të përmirësuara dhe zhvillimit ekonomik që të sigurojë një integrim të lehtë dhe të shpejtë të Shqipërisë në Bashkimin Evropian (BE). Masat e reformës së MFP-së janë formuluar në gjashtë shtylla: 1.: Programimi Makroekonomik dhe Monitorimi i Riskut; 2.: Planifikimi i integruar strategjik dhe buxhetor, monitorimi dhe raportimi transparent; 3.: Menaxhimi dhe mobilizimi i të ardhurave; 4.: Kontabiliteti dhe Menaxhimi i Zbatimit të Buxhetit; 5.: Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik; 6.: Mbikëqyrja e Jashtme".

Strategjia Kombëtare e Migracionit 2024–2030 dhe Plani i saj i veprimit 2024–2026 është miratuar nga Qeveria Shqiptare në Maj 2024. Ajo siguron një kornizë të plotë për qeverisjen e duhur të migracionit në vend, deri në vitin 2030, duke adresuar edhe detyrimet e procesit të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Dokumenti strategjik përbëhet nga katër qëllime kryesore politike, që janë: i. Garantimi i qeverisjes strategjike të migracionit në Shqipëri; ii. Zhvillimi i politikave të efektshme për migracionin për motive punësimi duke rritur ndikimin pozitiv të migracionit te zhvillimi socio-ekonomik kombëtar/lokal; iii. Promovimi i migracionit të rregullt, mbrojtja e të drejtave të migrantëve dhe integrimi i tyre në shoqërinë shqiptare; iv. Forcimi i sistemit të mbrojtjes ndërkombëtare, garantimi i të drejtave të azilkërkuesve dhe refugjatëve dhe ofrimi i zgjidhjeve të qëndrueshme."

Fusha e prokurimit publik në Shqipëri është vlerësuar me nota të larta në treguesit përkatës duke marrë vlerësim maksimal sa i takon cilësisë së kuadrit ligjor në fushën e prokurimit, kapaciteteve institucionale në nivel qendror për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave në fushën e prokurimit në mënyrë efektive dhe eficiente, si dhe sistemit të shqyrtimit të ankesave.

Strategjia kombëtare për prokurimin publik 2024–2030, si dhe plani i veprimit për zbatimin e saj 2024–2027, të miratuara me vendimin nr. 304, datë 22.5.2024, të Këshillit të Ministrave, janë në koherencë të plotë me objektivat ndërkombëtarë për zhvillim të qëndrueshëm, me kuadrin ligjor të BE-së në këtë fushë si dhe me angazhimet e ndërmarra nga pala shqiptare në takimet bilaterale me BE.

Qëllimi kryesor i kësaj Strategjie është garantimi i një sistemi prokurorimi eficient dhe efektiv në përputhje me parimet e transparencës, konkurrencës së lirë dhe të ndershme, mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë, duke promovuar dhe nxitur një sistem të qëndrueshëm që garanton vlerën për para *(value for money)*.

Risia që planifikon të sjellë qeveria shqiptare në fushën e prokurimeve publike është dizajnimi dhe implementimi i një sistemi dinamik te blerjeve. Do të krijohet një sistem i informatizuar që nëpërmjet Inteligjencës Artificiale do zhvillojë procedurat dhe shpalljen e fituesit të një tenderi. Kjo do të jetë mënyra e re e funksionimit të prokurimeve publike duke rritur ndjeshëm nivelin e transparencës dhe integritetin e sistemit të prokurimeve publike.

Procesi i integrimit evropian i jep shtysë arritjes së të gjithë Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, pjesë e Agjendës 2030 dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë lidhet me realizimin e Objektivit 16: "Promovimi i shoqërive paqësore dhe përfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrim i aksesit në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet" dhe synimit 16.6 "Zhvillimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe transparente në të gjitha nivelet".

2. Plani i ri i Rritjes, Instrumenti për Reforma dhe Rritje dhe Agjenda e Reformave

Komisioni Evropian, më 8 nëntor të vitit 2023, publikoi **Planin e ri të Rritjes për Ballkanin Perëndimor**. Synimi i Planit të ri të Rritjes është për të nxitur rritjen ekonomike dhe për të përshpejtuar konvergjencën socio-ekonomike të vendeve të Ballkanit Perëndimor, të cilat kanë një hendek të dallueshëm konvergjence krahasuar me vendet anëtare të BE-së. Objektivi kryesor i Planit të Rritjes, përveç reduktimit të pabarazisë me vendet e BE-së, është t'u mundësojë vendeve të Ballkanit Perëndimor të nxisin reformat dhe investimet për të përshpejtuar ndjeshëm shpejtësinë e procesit të anëtarësimit dhe zhvillimin e rritjes së tyre ekonomike. Kjo iniciativë e re zhvillimore ofron mundësinë për mbështetje financiare deri në 6 miliardë euro, për periudhën 2024–2027, për të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor si dhe mundësinë e integrimit të përshpejtuar në Tregun e Vetëm Evropian, në disa drejtime, edhe para anëtarësimit.

Plani i Rritjes për Ballkanin Perëndimor bazohet në katër shtylla: **a) rritja e integrimit me tregun e vetëm të BE-së; b) nxitja e integrimit ekonomik rajonal, bazuar në rregullat dhe standardet e BE-së, duke zbatuar plotësisht Planin ekzistues të Veprimit të Përbashkët të Tregut Rajonal; c) përshpejtimi i reformave themelore, duke përfshirë grupimin e parë themelor, mbështetja e rrugës së Ballkanit Perëndimor drejt anëtarësimit në BE, përmirësimi i rritjes së qëndrueshme ekonomike** duke përfshirë tërheqjen e investimeve të huaja dhe forcimin e stabilitetit rajonal; dhe **d) krijimi e një instrumenti të ri financimi: Faciliteti i Reformave dhe Rritjes (Faciliteti) për Ballkanin Perëndimor** (miratuar më 14 maj 2024, nëpërmjet Rregullores 2024/1449 të Bashkimit Evropian dhe Vendimit Zbatues të Komisionit Evropian 23.10.2024).

Objektivat e Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor synojnë integrimin e shpejtë të vendeve kandidate në Bashkimin Evropian, nëpërmjet zbatimit të iniciativave dhe reformave (në kuadër edhe të zbatimit të planit të veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal), të cilat do t'u japin gradualisht akses vendeve të Ballkanit Perëndimor të bëhen pjesë e Tregut të Vetëm të Bashkimit Evropian, edhe para anëtarësimit.

Instrumenti "Faciliteti për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor" mbështet shtyllën e tretë dhe të katërt të Planit të Ri të Rritjes së Bashkimit Evropian. Ky Instrument do të ofrojë nxitje kyçe për zbatimin e Reformave të Rritjes, përmes mbështetjes financiare e cila do të mbulojë periudhën 2024–2027 dhe do të ofrojë asistencë financiare në formën e mbështetjes së pakthyeshme (deri në 2 miliardë euro) dhe kredive (deri në 4 miliardë euro) për të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, përmes disbursimit direkt në buxhetet kombëtare, dhe ose si financim i investimeve kapitale përmes Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor (WBIF).

Dokumenti i politikës "Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027" për Shqipërinë është miratuar me vendimin nr. 621, datë 10.10.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Dokumentit të Politikës "Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027", në kuadër të Instrumentit të Bashkimit Evropian "Faciliteti për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor", pas një konsultimi të gjerë me Komisionin Evropian, institucionet shqiptare, grupet e interesit dhe shoqërinë civile.

Agjenda Kombëtare e Reformave (AKR) 2024–2027 është një agjendë e përmbledhur reformash e masash (31 reforma) për të krijuar mjedisin e nevojshëm për transformimin ekonomik dhe integrimin e vendit, ndërsa prioritetet e reformave të përcaktuara janë në përputhje me drejtimet prioritare që përcakton Plani i Ri i Rritjes për Ballkanin Perëndimor, në përputhje me Programin Ekonomik të Reformave (ERP) 2024-2026, me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2021–2030, me S3, si edhe me një serë dokumentesh kombëtare strategjike për vendin. Ky dokument i politikës mikse do të shërbejë edhe si instrument plotësues për detyrimet e lindura nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit midis Shqipërisë dhe Komisionit Evropian dhe veçanërisht ato gjatë AKR 2024-2027 është dokumenti kryesor që shërben si bazë për planifikimin, hartimin dhe zbatimin e një sërë masave

ligjore (që përafrojnë *Acquis* të Bashkimit Evropian), administrative (që forcojnë kapacitete dhe aftësi) dhe investime, në kuadër të Planit të Ri të Rritjes për vendet e Ballkanit Perëndimor.

Qëllimi kryesor i AKR 2024-2027 është çlirimi i potencialit ekonomik të vendit, përmes stimulimit të transformimit ekonomik dhe përmirësimit të klimës së biznesit, për të hyrë gradualisht dhe i përgatitur në Tregun e Vetëm të BE-së, përmes forcimit të shtetit të së drejtës, me progres të vazhdueshëm në integrimin e përshpejtuar, konsolidimin dhe efikasitetin e reformave, dhe ecjes së qëndrueshme përpara në përmbushjen e kritereve të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Synimi kryesor i i AKR 2024–2027 është mbështetja e objektivit të dyfishimit të rritjes ekonomike në Shqipëri, nëpërmjet konsolidimit të ndryshimeve strukturore të ekonomisë dhe modernizimit të saj, përmes avancimit të teknologjisë dhe digjitalizimit, me burim të çmuar kapitalin human, dhe në bazat e qëndrueshme të reformave për shtetin e së drejtës.

Prioritetet kryesore të Reformave për Agjendën Kombëtare të Reformave 2024–2027 (miratuar më 23 tetor edhe me Vendim Zbatues të Komisionit Evropian) **janë organizuar sipas politikave** prioritare.

I. Klima e biznesit (6 reforma)

Shtylla e parë e politikës fokusohet në konsolidimin e reformave që mundësojnë e mbështesin transformimin e mëtejshëm të Shqipërisë në një ekonomi të qëndrueshme dhe konkurruese, e drejtuar nga qeverisja ekonomike transparente, infrastruktura ekonomike efikase dhe një kuadër ligjor i favorshëm për tërheqjen e investimeve dhe rritjen e eksporteve, që përputhet me *Acquis* dhe praktikat më të mira të Bashkimit Evropian.

Shtylla I përfshin disa iniciativa reformuese që nxisin një klimë biznesi edhe më konkurruese dhe tërheqëse, përmes një kornize kohezive dhe mbështetëse për zhvillimin ekonomik, si më poshtë vijon:

1. Forcimi i administrimit tatimor dhe i kuadrit strategjik për sistemin dhe politikat tatimore, përmes miratimit të strategjisë afatmesme për të ardhurat, zbatimin e masave konkrete të strategjisë për forcimin e administrimit tatimor.

2. Përmirësimi i transparencës dhe efikasitetit të shërbimeve të kadastrës, për qytetarët dhe bizneset, përmes kryerjes së regjistrimit fillestar në 95% të zonave dhe përfundimit të digjitalizimit 100% të kartelave të pasurive të paluajtshme, forcimit të kuadrit strategjik të politikës së tokës (Udhërrëfyesi dhe Politika e Tokës, dhe Plani i Integritetit të Kadastrës).

3. Përmirësimi i tërheqjes dhe transparencës së investimeve, përmirësimi i drejtimit të shoqërive shtetërore publike, si dhe miratimi i kuadrit ligjor për PPP/koncesionet sipas standardeve të BE dhe aktet nënligjore, ngritjes dhe operacionalizimit të një autoriteti të pavarur, nga ana operacionale, të ndihmës shtetërore, përfshirjen në bordet e shoqërive shtetërore publike të anëtarëve të pavarur dhe procedurave transparente e proceseve të rekrutimit të bazuar në merita.

4. Përmirësimi i tërheqjes dhe transparencës së investimeve të huaja direkte dhe në përgjithësi i klimës të biznesit, përmes derregullimit dhe modernizimit të shërbimeve ndaj biznesit, nëpërmjet masave që lidhen me miratimin e ligjeve të unifikuara për investimet, kuadrit ligjor për inspektimet, përmirësimit të raportimit për bizneset, miratimit të planit të veprimit për rritjen në renditjen e OECD Policy SME Index.

5. Përmirësimi i eficiencës së transportit përmes Sistemeve Inteligjente të Transportit (SIT) dhe E-transporti, për lehtësimin e tregtisë me BE, duke përafruar legjislacionin kombëtar me direktivat e BE-së për informacionin elektronik të transportit të mallrave; ratifikimit të protokollit të Konventës së UN për transportin e mallrave; miratimit të legjislacionit përkatës për kornizat dhe standardet e Sistemeve Inteligjente të Transportit në transportin rrugor dhe hekurudhor.

6. Promovimi i eksportit dhe ndërkombëtarizimi i ndërmarrjeve, përfshirë lehtësimin e eksporteve dhe tregtisë dhe mbështetjen e zinxhirit të vlerës me BE-në; zbatimi i Udhërrëfyesit mbi Korsitë e Gjelbra /Programi i Lehtësimit të Tregtisë dhe Transportit dhe Programi i Nxitjes së Eksporteve; Rritja e peshës së eksporteve ndaj PBB-së në vlerë neto 40%; Ligjet në fushën e bujqësisë dhe sigurisë ushqimore.

II. Kapitali njerëzor (6 reforma)

Shtylla e dytë fokusohet në zhvillimin e kapitalit njerëzor, duke krijuar një sistem arsimor dinamik që pajis studentët dhe punonjësit me aftësitë përkatëse dhe kompetencën digjitale të nevojshme në ekonominë globale, duke nxitur inovacionin dhe rritjen e konkurrueshmërisë kombëtare, zhvillimin e produktivitetit dhe fuqisë punëtore të kualifikuar. Në kuadër të kësaj shtylle, përvijohen reforma për rritjen e efektivitetit të sistemit arsimor profesional, përafrimin e tij me kërkesat në përgjigje të zhvillimeve dinamike të tregut të punës dhe rritjen e pjesëmarrjes aktive në tregun e punës, si dhe më gjerë, me zhvillimin e ekonomisë, që konsistojnë në:

1. Rishikim i sistemit të Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) për ta përshtatur më mirë me kërkesën për aftësi të tregut të punës, përmes ngritjes së dy Komiteteve të reja të Aftësive Sektoriale të cilat do të përcaktohen gjatë prioritizimit që do të bëhet gjatë vitit 2027, 5 Kurrikulave të rishikuara të AFP në fushat S3, 85% e mësuesve AFP të trajnuar për kurrikulat e rishikuara të AFP, 50% e të diplomuarve nga shkollat e AFP të punësuar në sektorin përkatës të studimeve (3 muaj/6 muaj) pas diplomimit.

2. Përditësimi i kurrikulave në arsimin parauniversitar, përditësimi i kurrikulave në arsimin parauniversitar. Është përfunduar procesi i përditësimit të 51 programeve mësimore për klasat 1, 6 dhe 10, si dhe për lëndën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) për klasat 4 dhe 5. Nga këto programe, 41 i përkasin kurrikulës bërthamë dhe 10 kurrikulës me zgjedhje.

Deri në fund të muajit tetor 2025, janë miratuar:

- 21 programe të arsimit bazë;
- 16 programe të arsimit të mesëm të lartë;
- Njëkohësisht, janë miratuar edhe dokumentet bazë kurrikulare;
- Kurrikula Bërthamë e Arsimit Fillor;
- Kurrikula Bërthamë e Arsimit të Mesëm të Ulët;
- Kurrikula Bërthamë e Arsimit të Mesëm të Lartë.

Lidhur me zhvillimin e kurrikulave të TIK-ut dhe integrimit të teknologjisë:

Programet e lëndës së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) për shkollat me *SmartLab*, kurrukula TIK e re zbatohet në klasën I–IV për këtë vit shkollor dhe në shtator do të shtrihet në klasat I–V. Këto kurrikula janë miratuar më herët dhe janë zhvilluar me mbështetjen e ekspertizës së ofruar nga bashkëpunimi me AADF dhe kanë në fokus përfshirjen e komponentëve të kodimit dhe inteligjencës artificiale në procesin mësimor.

Për kurrikulat e tjera, puna është realizuar në bashkëpunim me ekspertë të fushës, duke synuar një qasje të orientuar drejt STEAM-it dhe zhvillimit të kompetencave ndërdisiplinore.

Për sa i përket trajnimi i mësuesve në arsimin parauniversitar dhe zhvillimit profesional të tyre, janë realizuar trajnimet në kuadër të Programit Kombëtar për Zhvillimin e Burimeve Njerëzore në Arsim (PKZHPM) 2025, për periudhën janar–nëntor 2025, dhe kanë përfunduar. Në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e arsimit të lartë, janë zhvilluar dhe zbatuar tetë module trajnimi, përmes të cilave janë përfshirë 15,990 mësues, drejtues shkollash dhe punonjës të shërbimit psikosocial në sistemin e arsimit parauniversitar. Përmes projektit GOVTECH, deri në nëntor 2025, janë trajnuar:

- 846 mësues të arsimit fillor për zbatimin e aftësive numerike në mjediset SmartLab;
- 256 drejtues dhe specialistë të Zyrave Vendore të Arsimit në fushën e kompetencave digjitale dhe zbatimit të kurrikulës;

- 219 mësues të TIK-ut për zbatimin e elementeve të inteligjencës artificiale në mësimdhënie.

Është hartuar Programi Kombëtar për Zhvillimin Profesional të Mësuesve 2026–2028. Në kuadër të këtij programi të ri, parashikohet që rreth 20,000 punonjës arsimorë të trajnohen çdo vit, me fokus të veçantë në përditësimin e kurrikulës, përdorimin e metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies, zbatimin efektiv të kurrikulës dhe integrimin e STEM-it dhe kompetencave digjitale në praktikën e përditshme mësimore. Trajnimet do të nisin me përditësimet e kurrikulave për klasat 1, 6 dhe 10, si dhe me kurrikulat e reja të lëndës TIK. Në këtë kuadër, janë trajnuar 416 mësues të TIK-ut për zbatimin e kurrikulës së re të TIK për klasat I–IV, në zbatim të projektit Element IT&GOVTECH *(SmanrtLabs)* dhe rreth 92 mësues të TIK në zbatim të projektit IA FOR TOUTH.

Programi "Art dhe Zeje" është zgjeruar dhe me 100 shkolla të tjera (nga 200 në 300). Ka përfunduar dhe shpërndarja me bazë materiale pranë ZVAP, në mbështetje të klubeve të ngritura.

3. Përditësimi i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, përmes përditësimit të katalogut kombëtar të kualifikimeve profesionale në perspektivën e të nxënit gjatë gjithë jetës në nivelet 2-5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, akreditimi për 90% e ofruesve publikë dhe privatë të AFP-së, përfundimi i aplikimit i procesit të akreditimit për 90% e ofruesve publikë dhe privatë të AFP-së, zbatimit (të pjesshëm) të *European Standard Guidelines.*

4. Arsimi digjital dhe infrastruktura TIK në shkolla.

Përmes lidhjes së internetit për 95% të shkollave publike të arsimit parauniversitar, janë instaluar 358 laboratorë inteligjentë, nga të cilët 100 sipas projektit element IT, 216 nga World Bank, 4 World Vision, 8 OSFA, 25 nga projekti IA FOR YOUTH, 5 lab shtesë nga AADF-ja. Në total shkojnë në 1005 nga ku 358 ekzistues dhe 647 planifikuar në CEB. Në këta laboratorë ku nxënësit mund të eksperimentojnë, të krijojnë dhe të shfrytëzojnë teknologjinë moderne për të mësuar më mirë. Për herë të parë, janë përfshirë nocionet bazë të inteligjencës artificiale në kurrikulën TIK nga klasa IV, duke përgatitur nxënësit për një botë ku dijet dhe teknologjia ecin bashkë.

Sistemi i Menaxhimit të Informacionit Parauniversitar (SMIP) shërben si mjet kryesor për administrimin e proceseve administrative, duke garantuar standardizim, gjurmueshmëri dhe transparencë në veprimtarinë e institucioneve arsimore në nivel lokal dhe qendror.

Ndërkohë, Sistemi i Menaxhimit të Informatizuar për Arsimin e Lartë (SMIAL) është miratuar me vendimin nr. 832, datë 30.12.2025 i Këshillit të Ministrave "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Arsimit të Lartë (SMIAL)".

5. Forcimi i efikasitetit të Skemës së Politikës së Papunësisë, përmes Programeve të reja Aktive të Tregut të Punës, rritjes në 8% të punëkërkuesve të papunë në Programet Aktive të Tregut të Punës, rritjes së numrit të punëkërkuesve të regjistruar në zyrat e punësimit në 60% të totalit të të papunëve, rritjes 20% të punëkërkuesve të papunë në Formim Profesional; 5000 të papunë që punësohen përmes Programeve të Promovimit të Punësimit.

6. Forcimi i mjedisit kombëtar të Kërkimit dhe Inovacionit, përmes Strategjisë së Specializimit Inteligjent (S3), platformës për promovimin e Sistemit Shqiptar të Informacionit të Kërkimit Shkencor (ACRIS), e cila është miratuar si bazë të dhënash shtetërore në mbledhjen e Këshillit të Ministrave të datës 26.02.2026, Planit të Veprimit për *"European Inovation Scorebord"* (ESI), si dhe ligjit për shkencën dhe kërkimin shkencor (ligji nr. 109/2024 "Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

III. Digjitalizimi (4 reforma)

Shtylla e tretë parashikon nismat reformuese në lidhje më transformimin digjital, për të krijuar një shoqëri digjitale udhëheqëse të zhvillimit dhe rritjes, ku infrastrukturat digjitale të

sigurta, të qëndrueshme dhe efikase mbështesin shërbimet publike dhe transformimin ekonomik, e sigurojnë qëndrueshmëri kibernetike, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian. Në kuadër të kësaj shtylle, përvijohen iniciativa reformuese, që konsistojnë në:

1. Përputhshmëria me Rregulloren e Identitetit Digjital dhe zbatimi i E-Portofolit Digjital për shërbimet publike, përmes miratimit të legjislacionit përkatës të përafruar me BE; zbatimit të Portofolit Digjital për shërbimet publike (pilotim në të paktën 10 shërbime); përfshirja në listën e vendeve të treta të besuara të Bashkimit Evropian për validimin e nënshkrimeve elektronike, marrëveshjes së njohjes reciproke për Portofolin Digjital *(Digital Wallet)* dhe përgatitjet për nënshkrim të marrëveshjes me partnerët e tjerë të Ballkanit Perëndimor.

2. Forcimi i qëndrueshmërisë kibernetike, përmes përditësimit të listës së infrastrukturës kritike, në përputhje me Direktivën NIS2 të Bashkimit Evropian, CERT-et kombëtare dhe qeveritare janë plotësisht funksionale dhe të "akredituara" në TF CSIRT Trusted Introducer, përafrimit të Direktivës NIS2, Ushtrimi i kompetencave të plota të Autoritetit Kombëtar të Sigurisë Kibernetike (AKSK), në përputhje me Direktivën NIS2 të Bashkimit Evropian.

3. Infrastrukturë digjitale e sigurt dhe të qëndrueshme, përmes përmirësimit të bazës ligjore të *broadband*-it dhe harmonizimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian, si edhe të zbatimit të masave rregullatore për futjen e infrastrukturave 5G.

4. Përmirësimi i mjedisit mundësues për bizneset innovative, përmes miratimit të strategjisë së sipërmarrjes inovative, miratimit të instrumenteve mbështetës për inovacionin, përgatitjes dhe zbatimit të skemave të mbështetjes për inkubatorët/ përshpejtuesit, startups, SME-të, duke synuar inovacionin e gjelbër dhe/ose digjital, rritjes dhe promovimit të inovacionit përmes një Plan Veprimi me masat përkatëse për inovacionin, sipas *"European Inovation Scoreboard"* (EIS).

IV. Energjia dhe tranzicioni i gjelbër (6 reforma)

Shtylla e katërt fokusohet në energjinë dhe tranzicionin e gjelbër, me synimin për të transformuar Shqipërinë në një lider rajonal të energjisë, nëpërmjet adoptimit të standardeve dhe praktikave të Bashkimit Evropian, duke nxitur një treg konkurrues të energjisë, duke adresuar risqet nga varfëria energjetike dhe aspektet mjedisore, si dhe duke rritur përpjekjet e mëtejshme në tranzicionin e gjelbërt. Në kuadër të kësaj shtylle, përvijohen iniciativa reformuese, që konsistojnë në:

1. Harmonizimi me aktet ligjore të paketës së energjisë së BE-së, me qëllim integrimin e tregut të energjisë elektrike të BE-së dhe Shqipërisë dhe krijimin e tregut të energjisë elektrike "brenda ditës", si edhe operacionalizimit të paketës së integrimit të energjisë elektrike.

2. Tërheqja graduale nga ndërhyrja publike në përcaktimin e çmimeve për furnizimin me energji elektrike, shoqëruar me masa për adresimin e grupeve vulnerabël, përmes një metodologjie dhe masave përkatëse.

3. Zhvillimi i një plani ankandi transparent dhe konkurrues për energjinë e rinovueshme.

4. Forcimi i kuadrit ligjor për energjitë e rinovueshme, përmes miratimit të legjislacionit për energjitë e rinovueshme, miratimit të legjislacionit për ngritjen e komuniteteve të energjisë, operacionalizimi i sistemit për garancitë e origjinës për energjinë e rinovueshme, 600 mw kapacitete të reja shtesë të energjisë së rinovueshme të instaluara, rritjes së energjive të rinovueshme në totalin e miksit të energjisë së gjeneruar.

5. Progresi në reformat për emetimet e karbonit të BE-së, me qëllim vendosjen e sistemit të tregtimit të emetimeve të karbonit[7] (ETS), përmes miratimit të akteve ligjore e nënligjore për Monitorimin, Raportimin, Verifikimin dhe Akreditimin (MRVA), në përputhje me *Acquis* të Bashkimit Evropian.

[7] ETS *(Emission Trade System)*.

6. Ndryshimet ligjore dhe zbatimi i strategjisë afatgjatë për rinovimin e ndërtesave, si edhe skemës së eficiencës së energjisë, miratimin e legjislacionit për etiketimin dhe ekodizajn, si edhe ngritjes së kapaciteteve të nevojshme për mbikëqyrjen e tregut, ngritja e skemës së detyrueshme të eficiencës së energjisë, në përputhje me Direktivën e Energjisë së BE, zbatimi i objektivave vjetorë për rinovimin e ndërtesave, në përputhje me strategjinë përkatëse.

V. Shteti i së Drejtës dhe të drejtat themelore (9 reforma)

Shtylla e pestë prioritizon garantimin e pakthyeshmërisë së reformës në drejtësi dhe të konsolidimit më tej të punës për sundimin e ligjit dhe shtetin e së drejtës, nëpërmjet masave që luftojnë krimin e organizuar, parandalojnë dhe ulin incidencën e korrupsionit, rrisin efikasitetin e gjyqësorit dhe promovojnë transparencën dhe lirinë e shprehjes, në përputhje me standardet evropiane. Në kuadër të kësaj shtylle, përvijohen iniciativa reformuese, që konsistojnë në:

1. Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, përmes ngritjes së Zyrës së Rikuperimit të Aseteve, anëtarësimit në Rrjetin Evropian të Zyrave të Rikuperimit të Aseteve, ripërdorimit për qëllime sociale i aseteve të konfiskuara, brenda gjashtë muajve nga konfiskimi. Gjatë vitit 2025, në kuadër të intensifikimit të hetimeve financiare dhe luftën kundër pastrimit të parave është zgjeruar numri i databazave elektronike ku Policia e Shtetit ka akses të drejtpërdrejtë, me qëllim identifikimin e pasurive të luajtshme, të paluajtshme, llogarive bankare, sigurimin e të dhënave për personat juridik etj., duke ndihmuar në gjurmimin e aseteve në një kohë sa më të shpejtë gjatë fazës së hetimeve paraprake. Kjo ka sjellë rritjen e efektivitetit për parandalimin dhe goditjen e rasteve në fushën e pastrimit të parave dhe hetimeve financiare. Kapacitetet hetimore për pastrimin e parave janë rritur përmes trajnimeve në fushën e pastrimit të parave dhe aseteve kriminale, organizuar kryesisht me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtar (17 trajnime me 354 punonjës) dhe takimeve koordinuese ndërinstitucionale dhe ndërkombëtare (32), me qëllim rritjen e bashkëpunimit dhe të luftës kundër pastrimit të parave.

Intensifikimit dhe përmirësimit të hetimeve në kuadër të pastrimit të parave, i është dhënë një fokus i veçantë hetimeve pasurore paralel me hetimit penal, duke ndihmuar që hetimet financiare të përdorin në kohë, mjetet e kërkimit të provës që lejon hetimi penal, si kontrollet, përgjimet, sekuestrimet e provave materiale që lidhen me veprën penale. Për vitin 2026 në fushën e pastrimit të parave nuk ka nisma me efekte financiare në buxhetin e shtetit.

Në qershor të vitit 2023, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, u krijua struktura përkatëse për rikuperimin e aseteve në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, angazhim në kuadër të Agjendës së Reformave dhe Udhërrëfyesit të Shtetit të së Drejtës.

Në qershor 2025 u miratua edhe ligji nr. 44/2025, "Për Zyrën e Rikuperimit të Aseteve" dhe po plotësohet kuadri nënligjor për strukturën organike dhe procedurat e veprimit të strukturës së krijuar në bazë të ligjit duke synuar shkëmbimin e informacionit dhe përfshirjen në platforma bashkëpunimi rajonale dhe të BE.

2. Forcimi i luftës ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar, përmes miratimit të Strategjisë Kombëtare për Parandalimin dhe Luftën kundër Krimit të organizuar dhe Krimeve të Rënda 2026 – 2030 dhe planit të saj të veprimit 2026-2028, zgjerimit të ndërveprimit midis bazave të të dhënave dhe mjeteve IT, progresit të vazhduar në lidhje me cilësinë e hetimeve, dënimet, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive për krime të lidhura me korrupsionin, në përputhje të plotë me të drejtat e procesit të rregullt ligjor, progres i vazhdueshëm me rezultatet e hetimeve, dënimeve, sekuestrimeve dhe konfiskimeve të pasurive të krimit të organizuar.

Gjatë vitit 2025, strukturat për hetimin e trafiqeve kanë intensifikuar shkëmbimin e informacionit në mënyrë të shpejtë dhe përmes kanaleve të sigurta të komunikimit (SIENA), si dhe shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira në luftën kundër këtij fenomeni, bazuar në standardet e BE-së. Në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, në kuadër të EMPACT strukturat policore janë bërë pjesë e 3 planeve operacionale dhe operacioneve të përbashkëta "*Jad Global Chain*" dhe "*Jad Danub* 10" (qershor 2025), si dhe "*JAD* Ditët e

Veprimit *Empact* Kundër Shfrytëzimit në Punë “ (shtator 2025) për luftën e trafikimit të qenieve njerëzore dhe shfrytëzimit seksual apo për punë dhe lypje e detyruar; kontrabandimit të migrantëve; përdorimit dokumenteve të falsifikuara që shoqërojnë këto krime, si dhe krime të tjera ndërkufitare. Zhvillimi i një bashkëpunimi operacional i Policisë Shqiptare përmes Task-Forcës së Europolit, me mbështetjen e Eurojustis dhe vendeve të tjera (Policia Kolumbiane dhe Kroate) ka mundësuar goditjen e një grupi ndërkombëtar të trafikimit të qenieve njerëzore nga shtetas kolumbianë rekrutonte dhe trafikonte gra dhe vajza, me qëllim shfrytëzimin seksual, në disa vende evropiane, përfshirë Kroacinë dhe Shqipërinë.

3. Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe kuadrit strategjik, me qëllim uljen e kërkesës dhe ofertës së drogave të paligjshme, përmes ngritjes dhe operacionalizimit të Sistemit Kombëtar të Paralajmërimit të Hershëm dhe Observatorit Kombëtar të Drogës, miratimit të Planit të Veprimit për parandalimin, trajtimin dhe uljen e dëmeve nga droga 2023–2026. Trafikimi i lëndëve narkotike mbetet një çështje me rëndësi për Shqipërinë, ndërkohë që janë shënuar përparime të dukshme në forcimin e kontrolleve kufitare, bashkëpunimin rajonal dhe përafrimin me standardet e BE-së. Përpjekjet janë përqendruar në goditjen e rrjeteve të përfshira në trafikimin e kanabisit, heroinës dhe kokainës, por vëmendje të veçantë ka marrë edhe identifikimi i drogave të reja sintetike.

4. Konsolidimi i pavarësisë dhe llogaridhënies së gjyqësorit, përmes referimit të rasteve të *vetting*-ut të dyshuar për elemente kriminale në prokurori, ndryshimit të dispozitave që rregullojnë përzgjedhjen e anëtarëve jomagjistratë të KLGJ-së dhe KLP-së për t’iu përshtatur standardeve të larta të integritetit, kontrollit të figurës dhe deklaratës së pasurisë, dhe për të siguruar zbatimin sa më të plotë të parimit të bazuar në merita për renditjen e pavarur, rritjes së transparencës për KLGJ-në dhe KLP-në për informacionet e lidhura me emërimet, promovimet, transferimet në gjyqësor, si edhe rekomandimeve nga inspektimet e ILD.

5. Rritja e efikasitetit të gjyqësorit në të gjitha nivelet, përmes udhërrëfyesit të KLGJ për çështjet e pashqyrtuara, përmirësimit të statistikave penale, ngritjes së Sistemit të Menaxhimit të Integruar të Çështjeve (ICMS), reduktimit të numrit të çështjeve të pashqyrtuara dhe kohës së disponimit në gjykata, sigurimit të një zgjidhje për ambientet e Gjykatës së Apelit, rritja e kapaciteteve të ILD, plotësimi i vendeve vakante në nivelet e gjyqësorit.

6. Parandalimi efektiv i korrupsionit, zvogëlimi i incidencës së korrupsionit, përmes platformës së hapur të të dhënave për buxhetin qendror dhe vendor, publikimit të gjithë deklaratave të pasurisë në faqen e internetit të ILDKPKI, sipas parashkrimeve ligjore, ndryshimeve në kuadrin ligjor për Kontrollin e Lartë të Shtetit (KLSH), kuadri ligjor për donacionet dhe sponsorizimet, kuadri ligjor për konfliktin e interesit, kuadri ligjor për financimin e partive politike.

7. Forcimi i lirisë së shprehjes, në përputhje me standardet evropiane, përmes rritjes së kapaciteteve në organet ligjzbatuese për trajtimin e rasteve të dhunës që përfshijnë gazetarë, përafrim i legjislacionit me *Digital Service Act Regulation* të BE dhe direktivën anti-SLAPP të BE-së, harmonizimi i legjislacionit penal dhe civil mbi shpifjen, me standardet e BE-së.

8. Përafrimi me politikën dhe kërkesat e vizave të Bashkimit Evropian, nëpërmjet përfundimit të marrëveshjeve pa viza me vendet (të paktën 4) për të cilat kërkohen viza për në Bashkimin Evropian.

Në datën 23 shtator 2024, u miratua nga Komisioni Evropian “Vendimi zbatues i Komisionit Evropian për miratimin e Agjendave të Reformës dhe programit shumëvjeçar të punës në kuadër të Facilitetit të Reformave dhe Rritjes për Ballkanin Perëndimor” (për 5 vende nga Ballkani Perëndimor).

Vendimi zbatues i Komisionit udhëzon dhe përcakton edhe modalitetet për zbatimin e Facilititetit për Reforma dhe Rritje. Disbursimi i mbështetjes së Bashkimit Evropian do të kushtëzohet nga progresi i matshëm në zbatimin e reformave të parashikuar në Agjendë. Kushtet e pagesës do të përcaktohen në bazë të plotësimit të hapave cilësore dhe sasiore, sipas

afateve kohore të përcaktuara për secilin vend dhe për secilën reformë, të cilat kanë si qëllim stimulimin e rritjes dhe vendosjen e përfituesve në një rrugë të qëndrueshme konvergjence, për t'i orientuar ata drejt reformave specifike që lidhen me bazat e zgjerimit, proces ky që përfshin ndër të tjera edhe sundimin e ligjit, luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Stabiliteti makrofinanciar, menaxhimi i shëndoshë i financave publike, transparenca dhe mbikëqyrja e buxhetit janë kushte të përgjithshme që duhet të përmbushen për pagesat dhe lirimin e fondeve.

Vlera e përgjithshme që pritet të përfitojë, në parim, vendi ynë për periudhën 2024–2027, në total kap vlerën e 922,085,888 euro (grant dhe kredi), pagesa të kushtëzuara me zbatimin e reformave kyçe siç janë përcaktuar në Agjendën Kombëtare të Reformave të secilit vend.

Në tabelën më poshtë paraqiten alokimet e mbështetjes për secilin sektor:

Fusha e politikës/reformave	**Vlera e mbështetjes (grant+kredi)**
Klima e biznesit	209,086,359.60 euro
Kapitali njerëzor	189,531,520.21 euro
Digjitalizimi	127,858,565.22 euro.
Energjia dhe tranzicioni i gjelbër	127,858,565.22 euro
Shteti i së dretjës dhe të drejtat themelore	267,750,877.76 euro
TOTALI	**922,085,888.00 euro**

Në përputhje me nenin 19 të Rregullores (BE) 2024/1449, për të maksimizuar ndikimin e mbështetjes financiare të Bashkimit për të tërhequr investime shtesë dhe për të siguruar kontrollin e Bashkimit Evropian mbi shpenzimet, investimet në infrastrukturë që mbështesin Agjendat e Reformave, duhet të zbatohen përmes Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor (*WBIF*) dhe Fondit të Përbashkët Evropian të Ballkanit Perëndimor të krijuar në kuadër të *WBIF* për marrjen e kontributeve të donatorëve (*EWBIF*) në përputhje me rregullat e fondit (Kushtet e përgjithshme të fondit të përbashkët).

Në kuadër të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Facilitetit për Reforma dhe Rritje ,e ratifikuar me ligjin nr. 19/2025, "Për ratifikimin e marrëveshjes së Facilitetit për Rregullimet specifike për Zbatimin e Mbështetjes së Bashkimit Evropian për Republikën e Shqipërisë në kuadër të Faciliteti për Reforma he Rritje" është hartuar dhe miratuar vendimi nr. 252 datë 2.5.2025, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësive e të marrëdhënieve midis autoriteteve dhe strukturave përgjegjëse për koordinimin dhe raportimin, sipas parashikimeve të marrëveshjes të facilitetit, ratifikuar me ligjin nr. 19/2025".

Vendimi nr. 252 datë 2.5.2025, i Këshillit të Ministrave përcakton funksionet dhe përgjegjësitë midis autoriteteve dhe strukturave për menaxhimin e asistencës financiare të dhënë nga Bashkimi Evropian për Republikën e Shqipërisë, në bazë të marrëveshjes së financimit që lidhet me zbatimin e mbështetjes së Bashkimit Evropian për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të Facilitetit për Reforma dhe Rritje në përputhje me Agjendën Kombëtare të Reformave 2024–2027. Gjithashtu, janë përcaktuar dhe funksionet e Koordinatorit Kombëtar të Facilitetit të Reformës dhe Rritjes të cilat do të ushtrohen nga drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore për Planifikimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndihmës i cili është njëkohësisht Koordinator Kombëtar i Asistencës së Bashkimit Evropian për Paraanëtarësim.

Paralelisht me strukturat e raportimit dhe verifikimit, Koordinatori Kombëtar në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë për Media dhe Informim kanë hartuar plane të dedikuara me qëllim komunikimin dhe vizibilitetin e hapave. Ky plan siguron që reformat të komunikohen qartë për publikun dhe që mekanizmi të ruajë vizibilitetin dhe besueshmërinë.

Në datë 15 korrik 2025, Koordinatori Kombëtar, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve të Marrëveshjes së Facilitetit, dorëzoi raportimin e parë zyrtar. Raportimi përfshinte kërkesën zyrtare për disbursimin e fondeve së bashku me dokumentacionin përkatës mbështetës për të gjithë hapat.

Agjenda Kombëtare e Reformave kishte parashikuar përfundimin e 36 hapave deri në qershor 2025. Nga këta, Shqipëria ka përfunduar 33 hapa dhe, përveç tyre, raportoi edhe 5 masa të parashikuara për dhjetor 2025. Në total, Shqipëria raportoi përfundimin e 38 hapave:

- 16 masa për dhjetor 2024;
- 17 masa për qershor 2025;
- 5 masa të parashikuara për dhjetor 2025.

Gjithashtu, paketa e raportimit të parë përfshiu edhe:

- Deklaratën e Sigurisë;
- Raportin Vjetor 2024 të Republikës së Shqipërisë;
- Raportin Vjetor për Mbikëqyrjen e Menaxhimit Financiar Publik për 2023 dhe Raportin për Transparencën e Buxhetit për 2024;
- Përmbledhjen e Auditimeve të dorëzuara nga Ministria e Financave.

Vlerësimi i Komisionit Evropian për Raportimin e Parë të Zbatimit të Facilitetit për Reforma dhe Rritje.

Më datë 8 tetor 2025 Komisioni Evropian dërgoi vlerësimin për raportimin e parë të zbatimit të Facilitetit për Reforma dhe Rritje adresuar Koordinatorit Kombëtar. Shqipëria ka raportuar gjithsej 41 masa, të ndara sipas periudhave të raportimit për dhjetor 2024, qershor 2025, dhe 5 masat e raportuara përpara afatit (*anticipated*). Nga këto, 21 masa janë vlerësuar si të realizuara, ndërsa 20 mbeten të parealizuara.

Masat e realizuara janë në vlerën **106,799,507.42 euro** nga të cilat është zbritur vlera e parafinancimit prej 7,475,965.52 euro. Në total, Shqipëria përfiton **99,323,541.90 euro**, të ndara si më poshtë:

- Mbështetje buxhetore (pagesë direkte në thesarin e shtetit tashmë e disbursuar): **46,209,348.37 euro**;
- Grante *WBIF* për investime: **28,504,617.19 euro**;
- Mbështetje buxhetore për investime në *WBIF* në formë huaje: **24,609,576.33 euro.**

Dhjetor 2024 *(grace period* – dhjetor 2026)

Referuar periudhës së parë të raportimit janë raportuar 16 masa, prej të cilave 11 janë vlerësuar si të realizuara dhe 5 masa mbeten të parealizuara kryesisht për shkak të vonesave në zbatimin e plotë të Kornizës për Energjinë e Rinovueshme dhe Etiketimin Energjetik, transparencën e pronësisë mediatike dhe konsolidimin e platformave për publikimin e të dhënave mbi pasuritë dhe shpenzimet publike.

Qershor 2025 *(grace period* – qershor 2026)

Në periudhën e dytë të raportimit janë raportuar 20 masa, nga të cilat 9 janë realizuar dhe 11 mbeten të parealizuara, për shkak të kërkesës për miratime të mëtejshme ligjore, përafrim të standardeve të BE-së dhe finalizimin e mekanizmave të matjes dhe raportimit institucional.

Masat e raportuara përpara afatit *(grace period* – dhjetor 2026)

Në kuadër të raportimit të masave të raportuara përpara afatit janë përfshirë 5 masa të parashikuara, prej të cilave 1 është realizuar plotësisht, ndërsa 4 mbeten të parealizuara për shkak të vonesave në ratifikimin parlamentar të protokolleve ndërkombëtare, në harmonizimin e politikës së vizave, si dhe në funksionalizimin e sistemit të paralajmërimit të hershëm për substancat narkotike.

- Komiteti i Monitorimit të Facilitetit për Reforma dhe Rritje

Më datë 24 shtator 2025 u zhvillua Komiteti I Monitorues i Facilitetit për Reforma dhe Rritje për vitin 2025. Ky Komitet përfaqëson një forum të nivelit të lartë, i cili u bashkëkryesua nga Koordinatori Kombëtar dhe përfaqësues të Komisionit Evropian.

Në fokus të këtij takimi ishte rishikimi i progresit te Agjendës Kombëtare të Reformave 2024-2027 dhe analizimi i cilësisë dhe sfidave te zbatimit. Takimi ishte i rëndësisë së lartë për të ndarë mësimet e nxjerra dhe përcaktimin e hapave të mëtejshëm për përmbushjen e objektivave të dakordësuar. Në takim pati një pjesëmarrje të madhe të të gjitha institucioneve përgjegjëse për koordinim dhe zbatimin e Facilitetit për Reforma dhe Rritje dhe gjithashtu kishte një pjesëmarrje aktive të shoqërisë civile, akademisë dhe komunitetit të biznesit.

Përdorimi i Inteligjencës Artificiale në Përshpejtimin e Procesit te Përafrimit me *EU ACQUIS*

Ndërsa fusha e teknologjive të AI nëpër botë zgjerohet, presioni i pajtueshmërisë së saj me zakonet individuale, mënyrat e të bërit biznes, profesionet dhe strukturat institucionale shkakton një transformim rrënjësor në strukturën socio-ekonomike të një vendi.

Megjithëse është e qartë se ky transformim ka filluar dhe do të vazhdojë të përshpejtohet, mjetet dhe shpejtësia e ndërveprimit të këtij transformimi me strukturat ekzistuese sociale, institucionale dhe ekonomike janë ende të paqarta.

AI, ose inteligjenca artificiale, është një fushë e zgjeruar dhe në zhvillim që përfshin zhvillimin e programeve kompjuterike inteligjente të cilat kryejnë detyra që zakonisht kërkojnë inteligjencë njerëzore, si perceptimi vizual, njohja e të folurit, vendimmarrja dhe përpunimi i gjuhës. Zhvillimi i AI ka qenë domethënës, pasi i ka lejuar këto sisteme të mësojnë, përshtaten dhe gjenerojnë njohuri nga sasi të mëdha të dhënash.

Zhvillimi dhe përhapja e shpejtë e llogaritjeve të performancës së lartë, internetit të sendeve dhe teknologjive *blockchain* (mekanizëm i avancuar rrjeti informacioni), në vitet e fundit kanë hapur rrugën për shfaqjen e teknikave dhe aplikimeve të reja të AI. Në mënyrë të ngjashme, falë teknikave të të dhënave me kompleksitet të lartë *(big data)* të përdorura në përpunimin e të dhënave digjitale, grupe të mëdha të dhënash vihen në dispozicion të aplikacioneve të AI.

Koncepti i AI mund të ndahet në tri kategori: AI "e ngushtë", "e përgjithshme" dhe "e lartë".

i. AI i ngushtë: Ky lloj AI është krijuar për të kryer një detyrë të specifike (p.sh., njohjen e fytyrës, kërkimet në internet ose drejtimin e një makine). AI funksionon nën një gamë të kufizuar të paracaktuar ose grup kontekstesh. Shumica e sistemeve të AI në përdorim sot janë shembuj të AI të ngushtë.

ii. AI e përgjithshme: Kjo i referohet një forme teorike të AI që mund të arrijë performancë të nivelit njerëzor ose më të lartë në shumicën e njohësve detyrat.

iii. AI e lartë: Një formë teorike e AI që ka inteligjencë më të madhe se njerëzit dhe tejkalon performancën e tyre njohëse në shumicën e fushave.

Ndërsa sistemet e AI mund të jenë të suksesshme në kryerjen e detyrave rutinë, procedurale dhe të modeleve të inteligjencës analitike, përdorimi i tyre është shumë i kufizuar në detyrat që përfshijnë inteligjencën emocionale dhe pasigurinë e lartë që kërkojnë dizajn, ndjeshmëri dhe përshtatshmëri. Në këtë kontekst, diskutimet dhe debatet konceptuale dhe teknike mbi kufijtë dhe të ardhmen e AI vazhdojnë.

Qeveria shqiptare ka nisur një rrugëtim ambicioz për të integruar inteligjencën artificiale (AI) në sektorë të ndryshëm publikë, për të transformuar shërbimet publike, për të përmirësuar punën e institucioneve dhe për të rritur angazhimin e qytetarëve. Duke përdorur potencialin e AI dhe *Big Data*, Shqipëria synon të nxisë një qeveri më efikase, transparente dhe më të përgjegjshme.

Synimi afatgjatë është të integrojmë AI në të gjithë sektorët, duke synuar një ndikim transformues në kujdesin shëndetësor, arsim, bujqësi, taksa dhe tatime etj. Iniciativa të tilla si diagnostikimi i i hershëm i sëmundjeve asistuar nga AI, rrugëtimet e personalizuara të arsimimit dhe bujqësia precize pritet të përmirësojnë ndjeshëm rezultatet e politikave dhe efikasitetin e shërbimeve. Për më tepër, këto iniciativa parashikohen të reduktojnë ndjeshëm punën manuale, të minimizojnë gabimet njerëzore dhe të thjeshtojnë proceset në të gjithë administratën. Adoptimi i teknologjive të AI do ta pozicionojë Shqipërinë në krye të

inovacionit digjital në qeverisje, duke kontribuar në modernizimin e administratës publike dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për qytetarët.

E-Albania 2.0 do të vijë bashkë me Platformën e Ndërveprimit me teknologjinë më të fundit dhe e riorganizuar sipas modelit "*life events*", do t'i bëjë shërbimet edhe më të thjeshta për të gjithë, por dhe për ata me aftësi ndryshe dhe të moshuarit që do të kenë shërbyesin virtual të dedikuar, asistentin virtual te *e-Albanias*. Aktualisht, në portalin *e-Albania* është implementuar Asistenti Virtual 1.0, i cili përdor inteligjencën artificiale për të gjeneruar automatikisht pyetjet që qytetarët mund të kenë rreth shërbimeve të ofruara në portal.

Në *e-Albania* do të integrohet inteligjenca e biznesit *(Business Intelligence),* për të vizualizuar dhe analizuar siç duhet të dhënat e shërbimeve dhe përdorimit të tyre, në mënyrë që t'u mundësohet institucioneve të marrin vendime më të mira, më të shpejta dhe më efikase gjatë ofrimit të shërbimeve publike, por edhe parashikime më të sakta në këtë aspekt.

Gjithashtu, janë zhvilluar dhe janë në zhvillim e sipër një sërë projektesh që përfshijnë inteligjencën artificiale:

Është zhvilluar **AI në transpozimin e *Acquis* së BE-së në legjislacionin shqiptar**: Përshtatja e legjislacionit shqiptar me *Acquis* e BE-së, është një detyrë e komplikuar që kërkon vite nëse realizohet manualisht nga ekspertë ligjorë dhe specialistë të integrimit. Për të adresuar këtë sfidë, do përdoret Inteligjenca Artificiale për ta automatizuar këtë proces, duke përfshirë përkthimin e akteve ligjore me asistencë të IA-së, analizimin dhe krahasimin e tyre me legjislacionin shqiptar për të identifikuar mbivendosje apo kontradikta, dhe automatizimin e hartimit të tabelave të përputhshmërisë. Ky modul synon të përshpejtojë punën e ekspertëve të përputhshmërisë ligjore, duke ruajtur njëkohësisht saktësinë, por pa zëvendësuar faktorin njerëzor, i cili mbetet element thelbësor dhe i pazëvendësueshëm në procesin e integrimit evropian. Përdorimi i IA-së nuk zvogëlon rolin e ekspertëve, përkundrazi, e fuqizon atë duke i mundësuar të fokusohen te detyrat më strategjike dhe vendimmarrëse, që janë kritike për procesin e integrimit evropian.

Është në zhvillim **AI në transformimin rrënjësor të sistemit të prokurimeve**: Do të automatizohen plotësisht procedurat e prokurimit përmes një sistemi elektronik me inteligjencë artificiale, duke eliminuar nevojën për letra dhe komunikim me zyra, duke kaluar në qasjen zero letra dhe zero komunikim me zyrat. Bizneset do të kenë dosjet e tyre virtuale që do të ndërveprojë me sistemet e tjera shtetërore, duke e bërë procesin më të thjeshtë dhe të barabartë për të gjithë, përfshirë edhe bizneset evropiane. Për më tepër, sistemi *e-Certis*, i cili është sistemi evropian i prokurimeve, do të mundësojë verifikimin e deklarimeve, ndërsa sistemi *Single Window* i Doganave do të lehtësojë më tej këtë ndërveprim. Përdorimi i inteligjencës artificiale dhe *machine learning* do të reduktojë gabimet njerëzore dhe do të automatizojë proceset si hartimi i termave të referencës, përcaktimi i fondeve limit dhe vlerësimi i procedurave të prokurimit. Kjo do të sjellë kursime financiare dhe do të krijojë një garë të drejtë, të barabartë dhe transparente në tendera.

3. Reforma në drejtësi

Reforma në drejtësi, një ndër shtyllat kryesore të procesit të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, mbetet themelore për forcimin e sundimit të ligjit, luftën kundër korrupsionit dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të qytetarëve. Përmbushja e angazhimeve të ndërmarra nga Shqipëria në këtë proces kërkon hapa të qartë dhe të matshëm, të cilët do të monitorohen dhe vlerësohen vazhdimisht.

Viti 2016 shënon miratimin e ndryshimeve të rëndësishme kushtetuese vijuar nga përpunimi i disa ligjeve thelbësore të sistemit të drejtësisë si pjesë e procesit të reformës në drejtësi në Shqipëri. Deri në fund të vitit 2016, ligjet e reformës në drejtësi, si Ligji për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Ligji për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë, Ligji për Organizimin e Prokurorisë, Ligji për SPAK-un dhe Ligji i Vettingut ishin miratuar nga

Kuvendi dhe shumica e institucioneve të reja ishin ngritur dhe kishin filluar të ushtronin veprimtaritë e tyre.

Përfundimi i fazës së parë të reformës në drejtësi u bë në kuadër të SND 2017–2020. Në vijim, u hartua një strategji e re - SND 2021–2025 – e cila u projektua mbi katër objektiva politikash, duke synuar konsolidimin e reformave të nisura në vitin 2016 dhe afrimin e sistemit të drejtësisë shqiptare me standardet e BE-së.

Procesi i vazhdueshëm për integrimin në BE ka vënë theksin më tej në forcimin e aspekteve legjislative, institucionale dhe operacionale të gjyqësorit, për të garantuar shtetin e së drejtës dhe mbrojtjen ligjore efikase. kapitulli 23, i cili është pjesë e grupit të "Themelorëve" në boshtin e negociatave të anëtarësimit, përfshin elemente të tilla si një sistem gjyqësor efikas, të pavarur dhe cilësor dhe luftën efikase kundër korrupsionit si kushte paraprake për gëzimin e të drejtave themelore në ligj dhe në praktikë. Prandaj, u konsiderua thelbësore që angazhimet e marra nga Shqipëria në një proces të tillë – kryesisht siç përcaktohet në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës (ROL) (2024) dhe në Planin e Rritjes për Ballkanin Perëndimor – të përkthehen në masa konkrete dhe piketa që vlerësohen dhe monitorohen në mënyrë efikase, dhe çdo progres apo mungesë e tyre raportohet dhe ndiqet siç duhet.

Në këtë kuadër, me vendimin nr. 787, datë 18.12. 2024 të Këshillit të Ministrave është miratuar Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2024–2030, e cila synon të avancojë reformat e mëdha në drejtësi gjatë shtatë viteve nëpërmjet zbatimit të politikave të reja që synojnë reformimin e sistemit të drejtësisë, forcimin e kapaciteteve të institucioneve të drejtësisë, harmonizimin e legjislacionit në fushën e sistemit të drejtësisë në përputhje me BE-në, *Acquis* dhe standardet evropiane, rrisin komunikimin publik dhe rivendosin besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Këto synime janë të përmbledhura në vizionin dhe misionin e strategjisë.

-Vizioni: *"Shqipëria konsolidon arritjet e Reformës në sistemin e drejtësisë në mënyrë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme, me synimin për të rritur më tej efikasitetin e drejtësisë në përputhje me standardet evropiane."*

- Misioni*: "Shqipëria konsolidon arritjet e Reformës në sistemin e drejtësisë në mënyrë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme, me synimin për të rritur më tej efikasitetin e drejtësisë në përputhje me standardet evropiane."*

SND 2024–2030 është konceptuar si një strategji ombrellë, e cila përmban objektivat më të rëndësishëm dhe rezultatet e pritshme nga zbatimi i saj për shtatë vitet e ardhshme, të hartuara në vijim të detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integrimit të Shqipërisë në BE dhe dokumente të tjera strategjike kombëtare.

SND 2024–2030 pasqyron harmonizimin e prioriteteve me objektivat e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030 (SKZHIE 2022–2030), Programin e Qeverisë, Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2024–2026 (PKIE), Agjendën e Zhvillimit 2030 të OKB-së etj.

Prioritetet më të rëndësishme strategjike të SND 2024–2030 janë:

1. Konsolidimi i kuadrit ligjor në përputhje me *Acquis* të BE-së dhe standardet evropiane;
2. Përafrimi i SND-së me Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës dhe rekomandimet e Komisionit të BE-së;
3. Reduktimi dhe eliminimi i çështjeve të prapambetura në gjykata dhe prokurori;
4. Digjitalizimi i sistemit gjyqësor dhe modernizimi i infrastrukturës;
5. Plotësimi i vendeve vakante për magjistratët dhe administratën e drejtësisë;
6. Vazhdimi i zbatimit të standardeve të larta të procesit të *vetting*-ut pas përfundimit të tij;
7. Forcimi i mekanizmave të llogaridhënies dhe transparencës për të rritur besimin e publikut te gjyqësori;
8. Rritja e kapacitetit profesional dhe integritetit të magjistratëve për të ofruar drejtësi me cilësi të lartë;
9. Rritja e cilësisë së shërbimeve të ofruara në përputhje me standardet më të mira evropiane;

10. Rritja e edukimit ligjor publik në fushën e drejtësisë.

Kostimi i Strategjisë u realizua mbështetur në metodologjinë dhe praktikën e planifikimit buxhetor, ndërsa vlerësimi i kostove indikative është mbështetur në objektivat dhe treguesit e përcaktuar për arritjen e tyre, si dhe në masat, aktivitetet dhe produktet e identifikuara për secilin aktivitet. Përllogaritjet buxhetore janë bërë duke përdorur instrumentin e rekomanduar nga IPSIS-is, të përshtatur sipas udhëzimeve përkatëse.

Kostoja e përgjithshme e përllogaritur për zbatimin e planit të veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2024–2030 është rreth 5.93 miliardë lekë, ose rreth 56.4 milionë euro.

Në kuadër të përditësimit të zhvillimeve sektoriale për vitin 2025 dhe në funksion të Agjendës Kombëtare të Reformave në fushën e "Themeloreve/Shtetit të së Drejtës", Ministria e Drejtësisë informon se gjatë vitit 2025 është shënuar progres i qëndrueshëm në drejtim të konsolidimit të pavarësisë dhe llogaridhënies së gjyqësorit, në veçanti përmes ndjekjes efektive gjyqësore të rasteve të procesit të rivlerësimit kalimtar *(vetting)* me dyshime për elemente penale. Raste të tilla janë referuar për ndjekje penale dhe janë trajtuar nga organet kompetente të prokurorisë, duke përfshirë hetime në vijim, procedime gjyqësore dhe vendime përfundimtare, përfshirë edhe mbyllje të arsyetuara të çështjeve kur nuk janë konstatuar elemente penale.

Ky progres është reflektuar edhe në vlerësimet e Komisionit Evropian, përfshirë Raportin për Shtetin e së Drejtës për Shqipërinë dhe vlerësimin e parë në kuadër të Facilitetit për Reforma dhe Rritje, ku konstatohet përmbushja e kërkesës për ndjekje efektive gjyqësore të rasteve të *vetting*-ut. Pas shpërbërjes së komisionerëve publikë, kompetencat e tyre u ushtruan nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.

- Lidhur me nismat e reja prioritare sektoriale me efekte financiare për buxhetin e shtetit 2027-2029, Ministria e Drejtësisë, përgjatë vitit 2026 do vijojë hartimin e Strategjisë së Re Ndërsektoriale të Drejtësisë për të Mitur, ku më poshtë jepet një projeksion i përmbajtjes së saj.

Reforma "Drejtësi për të mitur" ishte pjesë e reformës në drejtësi të ndërmarrë nga Kuvendi i Shqipërisë në vitin 2016, ndaj dhe për herë të parë u miratua me ligjin nr. 37/2017 Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur (KDPM). Risitë e këtij kodi dhe nevoja për një drejtësi miqësore për fëmijët diktuan nevojën e hartimit dhe miratimit të Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur (SDM) 2018-20211. Me vendimin nr. 892, datë 27.12.2022, të Këshillit të Ministrave, është miratuar dokumenti i dytë politik, Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë për të Mitur 2022-2026, i cili ka synuar zbatimin me efektivitet i të gjitha të drejtave të fëmijëve duke konsoliduar arritjet në fushën e drejtësisë penale për të mitur, aksesin në drejtësinë penale për të miturit, me qëllim evitimin e ripërfshirjes në kriminalitet dhe viktimizimin e tyre, që çdo fëmijë të ketë në çdo kohë akses te një sistem miqësor për të rivendosur të drejtat e tij/e saj të cenuara në fushën familjare, civile, administrative dhe penale.

Duke qenë se Strategjia hyn në vitin e fundit të zbatimit të saj gjatë vitit 2026, Ministria e Drejtësisë informon se, deri në këtë fazë, nuk janë përcaktuar ende fazat dhe afatet konkrete për nisjen e procesit të hartimit të Strategjisë së re të Drejtësisë për të Miturit. Planifikimi i këtij procesi, në përputhje me metodologjinë për hartimin e dokumenteve strategjike, parashikohet të realizohet gjatë muajve të parë të vitit 2026, pas së cilës do të përditësohet informacioni mbi ecurinë dhe hapat vijues të këtij procesi.

4. Siguria në Komunitet

Një nga prioritetet kryesore të Qeverisë Shqiptare dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme është forcimi i rendit dhe sigurisë publike, krijimi i kushteve për një jetesë më të sigurt për qytetarët, forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional për fuqizimin e sigurisë publike, si dhe intensifikimi i bashkëpunimit me qytetarët në këtë drejtim.

Niveli i rendit publik dhe sigurisë në vendin tonë paraqitet në parametra normale, si rezultat i rritjes së aftësive profesionale të Policisë së Shtetit dhe forcimit të kontrollit të territorit me IKMT dhe strukturat përgjegjëse por edhe i vëmendjes gjithnjë e më të shtuar të autoriteteve lokale kundrejt çështjeve të sigurisë publike dhe trajtimit të duhur të problemeve nga ana e tyre, rritjes së ndërgjegjësimit por edhe të përfshirjes së komunitetit dhe kontributit të këtij të fundit, investimeve të bëra në të gjithë infrastrukturën fizike dhe institucionale që kanë mundësuar parametra me cilësore shërbimeve publike dhe sjelljes qytetare. Shqipëria është sot një vend më i sigurt për të gjithë qytetarët që jetojnë në territorin e saj, për jetën, bizneset dhe pronat e tyre, për investimet e huaja dhe turistët që e vizitojnë atë.

Drejtimet kryesore të politikave:

- Parandalimi dhe forcimi i masave të sigurisë në shkolla nëpërmjet zbatimit të paketës së sigurisë në shkolla;
- Përmirësimi i sistemit Menaxhimit Policor të Çështjes;
- Përmirësimi i mëtejshëm i sistemit të Komisariatit Digjital;
- Parandalimi nëpërmjet evidentimit dhe ndërgjegjësimit i orientuar nga inteligjenca dhe informacioni;
- Përdorimi i teknologjive të reja për kontrollin e territorit;
- Siguria e sezonit turistik gjithëvjetor;
- Siguria e komunitetit me fokus të shtrirë në identifikim dhe parandalim;
- Siguria në kuadër të kontrollit të territorit për veprimtari të paligjshme;
- Siguria në kuadër të parandalimit të ngacmimeve dhe dhunës seksuale fizike, psikologjike apo në hapësirat kibernetike;
- Siguria e komunitetit në kuadër të menaxhimit të qarkullimit rrugor dhe ndërgjegjësimit;
- Siguria e komunitetit në kuadër të përballimit të emergjencave;
- Institucionalizimi dhe funksionimit të KVSP-ve;
- Analizimi i kuadrit ligjor, organizativ, të sigurisë publike në nivel qendror dhe vendor si dhe përgjegjësitë përkatëse të institucioneve në fushën e sigurisë;
- Orientimi i veprimtarisë së Prefektit të Qarkut për mbështetjen dhe implementimin e nismës së qeverisë *"Smart City"*.

Ndër prioritetet e përcaktuara për vitin 2026 ngritja dhe funksionimi i plotë i këshillave vendorë të sigurisë publike në të gjitha njësitë administrative në vend dhe Këshillit Kombëtar të Sigurisë në Komunitet, krijimi i një mekanizmi efektiv për monitorimin e zbatimit të paketës së sigurisë në shkolla, rritja e rolit të oficerëve të Sigurisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, rritjen e parametrave të sigurisë rrugore dhe reduktimin e numrit të aksidenteve me pasoja fatale, nëpërmjet digjitalizimit të monitorimit të akseve rrugore (radarët, makinat inteligjente dhe dronët), nëpërmjet zbatimit të projektit "Sistemi i kamerave në administrim të Policisë së Shtetit *Smart City*" zbatimi dhe implementimi i fazës së tretë të programit suedez me afat 2 vjeçar "Fuqizimi i Policimit në Komunitet".

Në proces konsultimi publik aktualisht janë dy projektligje:

- Projektligji **"Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2016, 'Për prefektin e Qarkut', të ndryshuar"**

Projektligji ka efekte financiare në buxhetin e shtetit për ngritjen e administratës së Prefektit Detar me seli në Durrës dhe Vlorë, që përballohen brenda tavaneve buxhetore të Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028, për Ministrinë e Punëve të Brendshme.

- Projektligji **"Për policinë bashkiake"**

Miratimi i këtij projektligji nuk shoqërohet me efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit lidhur me Policinë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore.

5. Specializimi inteligjent dhe avantazhi krahasues

- Nga koncepti tek kuadri i politikës, konteksti ndërkombëtar

Ideja e specializimit inteligjent u zhvillua mbi idetë e ekonomistëve klasikë (avantazhi krahasues dhe tregtia e lirë), të cilët theksuan nevojën e fokusimit në ato aktivitete ose fusha në të cilat kombet ose rajonet ishin më të afta sesa në ato aktivitete ku ato ishin më të dobëta.

Në nëntor 2009, Komisioni Evropian publikoi raportin "Dija për Rritjen", që publikonte rezultatet e një grupi këshillimor ekspertësh në BE. Të ngarkuar me gjetjen e një alternative për politikat publike që deri atëherë ishin parë (dëshmuar) se i shpërndanin dobët investimet publike në njohuri dhe inovacion, kërkime, edukim, mbështetje publike për kërkimin dhe zhvillimin e biznesit etj., te fusha të tilla, si bioteknologjia, ICT dhe nanoteknologjia, grupi i ekspertëve propozoi që qeveritë kombëtare dhe veçanërisht ato rajonale duhet të inkurajojnë investimet në fusha që do të "plotësonin asetet e tjera produktive të vendit për të krijuar aftësitë e ardhshme të brendshme dhe avantazhin krahasues ndërrajonal".

Ky propozim strategjik u emërtua "specializimi inteligjent" dhe ai u përhap shpejt dhe u miratua në Agjendën e BE-së 2020 me objektivat e saj të rritjes së zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse *(smart, sustainable and inclusive)*.

Në të vërtetë, Strategjitë e Kërkimit dhe Inovacionit për Specializimin Inteligjent propozohen si një kusht *ex-ante* për programet e ardhshme të Fondeve Strukturore të BE-së me synimin për të përqendruar burimet në kërkimin dhe inovacionin për të maksimizuar impaktin e fondeve strukturore. Megjithatë, çështjet e ngritura nga specializimi i zgjuar shkojnë përtej diskutimit në kontekstin e BE-së. Një numër vendesh, brenda OECD-së ose jo, tani po interesohen për Specializimin Inteligjent si një mënyrë për të nxjerrë ekonomitë e tyre nga kriza duke përdorur dinamizmin rajonal për zhvillimin intensiv ekonomik të udhëhequr nga dija dhe inovacioni.

Në këtë kuadër, **Strategjia e Specializimit Inteligjent (S3)** përbën instrumentin kryesor të politikave publike për orientimin e inovacionit drejt sektorëve me potencial të lartë zhvillimi, bazuar në avantazhet konkurruese të vendit dhe në një proces gjithëpërfshirës të zbulimit sipërmarrës *(Entrepreneurial Discovery Process)*. Përmes S3, inovacioni nuk trajtohet si një qëllim në vetvete, por si një mjet transformues për zhvillimin ekonomik, duke lidhur kërkimin shkencor, biznesin, institucionet publike dhe shoqërinë civile në një qasje të koordinuar të "*quadruple helix*" – helika e katërfishtë. Zbatimi i S3 mundëson përqendrimin e burimeve publike dhe private në fusha prioritare, rrit ndërveprueshmërinë me politikat dhe programet e Bashkimit Evropian, dhe krijon kushtet për ndërkombëtarizimin e ekosistemeve inovative shqiptare, duke siguruar një zhvillim më të balancuar territorial dhe një impakt të qëndrueshëm ekonomik e social.

EDP është ajo që e dallon specializimin inteligjent nga politikat tradicionale industriale dhe të inovacionit duke garantuar një proces ndërveprues me të gjithë aktorët e helikës së katërfishtë që synon vlerësimin e vizionit, përgatitjes dhe aftësitë së tregut dhe aktorëve të përfshirë në të për bërë dhe aplikuar inovacionin dhe transformimin teknologjik me qëllim zhvillimin e ekonomisë, shfrytëzimin e potencialeve ekzistuese dhe kthimin e investimit në inovacion dhe teknologji në sektorët prioritarë në një vlerë të shtuar për ekonominë.

Strategjitë e specializimit inteligjent kanë një qasje nga "poshtë-lart" që garanton angazhimin dhe vlerësimin e të gjithë aktorëve në procese dhe vendimmarrje duke tejkaluar politikat industriale tradicionale.

Ashtu si politikat tradicionale industriale, strategjitë e specializimit inteligjent synojnë të adresojnë tregun/sistemet dhe dështimet e koordinimit. Por politikat tradicionale industriale kërkonin nivele të konsiderueshme informacioni për të justifikuar mbështetjen e subvencioneve dhe ato priren të zbatohen në sektorë të integruar vertikalisht me paradigma teknologjike të qëndrueshme. Në të kundërt, specializimi inteligjent njeh mungesën e informacionit të përsosur, të nivelit të avancimit të një aktiviteti të caktuar dhe risqet relative për politikat. Kështu, ai përqendrohet në ndihmën ndaj sipërmarrësve dhe aktorëve të tjerë të helikës së katërfishtë në mënyrë që këta të identifikojnë pikat e tyre të forta të bazuara në njohuri në nivel

rajonal dhe të zhvillojnë një qasje më eksploruese në të cilën vendimmarrësit publikë dëgjojnë sinjalet e tregut duke përdorur një sërë instrumentesh vlerësimi (p.sh. analiza SWOT, sondazhe) dhe mekanizma të tillë, si partneriteti publik-privat, prognoza dhe hartëzimi teknologjik etj.

Kjo qasje e re e aplikuar në vendet e BE pikërisht për arsyet e sipërcituara është përfshirë dhe si pjesë e 3 kapitujve të integrimit në BE (kapitulli 20 "Ndërmarrjet dhe Politikat Industriale", kapitulli 22 "Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore" dhe kapitulli 25 "Shkenca dhe Kërkimi"), si dhe pjesë e Agjendës së Inovacionit të BE-së për Ballkanin Perëndimor 2021–2027.

6. Strategjia Kombëtare e Specializimit Inteligjent "S3" 2025–2030

Strategjia Kombëtare për Specializimin Inteligjent (S3) 2025–2030 u miratua nga qeveria në dhjetor 2024. Ajo synon të transformojë Shqipërinë në një qendër të inovacionit, kërkimit shkencor dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke rritur lidershipin e saj rajonal. Kjo strategji është hartuar për të identifikuar dhe zhvilluar fusha prioritare me potencial të lartë për rritje dhe inovacion, duke përfshirë sektorët strategjikë si energjia e rinovueshme dhe burimet natyrore, turizmi i qëndrueshëm dhe zinxhiri i ushqimit të shëndetshëm, si dhe prioritete horizontale që mbështesin prioritetet e sipërcituara dhe në tërësi zhvillimin ekonomik dhe inovativ të vendit.

Qasja S3 përfaqëson një koncept të politikës së inovacionit të bazuar në vend dhe identifikon fushat kyçe të zhvillimit, të njohura si fusha prioritare, për ndërhyrje publike dhe private, ku investimi në inovacion përbën një vlerë të shtuar për ekonominë dhe zhvillimin kompetitiv të vendit. Strategjia promovon lidhjet ndërsektoriale dhe diversifikimin përtej industrive tradicionale. Procesi i Zbulimit të Sipërmarrjes (EDP), një kornizë pjesëmarrëse dialogu gjithëpërfshirëse midis palëve të interesuara të territorit, përfshin të gjitha palët e interesuara të helikës së katërfishtë nga: qeveria, sektori privat, akademia dhe shoqëria civile, të cilat kontribuojnë bashkërisht në këtë proces.

Shqipëria filloi udhëtimin e saj drejt S3 në vitin 2016, e mbështetur nga TAIEX dhe u regjistrua në platformën për S3 të JRC në 2017. Ky proces përfaqëson një nismë të rëndësishme në fushën e inovacionit dhe zhvillimit inteligjent të ekonomisë për të përballuar sfidat shoqërore dhe për të shfrytëzuar inovacionin në një kontekst të ndryshimeve globale.

Duke përdorur kuadrin e ofruar nga JRC-ja, Shqipëria zhvilloi një Udhërrëfyes kombëtar S3 me një perspektivë rajonale, duke u mbështetur dhe në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030 (SKZHIE). S3, i pozicionuar si një ombrellë strategjike, ka për qëllim të nxisë inovacionin dhe sipërmarrjen, duke mbështetur njëkohësisht dhe objektivat e Shqipërisë për integrim në BE.

Sipas Udhërrëfyesit S3, Shqipëria finalizoi hapat e parë të analizës së kontekstit, nëpërmjet hartëzimit sasior dhe cilësor të potencialit ekonomik, inovativ, shkencor dhe teknologjik të vendit, duke identifikuar fushat e mundshme prioritare vertikale dhe horizontale të S3 që do të eksplorohen më tej gjatë fazës së EDP-së si më poshtë:

- Bujqësia, peshkimi dhe akuakultura;
- Prodhimtaria;
- Energjia;
- Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit mbështetës (Turizëm);
- TIK;
- Aktivitetet administrative dhe të shërbimeve mbështetëse (BPO).

Fushat ndërsektoriale që u evidentuan përfshijnë: ekonominë blu, ushqimin e shëndetshëm, energjinë e rinovueshme dhe aktivitetet administrative dhe të shërbimeve mbështetëse të zgjeruara (BPO).

Inputet e ofruara nga EDP plotësuan gjetjet nga faza e hartëzimit dhe shërbyen si bazë për hartimin e S3.

Duke njohur rëndësinë e këtij procesi për Qeverinë Shqiptare dhe spektrin e gjerë të sektorëve të përfshirë nga S3, me Urdhrin e Kryeministrit nr. 17, më 7 shkurt 2023 u krijua një Komitet Ndërministror për S3. Ky komitet mbështetet nga Ekipi Kombëtar i S3.

Për fazën e EDP-së, u ndoq një metodologji konsultimi e përshkruar nga manuali i JRC-së së KE-së, duke prezantuar një qasje të re që angazhoi të gjitha palët e interesuara të heliksit të katërfishtë, me një qasje nga poshtë-lart që nga hapat e parë të zhvillimit të strategjisë, duke organizuar nga tetori 2022 deri në tetor 2023, 33 evente me aktorë të helikës së katërfishtë (qeverisja qendrore dhe vendore, akademia, biznesi dhe shoqëria civile). Më shumë se 1600 përfaqësues të sektorëve të ndryshëm morën pjesë aktivisht në këto takime, duke pasur kështu një impakt të jashtëzakonshëm dhe duke gjeneruar propozime konkrete për t'u përfshirë në strategji. Të gjitha eventet e planifikuara për fazën e EDP (29 evente kombëtare dhe 3 *workshop*-e dypalëshe rajonale me vendet fqinje, Kosovën, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut), u përfunduan me sukses deri në korrik 2023, siç parashikohej në udhërrëfyesin e S3. Këto evente u lehtësuan nga ekspertë kombëtarë të S3, të cilët gjithashtu luajtën një rol vendimtar në mbledhjen e të dhënave. Procesi i EDP-së u vlerësua shumë nga aktorët e helikës së katërfishtë dhe konsiderohet si një hap i rëndësishëm drejt bashkëpunimit dhe rrjetëzimit ndërsektorial midis aktorëve kryesorë në fushat prioritare. Nisur nga kjo përvojë e vlefshme, qasja nga poshtë-lart do të shërbejë si metodologjia kryesore e konsultimit me palët e interesuara për strategjitë kryesore dhe dokumentet e politikave në Shqipëri në vijimësi. Kjo fazë u shoqërua me hartimin e një raporti, i cili shërbeu si bazë për strategjinë, i cili u validua dhe nga JRC. Gjithashtu, Ekipi Kombëtar i S3 dhe koordinatorët nga institucionet pjesë e Komitetit Ndërministror realizuan më 1 shtator 2023, një takim njëditor për të diskutuar gjetjet dhe për të zhvilluar propozime në lidhje me prioritetet për Komitetin Ndërministror të S3.

Një event përmbyllës i EDP-së u mbaj më 31 tetor 2023, ku iu prezantuan rezultatet e EDP-së të gjitha palëve të interesuara që morën pjesë në këtë faze, si dhe u prezantuan hapat e ardhshëm drejt finalizimit të S3, bazuar në njohuritë nga raporti i gjeneruar gjatë fazës së EDP-së dhe rezultatet e takimeve dypalëshe me vendet fqinje. Në këtë aktivitet gjithëpërfshirës morën pjesë aktorë nga helika e katërfishtë: ministra dhe zyrtarë të lartë të Qeverisë dhe përfaqësues të agjencive dhe institucioneve pjesë e Komitetit Ndërministror S3, rektorë dhe përfaqësues të tjerë të akademisë, shoqatave, biznesit dhe shoqërisë civile. Në konferencë morën pjesë edhe ambasadorë dhe përfaqësues të misioneve diplomatike në Shqipëri, të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë dhe organizatave ndërkombëtare.

Gjatë EDP-së u identifikuan prioritetet e S3 të cilat u diskutuan dhe miratuan nga Komiteti Ndërministror.

Prioritetet vertikale:

- Energjia e rinovueshme dhe burimet natyrore.

Nënsektorët:

- Energjia e rinovueshme.

Lëndët e para (kërkim, shfrytëzim dhe përpunim), pjesë e zinxhirit të furnizimit të BE-së:

- Ruajtja e mjedisit;
- Zinxhiri ushqimor i shëndetshëm dhe i qëndrueshëm.

Nënsektorët:

- Bujqësia organike e qëndrueshme dhe certifikimi;
- Përpunimi i ushqimit dhe produktet me vlerë të shtuar;
- Peshkimi dhe akuakultura e qëndrueshme;
- Prodhimi i bimëve aromatike mjekësore, vajrave dhe ekstrakteve;
- Turizmi i qëndrueshëm dhe i larmishëm.

Nënsektorët:

- Trashëgimia dhe traditat kulturore;
- Turizmi shëndetësor;

- Kulinaria (e kombinuar me bujqësinë, ushqimin, sigurinë ushqimore);
- Turizmi natyror dhe rural (agroturizëm, turizmi i aventurës dhe sportiv etj.).

Parakushtet për një S3 të suksesshëm:

- Përmbysja e tendencës drejt emigrimit dhe braktisjes së zonave rurale nga të rinjtë;
- Përmirësimi i kontekstit për akses në financa dhe kredi;
- Forcimi i infrastrukturës së rrjetit: aksesi në internet *broadband*, infrastruktura e transportit, transporti publik, logjistika dhe shërbimi shëndetësor;

Masat/prioritetet horizontale/ndërsektoriale:

- Kapitali njerëzor;
- Angazhimi i diasporës;
- Mbajtja e talenteve;
- Edukimi dhe aftësitë (rishikimi i kurrikulës, ngritja e aftësive, rikualifikimi);
- Ekonomia blu dhe jeshile;
- Tranzicioni i gjelbër;
- Ruajtja e burimeve natyrore;
- Gjurmë e reduktuar e karbonit;
- Shërbime teknologjike digjitale të avancuara;
- Përparimet në AI dhe *machine learning;*
- Transformimi digjital i ekonomisë lokale;
- Rritja e kapaciteteve eksportuese.

Masat horizontale/ndërvepruese në lidhje me përmirësimin e ekosistemit kombëtar të inovacionit:

- Korniza e politikave industriale/inovative;
- Kuadri legjislativ/rregullator sipas standardeve të BE-së;
- Skema nxitëse, mbështetje biznesi, derregullim;
- Forume, panaire dhe diplomaci ekonomike;
- Bashkëpunimi me helikën e katërfishtë;
- Strategjia e informimit dhe komunikimit;
- Platformat që mundësojnë bashkëpunimin, *cluster*-at
- Praktikat dhe proceset ekologjike/të qëndrueshme;
- Transferimi i teknologjisë;
- Rritja e rolit institucional të agjencive shtetërore;
- Mbështetja e produkteve "*Made in Albania*";
- Integrimi në zinxhirët globalë të vlerës.

Identifikimi i masave/ndërhyrjeve konkrete për planin e veprimit u finalizua në konsultim me aktorët kryesorë të helikës së katërfishtë për të garantuar transparencë dhe gjithëpërfshirje në çdo fazë të procesit. U realizuan më shumë se 120 takime individuale ose në grup me palët e interesuara e përfaqësues të qeverisë për të diskutuar masa specifike. S3 u hartua me mbështetjen e ekspertizës së JRC dhe projektit EU4I dhe drafti përfundimtar u konsultua me aktorët kryesorë të përfshirë në hartimin e planit të veprimit. Drafti përfundimtar i S3 u diskutua në Bllokun e Ekonomisë së Qeverisë dhe u përditësua më pas. Versioni përfundimtar iu dërgua JRC-së dhe komentet u pasqyruan në dokumentin e S3. S3 iu nënshtrua konsultimit publik dhe u miratua me vendim të Këshillit të Ministrave në dhjetor 2024.

Gjatë gjithë këtij procesi, Shqipëria ka marrë mbështetje të vazhdueshme nga stafi i JRC-së, si dhe në formën e sesioneve trajnuese dhe ekspertizës ndërkombëtare, që ka qenë thelbësore për procesin S3.

Strategjia e Specializimit Inteligjent të Shqipërisë, në përputhje me politikat evropiane dhe burimet e financimit, shpreh përkushtimin e vendit për të ndërtuar mbi parimet evropiane të zhvillimit ndërsa angazhohet në këtë rrugë. Ky përfaqëson një vizion, jo thjesht një strategji, për integrimin në kuadrin më të gjerë të Zonës Evropiane të Arsimit, Zonës Evropiane të

Kërkimit, Zonës Evropiane të Inovacionit dhe Tregut të Përbashkët Evropian. Strategjia e Specializimit Smart (S3) për Shqipërinë është krijuar për të harmonizuar me disa politika kyçe të BE-së, duke siguruar një qasje të koordinuar ndaj zhvillimit rajonal, inovacionit dhe rritjes ekonomike. S3 kontribuon dhe përputhet me disa nga këto politika si, Agjenda e Re Evropiane e Inovacionit; Politikat Industriale Evropiane; Marrëveshja e Gjelbër Evropiane; etj.

S3, gjithashtu, lehtëson tranzicionin e Shqipërisë drejt një ekonomie digjitale, duke përgatitur vendin për të kontribuar në vizionin e BE-së për një Evropë neutrale ndaj klimës deri në vitin 2050.

Perspektiva e Besueshme e Zgjerimit për Ballkanin Perëndimor thekson iniciativat për të nxitur sipërmarrjen dhe për të nxitur një ekonomi rrethore, duke përforcuar angazhimin e Shqipërisë me BE-në. Kjo është pjesë e Planit Ekonomik dhe Investimeve për Ballkanin Perëndimor, i cili synon të mbështesë reformat e nevojshme për integrimin në BE dhe krijimin e qëndrueshëm të vendeve të punës.

Për të mbështetur Shqipërinë në arritjen e objektivave S3, disa instrumente të BE-së janë vendimtare, si shembull:

1. Horizon Europe 2021–2027: Ky program ambicioz kërkimor inkurajon inovacionin dhe promovon përparimet teknologjike në përputhje me qëllimet S3.

2. Programi *LIFE*: Ndihmon zhvendosjen e Shqipërisë drejt një ekonomie të qëndrueshme, rrethore dhe neutrale ndaj klimës.

3. Programi i Evropës Digjitale (DEP): Ky program lehtëson integrimin e teknologjive digjitale në të gjithë sektorët, duke rritur qëllimet e transformimit digjital nën S3.

4. Evropa krijuese: Promovimi i diversitetit kulturor, mbështet sektorët kulturorë të Shqipërisë, duke rritur fuqinë e butë dhe aspektet e inovacionit të S3.

5. IPARD: Ky program ndihmon në zhvillimin rural dhe bujqësinë, duke u përafruar me objektivat e S3.

6. Erasmus+: Ai ofron mundësi thelbësore arsimore dhe trajnimi për të ndërtuar kapital njerëzor për objektivat e S3.

Nëpërmjet këtyre instrumenteve dhe rreshtimeve strategjike, S3 jo vetëm që vepron si një politikë e pavarur, por shërben si një komponent kritik i agjendës më të gjerë të Shqipërisë drejt konvergjencës së BE-së dhe rritjes së qëndrueshme socio-ekonomike. Duke shfrytëzuar këto burime, Shqipëria është e pozicionuar të ndikojë pozitivisht në trajektoren e saj të zhvillimit, duke përmbushur aspiratat e saj për integrim, duke nxitur inovacionin dhe qëndrueshmërinë.

Në kontekstin rajonal është i dukshëm fakti që të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor po avancojnë drejt strategjive të e tyre të Specializimit Inteligjent (S3), duke identifikuar fushat përkatëse prioritare. Këto përpjekje kërkojnë bashkëpunim ndërmjet qeverive, studiuesve, bizneseve dhe aktorëve shoqërorë për të nxitur inovacionin dhe rritjen rajonale. S3 ndihmon në përcaktimin e sektorëve prioritarë rajonalë në përputhje me pikat e forta kombëtare, duke mundësuar specializimin ku secili vend ka përparësi në burimet njerëzore dhe kapitale. Ndërkohë iniciativa të tjera kanë ndikuar në intensifikimin e bashkëpunimit, si shembull miratimi i Planit Shumëvjeçar të Veprimit për Zonën Ekonomike Rajonale (MAP REA) në Samitin e Triestes 2017, që synon nxitjen e investimeve rajonale, tregtisë dhe përafrimin me BE-në, miratimi në vitin 2020 të Planit i Veprimit i Tregut të Përbashkët Rajonal (CRM) 2021–2024 etj. Integrimi i S3 brenda këtyre kornizave siguron statusin e tij si një prioritet rajonal dhe kombëtar.

Potenciali për bashkëpunim i identifikuar përmes tri *workshope*-ve dypalëshe me Kosovën, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut:

1. Platforma dhe rrjete të përbashkëta – Zhvillimi i platformave të përbashkëta për kërkim dhe inovacion, veçanërisht në fushën e TIK-ut dhe përpunimit ushqimor, për të lehtësuar shkëmbimin e njohurive dhe projektet bashkëpunuese.

2. Marrëveshje dypalëshe dhe rajonale – Vendosja e marrëveshjeve formale për bashkëpunim në arsim, kërkim dhe adoptim teknologjie në të gjithë Ballkanin Perëndimor, me qëllim koordinimin e përpjekjeve dhe shfrytëzimin sa më efektiv të burimeve.

3. Financim nga BE-ja dhe programe rajonale – Shfrytëzimi i fondeve të BE-së dhe programeve rajonale për të mbështetur nisma të përbashkëta, zhvillimin e infrastrukturës dhe ndërtimin e kapaciteteve. Programet si "Agjenda e Ballkanit Perëndimor për Rininë, Sportin dhe Inovacionin 2021–2027" dhe "Plani i Veprimit për Tregun e Përbashkët Rajonal 2021–2024" janë thelbësore.

4. Promovimi i Specializimit Inteligjent mbi bazën e identifikimit të prioriteteve – Përdorimi i specializimit inteligjent për të identifikuar prioritetet me interes të përbashkët me vendet fqinje dhe për të ndërtuar rrugë konkrete bashkëpunimi.

5. Projekte për zhvillim të qëndrueshëm – Fokusimi në praktika të qëndrueshme në bujqësi, energji dhe lëndë të para, për të siguruar përfitime afatgjata ekonomike dhe mjedisore. Projekte të përbashkëta kërkimi dhe inovacioni në këto fusha mund të nxisin rritje të qëndrueshme.

Perspektiva rajonale thekson rëndësinë që Shqipëria dhe vendet fqinje të përqendrohen në nisma dhe përpjekje bashkëpunuese për të zhvilluar rezultate inovative që kontribuojnë në secilën ekonomi të Ballkanit Perëndimor dhe në rajonin në tërësi. Ideja është që secili vend të specializohet në një fushë ku ka më shumë avantazh dhe potencial, duke sjellë përfitime për rajonin dhe duke rritur avantazhin e tij konkurrues.

Komunikimi

Për të lehtësuar komunikimin efektiv dhe për të rritur vizibilitetin, është krijuar një faqe interneti e dedikuar për S3 https://s3albania.org/ e disponueshme në gjuhën shqipe dhe angleze.

Kjo faqe interneti ofron informacion të plotë në lidhje me procesin e S3, duke përfshirë detaje mbi të gjitha takimet e zhvilluara, lajmet, eventet e fokusuara në S3 dhe dokumentet relevante me interes për palët e interesuara.

Gjithashtu, çdo institucion i lidhur me Komitetin Ndërministror S3 ka inkorporuar një dritare për S3 në faqet e tyre të internetit, që lidhet me faqen e dedikuar të S3 të përmendur më lart.

S3 i janë kushtuar tri episode në programin "Auditor Arsimi" në Radio Televizionin Shqiptar (RTSH), një transmetim televiziv në A2Biznes (Ora Neës) dhe një sërë segmentesh lajmesh nëpër rrjete të ndryshme televizive. Gjithashtu, këto shfaqje mediatike, së bashku me mediat *online*, janë të aksesueshme përmes link-eve në faqen "Lajme" të faqes së internetit të S3.

Në janar 2024, nisi një program televiziv në RTSH1 me titull "Smart Albania" i programuar çdo javë në prime time dhe i konceptuar dhe organizuar në bashkëpunim me Ekipin Kombëtar të S3. Qëllimi i tij ishte të informonte publikun për profesionistët e arrirë, shqiptarë apo të huaj, të cilët kanë zgjedhur të ndërtojnë karrierën apo biznesin e tyre në Shqipëri. Transmetimi synonte jo vetëm të ndante histori të përpjekjeve të suksesshme, por gjithashtu të ofronte informacion rreth mundësive të ndryshme të disponueshme në fusha të ndryshme për sipërmarrje ose rritje profesionale. Për më tepër, ai synonte të trajtonte çështjen thelbësore të mbajtjes së kapitalit njerëzor dhe talenteve brenda vendit, një temë me rëndësi të konsiderueshme e diskutuar në të gjitha forumet e EDP-së mes aktorëve të helikës së katërfishtë. U transmetuan 22 episode.

Pjesë e S3 është gjithashtu një plan komunikimi me qëllim informimin dhe angazhimin e të gjitha palëve të interesuara në adresimin e sfidave dhe objektivave që kanë dalë nga konsultimet.

Si pjesë e përpjekjeve bashkëpunuese të Shqipërisë në rajon për arritjen e qëllimeve të përbashkëta, janë paraqitur propozime të shumta projektesh dhe sugjerime partneriteti. Ekipi i S3 është pjesë e *S3 CoP (S3 Community of Practice) Maritime Sustainable Blue BioEconomy*,

si dhe ka mbështetur nisma dhe iniciativa për pjesëmarrje në projekte, mbështetje për institucionet për realizimin e planit të veprimit dhe promovuar nismat përkatëse.

Strategjia e Specializimit Inteligjent zë një pozicion të spikatur në agjendën e Qeverisë Shqiptare, duke shërbyer si një mjet vendimtar për orientimin e investimeve të ardhshme në sektorët prioritarë dhe për avancimin e krijimit të një shoqërie të drejtuar nga dija.

Struktura e qeverisjes

Zbatimi i S3 udhëhiqet nga një model solid qeverisjeje. Ai përfshin:

1. Një *Komitet Ndërministror* i kryesuar nga Zëvendëskryeministri dhe i mbështetur nga Ekipi Shqiptar i S3, të krijuar të dy me urdhër të Kryeministrit:

a) *Komiteti Ndërministror* është organi më i lartë vendimmarrës, përgjegjës për validimin e rezultateve nga proceset e monitorimit, rishikimin dhe përditësimin e Planit të Veprimit, formimin e grupeve tematike të punës, angazhimin e ekspertëve të çështjeve, koordinimin me strategjitë sektoriale dhe iniciativat përkatëse, si dhe menaxhimin e buxhetimit afatmesëm dhe harmonizimin e mbështetjes së donatorëve për zbatimin e S3.

b) *Ekipi Kombëtar i S3*, drejton koordinimin teknik dhe është gjithashtu përgjegjës për përfaqësimin dhe raportimin kombëtar dhe ndërkombëtar mbi progresin e S3.

2. Një *Njësi Monitorimi e S3* e dedikuar brenda Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit. Kjo njësi do të ndjekë ecurinë e aktiviteteve të S3, përfshirë ato të financuara përmes Planit të Rritjes dhe do të veprojë si Sekretariat Teknik për Komitetin Ndërministror dhe do të sigurojë raporte të implementimit çdo 6 muaj.

Ekipi Kombëtar i S3 mban një dialog të strukturuar me institucionet drejtuese përgjegjëse për zbatimin e nismave të përshkruara në Planin e Veprimit të S3 dhe Njësinë e Monitorimit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, duke siguruar ndjekje efektive të progresit në implementimin e S3.

Ekipi Kombëtar i S3 punon ngushtë me përfaqësuesit e përcaktuar të ministrive në të dy nivelet administrative dhe politike, duke siguruar një proces implementimi të lehtë dhe të koordinuar, si dhe me rrjetin e koordinatorëve në institucione të ndryshme që janë pjesë e Komitetit, apo institucione/organizata të tjera që bëjnë pjesë në aktorët e *quadruple helix.* Ky rrjet lehtëson komunikimin efikas, koordinimin e aktiviteteve dhe siguron që të gjitha palët e përfshira të jenë të harmonizuara me objektivat e strategjisë dhe proceset e zbatimit të saj. Koordinatorët do të luajnë një rol kyç në lidhjen e përpjekjeve ndërinstitucionale dhe në forcimin e kuadrit bashkëpunues të nevojshëm për zbatimin e suksesshëm të S3. Rrjeti i koordinatorëve do të bashkëpunojë ngushtë dhe do të koordinohet nga Njësia e Monitorimit të S3.

Duke forcuar bashkëpunimet dhe partneritetet ndërkombëtare, si dhe bashkëpunimin e ngushtë me JRC, e cila ka mbështetur në mënyrë të vazhdueshme dhe efikase procesin e S3, modeli i qeverisjes do të sjellë gjithashtu praktikat më të mira dhe njohuritë globale në procesin e S3 në Shqipëri, duke konsoliduar rolin e saj si një model i inovacionit dhe zhvillimit të qëndrueshëm në kontekstin evropian.

DISA NGA INICIATIVAT MË TË RËNDËSISHME TË PLANIFIKUARA NË PLANIN E VEPRIMIT TË S3 QË PO ZBATOHEN

Qendrat e ekselencës

Strategjia e Specializimit Inteligjent (S3) parashikon ngritjen e dy Qendrave të Ekselencës – një për Nanoteknologjinë në Tiranë dhe një për Shkencat Biomarine në Vlorë. Të dyja qendrat janë përfshirë në listën indikative të projekteve të propozuara për *WBIF*/RGF, pasi përfaqësojnë një investim strategjik në infrastrukturën shkencore dhe teknologjike të Shqipërisë, duke hedhur bazat për rritje të mëtejshme dhe integrim në Hapësirën Evropiane të Kërkimit (ERA). Vendosja e një prej këtyre projekteve në Vlorë synon të diversifikojë infrastrukturën e kërkimit dhe inovacionit në vend, duke krijuar qendra shtesë kërkimore përtej Tiranës.

- Qendra e Ekselencës në Nanoteknologji ka si mision kryesor arritjen e ekselencës shkencore dhe teknologjike në nivel ndërkombëtar në fushën e nanoteknologjisë. Ky qëllim përfshin lehtësimin e integrimit dhe inovacionit në këto teknologji nga kompani shqiptare, të Ballkanit Perëndimor, të BE-së dhe më gjerë, për të adresuar sfida shoqërore, si dhe ofrimin e trajnimeve dhe zhvillimit të karrierës të nivelit më të lartë për studiuesit e rinj, duke krijuar një pol tërheqës për talentin vendas dhe ndërkombëtar.

- Qendra Ndërkombëtare e Ekselencës në Shkencat Biomarine, e cila do të vendoset strategjikisht përgjatë bregdetit shqiptar në Kanalin e Otrantos, synon të shndërrohet në një qendër ekselence për shkencat detare në zonën Adriatiko-Joniane. Ajo do të adresojë çështje kritike mjedisore si erozioni detar dhe ndotja e ujërave, duke promovuar njëkohësisht bashkëpunimin rajonal në detet Adriatik dhe Jon. Krijimi i kësaj qendre i përgjigjet nevojës urgjente për një qendër të dedikuar për shkencat detare në Shqipëri dhe në rajonin Adriatiko-Jonian, për të përmirësuar monitorimin mjedisor, për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe për t'u përafruar me standardet dhe politikat e Bashkimit Evropian. Qendra do të luajë gjithashtu një rol kyç në forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërtimin e një të ardhmeje të qëndrueshme për ekosistemet detare dhe bregdetare.

Ngritja e këtyre qendrave është tashmë e përfshirë në listën kombëtare të projekteve prioritare të Qeverisë, si dhe në Programin e Qeverisë 2025–2030.

Një kërkesë për bashkëfinancim nga *WBIF* është miratuar për të dyja qendrat (studimi i fizibilitetit dhe dizajni konceptual; 700,000 euro). Institucioni financiar ndërkombëtar i interesuar është Banka për Zhvillim e Këshillit të Evropës (CEB). Projekti është gjithashtu pjesë e listës indikative të *Growth Facility Reform (RGF)*, duke mundësuar mbështetje deri në 30% nga grantet e *WBIF*. Pritet konfirmimi i projekteve të përzgjedhura për mbështetje nga *WBIF* deri në nëntor 2025.

Së shpejti do të miratohet një task-forcë për secilën qendër, e përbërë nga përfaqësues të nivelit të lartë institucional dhe ekspertë, për të lehtësuar procesin e ngritjes së secilës qendër.

Laboratorë kombëtarë universitarë të certifikuar

Po ngrihen dy laboratorë kombëtarë universitarë të certifikuar në Universitetin e Mjekësisë në Tiranë dhe në Universitetin Bujqësor të Tiranës, të financuar nga AKSHI përmes një programi të infrastrukturës kërkimore të mbështetur plotësisht nga buxheti i shtetit. Këta laboratorë do të shërbejnë si qendra kërkimore për bujqësinë dhe shkencat farmaceutike, si dhe si qendra shërbimesh të hapura për komunitetin e biznesit, duke ofruar shërbime testimi për produkte bujqësore dhe farmaceutike, me një rol kyç në avancimin e të dy sektorëve në Shqipëri.

Laboratori i Universitetit të Mjekësisë ka përfunduar fazën e prokurimit të pajisjeve, ndërsa laboratori i Universitetit Bujqësor ndodhet ende në fazën e prokurimit të pajisjeve.

Angazhimi i diasporës për të kontribuar në kuadër të integrimit në BE përmes programit IOM

Ekipi Kombëtar S3 dhe institucionet udhëheqëse për masat/aktivitetet e S3 janë mbështetur nga programi i IOM, i cili asiston administratën publike përmes angazhimit të ekspertëve të diasporës shqiptare. Si rezultat, janë përgatitur dokumente zbatimi dhe është ofruar asistencë e targetuar për institucione, si: MSHMS, ME, MIE, MFA, MEPJ, si dhe për bashkitë Vlorë dhe Dibër, për masa që lidhen me:

- ngritjen e qendrave të integruara të kujdesit shëndetësor parësor në zonat rurale, të cilat përmirësojnë shërbimet përmes telemjekësisë dhe transferimit të mostrave laboratorike dhe shpërndarjes së barnave përmes postës ose dronëve;
- organizimin e kampeve verore dhe kampeve *scouting* në Vlorë dhe Dibër për fëmijët, me të paktën 50% të vendeve të rezervuara për fëmijë të familjeve të diasporës;
- hartimin e stimujve për kthimin e profesionistëve të diasporës;

- hartimin e stimujve për nxënësit e arsimit parauniversitar, të lidhur me arritjet në mësim, zhvillimin e talenteve dhe rezultatet në gara, si dhe me kontributet në riciklim, iniciativa mjedisore dhe angazhimin komunitar;

- zhvillimin e skemave bonus për studentët që kthehen për të punuar në vendlindje pas përfundimit të studimeve profesionale ose të arsimit të lartë;

- vendosjen e një sistemi shpërblimesh me grante dhe çmime për studentët që shkëlqejnë në gara kombëtare dhe ndërkombëtare në fusha të ndryshme;

- zhvillimin e të dhënave statistikore të standardizuara në arsimin e lartë nga INSTAT-i, përfshirë krijimin e një platforme digjitale për mbledhjen dhe standardizimin e të dhënave;

- zhvillimin e iniciativave që lidhen me diasporën.

Qendra rajonale e inovacionit e EIT *Raw Materials* – Përshpejtimi i Inovacionit dhe Përafrimi me BE-në

Qendra EIT Raw Materials në Shqipëri është plotësisht funksionale dhe vepron si një nxitës kyç i inovacionit, zinxhirëve të qëndrueshëm të furnizimit dhe zhvillimit sektorial.

Kontributet kryesore:

- Harta e CRM/SRM: Në partneritet me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Qendra po udhëheq hartimin e planit kombëtar për Lëndët e Para Kritike dhe Strategjike. Faza I (deri në tetor 2025) përfshin hartëzimin e depozitave, vlerësimin e kapaciteteve përpunuese dhe përafrimin e potencialit kombëtar me kërkesën e BE-së. Faza II, e mbështetur nga IPA III (2025–2027), do të ofrojë të dhëna të detajuara për politikëbërjen dhe do të udhëzojë Strategjinë Minerare 2025–2030.

- Bashkëpunimi me BE-në: Përmes një misioni ekspertësh TAIEX në dhjetor 2024, ekspertë ndërkombëtarë dhe institucione kombëtare ndanë praktika të mira dhe të dhëna për hartimin e planit.

- Lehtësimi i biznesit dhe investimeve: Organizim takimesh B2B, pritje investitorësh dhe nënshkrim marrëveshjesh bashkëpunimi me partnerë të BE-së dhe Institucionet e Arsimit të Lartë vendase.

Mbështetje për propozime IPA III: Asistencë për përgatitjen e një propozimi prej 8 milionë eurosh për eksplorim dhe përpunim të CRM/SRM.

Ndërtimi i kapaciteteve: Promovim programesh *Erasmus Mundus,* dorëzim i 7 propozimeve në *Horizon Europe* (përfshirë RISPECT, i financuar për 2025–2026), dhe organizim sesionesh informuese për programet e BE-së.

Qendra shërben si një urë lidhëse mes potencialit të Shqipërisë në lëndë të para dhe prioriteteve strategjike të Evropës, duke kontribuar ndjeshëm në zbatimin e Planit të Veprimit të S3 në fushën prioritare të lëndëve të para.

Në kuadër të Planit të Veprimit të S3, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar ka ndërmarrë projekte të financuara nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për eksplorimin e litiumit, të identifikuar si element kyç në listën e Lëndëve të Para Kritike.

Qendra rajonale e inovacionit e *EIT Food*

S3 parashikon hapjen e EIT KICs në fushat prioritare të S3. Në këtë kontekst Ekipi S3 po zhvillon diskutime me *EIT Food* për hapjen e qendrës rajonale të inovacionit të EIT Food në Shqipëri, të ngjashëm me atë të hapur për *EIT Raë Materials*. Diskutimet janë në vijim.

Hapja e një *hub*-i rajonal të EIT Food në Shqipëri do ta lidhte drejtpërdrejt vendin me rrjetet e inovacionit agroushqimor të BE-së, duke mundësuar akses në programet e EIT dhe duke forcuar aplikimet për *Horizon Europe* dhe fonde të tjera. Ajo do të përshpejtonte zhvillimin e *startup*-eve dhe SME-ve përmes inkubimit, testbed-eve dhe matchmaking B2B; do të ndihmonte fermerët dhe industrinë në adoptimin e teknologjive klimatike inteligjente; do të përmirësonte cilësinë, gjurmueshmërinë dhe gatishmërinë për eksport; do të forconte transferimin e teknologjisë nga Institucionet e Arsimit të Lartë dhe qendrat kërkimore; do të zhvillonte aftësitë e fuqisë punëtore dhe angazhimin e konsumatorëve; dhe do të shërbente si

një motor praktik për zbatimin e S3 dhe përafrimin me Marrëveshjen e Gjelbër të BE-së, duke pozicionuar Shqipërinë si një qendër rajonale për inovacion të qëndrueshëm në agroushqim.

Ligji për dhomat e tregtisë

Qeveria Shqiptare, në bashkëpunim me Këshillin Kombëtar të Ekonomisë, ka përgatitur projektligjin për Dhomat e Tregtisë, me qëllim përmirësimin e organizimit dhe përfaqësimit të komunitetit të biznesit. Ligji garanton, gjithashtu, ofrimin e shërbimeve thelbësore për ndërmarrjet dhe forcon rolin e biznesit në dialogun publik-privat, duke krijuar një entitet të dedikuar për përfaqësimin e një prej shtytësve kryesorë të zhvillimit ekonomik.

Projektligji promovon integrimin e bizneseve në tregun e BE-së, ndërkombëtarizimin, mekanizmat alternativë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe një qasje të re në mbështetjen e biznesit përmes arsimit profesional dhe trajnimit nga vetë dhomat e tregtisë. Kjo nismë përbën një kontribut të rëndësishëm në zbatimin e objektivave të S3, duke transformuar peizazhin e mbështetjes dhe përfaqësimit të biznesit dhe duke forcuar bashkëpunimin brenda kuadrit të *"quadruple helix"*.

Banka Shqiptare e Zhvillimit – Instrument Strategjik për Transformimin Ekonomik

E themeluar me ligjin nr. 23/2025, Banka Shqiptare e Zhvillimit pozicionohet si një institucion kyç dhe instrument strategjik për përshpejtimin e transformimit ekonomik të vendit dhe rritjen e konkurrueshmërisë në kuadër të integrimit në tregun e vetëm evropian.

Banka është në pronësi shumicë të Qeverisë Shqiptare (të paktën 51%), me kapital fillestar prej 100 milionë eurosh nga shteti dhe financime shtesë nga institucione financiare ndërkombëtare, përfshirë bashkëpunimin me BERZH-in dhe shtetet anëtare të BE-së. Banka do të ketë mandat zhvillimor, duke përmirësuar aksesin në financa për sektorët e nënfinancuar, mbështetur projektet strategjike të investimeve, modernizimin e infrastrukturës dhe eksportet, me fokus të veçantë te SME-të dhe *startup*-et.

Banka do të luajë gjithashtu një rol qendror në thithjen dhe shpërndarjen e fondeve të BE-së, duke kontribuar ndjeshëm në zhvillimin ekonomik kombëtar dhe në zbatimin e objektivave dhe nismave të Planit të Veprimit të S3.

Iniciativa të tjera

Një numër i konsiderueshëm iniciativash në fushën e energjisë, digjitalizimit dhe lidhshmërisë, pjesë e Planit të Veprimit të S3, janë përfshirë në listën indikative të propozuar në kuadër të *WBIF*/RGF.

KREU II

2.1 PËRPARËSITË AFATSHKURTRA DHE AFATMESME TË QEVERISË

1. Menaxhimi i Financave Publike

Totali i shpenzimeve publike për vitin 2026 është planifikuar 886.7 miliardë lekë ose 31.9% e PBB. Investimet Publike për vitin 2026 janë planifikuar në masën 6.5% e PBB ose 179.8 miliardë lekë (duke përfshirë këtu dhe fondin e rindërtimit në shumën 5 miliardë lekë dhe 6.8 miliardë lekë financime të pritshme mbi bazë projektesh nga Plani i Rritjes me BE). Në planifikimin e investimeve për vitin 2026 janë mbajtur në konsideratë të gjitha detyrimet kontraktuale për projektet e investimeve me financim të huaj dhe të brendshëm dhe do të ketë përparësi financimi i projekteve në vazhdim. Në raport me buxhetin e rishikuar të vitit 2025, vëllimi i investimeve publike në vitin 2026 parashikohet me rreth 15.5 miliardë lekë më shumë.

Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes për qeverisjen qendrore për vitin 2026 (pa përfshirë shpenzimet që realizohen nga institucione publike, që kanë si burim financimi të ardhurat jashtë limitit), janë parashikuar në masën 80.7 miliardë lekë ose rreth 2.9% e PBB-së. Në këtë zë është programuar mbështetja me prioritet e politikave ekzistuese të qeverisjes qendrore si: skema e fermerëve, mirëmbajtja e rrugëve nacionale, mirëmbajta e sistemeve të

teknologjisë së informacionit dhe siguria kibernetike, programet e nxitjes së punësimit, skemat për mbështetjen e zhvillimit ekonomik dhe mbështetje për arsimin dhe sportin.

Shpenzimet e buxhetit vendor për vitin 2026 janë parashikuar në masën 97.7 miliardë lekë, duke shënuar një rritje prej 9% krahasuar me buxhetin e vitit 2025. Këto shpenzime përfaqësojnë 3.52% të Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), nga 3.4% që përfaqësonin në vitin 2025 dhe 2.3% në vitin 2015. Transferta e pakushtëzuar për vitin 2026 është parashikuar në vlerën 27.8 miliardë lekë, që përbën një rritje prej 1.6 miliardë lekësh ose rreth 6% më shumë se në vitin 2025. Krahasuar me vitin 2015, si viti para zbatimit të reformës administrativo-territoriale, kjo transfertë është rritur me 15.5 miliardë lekë, ose më shumë se dyfish.

Përveç transfertës së pakushtëzuar, në vitin 2026 parashikohen edhe këto fonde shtesë:

- 13.8 miliardë lekë si transfertë e pakushtëzuar sektoriale për funksionet e reja;
- 200 milionë lekë si grant performance, që përdoret si mekanizëm financiar për nxitjen e performancës në qeverisjen vendore;
- 5.5 miliardë lekë si transfertë sektoriale për rritjen e pagave.

Në total, granti nga buxheti i shtetit për pushtetin vendor në vitin 2026 do të arrijë në 47.3 miliardë lekë, nga 43.1 miliardë lekë në vitin 2025, një rritje prej 4.2 miliardë lekësh ose 9.7%.

Shpenzimet e fondeve speciale që përfshin shpenzimet totale për Fondet e Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe kompensimin në vlerë të ish-pronarëve, janë planifikuar në vlerën prej 286.6 miliardë lekësh. Niveli i shpenzimeve për Skemën e Sigurimeve Shoqërore për vitin 2026, parashikohet në masën 204.1 miliardë lekë ose 7.3% e PBB. Nga ky fond, për indeksimin e pensioneve është parashikuar niveli prej 1.65 miliardë lekësh dhe 10 miliardë lekë për bonusin mujor për pensionistët. Ndërsa, shpenzimet e Skemës së Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për vitin 2026 janë parashikuar në masën 67.3 miliardë lekë ose 2.4% e PBB-s. Për vitin 2026, në buxhetin e FDSKSH-së është planifikuar një shtesë prej 1.5 miliardë lekësh, respektivisht 500 milionë lekë për rimbursimin e barnave onkologjike në shërbimin parësor dhe 1 miliardë lekë për shërbimin spitalor për sigurimin e barnave onkologjike.

Së fundi, shpenzimet për Fondin e Kompensimit në vlerë të pronarëve parashikohen në total në masën 3.5 miliardë lekë ose 0.1% e PBB-së.

Shpenzime të tjera sociale, përfshin fondet për pagesën e papunësisë, aftësisë së kufizuar, ndihmës ekonomike, dëmshpërblimin e ish-të përndjekurve politikë dhe bonusin e lindjeve.

- Shpenzimet për pagesën e papunësisë parashikohen në nivelin 1 miliard lekë;
- Shpenzimet për pagesën e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar parashikohen në nivelin 23.9 miliardë lekë ose 0.9% e PBB-së;
- Për ish-të përndjekurit është parashikuar një fond prej 1.5 miliardë lekësh ose 0.1% e PBB-së;
- Për bonusin e lindjeve është parashikuar një fond prej 2.3 miliardë lekësh ose 0.1% e PBB-së.

Shpenzimet për subvencione janë parashikuar në masën 2.45 miliardë lekë ose rreth 0.1% e PBB-së. Subvencionet shtetërore për vitin 2026 janë përqendruar në financimin e skemave të nxitjes së punësimit, mbështetjen e sektorit të ujësjellës-kanalizimeve bazuar në performancën e tij, si dhe në mbulimin e një pjese të shpenzimeve të veprimtarisë hekurudhore dhe veprimtarisë së shërbimeve qeveritare. Krahasuar me vitin 2025, ky zë shoqërohet me një rritje prej 500 milionë lekësh, ku 450 milionë lekë i alokohen subvencionit për programet e nxitjes së punësimit për të përmbushur angazhimet në kuadër të Planit të Rritjes me BE-në, si dhe për përballimin e efektit të indeksimit të rritjes së pagës minimale.

Niveli i fondit rezervë për vitin 2026, planifikohet në masën 2.5 miliardë lekë ose 0.1% e PBB-së.

Financimi për disa sektorë të rëndësishëm:

Arsimi me 3.2% të PBB-së për vitin 2026, ku shpenzimet totale të sektorit parashikohen të jenë 89.8 miliardë lekë nga 85.5 miliardë të planifikuar në buxhetin e rishikuar 2025.

Në këtë sektor do të financohen me përparësi gjatë vitit 2026, përveç përfshirjes së indeksimit të pagave për vitin 2026, politikat si vijon:

- Ofrimi i teksteve shkollore falas për rreth 220 mijë nxënës që ndjekin arsimin bazë nga klasa e parë në klasën e nëntë, si dhe tekste shkollore falas për rreth 16 mijë nxënës nga shtresa sociale në nevojë në arsimin e mesëm të lartë;
- Ofrimi i bursave financiare apo kuotës ushqimore/financiare për 4000 nxënës me nevoja të veçanta;
- Sigurimi i shërbimit të transportit për 35,000 fëmijë dhe nxënës që kanë vendbanimin e tyre mbi 2 km nga shkolla, si dhe transportin për rreth 13,500 mësues që punojnë mbi 5 Km nga vendbanimi/qendra e përhershme e punës në shkollë;
- Fillon pilotimi i programit të kujdesit pas shkollor në arsimin bazë;
- Mbështeten Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) publike dhe Kërkimi Shkencor ku granti për IAL-të planifikohet në masën 11.65 miliardë lekë ku prioritet mbetet ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë;
- Në S3 janë planifikuar mbështetje të dedikuara për masa/aktivitete për edukimin, trajnimin, rininë dhe mbajtjen e talenteve në periudhën 2025-2030, respektivisht, prej 11.860.000 eurosh për prioritetin: "Avancimi i Arsimit – Nxitja e Inovacionit dhe Gatishmërisë së Fuqisë Punëtore përmes Digjitalizimit dhe Modernizimit të Kurrikulave", si dhe prej 31.794.896 eurosh për prioritetin: "Fuqizimi i të rinjve dhe ruajtja e talenteve".

Kërkimi shkencor dhe inovacioni

Në S3 janë planifikuar mbështetje të dedikuara transversale në të gjitha sektorët për kërkimin dhe inovacionin, si dhe një paketë e dedikuar prej 359.945.000 eurosh, duke kontribuar në mënyrë thelbësore për arritjen e objektivit prej 1% të PBB-së për kërkimin shkencor si objektiv bazë në kapitullin 25 "Shkenca dhe Kërkimi". Gjithashtu, masa/aktivitete të veçanta që parashikojnë incentivimin e investimeve nga sektori privat në kërkim, inovacion dhe teknologji të avancuara, si dhe rritja e përthithjes së financimit të huaj, projektet e BE, do të rrisin më tej investimin e synuar në shkencë, inovacion, teknologji dhe diversifikojnë burimet e financimit në këta sektorë.

Shëndetësia me 2.9% të PBB-së, ku shpenzimet e sektorit të shëndetësisë për vitin 2026 planifikohen të jenë në masën 81.1 miliardë lekë nga 76.2 miliardë lekë të planifikuara në buxhetin e rishikuar për vitin 2025.

Theksojmë që përveç indeksimit të pagave dhe njehsimit të vjetërsisë për sistemin shëndetësor, projektbuxheti 2026 do të financojë me prioritet këto politika:

- Mbështetjen e mbi 400 mijë qytetarëve për rimbursimin e barnave falas nëpërmjet rritjes së financimit të skemës së rimbursimit me mbështetje 13.5 miliardë lekë nga 12.6 miliardë lekë të parashikuar në vitin 2025; Theksojmë që në vitin 2026 sigurohet financimi me 1.5 miliardë lekë më shumë për rimbursimin e barnave antitumorale në shërbimin parësor dhe sigurimin e tyre në të gjithë sistemin spitalor;
- Financimi i paketave të miratuara të shërbimit spitalor në spitalet publike e jopublike përfshirë këtu paketën e re për trajtimin e trombektomisë;
- Programet e mbrojtjes së shëndetit publik, nëpërmjet programit kombëtar vaksinimit ndaj gripit, programit të plotë të imunizimit të fëmijëve nga ku përfitojnë mbi 180 mijë fëmijë dhe 280 mijë qytetarë.
- Në S3 janë planifikuar mbështetje të dedikuara prej 13.820.000 eurosh për periudhën 2025-2028 për masat "Inovimi dhe përmirësimi i kujdesit shëndetësor parësor dhe shërbimeve të urgjencës në zonat rurale/turistike përmes pajisjes së tyre me teknologji të avancuara dhe integrimit të shërbimeve me personel/shërbime shëndetësore të specializuara" dhe "Mbështetja e personelit/ profesionistëve shëndetësorë të specializuar në zonat rurale",

Bujqësia me 0.6% të PBB-së, ku shpenzimet e sektorit të bujqësisë për vitin 2026 planifikohen të jenë në masën 16.3 miliardë lekë nga 14.9 miliardë lekë të planifikuara në buxhetin e rishikuar për vitin 2025.

Ndër prioritetet kryesore që parashikohet të financohen për bujqësinë janë:

-Skema kombëtare e fermerëve dhe e subvencionimit të naftës, me një fond total 5.14 miliardë lekë në vitin 2026 nga e cili parashikohet të përfitojnë fermerët në të gjithë Shqipërinë;

- Kompensimi i TVSH për fermerët e cila pritet të ketë një efekt pozitiv në të ardhurat e fermerëve me një total prej 1.5 miliardë lekësh;

- Në fushën e Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit synohet fuqizimi i sistemit të kontrollit dhe inspektimit, duke përfshirë të gjithë zinxhirin ushqimor nga ferma në tavolinë;

- Lidhur me Menaxhimin e Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit, fokusi do të jetë në rehabilitimin e kanaleve ujitës dhe investimeve në infrastrukturën e mbrojtjes nga përmbytja, nëpërmjet rehabilitimit/ndërtimit të argjinaturave mbrojtëse me një fond total prej 2.6 miliardë lekësh nga të cilat 1.1 miliardë janë fonde të dedikuara për Njësitë e Vetëqeverisjes vendore.

- Së fundi, është parashikuar të vijojë Garancia Shtetërore e akorduar për sektorin e bujqësisë në masën 3 miliardë lekë edhe përgjatë vitit 2026, në kushte ku afati për zbatimin e saj brenda vitit 2025 mund të jetë një afat i shkurtër për të marrë maksimumin e përfitimit nga kjo formë mbështetje.

- Në S3 sektori i bujqësisë dhe zhvillimit rural ka një vëmendje të veçantë duke angazhuar mbështetje të dedikuar prej rreth 400 milionë eurosh në periudhën 2025–2030 në prioritetin "Zinxhir Ushqimor i Shëndetshëm dhe i Qëndrueshëm" si dhe rreth 150 milionë euro për masa të tjera që lidhen me agroturizmin, edukimin/trajnimin, kërkimin dhe inovacionin etj., duke rezultuar sektori më i financuar në S3, pra ku inovacioni është konsideruar një vlerë e madhe e shtuar për ekonominë e vendit.

Mbrojtja Sociale me 9.2% të PBB, ku shpenzimet e sektorit planifikohen në 257.3 miliardë lekë për vitin 2026 nga 245.6 miliardë lekë të planifikuara në buxhetin e rishikuar për vitin 2025.

Ndër prioritetet kryesore që parashikohet të financohen në këtë fushë përmendim:

- Numri i familjeve dhe individëve në nevojë që pritet të përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike parashikohet të ulet në 59 000 përfitues në vit për vitin 2028, ku për vitet 2026–2027 parashikohet të ulet me 1000 familje, ku synohet punësimi i anëtarëve në moshë pune të familjeve përfituese.

- Numri i përfituesve nga PAK dhe kujdestarëve të tyre parashikohet të shkojë në 98 mijë përfitues në vitin 2028 nga 94 mijë përfitues në vitin 2026, në zbatim të skemës së re të vlerësimit të aftësisë së kufizuar pra sipas modelit biopsikosocial, bazuar në standardet e Organizatës Botërore të Shëndetit, synohet krijimi i një sistemi shërbimesh integruese, të cilat kombinojnë pagesat me shërbimet e përkujdesjes sociale;

- Mbështetja e personave nga grupet e pafavorizuara përmes punësimit në ndërmarrjet sociale synohet të punësohen mesatarisht 150 persona çdo vit, me qëllim integrimin në tregun e punës të kategorive të ndryshme të grupeve të pafavorizuara nga pikëpamja sociale dhe ekonomike me një fond mesatarisht prej 80 milionë lekësh përgjatë periudhës 2026–2028;

- Rritja e numrit të personave të punësuar në ndërmarrjet sociale në raport me numrin e anëtarëve në moshë pune në skemën e ndihmës ekonomike në 5% në vitin 2028;

- Rritja e numrit të personave përfitues nga shërbimet sociale të financuara nga fondi social nga 11 000 në vitin 2025 në 15 000 në vitin 2028.

- Mbështetjen e fondit social për njësitë e vetëqeverisjes vendore për ofrimin e shërbimeve të reja sociale territoriale për grupet në nevojë dhe mbështetjen e familjeve të NE-së me paketa sociale shëndetësore, duke synuar ofrimin e 95–115 shërbime në bashkitë e vendit, me një fond mesatarisht prej 400–450 milionë lekësh përgjatë periudhës 2026–2028. Parashikohet të

përfitojnë 61 njësi të vetëqeverisjes vendore në vitin 2028 nga 43 NJVQVV që parashikohen të përfitojnë në vitin 2025.

- Financimi i politikës për mbrojtjen e veçantë nga shteti, për gratë e papuna, me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç, ku njëri prej fëmijëve është nën moshën 5 vjeç dhe familja ka të ardhura nën 100 000 (njëqind mijë) lekë në muaj, periudha e kujdesit ndaj fëmijës deri në moshën 5-vjeçare njihet si periudhë sigurimi për efekt përfitimi pensioni pleqërie dhe barrëlindjeje, duke synuar të përfitojnë 8 700 gra në vitin 2028 nga 8 300 gra që janë parashikuar në vitin 2026, me një fond mesatarisht rreth 870 milionë lekë përgjatë periudhës 2026–2028.

- Rritja e numrit të grave dhe vajzave në nevoje të riintegruara pas trajtimit në institucionet e përkujdesjes sociale në 55 gra dhe vajza në vitin 2028 nga 47 gra/vajza që parashikohen në vitin 2025;

- Rritja e numrit të familjeve rome dhe egjiptiane që përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike nga 2400 familje në vitin 2025 në 2700 familje në vitin 2028;

- Mbështetja në S3 e masave dhe aktiviteteve për zhvillimin rural, mbajtjen e talenteve, krijimin e mundësive të barabarta për të rinjtë dhe profesionistët, mundëson një mbështetje indirekte për sektorin social.

Në fushën e turizmit, kulturës dhe sportit prioritetet për periudhën 2026–2028 do të jenë:

Në fushën e Turizmit, synojmë kthimin e Shqipërisë në një destinacion tërheqës turistik, cilësor dhe të qëndrueshëm, duke shfrytëzuar potenciale dhe burime lokale, duke u fokusuar në atë çka është unike në vendin tonë.

- Diversifikimi i produktit turistik për të arritur një turizëm gjithëvjetor duke promovuar gjerësisht Shqipërinë në komunitetin ndërkombëtar si një destinacion i denjë për konkurruar globalisht;

- Sigurimi e zhvillimi i qëndrueshëm i zonës bregdetare, nëpërmjet ofrimit të shërbimit të pastrimit gjatë sezonit turistik, me qëllim rritjen e turistëve të huaj;

- Zhvillimi i produkteve dhe shërbimeve të reja në turizëm, si dhe përmirësimi i imazhit të vendit duke promovuar produkte lokale;

- Në S3 një nga 3 prioritetet vertikale është Turizmi i Qëndrueshëm dhe i Diversifikuar, ku parashikohet një mbështetje financiare prej 177.534.461 eurosh.

Në fushat e kulturës dhe trashëgimisë kulturore do të prioritizohet:

- Përmirësimi dhe zgjerimi i tregjeve kulturore përmes legjislacionit nga i cili do të përfitojnë krijuesit, krijimtaria artistike dhe kulturore dhe trashëgimia kulturore;

- Krijimi i një mjedisi të qëndrueshëm ligjor e institucional për zhvillimin e artit dhe kulturës;

- Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë materiale dhe jomateriale kulturore;

- Rehabilitimi i trashëgimisë arkitektonike, muzeve dhe peizazhit përmes rritjes së numrit të monumenteve dhe muzeve të rehabilituara;

- Nxitja dhe përfaqësimi i vlerave kulturore të arteve dhe trashëgimisë (materiale dhe jomateriale) shqiptare në aktivitete të rëndësishme ndërkombëtare dhe prezantimi i praktikave të mira;

- Promovimi i vlerave të artit, trashëgimisë kulturore dhe fondeve muzeore;

-Mbështetja e krijimtarisë së artistëve shqiptar dhe shtimi i veprimtarive kulturore dhe artistike;

- Rritja e interesit të publikut ndaj programeve kulturore përmes përmirësimit të shërbimeve në infrastrukturë, si dhe rritjen e cilësisë artistike;

- Hartimi dhe zbatimi i një platforme arsimore përmes institucioneve të artit dhe trashëgimisë kulturore dhe sistemit parauniversitar;

- Zhvillimi i audiencave;

- Pasurimi i fondeve artistike në teatër - muzikë - arte pamore - film- balet- ansambël popullor dhe digjitalizimi i tyre në nivel kombëtarë;

- Në S3 ka një sërë masash/aktivitetesh të dedikuara për gjuhën, kulturën dhe trashëgiminë kulturore me mbështetjen financiare përkatëse.

Në fushën e zhvillimit ekonomik, parashikohen të financohen prioritetet për periudhën 2026–2028, si vijon:

- Promovimi i Shqipërisë si destinacion investimesh nëpërmjet organizimit dhe pjesëmarrjeve në mesatarisht 50 panaire ndërkombëtare dhe *road shou* promovuese, vizita në kompani *(after care)* si dhe monitorim efektiv investimesh strategjike për periudhën 2026–2028;

- 65 NVMV parashikohet të mbështeten me fonde publike, dhe nga këto rreth 26 biznese janë me drejtuese femra;

- Mesatarisht 15 biznese përfituese nga skemat mbështetëse të Fondit të Konkurrueshmërisë dhe 10 biznese të mbështetura për biznesin kreativ, për vitin 2026;

- 73 shërbime të ofruara për bizneset sipas sistemit të regjistrimit të biznesit në periudhën 2026-2028;

- 112 shërbime të ofruara për bizneset sipas sistemit të Regjistrimit të në periudhën 2026-2028;

- Rritjes së numrit të bizneseve të regjistruara në Regjistrin Tregtar dhe shërbimet e tjera, 373 mijë në periudhën 2026–2028;

- Rritjes së numrit të licencave të miratuara në Regjistrin e licencave dhe shërbimeve të tjera, 7700 shërbime në periudhën 2026–2028;

- Rritjes së numrit të kompanive dhe investitorëve të targetuar gjatë fushata outreach, nga 50 parashikuar në vitin 2025, në 80 në vitin 2028. Promovimi dhe përfaqësimi i vlerave të artit dhe trashëgimisë kulturore shqiptare, materiale dhe shpirtërore në evenimentet e rëndësishme ndërkombëtare;

- Përmirësimi i gjendjes fizike të monumenteve të kulturës përmes ndërhyrjeve të vazhdueshme në të gjithë vendin, përmirësimi i infrastrukturës në Muzetë Kombëtarë, Parqe Arkeologjikë si dhe përmirësimin i gjendjes fizike të monumenteve të kulturës përmes ndërhyrjeve të vazhdueshme në të gjithë vendin;

- Në S3 mbështetja për biznesin, incentivat, mbështetja në inovacion dhe teknologji, si dhe ndërhyrjet në përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator, ka një shtrirje horizontale në të gjitha fushat prioritare. S3 synon që investimi në inovacion të sjellë vlerë të shtuar në ekonomi duke parashikuar për herë të parë një mbështetje mbi 1 miliardë euro për periudhën 2025–2030 për inovacionin, teknologjinë, dhe kërkimin.

Në fushën e Infrastrukturës dhe Energjisë është planifikuar një buxhet prej 77.3 miliardë lekësh ose rreth 2.8% e PPB-së. Prioritetet për periudhën afatmesme do të jenë:

- Zgjerimi i rrjetit të rrugëve kombëtare nëpërmjet, ndërtimit, rehabilitimit dhe sistemimit të rrugëve kombëtare dhe përveç kësaj kalimin në praktikat e mirëmbajtjes së rrugëve bazuar në performancë;

- Zgjerimi i aksesit dhe cilësisë së shërbimit të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve përmes: i. një portofoli të investimeve publike; dhe ii. përmirësimit rrënjësor të menaxhimit të shoqërive aksionare të ujësjellës-kanalizimeve, duke standardizuar parimet e qeverisjes së sektorit;

- Rritja e eficiencës së energjisë kundrejt konsumit të përgjithshëm final të energjisë nëpërmjet shqyrtimit të programeve për promovimin e tregut, për penetrimin e teknologjive të përparuara si dhe rritjen e përdorimit të energjive të rinovueshme;

- Në S3 një nga 3 sektorët prioritarë vertikalë është Energjia e rinovueshme dhe burimet natyrore, për të cilat është parashikuar mbështetje financiare, respektivisht: 81.303.039 euro për prioritetin e energjisë së rinovueshme dhe 54.993.500 euro për prioritetin e burimeve natyrore/lëndët e para.

Për fushën e drejtësisë parashikohen të alokohen në buxhetin e vitit 2026 fonde në masën 14.9 miliardë lekë duke pasur si përparësi kryesore jetësimin e reformës në drejtësi.

Në fushën e rendit dhe sigurisë publike është planifikuar për vitin 2026 një buxhet prej 35.7 miliardë lekësh.

Për sektorin e Mbrojtjes, buxheti i parashikuar për vitin 2026 do jetë rreth 58.9 miliardë lekë ose rreth 2.12 % e PBB-së. Me këtë buxhet Ministria e Mbrojtjes synon:

- Modernizimin e kapaciteteve dhe infrastrukturës së FA duke:
- zhvilluar kapacitetet e FA në përputhje me Planin Afatgjatë të Zhvillimit;
- vijuar pajisjen e Forcave Tokësore me armatim të ri të ndërveprueshëm me aleatët në NATO;
- zgjeruar investimet në infrastrukturë për përmirësimin e mjediseve të punës dhe ushtarake;
- modernizuar pajisjet dhe sistemet kompjuterike;
- Vijimin e pjesëmarrjes në operacionet e NATO-s, duke rritur nivelin e angazhimit të FA-së, në operacionet e Aleancës dhe pjesëmarrjen në misionet e iniciativat e reja që NATO mund të ndërmarrë;
- Zhvillimin dhe mbajtjen në gatishmëri të kapaciteteve të FA për operacione të mbrojtjes kombëtare dhe kolektive, operacione në përgjigje të krizave, si dhe kapacitetet për përballimin e Emergjencave Civile, dhënien e ndihmës vendeve të rajonit në rast emergjencash civile në kuadrin e NATO-s, OKB-se dhe BE-së;
- Lartësimin e figurës dhe integritetit të ushtarakut, nëpërmjet zhvillimit të politikave të nevojshme në fushën e personelit, promovimit në karrierë, trajtimit të ushtarakut, rritjes së transparencës, llogaridhënies, si dhe eliminimin e korrupsionit në Forcat e Armatosura;
- Nxitjen e industrisë ushtarake dhe inovacionit në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, nëpërmjet zhvillimit të një ekosistemi ndërveprues inovacioni, si dhe fuqizimit të kërkimi-zhvillimit shkencor dhe teknologjik.

Diaspora

Parashikimi i angazhimit të diasporës në S3 si një prioritet i veçantë me synim nxitjen e kapitalit njerëzor, teknologjisë dhe kulturës, me një mbështetje të dedikuar prej 58.730.000 eurosh, tregon rëndësinë që diaspora parashikohet të ketë në zhvillimin ekonomik dhe inovativ të vendit në 5- vjeçarin 2025–2030. Gjithashtu, dhe në prioritetet e tjera ka masa/aktivitete të tjera që synojnë përfshirjen e diasporës në prioritetet përkatëse.

2. Reforma në Administratën Publike

Reforma në Administratën Publike është një kriter i posaçëm përbërës i grup-kapitujve themelorë, duke qenë kështu një agjendë ndërhyrjesh horizontale në të gjithë sektorët, për të garantuar suksesin e procesit të negociatave për të gjithë kapitujt negociues. Si shembulli më i qartë i prioritizimit të sektorit publik në agjendën e Qeverisë Shqiptare, krijimi i pozicionit qeveritar të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin në janar 2024 synon avancimin e kësaj reforme, me vizion madhor përgatitjen e institucioneve publike për përballimin me sukses të procesit negociues me Bashkimin Evropian dhe anëtarësimin e Shqipërisë në BE brenda dekadës.

Kjo qasje e strukturuar dhe e qëndrueshme është reflektuar edhe në vlerësimet e pavarura ndërkombëtare. Në fund të vitit 2024, raporti i vlerësimit të OECD/SIGMA mbi zbatimin e parimeve të Administratës Publike e pozicionoi Shqipërinë si një lider rajonal në kuadër të Reformës në Administratën Publike, duke evidentuar se brenda një dekade vendi është shndërruar në pikë reference në katër fusha kyçe: menaxhimin e burimeve njerëzore, menaxhimin e financave publike, qeverisjen digjitale dhe koordinimin e politikave. Sipas të njëjtit vlerësim, Shqipëria rezulton gjithashtu mbi mesataren rajonale në ofrimin e shërbimeve publike, duke reflektuar progres të qëndrueshëm dhe rezultate të prekshme në modernizimin e administratës publike.

Zbatimi i Reformës në Administratën Publike lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me disa prej OZHQ-ve të agjendës 2030, duke kontribuar drejtpërdrejt përmes përmirësimit të transparencës, llogaridhënies dhe efikasitetit të administratës publike për qytetarët dhe bizneseve në nivel lokal dhe kombëtar. Saktësisht, ajo mundëson zbatimin e objektivit 8: "Nxitja e rritjes ekonomike të pandërprerë, përfshirëse dhe të qëndrueshme, punësimit të plotë e produktiv dhe punës së denjë për të gjithë", treguesit 8.5 "Deri në vitin 2030, arritja e punësimit produktiv dhe punës së denjë për të gjitha gratë dhe burrat, përfshi të rinjtë/të rejat dhe personat me aftësi të kufizuar, si dhe pagë e barabartë për punë me vlerë të barabartë", si dhe veçanërisht objektivit 16 "Paqe, drejtësi dhe institucione të forta (veçanërisht treguesit 16.6 "Ndërtimi i institucioneve efikase, llogaridhënëse dhe transparente në të gjitha nivelet e qeverisjes).

Zhvillimet kryesore

Kuadër i ri strategjik me kohështrirje deri në vitin 2030 për Reformën në Administratën Publike

Në korrik të vitit 2025, me vendimin nr. 472, datë 31.7.2025 të Këshillit të Ministrave u miratua Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike (SNRAP) 2025–2030,[8] e cila garanton një numër angazhimesh të autoriteteve shqiptare në drejtim të zhvillimit dhe koordinimit të politikave, menaxhimit të shërbimit civil dhe burimeve njerëzore, llogaridhënies dhe mbikëqyrjes, ofrimit të shërbimeve me fokus qytetarin, si dhe ndërtimin e një administrate të gjelbër publike. Miratimi i kuadrit të ri strategjik, i cili përfshin Strategjinë Ndërsektoriale 2025–2030, Planin e Veprimit 2025–2027 dhe Pasaportën e Indikatorëve, përmbyll një punë gjithëpërfshirëse dyvjeçare, falë së cilës Shqipëria tashmë ka në fuqi një kuadër të plotë strategjik të reformës në administratën publike (duke përfshirë strategjitë për Menaxhimin e Financave Publike, Decentralizimin, Luftën kundër Korrupsionit dhe Agjendën Digjitale).

Paketa strategjike përshkruan vizionin afatgjatë të Shqipërisë për modernizimin dhe fuqizimin e plotë të administratës publike, me qëllim përgatitjen e saj për kërkesat impenjative të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Angazhimet e parashikuara janë plotësisht të harmonizuara me kuadret e tjera strategjike ndërsektoriale në fuqi, me kuadrin më të gjerë kombëtar të integrimit evropian dhe me angazhime të tjera ndërkombëtare, si Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE/NSDEI) dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ/SDGs). Në mënyrë thelbësore, Strategjia, Plani i Veprimit dhe Pasaporta e Treguesve pasqyrojnë dhe janë në përputhje të plotë me angazhimet e autoriteteve shqiptare të marra në kuadër të Udhërrëfyesit të Reformës në Administratën Publike 2023–2030, si dhe adresojnë gjetjet dhe rekomandimet e vlerësimit më të fundit të OECD/SIGMA mbi "Parimet e Administratës Publike në Shqipëri", i cili u zhvillua gjatë periudhës shkurt–tetor 2024.

Strategjia u formësua përmes një procesi të thelluar dhe transparent konsultimi me aktorë të tjerë institucionalë, duke siguruar konsensus të gjerë politik dhe pronësi ndërinstitucionale në të gjithë qeverinë. Departamenti i Administratës Publike (DAP), nën mbikëqyrjen politike të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, është institucioni përgjegjës për koordinimin teknik dhe monitorimin. Ai vepron përmes Drejtorisë së Programeve të Reformës në Administratën Publike, e cila shërben si Sekretariat Teknik.

Strategjia është e strukturuar rreth këtyre fushave kryesore:

- Menaxhimi i burimeve njerëzore i bazuar në meritë, duke garantuar procese transparente dhe objektive për rekrutimin, ngritjen në detyrë dhe vlerësimin e performancës.
- Transformimi digjital, duke avancuar ofrimin e shërbimeve përmes përdorimit sistematik të mjeteve digjitale që përmirësojnë aksesueshmërinë, efikasitetin dhe gjithëpërfshirjen.

[8] https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2025/143/1ef307a2-86ec-4be2-8abe-c1d99c0706c5

- Transparenca dhe llogaridhënia, duke përforcuar mekanizmat e integritetit përmes kuadrove më të qarta të remunerimit, forcimit të rregullave për konfliktin e interesit dhe masave gjithëpërfshirëse antikorrupsion.

- Shërbime të orientuara drejt qytetarit, duke lidhur performancën e ofrimit të shërbimeve publike me kënaqësinë e qytetarëve dhe mekanizma të strukturuar të *feedback*-ut.

- Monitorim i fuqishëm dhe menaxhim adaptiv, duke prezantuar instrumente vlerësimi në kohë reale që mundësojnë rregullime të shpejta dhe të bazuara në prova të politikave publike. Administratë Publike e Gjelbër, duke integruar konsideratat e qëndrueshmërisë në planifikimin dhe operacionet e sektorit publik.

Paketa strategjike u diskutua dhe u formësua në mënyrë intensive me kontributin e partnerëve kyç vendas dhe ndërkombëtarë, përfshirë aktorë të shoqërisë civile, përfaqësues të biznesit dhe, mbi të gjitha, OECD/SIGMA dhe Shkolla Rajonale Evropiane e Administratës Publike (ReSPA), ekspertiza e të cilëve facilitoi përkthimin e vizionit të Qeverisë Shqiptare në angazhimet e detajuara të paketës strategjike.

- Energjizimi dhe motivimi i nëpunësve në qendër të vizionit për administratën 2030

Në maj 2024, në kuadër të vizionit për administratën 2030, u prezantua "Paketa e Motivimit" për nëpunësit publikë, e ndërtuar mbi praktikat më të mira evropiane dhe e përshtatur për realitetin shqiptar, me qëllim rritjen e angazhimit, mirëqenies dhe kulturës organizative në administratën publike. Si pjesë e zbatimit të saj, janë finalizuar masa konkrete si fleksibilizimi i orarit të punës dhe përmirësimi i regjimit të pushimeve vjetore, duke forcuar balancën punë–jetë private dhe duke ruajtur njëkohësisht produktivitetin institucional.

Përgjatë viteve 2024–2025, zbatimi i Paketës së Motivimit për nëpunësit publikë ka vijuar paralelisht me punën për jetëzimin e vizionit për Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) si një qendër e ardhshme ekselence në zhvillimin profesional të sektorit publik, përmes miratimit të ndryshimeve përkatëse në vendimin nr. 138, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për rregullat e organizimit e të funksionimit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike dhe trajnimin e nëpunësve civilë".[9] Këto ndryshime të miratuara në janar 2025 targetojnë reformimin e sistemit të trajnimit të ofruar nga ASPA, duke mundësuar kritere të rishikuara për përzgjedhjen e trajnerëve dhe ripërcaktimin e masës së pagesës së tyre, me qëllim tërheqjen e ekspertëve më të mirë, ku prioritet do të ketë trupa ekzistuese e ekspertizës sektoriale brenda administratës publike. Këto ndërhyrje synojnë në mënyrë madhore rritjen e përgjithshme të kapaciteteve administrative të institucioneve publike në drejtim të thellimit të përgatitjeve për zbatimin e suksesshëm të agjendës kombëtare për integrimin evropian të vendit.

- Trajnimi i sektorit privat mbi veprimtarinë publike

Përgjatë vitit 2025, ASPA ka adoptuar një qasje të strukturuar drejt modelit vetëfinancues në përputhje me bazën e saj rregullatore, përmes përfshirjes së sektorit privat në programet e saj të trajnimit. Kjo qasje përfshin një proces gjithëpërfshirës të vlerësimit të nevojave për trajnim në sektorin privat, si dhe zhvillimin e kurrikulave të posaçme në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për fushat tematike përkatëse.

Gjatë vitit 2024, ASPA realizoi një vlerësim të nevojave për trajnim në sektorin privat përmes një pyetësori *online* me mbi 350 kompani, duke identifikuar fusha prioritare si prokurimi publik, fondet e BE-së, menaxhimi i projekteve dhe burimet njerëzore. Në vijim, në korrik 2025, ASPA zhvilloi një fushatë të synuar kontakti, e cila çoi në identifikimin e një kërkese konkrete për 25 module trajnimi nga shoqëri aksionare, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe individët.

[9] Miratuar përmes VKM Nr. 22, datë 09.01.2025, e aksesueshme në linkun https://aspa.gov.al/wp-content/uploads/2025/01/vendim-2025-01-09-22.pdf.

Fushat më të kërkuara lidhen kryesisht me standardet e administratës publike dhe përgatitjen për tregun evropian, duke përfshirë prokurimin publik, menaxhimin e projekteve, fondet e BE-së, PPP-të dhe menaxhimin financiar. Të dhënat e mbledhura përbëjnë një bazë solide për zhvillimin e mëtejshëm të portofolit të trajnimeve me pagesë të ASPA-s dhe për hartimin e një oferte të qëndrueshme, të orientuar nga tregu, duke forcuar rolin e saj edhe në profesionalizimin e sektorit privat. Deri në dhjetor 2025, ASPA trajnoi 339 individë përfaqësues të sektorit privat.

Gjithashtu, falë ndryshimeve të sipërcituara në vendimin nr. 138, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, punonjësit e institucioneve publike vetëfinancuese, përfshirë shoqëritë aksionare publike dhe institucionet e arsimit të lartë, kanë të drejtë të marrin pjesë në trajnimet e ASPA-s, me kostot përkatëse të mbuluara nga institucionet e tyre.

Në tërësi, kjo qasje ka forcuar në mënyrë progresive rolin e ASPA-s si një aktor qendror në zhvillimin e kapaciteteve, jo vetëm për administratën publike, por edhe për institucionet e lidhura ngushtë me të, duke promovuar kështu një qasje më të integruar dhe gjithëpërfshirëse ndaj zhvillimit profesional ndërsektorial.

- Integrimi i përshpejtuar

Më 29 nëntor 2024, Shqipëria mori zyrtarisht statusin "Vëzhgues" në Rrjetin Evropian të Administratës Publike (EUPAN). Në vijim të këtij zhvillimi, përgjatë vitit 2025, përfaqësuesit e Shqipërisë kanë marrë pjesë periodikisht në takimet dhe shkëmbimet e Rrjetit. Pjesëmarrja direkte në tryezën e EUPAN i mundëson Shqipërisë akses në kohë reale në diskutimet e politikave dhe trendeve të fundit të zhvillimit të hapësirës së përbashkët administrative evropiane, duke garantuar ritëm të njëkohshëm me vendet anëtare të BE-së në terma të rritjes së **inovacioni**t dhe **efektivitetit** t**ë politikave** reformuese të sektorit publik në të gjithë Evropën.

Këto shkëmbime ofrojnë përfitime të rëndësishme në kontekstin e forcimit të administratës publike shqiptare, e cila përbën një shtyllë kyçe të procesit të integrimit evropian, dhe njëherësh janë një komponent thelbësor në zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2025–2030.

- Reforma e pagave

a) Niveli qendror:

Në vitin 2024, Qeveria Shqiptare finalizoi me sukses fazën e dytë të reformës së pagave për nëpunësit civilë, në vijim të fazës së parë të zbatuar në vitin 2023, me qëllim për të përmirësuar kënaqësinë dhe motivimin e tyre, si dhe për të bërë shërbimin publik më tërheqës si punëdhënës në tregun e punës. Përveç rritjes së pagave, reforma ka sjellë edhe një rregullim në strukturën e pagës. Krahasuar me vitin 2013, pagat e nëpunësve civilë janë rritur mesatarisht nga 35% deri në 65%, varësisht nga kategoria. Gjithashtu, është rritur indeksi i shkallës së komprimimit të pagave dhe pesha e elementit të vjetërsisë në pagën totale.

Si rezultat i këtyre ndërhyrjeve, Qeveria Shqiptare ka arritur jo vetëm objektivin për një pagë mesatare prej 900 eurosh në administratën publike, sipas angazhimit të marrë përsipër në Udhërrëfyesin për Reformën në Administratën Publike, por ka siguruar një pagë mesatare prej 1.050 eurosh, nga 530 euro në fillim të vitit 2023. Kjo rritje është vlerësuar si domethënëse edhe nga Komisioni Evropian në Raportin e Progresit të vitit 2024, si dhe ka rritur kënaqësinë e nëpunësve me pagën e tyre (nga 13% e nëpunësve të kënaqur në vitin 2022 në 47% deri në prill 2024, sipas sondazhit rajonal të OECD/SIGMA).

Reforma e plotë e pagave, e shtrirë përgjatë dy viteve 2023–2024 arrin një kosto prej rreth 39 miliardë lekësh dhe prej saj kanë përfituar rreth 130 mijë punonjës publikë.

b) Niveli vendor: Në gusht 2024, në përmbyllje të reformës në nivelin qendror, Qeveria Shqiptare miratoi një reformë të plotë të pagave edhe për punonjësit e njësive të vetëqeverisjes vendore, duke ndryshuar metodën e llogaritjes së vjetërsisë për ta përshtatur me atë të nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe duke barazuar pagën e nëpunësve lokalë me atë të klasës përkatëse në administratën shtetërore. Ndryshimet ligjore mundësuan rritjen e

pagave nga 40% deri në dyfishimin e pagës për disa pozicione specifike, si dhe standardizimin e pagave në të 61 bashkitë e vendit.

c) Vijimi i reformës në vitin 2026: Në vijim të zhvillimeve të mësipërme, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026", janë konsoliduar masat për garantimin e qëndrueshmërisë së modelit të ri të pagave në administratën publike, duke e kthyer atë në standard afatgjatë të sistemit të shpërblimit. Në këtë kuadër, ka hyrë në fuqi indeksimi i pagave të administratës publike, në përputhje me ligjin nr. 35/2023, "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", të ndryshuar, si dhe rritja e pagës minimale me 10.000 lekë, nga 40.000 në 50.000 lekë, ose 25%. Si rezultat i kësaj politike të qëndrueshme ndër vite, paga minimale në Shqipëri është tashmë pothuajse 2.3 herë më e lartë krahasuar me vitin 2013. Paralelisht, janë zbatuar rritje korrektuese për pagat më të ulëta të nëpunësve publikë, me qëllim ruajtjen e hierarkisë dhe balancave të brendshme të sistemit të pagave.

- Investim i intensifikuar në kapacitetet udhëheqëse të administratës publike

Përgjatë vitit 2025, investimi në forcimin e kapaciteteve udhëheqëse të administratës publike është intensifikuar më tej, si pjesë e përpjekjeve për të rritur cilësinë e vendimmarrjes strategjike, koherencën institucionale dhe aftësinë e administratës për të operuar në mjedise komplekse dhe të pasigurta, në funksion të reformave dhe procesit të integrimit evropian.

Në këtë kuadër, Programi i Trajnimit Ekzekutiv për drejtuesit e nivelit të lartë, "*Të udhëheqësh me besim: Marrja e vendimeve në Mjedise Komplekse dhe të Pasigurta",* u zhvillua në sajë të partneritetit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike me Institutin Kombëtar të Shërbimit Publik të Francës (INSP). Programi përfaqëson një thellim dhe avancim të drejtpërdrejtë të qasjes së nisur në vitin 2024 për zhvillimin e lidershipit publik dhe është konceptuar posaçërisht për Korpusin e Menaxhimit të Lartë, përfshirë sekretarë të përgjithshëm dhe ekipe drejtuese me përgjegjësi vendimmarrëse në ministritë e linjës dhe Kryeministri.

Programi u strukturua në katër module dhe fokusohet në dimensione kyçe të lidershipit strategjik në sektorin publik, përfshirë menaxhimin e riskut ligjor në vendimmarrje, integritetin strategjik në nivelet më të larta drejtuese, aftësinë për të adresuar dilema institucionale, prioritete sektoriale dhe objektiva të zhvillimit kombëtar, si dhe rolin e transformimit digjital dhe komunikimit institucional në qeverisjen moderne. Metodologjia ndërthur ekspertizën ndërkombëtare me raste konkrete nga konteksti shqiptar, diskutime të strukturuara dhe simulime vendimmarrjeje, duke garantuar relevancë praktike dhe zbatim të drejtpërdrejtë.

Ky program ndërtohet mbi përvojën e Programit të Zhvillimit të Lidershipit, i mbajtur në korrik-tetor 2024 nën koordinimin e Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, dhe përfaqëson fazën e tij të avancuar, të orientuar drejt lidershipit ekzekutiv dhe vendimmarrjes strategjike. Në kuadër të programit ekzekutiv 2025, 67 drejtues të administratës publike morën pjesë dhe u certifikuan.

Gjithashtu, me nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, AKSHI, *Tony Blair Institute for Global Change dhe Apolitical* në korrik 2025, Shqipëria ka nisur për herë të parë zbatimin e programit *Government AI Campus* si një investim strategjik në kapacitetet njerëzore të administratës publike. Duke filluar nga nëntori 2025, mbi 1,000 nëpunës publikë, përfshirë drejtues të nivelit të lartë dhe të mesëm, janë përfshirë në trajnime të strukturuara në tri nivele, me fokus në përdorimin praktik të inteligjencës artificiale për përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve dhe rritjen e efikasitetit institucional.

Në tërësi, dy programet përfaqësojnë një qasje të konsoliduar dhe progresivisht të intensifikuar ndaj zhvillimit të lidershipit publik, drejt përputhjes me standardet evropiane dhe nevojat konkrete të fazës aktuale të reformave të integrimit evropian për sektorin publik.

- Rishikim rrënjësor i kuadrit ligjor për administratën shtetërore dhe shërbimin civil

Ndër proceset më të rëndësishme të vitit 2025 ishte finalizimi i punës intensive për rishikimin e kuadrit ligjor që rregullon administratën shtetërore dhe shërbimin civil, me fokus të veçantë në përgatitjen e ndryshimeve në ligjin nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar dhe ligjin nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore". Ky proces u ndërmor si një komponent kyç i agjendës së Reformës në Administratën Publike, me synim forcimin e profesionalizmit, rritjen e efektivitetit institucional dhe garantimin e qëndrueshmërisë së sistemit të shërbimit civil.

Konkretisht, ndryshimet në ligjin nr. 152/2013, të ndryshuar, synojnë të adresojnë sfidat e evidentuara gjatë zbatimit praktik, veçanërisht në lidhje me rekrutimin, zhvillimin e karrierës, rolet drejtuese dhe menaxhimin e performancës. Ndërkohë që përgjatë vitit 2025 ka vijuar zbatimi në mënyrë të qëndrueshme dhe efektive i dispozitave për rekrutimin, ngritjen në detyrë dhe largimin nga shërbimi civil, mbi bazën e meritave në ligjin për shërbimin civil në të gjitha nivelet, veçanërisht në nivelin e lartë, ndryshimet e propozuara ligjore kanë për qëllim të konsolidojnë më tej parimet e meritokracisë, të forcojnë kapacitetet administrative dhe të garantojnë vazhdimësinë e shërbimit civil. Për këtë qëllim, ndryshimet parashikojnë rritjen e efektshmërisë së procedurës së rekrutimit dhe përsosjen e testimit të mbështetur në kompetenca, duke përmirësuar njëkohësisht qartësinë dhe zbatueshmërinë në praktikë të kuadrit ligjor.

Ligji synon të ngrejë në një tjetër fazë zhvillimi menaxhimin e shërbimit civil në Shqipëri. Krahas konsolidimit të shërbimit civil në dekadën e fundit, është synuar unifikimi i standardeve të pranimit në institucionet e administratës publike, pjesë e shërbimit civil, me institucionet shtetërore jashtë kësaj fushe veprimi, duke propozuar disa ndërhyrje thelbësore me qëllim konsolidimin e mëtejshëm, por dhe modernizimin e shërbimit civil në Shqipëri.

Si bazë për këtë rishikim kanë shërbyer rekomandimet e raporteve të monitorimit të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC) dhe rezolutat e Kuvendit të Shqipërisë. Gjithashtu, këto ndryshime ligjore reflektojnë zotimet që Shqipëria ka ndërmarrë në kuadër të procesit të negociatave me Bashkimin Evropian, përkatësisht në Udhërrëfyesin për Reformën në Administratën Publike 2023–2030, raportet e monitorimit të institucioneve ndërkombëtare, Komisionit Evropian në Raportet vjetore të Progresit dhe Raportin e Shqyrtimit Analitik të Legjislacionit për Grup-kapituj Themelorë, si dhe OECD/SIGMA në Raportet periodike të Vlerësimit për Shqipërinë. Hartimi dhe miratimi i këtij projektligji nga Këshilli i Ministrave është i parashikuar në dokumentet e politikave të qeverisë dhe në Strategjinë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2025–2030. Përmirësimi i procesit të rekrutimit dhe ndërhyrja për rregullimin e sistemit të TND-së janë parashikuar në pozicionin negociues të Qeverisë Shqiptare për grup-kapitullin I – Themelorët, në seksionin referuar Reformës në Administratën Publike dhe në Udhërrëfyesin përkatës 2023–2030. Ky akt është parashikuar për ndërhyrje edhe në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të Këshillit të Ministrave për vitin 2025.

Paralelisht, rishikimi i ligjit nr. 90/2012 fokusohet në forcimin e bazave organizative të administratës shtetërore. Ndryshimet synojnë të përmirësojnë rregullimin e strukturave institucionale, të qartësojnë mandatet dhe përgjegjësitë funksionale, si dhe të sigurojnë një kuadër më të qëndrueshëm dhe transparent për krijimin dhe funksionimin e institucioneve të varësisë, në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë dhe të llogaridhënies efektive.

Ligji nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore" përbën rregullimin e parë ligjor horizontal, të parimeve dhe formave të organizimit institucional (ministri, institucione varësie, agjenci autonome, njësi të drejtpërdrejta shërbimi etj.).

Qëllimi i ndryshimeve të planifikuara është përmirësimi i organizimit, funksionimit dhe llogaridhënies në administratën publike shqiptare. Në mënyrë specifike objektivat kryesorë të këtij projektligji janë përcaktimi i rregullave që synojnë:

1. krijimin e një kuadri efektiv dhe modern të llogaridhënies për institucionet e varësisë;

2. mirëpërcaktimi i tipologjisë së institucioneve të varësisë bazuar në tipologjinë e funksioneve që ato kryejnë;

3. kufizimin e shkëputjes së strukturave të brendshme ministrore të vogla (drejtori/drejtori të përgjithshme) dhe organizimit të tyre si institucione varësie me vete;

4. lehtësimin e Qendrës së qeverisjes nga institucionet në varësi të drejtpërdrejtë të Kryeministrit që duhet ose mund të kalojnë në varësi të ministrive përgjegjëse drejtpërdrejt mbështetjes së realizimit të rolit kushtetues të Kryeministrit; dhe

5. transferimin e vendimmarrjes në nivelin menaxherial të mesëm të institucionit, shoqëruar me rritjen e përgjegjësisë menaxherie dhe lehtësimin e barrës së shtuar mbi pozicionet e ministrit apo sekretarit të përgjithshëm.

Procesi teknik i hartimit për të dyja ligjet u mbështet nga një fazë e gjatë analize dhe konsultimesh të gjera të brendshme me të gjitha institucionet përkatëse, me synimin për të garantuar paraprakisht koherencë në identifikimin dhe adresimin e sfidave në të gjitha institucionet e administratës publike dhe zbatueshmëri praktike të ndryshimeve të propozuara. Paralelisht, u organizuan tryeza të gjera konsultimi me aktorë kyç, përfshirë institucione publike, organe të pavarura, organizata të shoqërisë civile dhe aktorë të tjerë të interesuar. Të dyja projektligjet iu nënshtruan gjithashtu konsultimit publik në gjysmën e dytë të vitit 2025 në platformat zyrtare të konsultimit, në përputhje me kërkesat për transparencë dhe politikëbërje gjithëpërfshirëse.

Në tërësi, procesi gjithëpërfshirës dhe interaktiv i hartimit ka mundësuar integrimin sistematik të komenteve institucionale dhe kontributit të palëve të interesit. Si rezultat, projektndryshimet në ligjin nr. 152/2013, të ndryshuar dhe ligjin nr. 90/2012 kanë arritur një fazë të pjekur, duke ofruar një bazë solide dhe të mirëtestuar për hapat e mëtejshëm të procesit legjislativ dhe për avancimin e vazhdueshëm të Reformës në Administratën Publike në kontekstin e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Këto nisma ligjore do të shoqërohen edhe nga miratimi i projektvendimeve të kostuara sikurse detajuar për secilin akt respektiv.[10]

- Projektvendim "Për miratimin e procedurës për rikthimin e nëpunësve civilë në detyrë në zbatim të vendimit gjyqësor të formës së prerë", kostoja për të cilin llogaritet ALL 1,349,436.00

Projektvendimi synon miratimin e procedurës së zbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civilë në detyrë, duke plotësuar kështu bazën ligjore për këtë proces, mbështetur në ndryshimet që pritet të miratohen në ligjin nr. 152/2013, të ndryshuar dhe bazuar edhe në rekomandimet e lëna nga Raporti i Progresit të Komisionit Evropian dhe vlerësimi i OECD/SIGMA..

Përputhshmëria e projektaktit me Programin Politik Qeverisës 2025–2029, referenca e saktë në program është 1.3. Administrata Publike, Antikorrupsioni dhe Transparenca.

Ky projektakt është parashikuar në PKIE në grup-kapitullin "Themelorët" për kriterin "Reforma në Administratën Publike" (RAP). Ky projektakt lidhet me SNRAP 2025–2030, specifikisht VKM-ja nr. 472, datë 31.7.2025 "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2025–2030, planit të veprimit 2025–2027 dhe pasaportës së treguesve", si edhe VKM-së nr. 737, datë 13.12.2023, "Për miratimin e udhërrëfyesit për reformën në administratën publike 2023–2030".

- Projektvendim "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, 'Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura'", kostoja për të cilin llogaritet ALL 1,255,611.00

[10] Kostimi i referuar në këtë dokument reflekton kostimin e parashikuar në Planin e Veprimit 2025–2027 në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2025–2030.

Projektvendimi propozon të miratojë klasat e zbatueshme për secilën nga kategoritë e shërbimit civil, përshkrimin e përgjithshëm të punës për çdo kategori dhe klasë, kërkesat e përgjithshme për pranimin në çdo kategori dhe klasë, metodologjinë e klasifikimit të një pozicioni në një kategori dhe klasë të caktuar, mbështetur në ndryshimet që pritet të miratohen në ligjin nr. 152/2013, të ndryshuar. Miratimi i këtij vendimi synon përmirësimin e procesit në këto drejtime dhe ka ndikim në procesin e rekrutimit dhe të vlerësimit të nëpunësve civilë dhe në menaxhimin e nëpunësve civilë.

Sa i takon përputhshmërisë së projektaktit me Programin Politik Qeverisës 2025–2029, referenca e saktë në program është *"1.3. Administrata Publike, Antikorrupsioni dhe Transparenca"*.

- Projektvendim "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive"

Projektvendimi propozon të miratojë procedurën dhe rregullat për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës, konfirmimin, emërimin në kategorinë ekzekutive, mbështetur në ndryshimet që pritet të miratohen në ligjin nr. 152/2013, të ndryshuar. Miratimi i këtij vendimi synon përmirësimin e procesit të rekrutimit në nëpunësve në kategorinë ekzekutive, bazuar edhe në rekomandimet e lëna nga Raporti i Progresit të Komisionit Evropian dhe vlerësimi i OECD/SIGMA. Nëpërmjet miratimit të këtij projektvendimi, VKM-së nr. 243, datë 18.3.2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive", i ndryshuar, shfuqizohet.

Sa i takon përputhshmërisë së projektaktit me Programin Politik Qeverisës 2025–2029, referenca e saktë në program është *"1.3. Administrata Publike, Antikorrupsioni dhe Transparenca"*.

- Projektvendim "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët drejtuese, të mesme drejtues dhe të lartë drejtuese"

Projektvendimi propozon të miratojë procedurën dhe rregullat për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës, konfirmimin, emërimin në kategorinë ulët, të mesme dhe të lartë drejtuese, mbështetur në ndryshimet që pritet të miratohen në ligjin nr. 152/2013, të ndryshuar. Miratimi i këtij vendimi synon përmirësimin e procesit të rekrutimit të nëpunësve të këtyre kategorive, bazuar edhe në rekomandimet e lëna nga Raporti i Progresit të Komisionit Evropian dhe vlerësimi i OECD/SIGMA. Nëpërmjet miratimit të këtij projektvendimi, VKM-së nr. 242, datë 18.3.2015, "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese", i ndryshuar, dhe VKM-së nr. 118, datë 5.3.2014, "Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së", i ndryshuar, do të shfuqizohen.

Sa i takon përputhshmërisë së projektaktit me Programin Politik Qeverisës 2025–2029, referenca e saktë në program është *"1.3. Administrata Publike, Antikorrupsioni dhe Transparenca"*.

- Projektvendim "Për miratimin e rregullave, kritereve dhe masës për trajtime të tjera financiare të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe fushave dhe nënfushave prioritare të zhvillimit të vendit"; akt nënligjor ky në zbatim të ligjit nr. 35/2023, të ndryshuar

Projektvendimi propozon të miratojë përkufizimet, kriteret, rregullat, procedurën dhe masat e trajtimeve të tjera financiare, si dhe fushat dhe nënfushat prioritare të zhvillimit të vendit, me qëllim krijimin e një sistemi të drejtë, transparent dhe të qëndrueshëm që nxit performancën e lartë dhe inovacionin në administratën publike.

- Projektvendim "Për rregullat e hollësishme për sistemin e brendshëm të performancës"

Mes ndryshimeve që pritet të miratohen në ligjin nr. 90/2012, parashikohet edhe krijimi i një sistemi të detyrueshëm, të uniformizuar të mbikëqyrjes/llogaridhënies së trupave joministrore, bazuar në rezultatet/perfomancën e institucionit. Ky sistem konsiston në

mbikëqyrjen profesionale nga një njësi e shërbimit civil në kuadër të ministrisë mëmë, dhe instrumente të strukturuara në mënyrë eksplicite të planifikimit, raportimit, dhe vlerësimit. Për të bërë të mundur zbatimin në praktikë të këtij përcaktimi, është i nevojshëm miratimi i vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, ku do të miratohen rregullat e hollësishme të zbatimit të tij. Ky rregullim adreson dhe rekomandimin e OECD/SIGMA për përmirësimin e sistemit tërësor të mbikëqyrjes institucionale nga ministria tek institucionet e varësisë, bazuar edhe në rekomandimet e lëna nga Raporti i Progresit të Komisionit Evropian dhe vlerësimi i OECD/SIGMA .

- Projektvendim "Për miratimin e rregullave të organizimit dhe funksionimit të kabineteve ndihmëse dhe të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, të procedurave të hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm, si dhe miratimin e rregullave të detajuara për delegimin", kostoja për të cilën llogaritet ALL 1,255,611.00

Projektvendimi synon miratimin e: i. rregullave dhe procedurave për organizimin e brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, përfshirë këtu edhe për drejtoritë me status të veçantë; ii. rregullave të delegimit; dhe iii. numrit minimal të punonjësve për krijimin e një institucioni varësie, mbështetur në ndryshimet që priten të miratohen në ligjin nr. 90/2012. Nëpërmjet këtij vendimi, VKM-së nr. 893/2014, "Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm", i ndryshuar, do të shfuqizohet.

- Projektvendim "Për rregullat për përmbajtjen e detajuar, formën dhe procedurën e shqyrtimit paraprak të raportit të analizës organizative-funksionale dhe vendimmarrjen mbi vazhdimësinë e saj, si dhe procesin e hartimit e miratimit të aktit ligjor apo nënligjor përkatës".

Ndryshimet që pritet të miratohen në ligjin nr. 90/2012, përcaktojnë, mes të tjerash, edhe një sistem të detyrueshëm të përgatitjes dhe vlerësimit e kontrollit të iniciativave për ndryshime institucionale. Sistemi do të mbështetet në dy shtylla kryesore, duke nisur me kryerjen nga secila ministri të një analize të thelluar dhe të detyrueshme *ex ante* përpara hartimit të akteve ligjore për ndryshime institucionale, si krijimi i strukturave apo agjencive të reja, hap i cili gjithnjë do të ndërmerret në ruajtje dhe respektim të kompetencave të Departamentit të Administratës Publike (DAP) si njësi ekskluzive e zhvillimit të politikave të Qeverisë Shqiptare në fushën e organizimit të administratës publike. Për të bërë të mundur zbatimin efektiv të këtij sistemi, ligji autorizon Këshillin e Ministrave të miratojë përmbajtjen e detajuar, formën dhe procedurën e shqyrtimit paraprak të raportit të analizës organizative-funksionale dhe vendimmarrjen mbi vazhdimësinë e saj, si dhe procesin e hartimit e miratimit të aktit ligjor apo nënligjor përkatës.

- Projektvendim "Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë dhe pezullimin e lirimin nga shërbimi civil".

Projektvendimi propozon të miratojë procedurën dhe rregullat për transferimin, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil, mbështetur në ndryshimet që pritet të miratohen në ligjin nr. 152/2013, të ndryshuar. Miratimi i këtij vendimi synon përmirësimin e këtyre proceseve dhe pritet të ndikojë pozitivisht në menaxhimin më të mirë të nëpunësve civilë. Nëpërmjet miratimit të këtij projektvendimi, VKM-së nr. 124, datë 17.2.2016, "Për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil", i ndryshuar, dhe VKM-së nr. 125, datë 17.2.2016, "Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë", do të shfuqizohen.

- Projektvendim "Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë"

Projektvendimi propozon të miratojë nivelet e vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë, metodologjinë e vlerësimit, si dhe procesin e vlerësimit, mbështetur në ndryshimet që pritet të miratohen në ligjin nr. 152/2013, të ndryshuar. Miratimi i këtij vendimi synon përmirësimin e procesit të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësve civilë dhe lidhjen e

këtij procesi me shpërblimin e tyre. Nëpërmjet miratimit të këtij projektvendimi, VKM-së nr. 109/2014, i ndryshuar, shfuqizohet.

- Projektvendim "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 833, datë 28.10.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit"

Projektvendimi synon disa përmirësime në përmbajtjen dhe mbajtjen e dosjes së personelit, si dhe të menaxhimit, përdorimit dhe vënies në funksion të plotë të Regjistrit Qendror të Personelit, mbështetur në ndryshimet që priten të miratohen në ligjin nr. 152/2013, të ndryshuar.

- Projektvendim "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 115, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për përbërjen dhe vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil";

Projektvendimi synon disa përmirësime në procedurën e masave disiplinore dhe vendimmarrjen në komisionet disiplinore, mbështetur në ndryshimet që priten të miratohen në ligjin nr. 152/2013, të ndryshuar.

- Projektvendim "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 138, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për rregullat e organizimit e të funksionimit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, trajnimin e nëpunësve civilë, si dhe të çdo individi tjetër jashtë shërbimit civil", i ndryshuar

Projektvendimi synon disa përmirësime në lidhje me programet e trajnimit të ofruara nga ASPA, mbështetur në ndryshimet që priten të miratohen në ligjin nr. 152/2013, të ndryshuar.

- Projektvendim "Për punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës publike"

Projektvendimi propozon të miratojë procedurën dhe rregullat për krijimin e kushtet të nevojshme për punësimin e studentëve të ekselencës, në mënyrë që ata të kenë mundësi të krijojnë eksperienca të përshtatshme pune, me qëllim zhvillimin e karrierës së tyre të mëvonshme në administratën publike, mbështetur në ndryshimet që pritet të miratohen në ligjin nr. 152/2013, të ndryshuar. Nëpërmjet miratimit të këtij projektvendimi, VKM-së nr. 586, datë 30.8.2019, "Për punësimin e përkohshëm të studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore", do të shfuqizohet.

3. Lufta kundër korrupsionit

Lufta ndaj korrupsionit është një nga prioritetet kryesore të Qeverisë Shqiptare. Qëllimet e politikës kundër korrupsionit kanë synuar rritjen e efektivitetit të ndërhyrjeve parandaluese, ndëshkuese dhe ndërgjegjësuese ndaj korrupsionit, me synim final rritjen e besimit të qytetarëve dhe bizneseve në institucionet publike në vend.

Autoritetet shqiptare vijojnë punën në drejtim të parandalimit dhe ndëshkimit të korrupsionit në kuadër të detyrimeve që rrjedhin nga aderimi i Shqipërisë në instrumentet ndërkombëtarë për luftën kundër korrupsionit, si Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, Konventa Penale e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit, Konventa Civile e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit etj., mes të tjerash.

Ndër vitet e fundit Shqipëria ka përparuar ndjeshëm drejt forcimit të strukturës së saj institucionale dhe ligjore në luftën kundër korrupsionit. Krijimi dhe konsolidimi gradual i një kuadri të plotë institucional kundër korrupsionit është lehtësuar në masë të madhe nga zbatimi i reformës në drejtësi, e cila ka përmirësuar gjithashtu efikasitetin e sekuestrimit dhe konfiskimit të aseteve kriminale në çështjet që përfshijnë korrupsionin dhe ka përmirësuar ndjeshëm hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit. Shqipëria ka miratuar Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024–2030, e cila adreson sektorët vulnerabël si prona, prokurimi publik, shëndetësia, arsimi, doganat dhe tatimet, duke përfshirë edhe qeverisjen vendore dhe sektorin privat. Kuadri institucional për luftën kundër korrupsionit është i konsoliduar dhe funksional. Në mars 2025, GRECO përfundoi procedurën e vlerësimit

të përputhshmërisë të raundit të pestë për Shqipërinë, duke konkluduar se 18 nga 24 rekomandime ishin adresuar në mënyrë të kënaqshme.

Këto zhvillime të fundit njihen nga Raporti i Progresit të Komisionit Evropian për vitin 2025, sipas së cilit Shqipëria ka bërë disa përparime në forcimin e luftës kundër korrupsionit dhe në vijimin e masave të ndërmarra kryesisht në drejtim të hetimit dhe ndëshkimit të funksionarëve të lartë. SPAK ka miratuar Strategjinë për Reduktimin e Stokut *(backlog)* të Çështjeve 2025–2027, e cila kontribuon në zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe Strategjisë Kombëtare Kundër Krimit të Organizuar, dhe veprimtaria e tij ka dhënë rezultate pozitive në luftën kundër korrupsionit. Në raport vijon të vlerësohet puna e SPAK në hetimin dhe ndëshkimin e rasteve të korrupsionit të funksionarëve të lartë dhe ka shënuar përparime konkrete drejt ndërtimit të një bilanci të qëndrueshëm në luftën kundër korrupsionit.

Drejtimet kryesore të politikës kombëtare antikorrupsion shtrihen në 3 qasje të mirëkonsoliduara, përkatësisht parandalimin e korrupsionit përmes promovimit të integritetit në të gjitha nivelet e qeverisjes, ndëshkimin e praktikave korruptive në institucionet publike, si dhe edukimin dhe ndërgjegjësimin ndaj korrupsionit. Këto qëllime madhore zbatohen në partneritet dhe në mbikëqyrje të vazhdueshme nga qytetarët, organizatat e shoqërisë civile, sektori privat dhe grupet e interesit.

Me VKM-në nr. 522, datë 25.9.2025, kompetencat e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit vijojnë të ushtrohen nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin. Ky pozicion ndërthur agjendën e ndërhyrjeve të dedikuara në luftën kundër korrupsionit dhe promovimin e integritetit, transparencës dhe qeverisjes së hapur, me drejtimin politik të Reformës në Administratën Publike dhe zbatimin e parimeve të mirëqeverisjes.

Që nga krijimi i saj në vitin 2021, Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit (DPAK) ushtron kompetenca të dyfishta, përkatësisht në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave antikorrupsion, si dhe në hetimin administrativ të praktikave korruptive. Me miratimin e VKM Nr. 436, datë 26.6.2024, DPAK, deri atëherë strukturë e brendshme e Ministrisë së Drejtësisë, u riorganizua si një institucion i mëvetësishëm juridik në varësi të Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin si Koordinator Kombëtar Kundër Korrupsionit. Koordinatorët kundër Korrupsionit janë tashmë të pranishëm në 26 institucione publike dhe ndërmarrje me kapital shtetëror që ofrojnë shërbime direkte për publikun dhe që operojnë në sektorët me riskun më të lartë të korrupsion.

Revolucioni digjital i dekadës së fundit në modernizimin e shërbimeve dhe konsolidimi i infrastrukturës digjitale, me synim final ofrimin e shërbimeve cilësore me fokus qytetarët, ka qenë një instrument kyç për minimizimin dhe parandalimin e korrupsionit "të vogël" në sportele.

Në vitin 2022 GRECO ka vlerësuar rritjen e burimeve financiare të akorduara nga buxheti i shtetit për ILDKPKI 37% nga viti 2019 deri në vitin 2021,146 si dhe faktin që buxheti i dedikuar për burimet njerëzore ka ndjekur një trajektore në rritje, duke kaluar nga 985,000 euro në vitin 2019, në 1,002,166 euro në vitin 2020 dhe duke arritur 1,052,666 euro në vitin 2021. ILDKPKI-ja vlerësohet gjithashtu si një institucion i mirorganizuar, me kapacitet të plotë kontrolli dhe verifikimi të pasurive të zyrtarëve publike, i cili kryhet *online* prej fillimvitit 2022.

Përgjatë vitit 2024, ka vijuar puna për zbatimin e rekomandimeve të GRECO-s, në kuadër të Raundit V të Vlerësimit, i filluar në vitin 2022. Në shtator 2024, Shqipëria ka dorëzuar pranë Sekretariatit të GRECO-s Raportin Kombëtar të radhës, ku nga 19 rekomandimet e mbetura për adresim (nga të cilat 7 lidhen me qeverinë qendrore - funksionet e larta ekzekutive - dhe 12 lidhen me agjencitë e zbatimit të ligjit), 14 janë raportuar nga Qeveria Shqiptare si të adresuara plotësisht dhe 5 të tjera si në proces.

Njëkohësisht, gjatë vitit 2025, Shqipëria shënoi progres të mëtejshëm në forcimin e integritetit dhe luftën kundër korrupsionit, përmes avancimit të reformave institucionale,

përmirësimit të kuadrit ligjor dhe rritjes së efektivitetit të mekanizmave të transparencës dhe llogaridhënies. Sipas raportit të miratuar në mars 2025, në plenaren e 99 të GRECO-s, vendi ynë ka adresuar mbi 75% të rekomandimeve që lidhen me qeverisjen qendrore dhe institucionet e zbatimit të ligjit. Rezultatet e Shqipërisë u vlerësuan në mënyrë shumë pozitive, duke reflektuar përparim të qëndrueshëm në zbatimin e rekomandimeve dhe konsolidimin e kuadrit institucional të integritetit.

GRECO përmbylli procedurën e vlerësimit të Raundit të Pestë për Shqipërinë, duke konkluduar se 18 nga 24 rekomandime janë adresuar në mënyrë të kënaqshme. Në veçanti, Shqipëria u vlerësua pozitivisht për nivelin e zbatimit të rekomandimeve që lidhen me procesin e konsultimit publik për projektaktet ligjore dhe nënligjore, duke e konsideruar konsultimin publik si një mekanizëm efektiv për përfshirjen e palëve të interesuara dhe forcimin e transparencës në proceset e vendimmarrjes publike. Planet e Integritetit janë miratuar për të gjitha ministritë. Udhëzimet dhe shembujt ilustrues kanë plotësuar Kodin Ministror të Etikës dhe organizohen trajnime të rregullta mbi çështjet e lidhura me integritetin për anëtarët e Qeverisë dhe këshilltarët politikë. Pavarësia e Komisionit të Etikës është forcuar, duke krijuar kanale konfidenciale këshillimi. Gjithashtu, referuar funksionit të mekanizmave parandalues në organet ligjzbatuese, donacionet dhe sponsorizimet për policinë janë rregulluar me kuadrin ligjor përkatës, miratimi i ndryshimeve në kuadrin ligjor për zbatimin e shërbimeve shtesë me pagesë ndihmojnë në zbutjen e rrezikut të sjelljeve joetike. Manuali i Etikës së Policisë është miratuar dhe është në zbatim për të gjithë punonjësit e policisë, i pajisur me udhëzime dhe me trajnimet përkatëse. Sistemi për ofrimin e këshillimit konfidencial në polici mbi çështjet e lidhura me integritetin është ngritur dhe jepen të dhëna për qëndrueshmërinë e drejtuesve të lartë të Policisë së Shtetit në detyrë. *Vettingu* në polici vijon dhe adreson çështje të lidhura me integritetin, proces i cili shtrihet edhe te nivelet drejtuese. Regjimi i dhuratave në polici është plotësuar me mekanizma të përshtatshëm mbikëqyrjeje dhe zbatimi, si dhe janë vendosur kufizime pas përfundimit të marrëdhënies së punës dhe një sistemi i sinjalizimit është tashmë funksional dhe shoqërohet me masa ndërgjegjësuese dhe trajnime gjithashtu.

Në raportin më të fundit të OECD/SIGMA (2024), fusha e prokurimit publik ka marrë vlerësimin më të lartë lidhur me cilësinë e kuadrit ligjor, kapacitetin institucional dhe administrativ qendror për të zbatuar dhe monitoruar në mënyrë efektive politikat e prokurimit publik, si dhe zhvillimin e procedurave të shqyrtimit të ankesave. Miratimi i ligjit nr. 16/2024, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020, 'Për Prokurimin Publik'", solli ndërhyrje prioritare në sektorin e prokurimit publik, duke rritur përputhshmërinë me rekomandimet e BE-së dhe duke ofruar disa risi kyçe për të siguruar barazi në tendera, transparencë dhe forcimin e mekanizmave kundër korrupsionit, përfshirë:

- digjitalizimin e të gjithë sistemit të prokurimit publik;
- vlerësimin automatik të përputhshmërisë me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për kualifikimin e ofertuesve në fazën fillestare të parakualifikimit;
- profesionalizimin e mëtejshëm të të gjithë stafit përgjegjës dhe të angazhuar në ciklin e prokurimit përmes certifikimit dhe trajnimeve të detyrueshme;
- përcaktimin e qartë të detyrimit për autoritetet ose entitetet kontraktuese të marrin masa të përshtatshme për të parandaluar, identifikuar dhe zgjidhur rastet e konflikteve të interesit që lindin gjatë procedurave të prokurimit dhe zbatimit të kontratave, në përputhje me legjislacionin aktual, për të shmangur deformimin e konkurrencës dhe për të siguruar trajtim të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë.

Në vijim i gjithë cikli i prokurimit publik do të hyjë në një fazë tjetër përmes injektimit të teknologjisë më të avancuar dhe proceseve të robotizuara në përputhje me standardet më të larta evropiane për të zvogëluar në minimum tendenca ndërhyrje, në procesin e hartimit të kritereve dhe më pas në kontrollin e zbatimit të kontratave. Për të minimizuar edhe ndikimin e pashmangshëm të faktorit njerëzor në këtë proces, do të punohet për një proces të evidentimit

të risqeve të korrupsionit në prokurimet publike, të cilat shkojnë përtej automatizimit, për të krijuar një sistem që krijon imunitet të plotë dhe jep besueshmëri për përdorimin me ndershmëri dhe efektivitet të fondeve publike.

Policia e Shtetit vijon të konsiderohet një sektor me rrezik të integritetit nga gjetjet e Komisionit. Në vijim të rekomandimeve të adresuara në kuadër të dialoguar me Komisionin Evropian, janë ndërmarrë masa për forcimin e kuadrit ligjor dhe institucional në sektorin e Policisë së Shtetit, duke kulmuar me miratimin e ligjit nr. 82/2024, "Për Policinë e Shtetit". Ky ligj i ri adreson në mënyrë efektive plotësisht disa rekomandime të GRECO-s:

- Zbatimin e politikave që adresojnë në mënyrë të duhur rrezikun e korrupsionit dhe të konfliktit të interesit në ofrimin e shërbimeve shtesë nga Policia e Shtetit në këmbim të pagesës;
- Miratimin e rregullave për eliminimin ose, minimalisht, kufizimin e rreziqeve të korrupsionit dhe të konfliktit të interesit në lidhje me dhuratat private ose sponsorizimet për Policinë e Shtetit;
- Krijimin e një sistemi dhe emërimin e individëve të trajnuar dhe të besueshëm për ofrimin e këshillave konfidencialë mbi çështjet e etikës dhe integritetit për të gjithë stafin e Policisë së Shtetit;
- Hartimin e rregullave të qarta për kufizimet pas punësimit për oficerët e Policisë.

Për të garantuar qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë e politikave për reduktimin progresiv të korrupsionit, forcimin e integritetit të institucioneve dhe promovimin e qeverisjes së mirë, në vijim Qeveria Shqiptare ka vijuar me zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale 2024–2030. Vizioni i strategjisë së re është ndërtimi i institucioneve publike që funksionojnë në përputhje me standardet më të larta të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies publike dhe ofrojnë shërbime eficiente ndaj qytetarëve. Në vitin e parë të zbatimit të saj, kjo strategji shënoi një nivel zbatimi në masën 87.5%.

Duke njohur përhapjen dhe qëndrueshmërinë e korrupsionit, rrezikun e shfaqur në institucionet publike dhe specifikisht në disa sektorë të konsideruar vulnerabël si pronat, taksat, tatimet, prokurimet publike, shëndetësia dhe arsimi, fokusi madhor i strategjisë së re antikorrupsion do të jetë kalimi nga një qasje ndërsektoriale në një qasje kombëtare, gjithëpërfshirëse dhe të integruar. Në këtë drejtim është konsoliduar puna për krijimin e një mase kritike ekspertize sektoriale brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, në funksion të kryerjes së vlerësimit të riskut të korrupsionit në fushat e prokurimit publik dhe të drejtat pronësore, ndjekur nga miratimi i planeve të dedikuara sektoriale të integritetit. Ky proces do të vijojë më pas edhe në sektorët e tjerë të identifikuar me risk të lartë korrupsioni. Me urdhrin nr. 2, datë 22.4.2025, Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin miratoi dokumentin Metodologji e Vlerësimit të Riskut të Korrupsionit, e cila vendos parimet bazë dhe ka rëndësi për identifikimin dhe adresimin e vulnerabiliteteve që mund të krijohen nga praktikat korruptive, duke mundësuar zhvillimin e politikave dhe masave që do të përmirësojnë performancën e institucioneve publike. Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Korrupsionit është një komponent kyç për identifikimin dhe menaxhimin e risqeve të korrupsionit në sektorët vulnerabël të njohur nga strategjia antikorrupsion, siç janë pronësia, kujdesi shëndetësor dhe social, arsimi, kontratat publike, tatimet dhe doganat, të cilat kanë një ndikim të madh në qeverisje dhe besimin e publikut ndaj institucioneve. Në këtë linjë është, hartuar dhe konsoliduar gjithashtu dokumenti Metodologji e Vlerësimit të Riskut të Korrupsionit në sektorin e prokurimit publik. **Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Korrupsionit në sektorin e prokurimit publik**, mundëson identifikimin sistematik të risqeve përgjatë të gjithë ciklit të prokurimit. Ajo ofron një qasje të unifikuar dhe praktike për institucionet publike, duke forcuar masat parandaluese dhe transparencën në këtë sektor me risk të lartë.

Përgjatë vitit 2025, është kryer vlerësimi i riskut të integritetit në sektorin e pronës, pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, duke realizuar një proces të strukturuar të vlerësimit të

riskut të integritetit. Gjatë këtij procesi u analizuan funksionet kyçe institucionale të Agjencisë, procedurat me risk të lartë, si dhe efektiviteti i instrumenteve ekzistuese të integritetit dhe kontrollit të brendshëm. Ky plan përbën një instrument thelbësor parandalues, që synon forcimin e transparencës, llogaridhënies dhe besimit publik në këtë sektor me ndjeshmëri të lartë. Plani i Integritetit i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës është miratuar me urdhrin nr. 1219, datë 25.11.2025 të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë dhe ka nisur nga zbatimi.

Një hapësirë të posaçme në këtë strategji paraqet edhe sektori privat, bashkëpunimi i tij me sektorin publik për të përmirësuar eficiencën dhe zvogëluar ndërhyrjet për korrupsion. Si risi vjen edhe bashkëpunimi i shtuar me shoqërinë civile posaçërisht për rritjen e rolit aktiv të grave në luftën kundër korrupsionit. Në këtë drejtim, me pjesëmarrjen e aktorëve të dhomave të biznesit dhe të organizatave të shoqërisë civile, në tetor 2025 u mbajt një konferencë një-ditore me fokus "Qasja shumëpalëshe e Shqipërisë në parandalimin e korrupsionit", e cila adresoi dhe promovoi urat e bashkëpunimit midis sektorit publik – sektorit privat për zbatimin e strategjisë. Përgjatë vitit 2025 është promovuar me ndërhyrjen direkte të Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit, gjithashtu nevoja për të kontribuuar me instrumentet e integritetit (Plane Integriteti) edhe në sektorin privat dhe duke krijuar ura bashkëpunimi për shkëmbimin e asistencave që shoqëria civile pritet t'i japë sektorit privat. Lançimi i rrjetit antikorrupsioni.al, një platformë komunikimi dhe ndarjeje të dhënash për luftën kundër korrupsionit i bërë në dhjetor 2025, renditet një tjetër angazhim i kryer në këtë kuadër.

Gjithashtu, në një fotografim të situatës aktuale mbi instrumentet e promovimit të integritetit, në nivelin qendror, aktualisht me rikompozimin e kabinetit qeveritar në shtator 2025, ministritë e linjës që kanë pësuar konfigurim do të adaptojnë planet institucionale të integriteti (gjithsej janë 12 ministri), të gjithë ministrat e Shtetit (4). 48 institucione varësie të ministrive të linjës, dhe 3 institucione të pavarura (Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Kuvendi dhe KLP) vijojnë të kenë në fuqi Plane të Dedikuara Integriteti. Ndërkohë, në nivelin vendor, 33 bashki kanë në fuqi Plane të dedikuara Integriteti. Është vijuar me shpërndarjen e informacioneve dhe me fokus rritjen e kulturës së integritetit dhe të llogaridhënies në administratën publike, në nivel qendror dhe vendor. Etika në administratën publike është gjithashtu një element themelor në Strategjinë për Reformën në Administratën Publike 2024–2030, e miratuar nga qeveria shqiptare me vendim nr. 472, datë 31.7.2025. Zbatimi i rregullave të etikës do të forcohet përmes ngritjes së kapaciteteve të stafit në njësitë që monitorojnë etikën dhe menaxhojnë burimet njerëzore. Përmes këtyre masave, synohet avancimi i përgjegjshmërisë institucionale dhe konsolidimi i një administrate të bazuar në ndershmëri dhe integritet. Në vijim të kësaj qasjeje, përgjatë dhjetor 2025 u promovua edhe Rrjeti i Koordinatorëve dhe Këshilltarëve të Etikës në çdo institucion të administratës publike, të konsideruar gjithashtu edhe si bashkëpunëtor me rëndësi të Pikave të Kontaktit Antikorrupsion që garantojnë zbatimin e strategjisë antikorrupsion.

Në vijim do të punohet për promovimin e kapitalit njerëzor në administratën publike, mes të tjerash edhe përmes promovimit të modeleve të integritetit në administratë. Për këtë, masat për zhvillimin e kapitalit njerëzor, duke përfshirë rritjen e ndjeshme të pagave dhe përmirësimin e sistemit të vlerësimit në punë, do të ndërthuren me masa për rritjen e integritetit të zyrtarëve publikë, me fokus të veçantë në fushat me risk.

Edukimi i shtuar për integritetin dhe ligjshmërinë do të prioritizohet si investimi më i qëndrueshëm në mbrujtjen që në moshë të hershme me standardet e mirëqeverisjes dhe frymën e zbatimit të ligjit. Për këtë, është vijuar me përgatitjen e Kurrikulës së dedikuar për Integritetin për nxënësit e shkollave fillore dhe të arsimit të mesëm të ulët (klasat 1-9). Kjo kurrikul synon të angazhojë nxënësit në një mënyrë bashkëkohore, interesante dhe interaktive për të diskutuar mbi kulturën e ligjshmërisë dhe për të promovuar një shoqëri pa korrupsion. Kurrikula do t'i njohë nxënësit me konceptet themelore që lidhen me integritetin dhe do të rrisë ndërgjegjësimin mbi rolin e tyre në krijimin e një shoqërie më të drejtë dhe të bazuar në integritet. Përgjatë

nëntor 2025 janë zhvilluar gjithashtu orë të hapura mësimore informative për kulturën e ligjshmërisë dhe të luftës kundër korrupsionit për nxënësit e klasave të X në gjimnazet e Tiranës, për të lehtësuar marrjen e koncepteve të para për integritetin dhe etikën.

Përgjatë vitit 2025 është vijuar me procedurat parlamentare të diskutimit ligji i ri për konfliktin e interesit. Ardhur në Kuvend me iniciativë të deputetëve, ky ligj ka kaluar edhe në lupën e konsultimit me strukturat e Bashkimit Evropian dhe ka vijuar me diskutimin e tij në mbledhjet e komisionet e përhershme parlamentare, përgjatë muajit dhjetor 2025. Zbatimi i suksesshëm i këtij ligji do të përmirësojë ndjeshëm zbatimin praktik të rregullimeve ligjore. Po ashtu në vitin 2025 u finalizua rishikimi i mëtejshëm i ligjit nr. 60/2016 me miratimin në dhjetor 2025 të ligjit nr. 96/2025 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", me synim përmirësimin e efektivitetit të ligjit për sinjalizuesit dhe forcimin e masave mbrojtëse për ta, për ta përafruar atë me *Acquis* -në e BE-së dhe standardet evropiane. Ligji u hartua në konsultim të hapur me ekspertizën teknike të Bashkimit Evropian dhe Projektit EU4GG me qëllim linjëzimin e kuadrit të brendshëm ligjor me Direktivën nr. 2019/1937/BE, e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e datës 13 tetor 2019, "Për mbrojtjen e personave që raportojnë shkelje të ligjit të Unionit. Ligji u miratua nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në seancën plenare të datës 18 dhjetor 2025.

Ligji nr. 12/2026, "Për lobimin në Republikën e Shqipërisë", u miratua më datë 28.1.2026 nga Kuvendi i Shqipërisë.

Ky ligj synon vendosjen e një kuadri të qartë, gjithëpërfshirës dhe transparent për rregullimin e veprimtarisë së lobimit, formalizimin e marrëdhënieve ndërmjet subjekteve private dhe institucioneve publike, si dhe forcimin e integritetit dhe llogaridhënies në proceset e vendimmarrjes publike. Miratimi i tij do të kontribuojë në përafrimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor kombëtar me standardet evropiane dhe rekomandimet ndërkombëtare në fushën e transparencës dhe luftës kundër korrupsionit.

Ligji nr. 23/2026, "Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve zyrtare", u miratua më datë 3.2.2026 nga Kuvendi i Shqipërisë.

Ky ligj synon të forcojë integritetin e zyrtarëve dhe të institucioneve publike, si dhe garantimin e kryerjes së funksioneve publike nga ana e zyrtarëve publikë në mënyrë objektive, të paanshme dhe transparente në interesin më të mirë të mundshëm të publikut dhe të besimit të tij ndaj institucioneve publike nëpërmjet identifikimit, parandalimit, menaxhimit dhe zgjidhjes së konfliktit të interesit publik dhe privat të zyrtarëve.

Përgjatë vitit 2026 parashikohet miratimi i akteve të mëposhtme ligjore dhe nënligjore, të cilat pritet të forcojnë kuadrin rregullator dhe të avancojnë zbatimin efektiv të politikave në fushën e parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit:

- Miratimi i projektligjit "Për donacionet dhe sponsorizimet", si ndërhyrje në nivel primar për rritjen e transparencës dhe integritetit në marrëdhëniet midis sektorit publik dhe atij privat. Ky projektligj synon të përcaktojë rregulla të qarta për pranimin, regjistrimin, publikimin dhe monitorimin e këtyre kontributeve dhe do të shërbejë për rritjen e transparencës dhe parandalimin e ndikimit të papërshtatshëm në proceset e vendimmarrjes publike, duke reduktuar ndjeshëm hapësirat për abuzim dhe konflikt interesi. Procesi i hartimit është mbështetur nga asistenca teknike e Delegacionit të Bashkimit Evropian, nëpërmjet projektit *EU4Good Governance*.

- Miratimi i projektvendimit të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e planit të veprimit 2027–2030, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2024–2030", me qëllim operacionalizimin e objektivave strategjikë dhe përcaktimin e masave konkrete të zbatimit;

- Miratimi i projektvendimit të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e marrëdhënies së punës, strukturës dhe kritereve të përzgjedhjes së punonjësve të njësisë përgjegjëse të

sinjalizimit në autoritetet publike", për të garantuar funksionimin e qëndrueshëm dhe profesional të mekanizmave të sinjalizimit."

Thellimi i luftës kundër korrupsionit lidhet me Agjendën 2030 në kuadër të realizimit të Objektivit 16 "Promovimi i shoqërive paqësore dhe përfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrim i aksesit në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet", dhe më posaçërisht, Treguesit 16.5 "Ulja në mënyrë të konsiderueshme e korrupsionit dhe mitmarrjes në të gjitha format e tyre".

4. Digjitalizimi

Teknologjitë e informacionit dhe telekomunikimit kanë çelur mundësi dhe oportunitete të reja të paimagjinueshme deri disa dekada më parë. Këto teknologji të reja të zhvilluara shumë vrullshëm janë mundësi për më shumë zhvillim, mirëqenie dhe demokratizim, por njëherazi paraqesin rreziqe që mund të krijojnë hendeqe të reja midis vendeve e civilizimeve të ndryshme apo edhe midis vetë shtresave të ndryshme të shoqërisë së një vendi, duke mbarsur konflikte potenciale sociale apo midis shteteve.

Zhvillimi i infrastrukturës digjitale, rrjeteve të telekomunikacionit/komunikimeve elektronike të shpejta dhe shumë të shpejta është një domosdoshmëri për të mbështetur gjithë transformimin digjital të ekonomisë dhe zhvillimet inovatore në sektorë strategjikë si energji, transport, industri, arsim etj. si dhe përmirësimin rrënjësor të cilësisë së shërbimeve publike. Qeveria Shqiptare ka vazhduar promovimin e TlK në sektorë të ndryshëm, duke prezantuar dhe implementuar strategji dhe politika të ndryshme të cilat e kanë TIK në fokusin e tyre, zhvillimin e shoqërisë së informacionit, agjendën digjitale, zhvillimin e *Broadband*-it, sigurinë kibernetike, ndërveprueshmërinë, të dhënat e hapura etj.

Në S3 është parashikuar mbështetje e veçantë e dedikuar për konektivitetin dhe infrastrukturën digjitale prej 7.370.000 eurosh, si dhe një sërë masash/aktivitetesh në prioritetet e tjera që lidhen me digjitalizimin, sigurinë kibernetike dhe inteligjencën artificiale.

Zhvillimi i infrastrukturës digjitale *broadband*, 5G, tarifat e *roaming*-ut dhe në tërësi komponentët e integrimit digjital janë pjesë e angazhimeve rajonale të Ballkanit Perëndimor (BP) në Planin e Veprimit te Tregut të Përbashkët Rajonal 2021-2024 (CRM). Agjenda Digjitale për Ballkanin Perëndimor, si një përpjekje e përbashkët e partnerëve të Ballkanit Perëndimor (BP) dhe Komisionit Evropian (KE) është prezantuar si një nga gjashtë iniciativat e Komunikatës mbi një perspektivë të besueshme të zgjerimit dhe angazhimin e BE-së me Ballkanin Perëndimor.

Qasja në informacion të paanë është sot më e lehtë se kurrë, por teprimi me informacion të pasigurt apo të rremë mbart rrezikun e deformimeve zhvillimore, sociale dhe kulturore.

Shqipëria është një shembull për t'u ndjekur gjatë viteve të fundit sa i përket transformimit digjital dhe digjitalizimit të shërbimeve publike, duke eliminuar praktikisht radhët në sportele, pritjet e gjata dhe paraqitjen fizike të dokumentacionit nga qytetarët dhe bizneset. Aktualisht, 95% e të gjitha shërbimeve publike ofrohen vetëm *online*. Në portalin *e-Albania* ofrohen 1271 shërbime elektronike të aksesueshmë vetën në mënyrë digjitale, duke garantuar një proces më të shpejtë, më transparent dhe më efikas për përdoruesit. Gjithashtu, që nga viti 2017 janë gjeneruar mbi 51 milionë dokumente me vulë elektronike, çka dëshmon për shkallën e lartë të përdorimit të platformës.

Viti 2022 shënoi një ndryshim rrënjësor në shërbimin e administratës publike ndaj qytetarëve dhe bizneseve. Që prej majit 2022, për të gjitha shërbimet publike për të cilat aplikohej nëpërmjet *e-Albania,* dhe përgjigja e tyre, dokumenti administrativ final ofrohet vetëm *online*, duke shmangur në këtë mënyrë plotësisht kontaktin e drejtpërdrejtë fizik të qytetarëve dhe bizneseve me institucionet publike dhe rrjedhimisht duke shmangur mundësitë për korrupsion.

Në *e-Albania* aktualisht ofrohen 1271 shërbime elektronike vetëm *online*. Portali *e-Albania* vepron si një pikë e vetme për ofrimin e shërbimeve publike të institucioneve qeveritare për qytetarët dhe bizneset 24/7.

Aktualisht janë të regjistruar 3.43 milionë qytetarë dhe biznese të cilët shërbehen çdo ditë nëpërmjet *e-Albania*, pa asnjë kosto shtesë, pa pritur në radhë dhe pa pasur asnjë kontakt fizik me punonjësit apo administratën. Për vitin 2025 janë marrë nëpërmjet *e-Albania* 17,000,000 shërbime publike, kryesisht në shërbime të gjendjes civile, turizëm, kulturë dhe art, financë dhe ekonomi, shërbime sociale, arsim, punë të jashtme etj., Që nga viti 2017 e deri më tani janë gjeneruar mbi 51 milionë dokumente me vulë elektronike, përkthyer kjo në kursime në kohë dhe kostoja për qytetarët dhe bizneset. Nëpërmjet ligjit nr. 100/2024 janë bërë disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 43/2023, "Për qeverisjen elektronike". Nëpërmjet këtyre ndryshimeve është synuar rregullimi i procesit të riinxhinierimit të shërbimeve, krijimin dhe funksionimin pranë AKSHI-t i Bordit Këshillimor, si organ konsultatitv për çështjet e teknologjisë së informacionit, i cili zëvendëson Komitetin Ndërministror për Teknologjinë dhe Inovacionin, shfuqizimi i ligjit nr. 13/2016, "Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë", i cili është ligji themeltar i funksionimit të ADISA-s, si dhe disa ndryshime të tjera teknike, me qëllim përmirësimin e ligjit të qeverisjes elektronike, disa prej të cilave janë evidentuar gjatë zbatimit të tij. Gjithashtu, ofrimi i shërbimeve të autentifikimit, nënshkrimit elektronik, vulës elektronike dhe certifikatës elektronike të cilat mundësojnë të njëjtën vlefshmëri ligjore dhe fuqi provuese me formën shkresore dhe për shtetasit shqiptarë dhe të huaj, është një tjetër ndryshim i bërë në ligj.

Vendimi nr. 479, datë 24 korrik 2024, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e dokumentit të metodologjisë dhe standardet teknike për përdorimin e inteligjencës artificiale në Republikën e Shqipërisë", shënon miratimin e një metodologjie gjithëpërfshirëse dhe standardeve teknike për përdorimin e Inteligjencës Artificiale (AI) në Republikën e Shqipërisë. Ai përshkruan se si sistemet e AI duhet të zhvillohen, menaxhohen dhe rregullohen brenda vendit, veçanërisht në institucionet e sektorit publik. Metodologjia e miratuar për përdorimin e AI në Shqipëri synon të sigurojë zhvillimin, menaxhimin dhe përdorimin e sistemeve të AI-së, në përputhje me standardet ndërkombëtare për siguri dhe etikë. Ajo klasifikon sistemet e AI sipas rrezikut që paraqesin dhe kërkon vëzhgim të vazhdueshëm për të siguruar që ato të jenë të sigurta dhe të ndershme. Për më tepër, përfshin masa për mbrojtjen e të dhënave, transparencën dhe mbikëqyrjen njerëzore. Është bazuar në parimet e OECD për përdorimin e sigurt të IA-së, si dhe aktit të IA-së të BE-së miratuar së fundmi (EU AI Act).

Ky vendim është në përputhje me punën e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për hartimin e Strategjisë së parë Kombëtare të Shqipërisë për Inteligjencën Artificiale, e cila është konsultuar gjerësisht me partnerë vendas dhe të huaj, duke përfshirë përfaqësues të akademisë dhe të sektorit të biznesit. Strategjia ndodhet në fazën përfundimtare të hartimit.

Zhvillimi i sektorit digjital do të mbajë në konsideratë 4 çështje që konsiderohen kyçe:

- Rritjen e aksesit në teknologjitë digjitale qoftë nga pikëpamja e penetrimit gjeografik, po ashtu edhe nga pikëpamja e përballueshmërisë financiare;
- Aftësitë digjitale jo vetëm të nxënësve, të rinjve/të rejave, profesionistëve të sektorit por edhe të popullsisë në moshë madhore;
- Mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian;
- Sigurinë kibernetike në bashkërendim me partnerët tanë strategjikë euroatlantikë.

Një fokus të veçantë i ka marrë siguria kibernetike dhe mbrojtjes së të dhënave, duke pranuar rolin e tyre vendimtar në një ekonomi digjitale. Hapat e ndërmarrë në këtë drejtim përfshijnë krijimin e Qendrës Qeveritare Operacionale të Sigurisë Kibernetike (Gov-SOC) për monitorimin dhe reagimin ndaj aktiviteteve në rrjetin qeveritar. Ekipi i Qendrës Qeveritare Operacionale të Sigurisë Kibernetike, duke operuar në skenës ndërkombëtare nëpërmjet emrit

NAIS G-CSIRT, është tashmë një ekip i akreditуar nga *Trusted Introducer* dhe anëtar i FIRST që prej vitit 2025. Në planet afatshkurtra qëndron dhe certifikimi nga bordi i *Trusted Introducer.* Përveç Gov-SOC, është krijuar edhe qendra e monitorimit të rrjetit qeveritar, e cila luan një rol kryesor në sigurimin e monitorimit, sigurisë dhe efikasitetit të vazhdueshëm të rrjetit qeveritar dhe pajisjeve të lidhura me to.

Situata e zhvillimit të infrastrukturës digjitale ka përmirësim por mbetet ndarja e theksuar midis zonave urbane dhe rurale. Për arritjen e objektivave për *gigabit society* nevojiten investime të rëndësishme. Vizioni për zhvillimin e infrastrukturës digjitale "*Shqipëria me infrastrukturë digjitale broadband të shpejtësisë së lartë dhe shumë të lartë në gjithë vendin, për të ngritur themelet për një shoqëri Gigabit*" mbështetet në objektivat strategjikë, që synojnë zhvillimin e qëndrueshëm të infrastrukturës *broadband,* reduktimi i ndarjes digjitale dhe ofrimi i shërbimeve *broadband* gjithëpërfshirëse, dhe rritjen e kërkesës për zhvillimin e ekonomisë digjitale dhe një shoqëri *Gigabit*. Në kuadër të programit GovTech do zbatohet projekti prioritar për periudhën 2027–2029, për zhvillimin e sistemit AFMIS-it në nivel vendor.

Ligji nr. 87/2023, "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ndërmjet Bashkimit Evropian, dhe Republikës së Shqipërisë, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Programin e Bashkimit "Evropa Digjitale" (2021–2027)" është një arritje e rëndësishme në kuadrin e transformimit digjital, duke i hapur rrugën pjesëmarrjes së personave juridikë shqiptarë nga sektori publik, privat dhe akademik në projektet e BE-së që lidhen me: Kompjuterë me Performancë të Lartë (HPC), Inteligjencën Artificiale, aftësitë digjitale të avancuara dhe aplikimi dhe përdorimi më i mirë i aftësive dhe ndërveprueshmërisë digjitale. Gjatë vitit 2024, Shqipëria shënoi një arritje të rëndësishme në kuadër të Programit Digjital të Evropës (DEP), duke u shpallur fituese me dy konsorciume, të cilat u njohën si *European Digital Innovation Hubs* (EDIHs). Gjithashtu, janë organizuar me sukses sesione informuese për thirrjet e hapura për EDIH dhe për iniciativa të tjera në kuadër të DEP-së. Përmes platformave të komunikimit të MIE-s dhe AKSHI-t, është siguruar një shpërndarje e vazhdueshme dhe transparente e mundësive për aplikim, duke ndihmuar aktorët shqiptarë të përfitojnë nga mbështetja e Bashkimit Evropian për inovacion dhe teknologji digjitale.

Gjatë vitit 2025, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, së bashku me MIE-n, kanë organizuar një sesion informues mbi thirrjet e hapura për vitin 2025, sesion i cili u realizua në muajin nëntor, me pjesëmarrjen e mbi 50 institucioneve që janë grup potencial i synuar për të aplikuar nga Shqipëria. Ndërkohë, po ashtu, është përcjellë me *e-mail* çdo kërkesë për partneritet që ka ardhur pranë NCP-së *(National Contact Person)* të AKSHI-i dhe MIE-s, duke u komunikuar te pjesëmarrësit.

Në vitin 2025, në kuadër të thirrjes së dytë të hapur për EDIH, nga Shqipëria ka fituar projektin EDIH një nga konsorciumet që kanë aplikuar dhe aktualisht ndodhet në fazën e nënshkrimit të marrëveshjes së grantit.

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit gjatë vitit 2024 u shpall fituese dhe po implementon në bashkëpunim me *Western Balkan Investment Frameëork* projektin "Studim i fizibilitetit për krijimin e *High Performance Computing* për të dhënat e institucioneve qeveritare dhe ngritjen e një rrjeti të sigurt shkëmbimi informacioni për të mundësuar ndërveprueshmërinë rajonale në rajonin e Ballkanit Perëndimor". Zbatimi i këtij projekti pritet të përfundojë në katërmujorin e parë të 2026. Në vazhdim synohet aplikimi në thirrjen e radhës të *Western Balkan Investment Framework* për formën e detajuar të projektit, për të vijuar më pas me aplikimin për projekt investimin.

Qendra HPC do të jetë hapi tjetër në rrugëtimin e Qeverisë për Transformimin Digjital që mundëson njohuri nga të dhënat e ruajtura në Qendrën e të Dhënave Qeveritare për shkak të analizave dhe përpunimit në kohë reale dhe do t'i mundësojë qeverisë sonë të jetë në përputhje me "Programin e Evropës Digjitale".

Synimi afatgjatë është integrimi AI në të gjithë sektorët, duke synuar një ndikim transformues në kujdesin shëndetësor, arsim, bujqësi, taksa dhe tatime etj. Iniciativa të tilla, si diagnostikimi i hershëm i sëmundjeve asistuar nga AI, rrugëtimet e personalizuara të arsimimit dhe bujqësia precize pritet të përmirësojnë ndjeshëm rezultatet e politikave dhe efikasitetin e shërbimeve. Për më tepër, këto iniciativa parashikohen të reduktojnë ndjeshëm punën manuale, të minimizojnë gabimet njerëzore dhe të thjeshtojnë proceset në të gjithë administratën. Më 28 dhjetor 2023, u lançua versioni i parë i asistentit virtual të *e-Albania* (versioni 1.0), duke shënjuar një shtesë novatore në portalin e shërbimeve publike të qeverisë shqiptare. Asistenti virtual i *e-Albania-s*, i cili ndihmon në kohë reale qytetarët për pyetjet që mund të kenë për shërbimet *online*, iu përgjigj rreth 1 milion pyetjeve gjatë vitit 2024. Në kuadër të zhvillimit të vazhdueshëm të portalit *e-Albania* drejt ofrimit të shërbimeve më intuitive dhe të orientuara nga përdoruesi, asistenti virtual është përmirësuar më tej në **Diella 3.0**, duke u mbështetur në teknologji të inteligjencës artificiale dhe *machine learning*. Gjatë vitit 2025, Diella ka integruar ndërveprimin zanor, duke u mundësuar qytetarëve akses përmes komandave me zë në mbi **50 dokumente zyrtare**. Në të njëjtin vit, Diella përpunoi mbi **1,400,000 kërkesa të qytetarëve** dhe gjeneroi rreth **61,000 dokumente elektronike**, duke ofruar përgjigje të menjëhershme dhe automatizim të proceseve që më parë vareshin nga ndërhyrja njerëzore. Ky zhvillim ka kontribuar ndjeshëm në rritjen e efikasitetit, aksesueshmërisë dhe cilësisë së shërbimeve publike digjitale.

Digjitalizimi si një qasje horizontale ka efekte shumëdimensionale në thuajse të gjithë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030, por më drejtpërdrejt efektet e tij lidhen në kuadër të realizimit të Objektivit 9: "Ndërtimi një infrastrukture të fortë, nxitja e industrializimit përfshirës e të qëndrueshëm dhe nxitja e novacionit" dhe synimit 9.c "Rritja e ndjeshme e aksesin ndaj teknologjisë së informacionit dhe komunikimit dhe përpjekje për ofrim aksesi universal dhe të përballueshëm në internet në vendet më pak të zhvilluara deri në vitin 2030".

5. Bujqësia

Zhvillimi ekonomik në zonat rurale karakterizohet nga një mbizotërim i aktivitetit ekonomik nga bujqësia, sektor i cili dominohet nga fermat e vogla dhe familjare. Këto njësi ekonomike luajnë rol të rëndësishëm për sigurimin e ushqimit të popullsisë shqiptare, si dhe për uljen e varfërisë në zonat rurale, por ato janë të integruar në mënyrë të pamjaftueshme në zinxhirët e shkurtër të furnizimit. Në periudhën 2022–2023, edhe falë integrimit të një pjese të rëndësishme të fermerëve në skemat kombëtare të mbështetjes ku mbështetja ndaj naftës ka pasur një rol thelbësor, numri i fermerëve që zotërojnë një NIPT fermeri është rritur ndjeshëm.

Madhësia e vogël e fermës tipike prej 1.2 ha, kombinuar me fragmentimin e tokës janë sfida kryesore për rritjen dhe konkurrencën e sektorit të bujqësisë ndonëse fermat familjare luajnë rol kritik për sigurinë ushqimore të popullsisë shqiptare, si dhe për rritjen e mirëqenies në zonat rurale. Bujqësia kontribuon në 15.45% të prodhimit të brendshëm bruto dhe punëson 36.7% të fuqisë punëtore në vend. Agropërpunimi është rritur ndjeshëm gjatë 10 vjetëve të fundit, duke arritur në 24.4% të xhiros totale të bujqësisë. Tendencat pozitive dëshmojnë se sektori ka potencial të lartë për zhvillim dhe krijimin e vendeve të punës. Zonat rurale kanë gjithashtu një potencial të lartë për turizmin e qëndrueshëm të bazuar në natyrë, por i cili po vlerësohet dhe lidhet me sektorët e tjerë të ekonomisë lokale. Sektori i turizmit rural, i cili ofron punësim tërheqës për të rinjtë/të rejat dhe gratë, është një forcë shtytëse e rimëkëmbjes ekonomike. Zhvillimi i sektorit po nxjerr në pah nevojën për të punësuar të kualifikuar. Sektori shihet si një prej motorëve të zhvillimit të zonave rurale duke lidhur kështu në të njëjtën pikë prodhimin, përpunimin, dhe shërbimet ndaj produktit.

Vizioni për sektorin e bujqësisë synon të bëjë të mundur një sektor agroushqimor dhe të peshkimit të efektshëm, inovativ dhe të qëndrueshëm në Shqipëri, i cili të mund të përballojë më mirë presionet e tregut kombëtar dhe ndërkombëtar dhe të reagojë ndaj sfidave të

ndryshimeve klimatike dhe menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore, ndërkohë që kontribuon në përmirësimin e cilësisë së jetës së banorëve të zonave rurale.

Inovacioni në sektorin e bujqësisë dhe zhvillimit rural konsiderohet vlerë e shtuar e konsiderueshme në ekonominë e vendit dhe për këtë arsye ajo zë një vend të rëndësishëm dhe kryesor në S3 me objektiv kryesor: "Transformimin e sektorit bujqësor për të ofruar ushqim të shëndetshëm, duke u përqendruar në zhvillimin e një zinxhiri ushqimor të qëndrueshëm, të bazuar në traditë, si dhe në nxitjen e shtimit të vlerës dhe rritjes së konkurrueshmërisë në treg" dhe objektiva specifikë, si vijon:

1. Bujqësi e qëndrueshme dhe certifikim. Rritja e qëndrueshmërisë ekonomike të fermave për t'u përballur me sfidat aktuale dhe të ardhshme (p.sh. ndryshimet klimatike), përmes uljes së kostove, prodhimit të qëndrueshëm dhe certifikimit;
2. Përpunimi i ushqimit dhe produktet me vlerë të shtuar;
3. Peshkimi dhe akuakultura e qëndrueshme;
4. Prodhimi i bimëve mjekësore dhe aromatike, vajrave dhe ekstrakteve;
5. Forcimi i agroturizmit dhe zhvillimit të biznesit në zonat rurale.

Hapja e qendrës rajonale të inovacionit të *EIT Food* dhe ngritja e laboratorëve të certifikuar në nivel kombëtar përbëjnë iniciativa në progres me impakt të rëndësishëm në sektor.

Në funksion të këtij vizioni mbështetet adresimi i sfidave kryesore ekonomike, mjedisore dhe sociale për të përmirësuar mundësitë për zhvillimin e bujqësisë, peshkimit dhe biznesit në zonat rurale, duke i kushtuar vëmendje të veçantë barazisë gjinore dhe tërheqjes së fermerëve dhe sipërmarrësve të rinj, për të përmbushur prioritetet e politikave të sektorit dhe ambiciet e procesit të akreditimit të BE-së.

Objektivat e përgjithshëm për sektorin e bujqësisë konsistojnë në:

- Promovimin e prodhimit të qëndrueshëm dhe të cilësisë së ushqimit nëpërmjet zhvillimit të një sektori konkurrues dhe inovativ agroushqimor;
- Forcimin e menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe veprimeve lidhur me klimën;
- Forcimin e strukturës sociale-ekonomike të zonave rurale;
- Nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm të peshkimit detar dhe të ujërave të brendshme;

Harmonizimin e plotë të legjislacionit me *Acquis* të BE-së për tre kapitujt të udhëhequr nga MBZHR: kapitulli 11: "Bujqësia dhe Zhvillimi Rural"; kapitulli 12: "Siguria ushqimore, politika veterinare dhe fitosanitare"; kapitulli 13: "Peshkimi"; forcimin e kapaciteteve institucionale dhe administrative drejt përafrimit me *Acquis communautaire* të BE-së në *cluster*-in 5 dhe kapitujt përkatës, 11, 12 dhe 13, si dhe transferimi i njohurive dhe inovacioni.

Në kuadër të masave të "Agjendës Kombëtare të Reformave 2024–2027", MBZHR-ja ka planifikuar përafrimin e 3 ligjeve dhe 25 akteve nënligjore në zbatim të këtyre ligjeve.

Aktet ligjore/nënligjore të parashikuara për miratim janë, si më poshtë vijon:

1. Ligji "Për shëndetin e kafshëve" dhe 10 akte nënligjore;
2. Ligji "Për shëndetin e bimëve" dhe 10 akte nënligjore;
3. Ligji "Për kontrollet zyrtare" dhe 5 akte nënligjore.

Aktualisht, është miratuar ligji nr. 41/2025, "Për shëndetin e kafshëve" dhe ligji nr. 40/2025, "Për shëndetin e bimëve". Ndërkohë, projektligji "Për kontrollet zyrtare" është parashikuar për miratim në Kuvend brenda muajit qershor 2026 dhe 25 aktet nënligjore janë parashikuar për miratim brenda dhjetorit 2026.

Bujqësia pritet të rritet mesatarisht me rreth 2.4 për qind në vit në terma realë përgjatë periudhës 2025-2027, me një kontribut mesatar vjetor në rritjen ekonomike prej rreth 0.4 pikë përqindjeje.

Eksportet bujqësore shqiptare gjatë vitit 2024 arritën vlerën 53 miliardë lekë (53, 287 mln All) (529 milionë euro), duke shënuar një rënie vjetore rreth -4.28 % në lekë dhe rritje prej 3.4 % në euro ose me 17 milionë euro krahasuar me vitin 2023. *(Ky ndryshim vjen si pasojë e*

rënies së kursit të këmbimit për EUR nga 108.8 në vitin 2023 në 100.7 në vitin 2024 sipas BSH-së).

Eksportet bujqësore shqiptare gjatë 11M 2025 arritën vlerën 51.21 miliardë lekë (51,208 mln All) (522 milionë euro), duke shënuar një rritje me rreth 5.8% të vlerës në lekë ose rritje me +9% të vlerës në euro (+43.1 milionë euro) krahasuar me 11M 2024. Synimi sipas SKZHIE 2022–2030 është arritja e eksporteve bujqësore në vlerën 1 miliard` USD. (*Kursi i këmbimit për EUR ishte 100.93 në* 11M 2024 *dhe 97.96 në* 11M 2025, *sipas BSH-së).*

Në këtë kontekst, përmbushja e objektivit ambicioz të përcaktuar në SKZHIE 2022–2030 për rritjen e eksporteve bujqësore në nivelin 1 miliard USD kërkon një transformim të thellë strukturor të sektorit bujqësor. Përtej rritjes sasiore të prodhimit, theksi duhet të vihet te rritja e produktivitetit, formalizimi i zinxhirit të vlerës, përmirësimi i cilësisë dhe gjurmueshmërisë, si dhe fuqizimi i kapaciteteve të planifikimit dhe monitorimit. Në këtë drejtim, digjitalizimi i bujqësisë përbën një levë kyçe për modernizimin e sektorit dhe rritjen e konkurrueshmërisë së tij në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare.

Në vijim të këtij orientimi strategjik, ka filluar procesi i hartimit të Strategjisë Kombëtare për Bujqësinë Digjitale dhe Transformimin Rural, i asistuar nga FAO në bashkëpunim me agjenci të tjera të Kombeve të Bashkuara si ILO dhe ITU, përmes programit të përbashkët "Digital Agriculture and Rural Transformation" (DART). Ky program trevjeçar synon ndërtimin e një strategjie gjithëpërfshirëse dhe të orientuar nga nevojat e fermerëve, si dhe një plani veprimi që do e përputhë këtë strategji me standardet e Bashkimit Evropian dhe objektivat kombëtarë të zhvillimit bujqësor.

Strategjia e Bujqësisë Digjitale do të synojë përmirësimin e shërbimeve digjitale për fermerët, forcimin e sistemeve të informacionit bujqësor, rritjen e transparencës dhe efikasitetit në përdorimin e fondeve publike, si dhe koordinimin më të mirë ndërinstitucional. Zbatimi i saj pritet të kontribuojë drejtpërdrejt në rritjen e produktivitetit, qëndrueshmërisë dhe reziliencës së sektorit bujqësor, duke mbështetur në mënyrë konkrete arritjen e objektivave strategjikë të zhvillimit ekonomik dhe eksporteve të vendit.

Bujqësia ka ndikim thelbësor në shumë prej Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030, por më drejtpërdrejt efektet e saj lidhen në kuadër të realizimit të Objektivit 2: "Eliminimi i urisë, arritja e sigurisë ushqimore dhe përmirësimi i ushqyerjes, si dhe nxitja e bujqësisë së qëndrueshme" dhe synimit 2.4 "Deri në vitin 2030, sigurimi i sistemeve të qëndrueshme të prodhimit të ushqimit dhe zbatimi i praktikave të qëndrueshme bujqësore që rrisin produktivitetin dhe prodhimin, që ndihmojnë ruajtjen e ekosistemeve, që forcojnë kapacitetin për përshtatje ndaj ndryshimeve klimatike, motit ekstrem, thatësirës, përmbytjeve dhe fatkeqësive të tjera dhe që përmirësojnë në mënyrë progresive cilësinë e tokës". Objektivin 12 "Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit", si dhe harmonizimin e plotë të legjislacionit dhe sigurimin e kapaciteteve të nevojshme institucionale dhe administrative drejt përafrimit me *Acquis* të BE-së në sektorin bujqësor. Në interes të përmbushjes së këtyre objektivave, vendi ynë synon përmirësimin dhe menaxhimit të burimeve ujore për ujitjen, identifikimin dhe krijimin e burimeve të reja ujore, modernizimin e sistemeve aktuale të ujitjes duke aplikuar zgjidhje smart në këtë sektor.

Në vijim të procesit të negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Evropian (BE), si synimi politik dhe strategjik i Shqipërisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) me hapjen *e grup-kapitullit* V "Burimet, Bujqësia dhe Kohezioni", në vijim të Konferencës së Shtatë Ndërqeveritare të datës 17 nëntor 2025, ka nisur përgatitjen e Planit të Punës në lidhje me politikat e integrimit, harmonizimin e legjislacionit kombëtar në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural me standardet dhe kërkesat e BE-së, si dhe planin e punës të detajuar për adresimin e piketave mbyllëse *(closing benchmarks)* për tre kapitujt e *Acquis* të BE-së (kapitujt 11, 12 dhe 13), që udhëhiqen nga MBZHR-ja.

Pozicioni Negociues, i miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave në muajin shtator 2025, përcakton dinamikën e transpozimit të *Acquis*-it dhe përafrimin e legjislacionit duke përfshirë zhvillimet e reja në Politikën e Përbashkët Bujqësore të BE-së (CAP), Organizimin e tregut të përbashkët (CMO); Bujqësinë organike; Politikat e cilësisë etj., reformën e politikave dhe forcimin e kapaciteteve administrative në periudhën e para-anëtarësimit, duke përfshirë gjithashtu planin për krijimin e Agjencisë së Pagesave dhe Sistemin e Integruar të Administrimit dhe Kontrollit (IACS).

Gjatë vitit 2025, ka nisur hartimi i ligjit të ri "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural", miratimi i të cilit është parashikuar në vitin 2026. Ligji i ri synon të harmonizojë kuadrin kombëtar me rregullat e CAP (Reg. 2021/2115 dhe 2021/2116), duke siguruar financim, menaxhim dhe instrumente mbështetëse (pagesa direkte, masa sektoriale, zhvillim rural). Gjithashtu, po hartohet projektligji "Për organizimin e tregut të produkteve bujqësore" dhe legjislacioni specifik për standardet e marketingut të fruta dhe perimeve, duke u përafruar me rregulloret e BE-së, të cilat planifikohen të miratohen gjatë vitit 2026. Në vitin 2026 është planifikuar po ashtu miratimi i ligjit për "Skemat e cilësisë së produkteve bujqësore, verës dhe pijeve alkoolike", në përafrim të plotë me rregulloret përkatëse të BE-së.

Transpozimi i duhur i *Acquis* të BE-së në legjislacionin kombëtar dhe zbatimi i tij janë thelbësore për zbatimin e suksesshëm të Politikës së Përbashkët Bujqësore të BE-së (CAP). Shqipëria synon të transpozojë dhe zbatojë gradualisht *Acquis* të BE-së në "Bujqësi dhe Zhvillim Rural" deri në vitin 2030. Disa masa, në përputhje me CAP, do të futen në periudhën e para-anëtarësimit dhe do të financohen nga buxheti kombëtar.

Përshtatja dhe implementimi i politikave bujqësore me Politikën e Përbashkët Bujqësore të BE (EU CAP), krahas të tjerash, ka në themel të saj mbështetjen e fermerëve dhe të agrobiznesit me pagesa direkte, grante investimesh dhe masa të tjera kundrejt përmbushjes së kushtëzimeve që lidhen me objektivat e parashikuar. Zbatimi gradual i këtyre masave mbështetëse të ngjashme me ato që aplikohen në vendet anëtare të BE-së do të bëjë të mundur edhe përfitimin dhe absorbimin e fondeve respektive të BE-së për vendin tonë që nga momenti i anëtarësimit.

Plani i veprimit ofron vlerësimin e burimeve të nevojshme dhe masat e zhvillimit të kapaciteteve të nevojshme për të forcuar programimin dhe zbatimin e politikës në përputhje me BE-në. Ky është një parakusht për menaxhimin dhe kontrollin e pagesave në bujqësi, në përputhje me rregullat e CAP, dhe rregullat e funksionimit të Fondit Evropian të Garancive Bujqësore (EAGF) dhe Fondit Evropian Bujqësor për Zhvillimin Rural (EAFRD).

Plani i veprimit përfshin gjithashtu buxhetin e vlerësuar për miratimin, zbatimin e legjislacionit dhe rregullave në përputhje me kërkesat e *Acquis* të BE-së. Struktura aktuale organizative e MBZHR nuk mund të sigurojë zbatimin në kohë të aktiviteteve të parashikuara në Pozicionin Negociues, ndaj nevojitet rritje kapacitetesh administrative që kërkon rritje në buxhet për transpozimin dhe forcimin e tyre. MBZHR-ja ka hartuar një kërkesë lidhur me kapacitetet e nevojshme për të tre kapitujt, e cila është adresuar dhe pranë Ministrisë së Financave, si dhe parashikuar në PBA 2026-2028.

6. Turizmi

Sektori i turizmit po konsolidohet si një nga sektorët prioritarë të zhvillimit ekonomik të vendit. Në vitin 2024, Shqipëria përjetoi një rritje rekord të turizmit, duke u renditur ndër destinacionet kryesore për rritjen në përqindje të mbërritjeve turistike ndërkombëtare dhe net-qëndrimeve ku numri i vizitorëve të huaj që hynë në Shqipëri tejkaloi 11 milionë turistë. 10.2 milionë mbërritje ndërkombëtare u regjistruan në vitin 2023, shifër e cila u rrit në 11.7 milionë në vitin 2024.

Po ashtu, ky sektor rezulton një nga 3 sektorët prioritarë vertikalë në S3 me objektiv kryesor: "Zhvillimi i një sektori turizmi dinamik, të larmishëm, gjithëpërfshirës në të gjithë territorin e vendit dhe funksional gjatë gjithë vitit, i cili kontribuon në zhvillimin socio-ekonomik të vendit,

duke promovuar praktika të përgjegjshme dhe duke ruajtur pasuritë tona natyrore dhe kulturore për brezat e ardhshëm" dhe objektiva specifikë, si vijon:

1. Ruajtja dhe promovimi i siteve historike dhe kulturore të Shqipërisë, muzeve dhe traditave, me qëllim tërheqjen e vizitorëve të interesuar për trashëgiminë kulturore, duke siguruar që trashëgimia kulturore shqiptare të ruhet, restaurohet dhe promovohet;
2. Zhvillimi i nënsektorit të turizmit shëndetësor dhe të mirëqenies, duke shfrytëzuar burimet natyrore dhe terapeutike të Shqipërisë;
3. Zhvillimi i turizmit natyror, aventurier dhe rural;
4. Promovimi i turizmit rural përmes lidhjes së vizitorëve me fermat lokale dhe aktivitetet e agroturizmit, duke theksuar prodhimin e qëndrueshëm ushqimor;
5. Zhvillimi i produkteve dhe shërbimeve turistike të specializuara *(niche),* me fokus të veçantë në turizmin kulinar;
6. Zhvillimi i aftësive profesionale në sektorin e turizmit dhe forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërsektorial.

Gjithashtu, objektiv i veçantë është dhe Zhvillimi i Ekonomisë Blu dhe Turizmit Bregdetar të Qëndrueshëm.

Për sa u përket të ardhurave nga udhëtimet e jo-rezidentëve, të dhënat e Bankës së Shqipërisë tregojnë se në vitin 2024 të ardhurat totale nga shpenzimet e turistëve të huaj arritën një rekord prej rreth 4.99 miliardë eurosh, duke shënuar një rritje prej rreth +19.6% krahasuar me një vit më parë.

Ndërsa për 9 mujorin e parë të 2025, rezulton se të ardhurat nga udhëtimet e jo-rezidentëve në Shqipëri arritën një vlerë prej 4.42 miliardë eurosh, rreth 560 milionë euro më tepër se 2024.

Sipas po këtyre të dhënave paraprake, në 10 muajt e parë të vitit 2025 (BSH) rezulton se Shqipërinë e kanë vizituar 11.137.328 vizitorë të huaj nga janari deri në tetor 2025 ose 7 për qind më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit 2024.

Me synim inkurajimin dhe tërheqjen e investimeve strategjike, kuadri ligjor ekzistues u ofron investitorëve strategjikë mekanizma nxitjeje dhe mbështetjeje, duke i konsideruar këto investime si prioritet dhe duke garantuar një sërë masash, shërbimesh dhe lehtësirash administrative. Një zhvillim të vrullshëm kanë pasur vitet e fundit të tri kategoritë kryesore të turizmit në vend – turizmi bregdetar, ai tematik (agroturizmi, kulturor etj.), si dhe turizmi natyror për të cilat Shqipëria ka potenciale të paçmuara zhvillimi.

Sfidat kryesore me të cilat lidhet zhvillimi i turizmit në Shqipëri kanë të bëjnë me natyrën sezonale të turizmit të bregdetit, përqendrimit të turizmit dhe mbipopullimit në zonat bregdetare gjatë sezonit veror, mungesës së fuqisë së kualifikuar punëtore, mungesa e standardizimit dhe sistemit të klasifikimit, informalitetit, zgjidhja e problemit të pronësisë, lidhjet jo të mira të infrastrukturës së transportit, veçanërisht atij detar etj.

Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Turizmit 2025–2030 e miratuar nga qeveria shqiptare vendos kornizën strategjike dhe prioritetet kryesore për zhvillimin dhe investimet në sektorin e turizmit deri në vitin 2030, e cila projekton krijimin, përmirësimin dhe konsolidimin e produkteve turistike duke e ndarë vendin në 6 rajone turistike: Rajoni turistik i bregdetit të Adriatikut, rajoni turistik verior i brendshëm, rajoni turistik i Tiranës, rajoni qendror, rajoni turistik i bregdetit të Jonit, si dhe rajoni turistik jugor i brendshëm.

Vizioni për zhvillimin e turizmit: "Shqipëria është destinacioni i ri më emocionues në Evropë, që ofron vlerën më të mirë të bazuar në aspektet e cilësisë, gjithëpërfshirjes dhe qëndrueshmërisë" mbështetet në arritjen e gjashtë prioriteteve bazë ndër më të rëndësishmit në ekonomi. Kështu në 5 vitet në vijim prioritare do të jenë:

- Investimet në sektorin e turizmit dhe transportit;
- Përshtatje më e mirë e politikave fiskale dhe rregullatore;
- Mirëmenaxhimi i destinacioneve turistike të vendit;

- Zhvillimi i mëtejshëm i produktit turistik që Shqipëria ofron një marketing sa më i përshtatshëm për këto destinacioneve; si edhe
- Ngritja e kapaciteteve turistike dhe zhvillimi i burimeve njerëzore në këtë sektor.

Disa nga llojet e investimeve që konsiderohen me përparësi në përputhje me Strategjinë janë:

- Investimet në infrastrukturë janë një nga shtyllat kryesore të strategjisë dhe përfshijnë: përmirësimin e infrastrukturës që lidh destinacionet turistike kryesore (rrugët, shërbimet, sinjalistika, infrastruktura turistike, marina/portet, hapësirat publike, aksesueshmëria) – veçanërisht për të mbështetur turizmin e brendshëm/malor dhe kulturor, jo vetëm vendpushimet bregdetare.
- Zgjerimi i kapacitetit të akomodimit: ndërtimi i hoteleve/shtëpive të reja, rinovimi i atyre ekzistuese, rritja e kapacitetit të shtretërve për të përmbushur objektivin prej ~477,000 shtretërish deri në vitin 2030.
- Zhvillimi dhe diversifikimi i produktit turistik: zhvillimi i turizmit natyror dhe ekoturizmit, turizmit rural dhe agroturizmit, turizmit kulturor, historik dhe trashëgimisë, veçanërisht në rajonet më pak të zhvilluara. Strategjia promovon diversifikimin e ofertës turistike për zgjatje të sezonit dhe rritje të qëndrueshmërisë.
- Shërbimet dhe kapitali njerëzor: përmirësimi i aftësive të fuqisë punëtore, promovimi i arsimit të lartë në turizëm, përmirësimi i standardeve të shërbimit, ndërtimi i kapaciteteve për menaxhim të qëndrueshëm të destinacioneve. Të punësuar në sektor planifikohen mbi 73 mijë në 2030 përkundër 42 mijë punonjësve që ishin në turizëm në 2023.

Në themel të strategjisë është rritja e të ardhurave nga turizmi në rreth €6.7 miliardë deri në vitin 2030 përkundër 4.17 miliardë euro që ishin në 2023, duke e bërë sektorin një nga motorët kryesorë ekonomikë të vendit, me rritje të kapaciteteve, punësimit dhe diversifikimit të ofertës turistike.

Turizmi lidhet me disa nga Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030, duke kontribuar në dimensionin ekonomik, social dhe mjedisor të zhvillimit. Megjithatë, ndikimi i tij më i drejtpërdrejt reflektohet në kuadër të realizimit të Objektivit 8: "Nxitja e rritjes ekonomike të pandërprerë, përfshirëse dhe të qëndrueshme, punësimit të plotë e produktiv dhe punës së denjë për të gjithë" dhe synimit 8.9, i cili parashikon që "Deri në vitin 2030, të hartohen dhe zbatohen politika për promovimin e turizmit të qëndrueshëm që krijon vende pune dhe promovon kulturën dhe produktet vendase". Në këtë kontekst, zhvillimi i sektorit të turizmit në Shqipëri përfaqëson jo vetëm një prioritet ekonomik, por edhe një instrument të rëndësishëm për nxitjen e punësimit, fuqizimin e komuniteteve lokale dhe promovimin e trashëgimisë kulturore e natyrore të vendit.

Në këtë kuadër, prioritetet e strategjisë sektoriale të turizmit reflektojnë qartësisht orientimin drejt zhvillimit të një turizmi të qëndrueshëm dhe të larmishëm, duke përfshirë dimensionin kulturor, natyror, rural dhe detar. Ato adresojnë nevojën për diversifikimin e ofertës turistike, zgjatjen e sezonit, shpërndarjen më të balancuar territoriale të zhvillimit dhe ruajtjen e aseteve natyrore e kulturore si elemente thelbësore të konkurrueshmërisë afatgjatë të sektorit. Gjithashtu, strategjia parashikon përcaktimin e treguesve të matshëm për monitorimin e zbatimit të politikave, duke mundësuar vlerësimin periodik të progresit në terma ekonomikë, socialë dhe mjedisorë, në përputhje me objektivat kombëtarë dhe me kornizën e zhvillimit të qëndrueshëm.

7. Energjia

Sektori i energjisë është një prioritet kyç i SKZHIE 2030 dhe gur themeli i zhvillimit ekonomik dhe social të Shqipërisë, duke luajtur një rol të dyfishtë në ruajtjen e rritjes së shpejtë në industri të ndryshme, si dhe duke përmirësuar cilësinë e jetës për familjet shqiptare. Shqipëria e ka përafruar kuadrin e saj legjislativ me direktivat e BE-së për të nxitur praktikat e qëndrueshme të energjisë, veçanërisht përmes Ligjit të Energjisë së Rinovueshme të vitit

2023 që promovon përdorimin e energjisë së rinovueshme, redukton varësinë nga lëndët djegëse fosile dhe integron Shqipërinë në tregjet rajonale të energjisë.

Energjia e rinovueshme është një nga 3 prioritet vertikalë të S3 me objektiva kryesorë dhe specifikë, si vijon:

- Promovimi i zhvillimit të projekteve të energjisë diellore dhe asaj me erë për të diversifikuar portofolin e energjisë së rinovueshme, duke shfrytëzuar potencialin e bollshëm të Shqipërisë në rrezatim diellor dhe burime të erës për prodhimin e energjisë së pastër:

1. Nxitja e investimeve në energjinë e rinovueshme, përfshirë edhe përmes liberalizimit të tregut të energjisë;

2. Thjeshtimi i procedurave për dhënien e lejeve dhe licencave për kompanitë që operojnë në sektor, si dhe përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator, përfshirë hartimin e akteve nënligjore dhe udhëzimeve për të lehtësuar zbatimin e legjislacionit në fushën e energjisë.

- Nxitja e përdorimit të teknologjive të shndërrimit të mbetjeve në energji *(waste-to-energy),* teknologjive inovative dhe burimeve të biomasës për prodhimin e energjisë së pastër, duke reduktuar mbetjet në landfille dhe duke promovuar eficiencën e përdorimit të burimeve:

1. Inkurajimi i përdorimit të teknologjive *waste-to-energy,* teknologjive inovative dhe burimeve të biomasës për prodhimin e energjisë së pastër, reduktimin e mbetjeve në landfille dhe rritjen e ndërgjegjësimit publik.

- Promovimi i një përzierjeje të larmishme të burimeve të energjisë së rinovueshme dhe teknologjive në zhvillim, për të reduktuar varësinë nga një burim i vetëm energjie:

1. Promovimi i masave mbështetëse për integrimin e burimeve alternative të energjisë, rritjen e eficiencës energjetike dhe diversifikimin e përzierjes së prodhimit të energjisë elektrike;

2. Forcimi i partneritetit ndërmjet akademisë, bizneseve dhe qeverisë për të adresuar hendekun e aftësive dhe për të përmirësuar programet arsimore dhe të trajnimit, përfshirë rishikimin e kurrikulave, si dhe proceset e rritjes dhe riaftësimit profesional *(upskilling* dhe *reskilling).*

- Mbështetja e një infrastrukture moderne dhe fleksibile të rrjetit energjetik dhe sistemeve të magazinimit të energjisë, të afta për të menaxhuar në mënyrë efikase natyrën e ndryshueshme të burimeve të rinovueshme dhe për të mundësuar shkëmbimin ndërrajonal të energjisë.

1. Investimi në zhvillimin e rrjeteve inteligjente *(smart grids)* dhe sistemeve të magazinimit të energjisë, për të mbështetur integrimin e burimeve të rinovueshme dhe ndarjen ndërrajonale të energjisë;

2. Përmirësimi i infrastrukturës energjetike, përfshirë ndërtimin e qendrave teknologjike (TEC) dhe stacioneve të karikimit për mbështetjen e transportit elektrik.

- Zbatimi i praktikave të përgjegjshme të menaxhimit të pyjeve, përfshirë ripyllëzimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të drurit, me qëllim balancimin e përfitimeve ekonomike me ruajtjen e mjedisit.

1. Praktika të qëndrueshme të përdorimit të energjisë.

Pjesë e priortetit të energjisë së rinovueshme janë dhe burimet natyrore me objektivin kryesor: "Orientimi i sektorit minerar të Shqipërisë për t'u shndërruar në partner strategjik të BE-së dhe kontribuues të rëndësishëm në zinxhirin e furnizimit të Bashkimit Evropian me lëndë të para kritike" dhe objektiva specifikë vijues:

1. Orientimi i sektorit minerar të Shqipërisë për t'u bërë partner strategjik i BE-së dhe kontribuues me vlerë në zinxhirin e furnizimit të BE-së me lëndë të para kritike;

2. Zgjerimi i vendburimeve minerare ekzistuese dhe eksplorimi i vendburimeve të reja të mineraleve kritike dhe strategjike (CRM/SRM);

3. Forcimi i përpunimit të mineraleve dhe rritja e eficiencës së përdorimit të burimeve jo të rinovueshme, përmes adoptimit të teknologjive të reja pa mbetje, duke iu afruar modelit të ekonomisë së gjelbër dhe qarkulluese;

4. Fuqizimi i infrastrukturës, kapaciteteve shkencore dhe kërkimore, si dhe i burimeve njerëzore në sektor.

Sektori kontribuon ndjeshëm në performancën ekonomike të vendit, me energjinë e rinovueshme që është një tipar përcaktues i sektorit. Fuqia energjetike e Shqipërisë mbështetet shumë në burimet e rinovueshme, duke e pozicionuar vendin si lider në adoptimin e energjisë së rinovueshme. Qëllimi kryesor i sektorit është që deri në vitin 2030, të bëhet një eksportues neto i energjisë, duke balancuar prodhimin dhe konsumin e energjisë vendase, duke reduktuar ndikimet mjedisore, duke nxitur zhvillimin me karbon të ulët, duke rritur kontributet e energjisë së rinovueshme, si dhe duke rritur pavarësinë e energjisë përmes diversifikimit të burimeve të energjisë dhe reduktimin e varësisë nga tregjet globale.

Strategjia energjetike e Shqipërisë, deri në vitin 2030, mbështet një vizion më të gjerë të një tregu energjie të koordinuar të Ballkanit Perëndimor, duke nxitur bashkëpunimin e ndërsjellë, duke përmirësuar konkurrencën rajonale, si dhe duke krijuar vende pune "të gjelbra". Iniciativat përfshijnë projekte bashkëpunuese për integrimin e sistemit energjetik dhe zhvillimin e kornizave të politikave për përfshirjen sociale dhe reformën fiskale për kalimin drejt rritjes me karbon të ulët.

Kapaciteti total i prodhimit të energjisë në vitin 2024 arriti në 3213 MË (+537 MË nga viti 2023). Prodhuesi publik KESH kontribuoi me 55.7% të prodhimit total të energjisë elektrike, me 7,836 Gwh të prodhuara, 1,066 Gwh mbi mesataren 2009-2024. Kapaciteti i transmetimit ishte 6,837 Gwh dhe rrjeti i shpërndarjes përbëhej nga 77,656,2 km linja të tensionit të mesëm dhe të ulët, me humbje energjie në 17.93 18,93%, me 1 % më pak se vitin 2023 më poshtë objektivit prej 19,63%. Konsumi total gjatë vitit 2024 arriti në 8,170,000 7,875,861 mwh, me një diferencë prej 294,000 mwh më shumë nga vitit 2023 duke reflektuar një rënie prej 6,4% nga viti 2022 për shkak të zhvendosjeve ekonomike dhe rritjes së vetëprodhimit nga bizneset gjatë krizës energjetike. Konsumatorët familjarë zënë 41.7 39.5% të konsumit total, duke shënuar një rritje të lehtë nga viti 2023.

Në vitin 2024, burimet e rinovueshme përbëjnë 51.4 % të konsumit total të energjisë, gati dyfishi i mesatares së BE-së prej 23%. Kapaciteti i instaluar i energjisë së rinovueshme arriti në 3,213 mw, duke shënuar një rritje prej 537 mw nga viti 2023, kryesisht përmes projekteve diellore dhe të erës. Ankandet e suksesshme fotovoltaike në 2022 shtuan 240 MË kapacitet diellor. Ankandet e energjisë së erës dhanë 222 mw në kapacitet në tri projekte, duke mundësuar marrëveshje afatgjata për kontratat e blerjes së energjisë elektrike 15-vjeçare.

Në vitin 2024, prodhimi vendas i energjisë rezulton rreth 959 gwh më i ulët se prodhimi i energjisë elektrike për vitin 2023. Kjo për faktin se, nga pikëpamja hidrologjike , viti 2024 ka qenë poshtë mesatares shumëvjeçare me 32,5% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022, duke sinjalizuar rimëkëmbjen dhe përmirësimin e efikasitetit.

Zhvillimet në sektor gjatë vitit 2024 nxorën në pah rritjen e jashtëzakonshme të energjisë diellore, e cila kontribuoi në 6.75% të totalit të energjisë së prodhuar (430,000 mwh), një rritje e konsiderueshme nga 1% në 2023 (72,500 mwh). Vetëm centrali diellor i Karavastasë përbënte 55% të prodhimit të energjisë diellore. Janë dhënë një rekord prej 16 licencash të reja për projektet diellore, me kapacitet të planifikuar gjithsej 253.14 MË. Kjo ka tejkaluar 9 licencat në 2023 (102 MË) dhe 15 në 2022 (225 MË). Impianti diellor lundrues në Vaun e Dejës (12,97 mwp) ka avancuar drejt zbatimit, i parashikuar të gjenerojë mesatarisht 17,822 mwh në vit. Rregullimet ligjore të paraqitura u mundësonin prodhuesve dhe konsumatorëve që kapacitete më të larta diellore (mbi 0.5 mw) të lidhen me rrjetin pa stimuj nga qeveria. Gjatë vitit janë iniciuar ankandet për projektet solare 300 mw me marrëveshje afatgjata të blerjes nga qeveria.

Zgjerimi i kapaciteteve gjeneruese pritet të vazhdojë trendin me fokus në rritjen e prodhimit të energjisë diellore dhe të erës bazuar në investimet e sektorit privat për të rritur më tej kontributet e energjisë së rinovueshme. Reformat në tregun e energjisë elektrike kulmuan me krijimin e Bursës Shqiptare të Energjisë në 2023, duke lehtësuar 827,541 mwh në tregti me një

çmim mesatar prej 106.5 €/mwh dhe duke lejuar çmimet konkurruese të energjisë dhe një integrim më të madh në tregun ndërkombëtar. ALPEX ka iniciuar ankandet e energjisë brenda ditës, duke rritur transparencën dhe efikasitetin në tregun shqiptar dhe atë të Kosovës. Në vitin 2024 u arit të tregtohej një volum total prej 1,173 Gwh energji elektrike në Tregun e Ditës në Avancë me një çmim klerues mesatar prej 112.01 eurosh/mwh, duke shënuar një rritje 41.7 % krahasuar me vitin 2023, kur rezultuan 827 Gwh, ndërkohë faturim total për vitin 2024 u rrit me rreth 80% krahasuar me vitin 2023, i cili ishte 167 milionë euro. Në tregun e ankandeve brenda të njëjtës ditë përgjatë vitit 2024 u arrit të tregtohej një volum total prej 365.53 mwh energji elektrike me një çmim klerues prej 200.8 eurosh/mwh. Mbi 2,100 biznese (20 kV) dolën nga tregu i rregulluar në fillim të vitit 2024, me 2,594 të tjera (10 kV) që do të pasojnë deri në vitin 2025.

Qeveria inkurajon investimet në sektorin e energjisë, duke ofruar një kuadër mbështetës dhe transparent për investime, duke nxitur IHD-të në këtë sektor, duke forcuar sistemet e transmetimit të energjisë për të mbështetur tregtinë e brendshme dhe rajonale të energjisë përmes shkëmbimeve energjetike lokale dhe rajonale, si dhe duke promovuar praktika eficiente ndaj energjisë në të gjithë sektorë, duke përfshirë banesat rezidenciale, ndërtesat publike, sistemet e furnizimit me ujë dhe vaditjen. Qeveria jep stimuj për sektorin privat dhe familjet si programi i subvencionimit për sistemet diellore të ngrohjes së ujit, duke ulur me 20% faturat e energjisë.

Pavarësisht reduktimit të humbjeve të shpërndarjes së energjisë nga 42% në 17.93% midis 2013 dhe 2023, një pjesë e energjisë elektrike të furnizuar ende mbetet e pa llogaritur, duke theksuar nevojën për përmirësime të mëtejshme. Luhatjet sezonale në konsumin e energjisë dhe mbështetja e tepërt në hidrocentralet e bëjnë Shqipërinë vulnerabël ndaj varësisë nga importi i energjisë. Sektori i energjisë është shumë i ndjeshëm ndaj modeleve të reshjeve, duke kërkuar diversifikimin dhe investimet në burime të tjera të rinovueshme.

Sektori i energjisë mbetet kritik për elasticitetin ekonomik të Shqipërisë dhe qëndrueshmërinë mjedisore. Duke zgjeruar kapacitetet e energjisë së rinovueshme, duke përmirësuar infrastrukturën dhe duke përafruar politikat me standardet e BE-së, Shqipëria është e pozicionuar mirë për të arritur pavarësinë dhe qëndrueshmërinë energjetike. Angazhimi i vendit për të modernizuar sektorin e tij energjetik jo vetëm që do të rrisë stabilitetin e brendshëm, por do ta vendosë Shqipërinë si një lider rajonal në energjinë e gjelbër.

Në funksion të bashkëpunimit rajonal për energjinë, në fillim të janarit 2025, qeveria Shqiptare së bashku me qeverinë Italiane dhe atë të Emirateve të Bashkuara Arabe (EBA) kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me vlerë prej rreth 1 miliard eurosh (1.02 miliardë dollarë) për të krijuar një rrjet energjetik nënujor për të importuar energji të rinovueshme përmes detit Adriatik. Marrëveshja synon të forcojë infrastrukturën ekzistuese të energjisë dhe kapacitetin e energjisë së rinovueshme brenda rajonit të Mesdheut.

Sipas projektit, që parashikohet të finalizohet brenda 3 viteve, rrjeti i ndërlidhjes së energjisë do të shtrihet rreth 430 km përgjatë shtratit të detit Adriatik, që lidh Italinë me Malin e Zi dhe rajonin e Ballkanit. Projekti do t'i mundësojë vendit të tregtojë energjinë e rinovueshme të prodhuar në vend.

Energjia lidhet me Agjendën 2030 në kuadër të realizimit të Objektivit 7: "Sigurimi i furnizimit me energji me kosto të përballueshme, të besueshme, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë" dhe synimit 7.1 "Deri në vitin 2030, sigurimi i aksesit universal në shërbime energjie me kosto të përballueshme, të besueshme dhe moderne".

2.2 PROGRAMET IPA 2021–2027 DHE FUSHAT PRIORITARE TE TYRE IPA 2021

	Dokumenti i veprimit	**(mln euro)**	**Institucioni përgjegjës**
1	BE për Drejtësinë	8	MD

2	BE për të Drejtat e Pronësisë	10	KM, ASHK
3	BE për Natyrën/SPIN	6	MMjedisit
4	BE për Ekonominë Qarkulluese	30,9	MMjedisit
5	BE për Inovacionin – faza e dytë	10	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (ish-*MEKI)*
Totali		**64,9**	

IPA 2022

	Dokumenti i veprimit	**(mln euro)**	**Institucioni përgjegjës**
1	BE për sektorin e ujit	29	MIE, AMBU, MMjedisit
2	EUIF *(instrumenti lehtësues për integrimin evropian)*	19	MIE, MBZHR, MF, MSHKN
3	BE për demokracinë	5	Kuvendi, KQZ
4	BE për rininë	5	Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sporteve, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, MF, MA
5	BE për agjencitë e zbatimit të ligjit	14.9	MB
6	OMN/ Vetingu – faza II	9.7	MD
Totali		**82.6**	

IPA 2023

Mbështetje buxhetore sektoriale prej **80 mln eurosh** për Shqipërinë: "*Kontrata e Ndërtimit të Shtetit dhe Rezistencës për Shqipërinë*", pjesë e Planit Vjetor të Veprimit që kontribuoi në Paketën e Mbështetjes Energjetike të Ballkanit Perëndimor në favor të Republikës së Shqipërisë për vitin 2023.

	Dokumenti i veprimit	**(mln euro)**	**Institucioni përgjegjës**
1	Kontrata e Ndërtimit të Shtetit dhe Rezistencës për Shqipërinë	80	MIE, MF, MSHMS
Totali		**80**	

IPA 2024

	Dokumenti i veprimit	**Indikative (mln euro)**	**Institucioni përgjegjës**
1	Mbështetje për kuadrin institucional të antikorrupsionit	3.85	MAPA, ILDKPKI
2	BE për qeverisjen vendore	10	MSHPV
3	BE për pyjet – ForestAl	13	MMjedisit
4	BE për Sigurinë Ushqimore	12.5	MBZHR
5	BE për punësimin dhe përfshirjen sociale, faza II (*Mbështetje Buxhetore).*	28 (24 SBS + 4 TA)	MEI, MSHMS
Totali (indikative)		**67.35**	

PROGRAMET OPERACIONALE 2024–2027

	Programet operacionale	**Kostoja indikative (mln euro)**	**Përfituesit**
1	Programi Operacional për Punësimin e të rinjve	63.48 (*50 EU + 13.48 bashkëfinancim i qeverisë shqiptar*e)	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, MF, MA, MSHMS,

2	Programi Operacional për Ekonominë dhe shoqërinë digjitale	44 (*30 EU – 14 bashkëfinancim i qeverisë shqiptare)*	AKSHI, MSHMS, MA, MF, MIE, AKEP
3	Programi Operacional për Energjinë	79 (50 EU – 29 bashkëfinancim i qeverisë shqiptare)	MIE, AEE, AKUM
Totali		**186.48(***130 EU+ 56.48bashkëfinancim i qeverisë shqiptare***)**	

Programet Operacionale 2024–2027 me një vlerë totale prej 186.48 milionë eurosh, nga të cilat 130 milionë euro janë financim i BE-së dhe 56.48 milionë euro, si bashkëfinancim i qeverisë shqiptare janë miratuar dhe ratifikuar, sipas:

- Marrëveshja financiare për Programin Operacional për Energjinë është ratifikuar me ligjin nr. 36/2025 datë 5.6.2025 dhe është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 116 datë 3.7.2025;
- Marrëveshja financiare për Programin Operacional për Ekonominë dhe Shoqërinë Digjital- e është ratifikuar me ligjin nr. 35/2025, datë 5.6.2025, dhe është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 115, datë 2.7.2025;
- Marrëveshja financiare për Programin Operacional për Punësimin e të Rinjve është ratifikuar me ligjin nr. 34/2025, datë 5.6.2025, dhe është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 111, datë 26.6.2025.

Programet operacionale do të fokusohen në reformat dhe përmirësimin e politikave, si: digjitalizimi me qëllim automatizimin dhe lehtësimin e jetës së qytetarëve dhe bizneseve, si dhe veprimtarisë së administratës publike, eficienca e energjisë, si dhe punësimi, arsimimi dhe aftësitë e të rinjve. Këto programe do të zbatohen plotësisht sipas modalitetit të menaxhimit indirekt.

IPA 2025

	Dokumenti i veprimit	(mln euro)	Institucioni përgjegjës
1	BE për Drejtësi të Integruar dhe të Drejtat e Njeriut	25,563	MD dhe institucionet e pavarura të gjyqësorit.
2	BE për Lëndët e Para Kritike	8	MIE
Totali indikativ		**33,563**	

IPA 2026

	Dokumenti i veprimit	(mln euro)	Institucioni përgjegjës
1	BE për Mirëqeverisjen e Integruar	22.437	MAPA, DAP, MSHPV, MF.
2	Instrumenti Lehtësues i Integrimit Evropian	25.5	SASPAC, MSH dhe KN, MF, MSHMS, bashkitë
Totali indikativ		**47,937**	

IPA 2027

	Dokumenti i veprimit	(mln euro)	Institucioni përgjegjës
1	BE për Sundimin e Ligjit dhe Demokracinë	18.5	MB, dhe agjencitë të varësi Policia Shtetit, Akademia e Sigurisë, Agjencia për Administrimin e Pronave të Sekuestruara dhe të Konfiskuara. Përfitues të tjerë MF, Agjencia e Inteligjencës Financiare, Kuvendi, KQZ etj.
Totali		**18.5**	

indikativ			

Marrëveshja e Financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, në lidhje me planin shumëvjeçar të veprimit në favor të Shqipërisë për vitet 2025–2027, në kuadër të Instrumentit të Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA III), është miratuar në parim me VKM nr. 702, datë 26.11.2025, është nënshkruar nga KKIPA në datën 5.12.2025, është miratuar me VKM nr. 735, datë 10.12.2025.

IPARD III

Vendimi i KE datë 9.3.2022 për IPA III Rural Development programme (IPARD III) për Republikën e Shqipërisë në vitet 2021-2027. Kontributi maksimal indikativ i Bashkimit Evropian për zbatimin e programit IPARD III është vendosur në 112,000,000 euro, i ndarë në vite, si më poshtë:

Viti	**2021**	**2022**	**2023**	**2024**	**2025**	**2026**	**2027**
Totali	**8**	**10**	**12**	**16**	**19**	**23**	**24**

2.3 BASHKËPUNIMI PËR ZHVILLIM ME DONATORË TË TJERË

Gjatë vitit 2025, ndihma e huaj ka luajtur një rol thelbësor në mbështetjen e prioriteteve strategjike të Qeverisë Shqiptare. Koordinimi i kësaj ndihme është realizuar nga SASPAC përmes bashkëpunimit të ngushtë me partnerë bilateralë, agjenci ndërkombëtare dhe institucione financiare ndërkombëtare, duke siguruar përafrimin e saj me objektivat e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030, procesin e integrimit evropian dhe prioritetet buxhetore afatmesme të vendit.

Forumi Vjetor i Dialogut me Donatorët dhe Partnerët për Ndihmën e Huaj, i zhvilluar në Tiranë më 30 shtator 2025, shërbeu si platforma kryesore për bashkërendimin e mbështetjes ndërkombëtare me prioritetet qeveritare.

Në fushën e integrimit evropian dhe qeverisjes së mirë, ndihma e huaj ka kontribuar drejtpërdrejt në mbështetjen e procesit të negociatave me Bashkimin Evropian, forcimin e shtetit të së drejtës, reformën në administratën publike dhe përmirësimin e mekanizmave kundër korrupsionit. Asistenca teknike dhe financiare e ofruar nga agjencitë e Kombeve të Bashkuara dhe partnerët bilateralë ka mbështetur zbatimin e udhërrëfyesve të reformave dhe rritjen e kapaciteteve institucionale në funksion të përmbushjes së standardeve evropiane.

Në drejtim të menaxhimit të financave publike dhe reformave ekonomike, institucionet financiare ndërkombëtare kanë qenë partnerë kyç në mbështetjen e stabilitetit makrofiskal dhe modernizimit të administrimit financiar. Banka Botërore ka vijuar mbështetjen për digjitalizimin e shërbimeve publike përmes financimit shtesë të projektit GovTECH, në vlerën 76.9 milionë euro, si dhe për forcimin e qëndrueshmërisë ekonomike dhe tranzicionin e gjelbër përmes Huas së Dytë për Politikat e Zhvillimit, me një financim prej 113.6 milionë eurosh. Paralelisht, është ofruar asistencë për përmirësimin e praktikave të kontabilitetit dhe raportimit të sektorit publik, duke kontribuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në përdorimin e fondeve publike.

Ndihma e huaj ka pasur një kontribut të rëndësishëm edhe në digjitalizimin dhe inovacionin, duke mbështetur modernizimin e administratës publike dhe përmirësimin e aksesit të qytetarëve në shërbime. Projektet dhe programet e asistencës teknike të ofruara nga Japonia, përmes JICA-s, si dhe nga partnerë të tjerë ndërkombëtarë, janë fokusuar në ngritjen e kapaciteteve institucionale, planifikimin e zhvillimit, përfshirjen financiare me fokus gjinor dhe përdorimin e teknologjive digjitale në zhvillimin ekonomik dhe social.

Në sektorin e energjisë, mjedisit dhe zhvillimit të gjelbër, ndihma e huaj ka mbështetur projekte strategjike që lidhen me eficiencën e energjisë, energjinë e rinovueshme dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Programet për Klimën në Shqipëri, të mbështetura

nga Banka Gjermane për Zhvillim KfW, me financim të konsiderueshëm në formë kredish dhe grantesh, do të kontribuojnë në modernizimin dhe digjitalizimin e sektorit energjetik. Paralelisht, projekte si ai fotovoltaik "Solar nga KESH", i financuar nga BERZH, dhe nismat për rehabilitimin e hidrocentraleve do të forcojnë qëndrueshmërinë dhe sigurinë energjetike të vendit.

Në drejtim të infrastrukturës dhe ndërlidhjes, janë financuar projekte me rëndësi të veçantë kombëtare dhe rajonale, si Projekti i Infrastrukturës Hekurudhore të Korridorit VIII, Faza I, për seksionin Durrës–Rrogozhinë. Ky projekt, i mbështetur nga BERZH dhe BEI përmes kombinimit të kredive dhe granteve, përbën një investim strategjik që kontribuon në rritjen e ndërlidhjes rajonale, zhvillimin ekonomik dhe integrimin e Shqipërisë në rrjetet evropiane të transportit.

Ndihma e huaj ka dhënë gjithashtu një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin social, arsimin dhe kapitalin njerëzor. Projekte për rinovimin e konvikteve të Institucioneve të Arsimit të Lartë publike sipas parimit të eficiencës së energjisë, të mbështetura nga Qeveria Gjermane, si dhe programe të shumta trajnimi dhe ngritjeje kapacitetesh të ofruara nga Japonia dhe Koreja e Jugut, kanë ndihmuar në forcimin e burimeve njerëzore dhe përmirësimin e shërbimeve publike. Paralelisht, programe të mbështetura nga Zvicra dhe partnerë të tjerë kanë kontribuar në fuqizimin e qeverisjes vendore, barazinë gjinore dhe rritjen e performancës institucionale.

Në tërësi, ndihma e huaj përbën një komponent plotësues dhe sinergjik me burimet buxhetore kombëtare, duke mbështetur investimet strategjike, rritur kapacitetet institucionale dhe përshpejtuar zbatimin e reformave prioritare. Përafrimi i vazhdueshëm i kësaj ndihme me prioritetet kombëtare siguron koherencë strategjike, rritje të efektivitetit të ndërhyrjeve dhe një kontribut të drejtpërdrejtë në arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe integrimit evropian të Shqipërisë.

KREU III

3.1 KUADRI MAKROEKONOMIK DHE FISKAL

1. Vështrim i përgjithshëm i objektivave ekonomikë

Gjatë viteve të fundit, ekonomia e Shqipërisë ka demonstruar një qëndrueshmëri dhe një elasticitet të konsiderueshëm pavarësisht sfidave globale dhe presioneve inflacioniste që kanë goditur vendin gjatë viteve të fundit. Vendi është përballur me disa goditje të njëpasnjëshme, duke përfshirë tërmetin e vitit 2019, pandeminë globale të COVID-19 dhe ndërprerjet e zinxhirëve të furnizimit të shkaktuara si pasojë e luftës Rusi–Ukrainë në vitin 2022. Politikat e kujdesshme makroekonomike dhe fiskale kanë mbështetur një rikthim të fortë ekonomik, dhe si rezultat fondamentet kryesore ekonomike dhe financiare, si dhe stabiliteti i përgjithshëm makroekonomik i vendit kanë mbetur solide. Përballë një mjedisi ekonomik sfidues, të karakterizuar nga çmime relativisht të larta, pasiguri dhe kosto të larta financimi, ekonomia ka ruajtur një normë të qëndrueshme rritjeje duke tejkaluar pritshmëritë fillestare. Performanca ekonomike gjatë kësaj periudhe ka qenë pozitive dhe relativisht e lartë, duke shfaqur një trajektore premtuese dhe pritet të vazhdojë ecurinë pozitive edhe në periudhën afatmesme. Edhe në vitin 2025, Shqipëria ka vijuar të shënojë performancë të qëndrueshme ekonomike, të udhëhequr nga rritja në sektorët e shërbimeve dhe të ndërtimit, e mbështetur nga konsumi privat, investimet dhe eksportet, të cilat kanë luajtur një rol kyç në nxitjen e aktivitetit ekonomik.

Konsolidimi fiskal do të vijojë të jetë objektivi themelor i politikës fiskale për periudhën afatmesme 2027–2029, në funksion të drejtpërdrejtë të sigurimit të stabilitetit makroekonomik të vendit, si një premisë thelbësore për sigurimin e një rritje ekonomike të qëndrueshme e gjithëpërfshirëse.

Politika fiskale do vijojë të targetojë një trajektore graduale rënëse të borxhit publik, ndërsa balanca primare ka rezultuar pozitive që prej vitit 2023 dhe do të vijojë të jetë pozitive ose së paku e balancuar, në përputhje edhe me rregullin fiskal të parashikuar në LOB, që përcakton se duke filluar nga viti buxhetor 2024 e për çdo vit në vijim balanca primare duhet të rezultojë jo më e vogël se sa zero (pra së paku e balancuar ose pozitive). Balanca primare në periudhën afatmesme do të targetohet respektivisht në 0.8 për qind të PBB-së për vitin 2027, 1.0 për qind në vitin 2028 dhe 1.4 për qind në vitin 2029. Respektimi në mënyrë të përvitshme i këtij objektivi (rregulli fiskal) të parametrit të balancës primare, pritet të çojë në një reduktim të nivelit të borxhit publik bruto rreth nivelit prej 50.2 për qind të PBB-së deri në vitin 2029, nga rreth 54.1 përqind që pritet të rezultojë në vitin 2025.

2. Zhvillimet e fundit ekonomike

Ekonomia shqiptare ka ruajtur kahun pozitiv të zhvillimit gjatë vitit 2025. Rritja ekonomike vijoi e qëndrueshme, e shoqëruar nga rritja e punësimit dhe e pagave, ndërsa shkalla e papunësisë mbeti në nivele të ulëta historike. Inflacioni ka vazhduar të bjerë, duke qëndruar nën objektivin 3%. Treguesit kryesorë financiarë, përfshirë borxhin publik dhe atë të huaj shënuan përmirësime të dukshme. Po ashtu, sektori financiar ishte solid, i mbështetur nga banka të mirëkapitalizuara, likuide dhe fitimprurëse, ndërsa raporti i kredive të këqija mbeti në nivele të ulëta. Këto zhvillime pozitive u evidentuan edhe në rikonfirmimin e vlerësimit të kreditit të Shqipërisë nga Moody's në Ba3 me një perspektivë të qëndrueshme dhe *Standard & Poor's* në BB me një perspektivë të qëndrueshme.

Ekonomia vijoi të rritet dhe prodhimi i brendshëm bruto (PBB) u rrit me 4.0% gjatë vitit 2024, duke tejkaluar pritshmëritë fillestare. Gjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2025, ekonomia e vendit vijoi sërish të performojë me një rritje pozitive, duke u rritur me 3.7 për qind në terma vjetorë. Rritja ekonomike gjatë kësaj periudhe u gjenerua kryesisht nga kërkesa e brendshme, si nga konsumi privat po ashtu edhe nga investimet, si dhe nga ecuria mjaft e mirë e eksporteve të shërbimeve (veçanërisht turizmi). Konsumi final total për nëntëmujorin e vitit 2025 ka shënuar rritje 4.2 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024, ndërsa konsumi final i popullatës u rrit me rreth 2.6 për qind. Investimet totale shënuan rritje me rreth 4.5 për qind në terma realë vjetorë përgjatë nëntë muajve të parë të vitit 2025, ndërkohë vetëm për tremujorin e tretë të vitit 2025 kjo normë ishte 4.7 për qind. Nga ana tjetër, gjatë kësaj periudhe eksportet e mallrave dhe shërbimeve janë rritur me rreth 6.1 për qind, ku vetëm eksportet e shërbimeve janë rritur me 9.9 për qind, ndërsa importet e mallrave dhe shërbimeve kanë shënuar një normë rritjeje prej rreth 2.6 përqind ësh.

Nga një këndvështrim sektorial, rritja e PBB-së u nxit kryesisht nga rritja e aktivitetit në sektorët e administrimit publik dhe aktiviteteve të pasurive të paluajtshme. Sektori i shërbimeve kontribuoi me 3.3 pikë përqindjeje në nëntëmujorin e parë të vitit, ndërsa ndërtimi kontribuoi me 0.4 pikë përqindjeje. Në të kundërt, sektori bujqësor dhe industrial vazhduan të japin kontribut negativ, respektivisht me -0.3 për qind dhe -0.4 për qind.

Rritja e PBB-së është mbështetur nga një sërë faktorësh**,** përfshirë bilancet e forta të sektorit privat, optimizmin e biznesit dhe të familjeve, kushtet e favorshme të financimit dhe vazhdimësinë e investimeve të huaja direkte (IHD). Për më tepër, rritja u mbështet nga politikat e kujdesshme makroekonomike: politika fiskale konsoliduese çoi në uljen e ndjeshme të borxhit publik, ndërsa politika monetare e matur vuri në kontroll inflacionin dhe politika mikro- e makroprudenciale forcuan rezistencën e sektorit bankar.

Rritja e PBB-së u shoqërua me rritje të punësimit dhe pagave. Statistikat zyrtare nga Anketa e Forcës së Punës tregojnë se punësimi u rrit me 0.8 pikë përqindjeje në nëntëmujorin e vitit 2025, kryesisht në reflektim të rritjes së punësimit në sektorin e shërbimeve. Evidencat tregojnë se interesi i përgjithshëm në rritje për pjesëmarrje në tregun e punës, është nxitur nga trendi rritës i pagave, duke intensifikuar kështu tendencat pozitive në ofertën e punës. Në përputhje me dinamikat pozitive të ekonomisë, pagat vazhduan të rriten edhe gjatë vitit 2025. Pagat në

sektorin privat u rritën me 9.8% gjatë tremujorit të tretë të vitit 2025 dhe kjo rritje ishte me bazë të gjerë në të gjithë sektorët dhe profesionet.

Rritja e shpejtë e eksporteve të shërbimeve, të investimeve të huaja direkte dhe të remitancave kanë kontribuar në përmirësimin e pozicionit të jashtëm të ekonomisë dhe mbiçmimin e Lekut gjatë viteve të fundit. Llogaria korrente rezultoi me një suficit prej 51 milionë eurosh ose rreth 0.3% të PBB-së gjatë nëntëmujorit të parë të vitit 2025. Kjo periudhë shfaqi një rritje të importeve, të nxitura nga zgjerimi i shpejtë i kërkesës së brendshme. Megjithatë, eksportet e mallrave pësuan rënie, për shkak të një mjedisi të pafavorshëm të jashtëm në terma të kërkesës dhe çmimeve, si dhe nga ndikimi i mbiçmimit të Lekut. Në kontrast, eksportet e shërbimeve të udhëhequra kryesisht nga turizmi vazhduan të performojnë pozitivisht, duke shënuar një rritje prej 14.5% krahasuar me nëntëmujorin e parë të vitit 2024. Në të njëjtën kohë, remitancat u rritën me një ritëm të përshpejtuar prej 5.7% , ndërsa flukset e IHD-ve u zgjeruan me 4.3% krahasuar me nëntëmujorin e parë të vitit 2024.

Kursi i këmbimit të Lekut kundrejt valutave kryesore ka shënuar një vlerësim të ndjeshëm edhe gjatë vitit 2025, duke theksuar tendencën forcuese të vërejtur në vitet e mëparshme. Kursi mesatar lek/euro për periudhën janar–nëntor 2025 ishte 97.94 nga 100.7m që ishte mesatarisht gjatë gjithë vitit 2024. Ndërsa kursi mesatar Lek/USD për periudhën janar–nëntor 2025 ishte 87.05 nga 93.04 që ishte mesatarisht gjatë gjithë vitit 2024. Presionet e vazhdueshme për forcimin e kursit vijuan të burojnë nga rritja e flukseve hyrëse valutore të ushqyera nga rritja e turizmit, remitancave dhe IHD-ve. Tregu i këmbimit valutor ka funksionuar normalisht, i karakterizuar nga rritje e volumit të tregtimit dhe volatilitet i ulët.

Inflacioni i çmimeve të konsumit ka shfaqur një ecuri të qëndrueshme gjatë periudhës së fundit, duke u konsoliduar rreth të njëjtës normë mesatare në vitet 2024 dhe 2025. Pas luhatjeve të theksuara të vërejtura në vitet pararendëse, presionet inflacioniste janë zbutur ndjeshëm, ndërsa inflacioni mesatar për vitin 2024 u regjistrua në nivelin 2.2 për qind dhe, sipas të dhënave më të fundit të nëntor 2025, mbetet në nivele të ngjashme edhe gjatë vitit 2025. Kjo ecuri reflekton ndikimin e vazhdueshëm të faktorëve disinflacionistë, përfshirë forcimin e kursit të këmbimit të lekut, uljen e çmimeve të ushqimeve dhe të energjisë, si dhe normalizimin gradual të kushteve të ofertës. Në këtë kontekst, dinamika e inflacionit sinjalizon një mjedis më të stabilizuar të çmimeve dhe një përforcim të tendencës së konsolidimit të inflacionit rreth niveleve të synuara.

Qëndrueshmëria e sektorit financiar, në terma të kapitalizimit, likuiditetit dhe përfitueshmërisë, vazhdon të mbetet një fondament tjetër i fortë i ekonomisë. Kreditë me probleme (NPL) kanë vijuar të ulen duke shënuar në fund të muajit tetor 2025 nivelin prej rreth 4.3 përqindësh nga rreth 8 për qind që shënonin rreth katër vjet më parë. Stoku total i kredive bankare në muajin nëntor 2025, pati një rritje me 12.2 për qind krahasuar me të njëjtin muaj të vitit 2024. Stoku i kredive në Lekë shënoi një rritje prej 15.8 përqindësh, ndërsa ai në valutë rritje prej 7.4 përqindësh, krahasuar me një vit më parë. Kreditimi i sektorit privat të ekonomisë ka shënuar rritje, si për kreditë ndaj bizneseve dhe ndaj konsumatorëve, deri në fund të muajit nëntor 2025, ku janë regjistruar rritje respektivisht prej 9.0 përqindësh dhe 19.8 përqindësh kundrejt një viti më parë.

Sa i përket depozitave bankare, referuar të dhënave të deritanishme, gjatë muajit nëntor të vitit 2025 stoku total i depozitave bankare ka shënuar rritje me 8.7 për qind krahasuar me të njëjtin muaj të të vitit 2024. Stoku total i depozitave në Lekë shënoi rritje me 14.1 për qind, ndërsa ai në valutë është rritur me 4.2 për qind. Në nëntor 2025 rezulton se rreth 47.5 për qind e totalit të stokut të depozitave përbëhet nga depozitat në Lekë, ndërsa pjesa tjetër prej 52.5 përqindësh përbëhet nga depozitimet në valutë të huaj.

3. Politika fiskale

Ekonomia shqiptare ka treguar një qëndrueshmëri të lartë përballë sfidave të tilla si pandemia, kriza energjetike dhe presionet inflacioniste, të cilat kanë testuar kuadrin fiskal të

vendit. Politikat e kujdesshme makroekonomike dhe fiskale kanë mbështetur rimëkëmbjen graduale të aktivitetit ekonomik, duke garantuar që fondamentet kryesore ekonomike dhe financiare të mbeten solide. Konsolidimi fiskal do të vijojë të jetë objektivi themelor i politikës fiskale për periudhën afatmesme 2027-2029, në funksion të drejtpërdrejtë të sigurimit të stabilitetit makroekonomik të vendit, si një premisë thelbësore për sigurimin e një rritje ekonomike të qëndrueshme e gjithëpërfshirëse. Me synimin për të ruajtur të pacenuar kredibilitetin e financave publike në perceptimin e tregjeve, politika fiskale do të targetojë një trajektore rënëse të përvitshme të borxhit publik, ndërsa balanca primare do të jetë së paku neutrale ose në nivel pozitiv në vijimësi, duke përbërë objektivin kryesor operacional që do të ankorojë politikën fiskale në afatin e mesëm dhe të gjatë, në përputhje edhe me rregullat fiskalë respektivë në LOB.

Balanca primare në periudhën afatmesme do të targetohet në vijimësi në vlera pozitive, respektivisht 0.8 për qind e PBB-së për vitin 2027, 1.0 për qind në vitin 2028 dhe 1.4 për qind në vitin 2029.

Për rrjedhojë, ky angazhim ndaj kujdesit fiskal pritet të drejtojë borxhin publik bruto në një trajektore rënëse, duke u përafruar me rregullin fiskal përkatës. Respektimi në mënyrë të përvitshme i këtij objektivi (rregulli fiskal) të parametrit të balancës primare, pritet të çojë në një reduktim të nivelit të borxhit publik bruto, sipas skenarit aktual bazë, në rreth 52.2 për qind deri në vitin 2027, me një rënie të mëtejshme në afërsisht 46.4 për qind deri në vitin 2031 dhe (në mungesë të ndonjë shoku makroekonomik të konsiderueshëm negativ) duke qëndruar nën 45% të PBB-së deri në vitin 2034.

Në të njëjtën kohë, krahas angazhimit për konsolidim fiskal, ne do të përpiqemi të ruajmë një ekuilibër të kujdesshëm midis shpenzimeve buxhetore korrente dhe kapitale. Konkretisht, shpenzimet kapitale të qeverisë qendrore, duke përfshirë pjesën më të madhe të investimeve publike, do të synohen në një mesatare vjetore prej 6.0 përqindësh të PBB-së përgjatë periudhës 2027–2029, duke përfshirë këtu edhe investimet e reja publike që potencialisht do të mundësohen në kuadër të Planit të Ri të Rritjes të implementuar nga Bashkimi Evropian me synimin përfundimtar për një zhvendosje të konsiderueshme të rritjes potenciale në vendet e Ballkanit Perëndimor. Kjo shpërndarje konsiderohet thelbësore për të mbështetur rritjen ekonomike si në afat të mesëm ashtu edhe në atë afatgjatë. Në bazë të strategjisë sonë fiskale qëndron përkushtimi për të ruajtur një bilanc fiskal korrent pozitiv, në përputhje me përcaktimet e "rregullit të artë" të buxhetit, duke targetuar një deficit fiskal të përgjithshëm prej 1.6 përqindësh të PBB-së për vitin 2027, nga 2.3 për qind i programuar për vitin 2026; nivelin prej 1.3 përqindësh të PBB-së në vitin 2028 dhe 0.9 për qind në vitin 2029. Për rrjedhojë, suficiti fiskal korrent i synuar është 4.8 për qind për vitin 2027, 5.0 përqind dhe respektivisht 4.6 për qind për vitin 2028 dhe 2029.

4. Skenari makroekonomik e fiskal afatmesëm

Pas recesionit të fortë prej -3.3 përqindësh në vitin 2020, ekonomia u rimëkëmb fuqishëm në vitin 2021 duke shënuar rritje reale prej 9.0 përqindësh, duke vijuar trendin pozitiv edhe gjatë viteve 2022-2024, përkatësisht në 4.8 për qind për vitin 2022 dhe 4.0 për qind për vitet 2023 dhe 2024. Për vitin 2025 kjo rritje vlerësohet të jetë rreth 3.9 për qind dhe pritet të vijojë trendin pozitiv në periudhën afatmesme. Rritja ekonomike parashikohet në normën 4.0 për qind për vitin 2026 dhe përgjatë periudhës afatmesme në vijim 2027–2029 parashikohet mesatarisht rreth 3.9 për qind në vit. Më specifikisht, rritja ekonomike parashikohet në 3.9, 4.1 dhe 3.9 për qind respektivisht për vitet 2027, 2028 dhe 2029.

Kërkesa e huaj neto pritet të ketë një kontribut pozitiv të moderuar në periudhën afatmesme. Eksportet e mallrave të cilat zakonisht kanë pasur performancë të mirë në vite, priten të vazhdojnë këtë trend pozitiv dhe të ruajnë ritmet e kaluara. Eksportet e shërbimeve, veçanërisht shërbimet turistike, priten gjithashtu të kenë performancë pozitive në periudhën afatmesme dhe të jenë elementi kryesor për të kompensuar kontributin negativ të ardhur prej rritjes së

importeve. Konsumi final total për periudhën afatmesme (2027–2029) parashikohet të rritet në terma realë me mesatarisht rreth 2.9 për qind në vit, duke kontribuar me mesatarisht rreth 2.3 pikë përqindjeje në vit në rritjen e PBB-së. Ndërsa investimet totale në ekonomi parashikohen të rriten në terma realë mesatarisht në rreth 4.9 për qind në vitet 2027–2029, me një kontribut mesatar në rritjen totale prej rreth 1.2 pikë përqindjeje në vit.

Sa i takon më specifikisht komponentëve të kërkesës së huaj neto, eksportet e mallrave dhe shërbimeve për periudhën 2027–2029, parashikohen të rriten me mesatarisht rreth 4.6 për qind në vit në terma realë, me një kontribut mesatar pozitiv prej rreth 1.7 pikë përqindjeje në vit në rritjen e PBB-së. Ndërsa importet e mallrave dhe shërbimeve për këtë periudhë afatmesme parashikohen të zgjerohen me mesatarisht rreth 3.0 për qind në vit me një kontribut mesatar negativ në rritjen e PBB-së me rreth 1.3 pikë përqindjeje në vit. Rrjedhimisht, në terma neto kërkesa e huaj parashikohet të ketë një kontribut të moderuar pozitiv në rritjen totale të PBB-së me mesatarisht rreth 0.4 pikë përqindjeje në vit.

Në përputhje me parashikimet afatmesme të rritjes, punësimi pritet të rritet me një mesatare prej 0.1 përqindësh në vit gjatë periudhës 2027-2029. Shkalla më e lartë e pjesëmarrjes në forcat e punës do të jetë gjeneruesi kryesor i rritjes së ofertës së punës, ndërkohë që trendet negative demografike (të vërejtura prej disa vjetësh tashmë) pritet të vijojnë të kenë efekte shtrënguese si në ofertën për punë, ashtu edhe në numrat agregat të punësimit përgjatë periudhës afatmesme në vijim. Ndërsa rritja e kërkesës për punë pritet të reflektojë dinamikën e perspektivës afatmesme të sektorëve kryesorë të aktivitetit ekonomik, të përmendur më sipër. Rrjedhimisht, pritet që shërbimet të kontribuojnë më shumë në rritjen e kërkesës për punë në krahasim me sektorët e tjerë të ekonomisë. Ndërkohë pritet që punësimi në afatin e mesëm të jetë së paku jo në rritje negative (në nivele mjaft të moderuara, por gjithsesi ende pozitiv), në reflektim të efekteve të kundërta të rritjes së shkallës së pjesëmarrjes në forcat e punës nga njëra anë dhe trendeve negative demografike nga ana tjetër. Në të njëjtën kohë pritet që produktiviteti i përgjithshëm i punës të vijojë një përmirësim të konsiderueshëm gjatë kësaj periudhe dhe të jetë një faktor i rëndësishëm i gjenerimit të rritjes ekonomike në afatin e mesëm. Kjo duke reflektuar si vijimin e lëvizjeve të forcave të punës drejt sektorëve me produktivitet relativ më të lartë se të tjerët, ashtu edhe në reflektim të vijimit të përmirësimeve teknologjike, përfshirë këtu patjetër edhe vijimësinë e përmirësimeve infrastrukturore dhe reformave strukturore. Papunësia pritet të vazhdojë rënien graduale duke arritur në 8.8 për qind në vitin 2027.

Objektivi kryesor i politikës monetare është ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Banka e Shqipërisë operon sipas një regjimi të shënjestrimit të inflacionit, me një objektiv afatmesëm për inflacionin e çmimit të konsumit prej 3.0% në vit.

Inflacioni i çmimeve të konsumit ka shfaqur një ecuri të qëndrueshme gjatë periudhës së fundit, duke u konsoliduar rreth të njëjtës normë mesatare në vitet 2024 dhe 2025. Pas luhatjeve të theksuara të vërejtura në vitet pararendëse, presionet inflacioniste janë zbutur ndjeshëm. Sipas të dhënave më të fundit të nëntor 2025, inflacioni mbetet në nivele të ngjashme me vitin 2024. Kjo ecuri reflekton ndikimin e vazhdueshëm të faktorëve disinflacionistë, përfshirë forcimin e kursit të këmbimit të lekut, uljen e çmimeve të ushqimeve dhe të energjisë, si dhe normalizimin gradual të kushteve të ofertës. Në këtë kontekst, dinamika e inflacionit sinjalizon një mjedis më të stabilizuar të çmimeve dhe një përforcim të tendencës së konsolidimit të inflacionit rreth niveleve të synuara.

5. Përshkrimi i Risqeve financiare

Intensifikimi i tensioneve gjeopolitike mund të ketë pasoja në ekonomi duke shkaktuar çmime të larta të mallrave, ulje të shkëmbimeve tregtare, rritje të kufizimeve financiare dhe ulje të besimit të biznesit dhe konsumit. Luhatjet e mundshme të çmimeve të mallrave, si rezultat i ndërprerjes së tregtisë nga konfliktet, pasiguritë dhe kufizimet e eksportit, mund të

çojnë në paqëndrueshmëri të çmimeve të mallrave, duke ushtruar presion mbi rritjen ekonomike dhe të ardhurat fiskale.

Një rritje e çmimeve të ushqimeve dhe energjisë mund të ndikojë negativisht në rritjen ekonomike, të përkeqësojë ekuilibrin e llogarisë korrente, dhe të rrisë deficitin buxhetor. Për më tepër, një skenar i tillë ngre rreziqe fiskale që lidhen me sektorin e energjisë.

Ekonomia shqiptare mund të ndikohet nga një recesion i mundshëm në Evropë si pasojë e uljes të kërkesës së jashtme. Kjo rënie mund të prekë veçanërisht sektorë të tillë si turizmi dhe të çojë në një reduktim të remitancave.

Frekuenca në rritje e motit ekstrem dhe fatkeqësive natyrore mund të ndikojnë negativisht rritjen ekonomike, produktivitetin dhe deficitet fiskale.

Sulmet e mundshme kibernetike mund të ngadalësojë shërbimet publike dhe ato financiare. Kërcënime të tilla kibernetike mund të pengojnë zgjerimin dhe përdorimin e shërbimeve publike digjitale dhe ato të sistemeve bankare dhe financiare.

Propozimi i Dokumentit të Politikave Prioritare:

Bazuar në të dhënat e kuadrit makroekonomik, sektorët prioritarë të dokumentit DPP 2027–2029, do të vijojnë të financohen, por politikat e reja duhet të akomodohen brenda tavaneve ekzistuese. Gjithashtu, projektet e reja strategjike do të akomodohen brenda tavaneve te vitit 2028, bazuar në kushtin që investimet të fillojnë në vitin 2028.

Shënim sqarues: Duke filluar nga viti 2027, disponohet hapësirë fiskale për fillimin e projekteve të reja strategjike. Tavanet e vitit 2026 janë ezauruar me projektet në vazhdim. Politikat e tjera, të cilat kërkojnë financim sipas këtij draft-dokumenti janë tashmë të akomoduara në tavanet buxhetore.

KREU IV

4.1 PROGRAME PRIORITARE PËR PERIUDHËN 2027–2029

1. Programi i garancisë rinore

Skema e Garancisë Rinore synon të reduktojë largimin e të rinjve/të rejave nga Shqipëria, si dhe të ulë papunësinë për të rinjtë/të rejat, e cila mbetet mbi mesataren, veçanërisht për kategorinë NEET (të rinjtë që nuk janë në arsim, punësim dhe as në trajnim).

Garancia Rinore përbën një instrument kombëtar të politikave të punësimit për integrimin e të rinjve 15–29 vjeç të kategorisë NEET në tregun e punës. Skema është pjesë e "Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023–2030", dhe zbatohet nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI), si institucioni përgjegjës për drejtimin politik dhe institucional të skemës, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA), si institucioni zbatues që menaxhon regjistrimin, ofrimin e shërbimeve të punësimit dhe formimit profesional, si dhe më mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Rinisë (AKR) me rol plotësues në kontaktimin dhe aktivizimin e të rinjve.

Pas fazës së pilotimit të skemës në Tiranë, Vlorë dhe Shkodër, ku u testuan mekanizmat e identifikimit, regjistrimit dhe aktivizimit të të rinjve NEET, parashikohet tashmë shtrirja kombëtare e skemës. Zbatimi do të mbështetet nga Programi Operacional IPA III 2024–2027, duke garantuar që çdo i ri 15–29 vjeç NEET të marrë brenda 4 muajve një ofertë për punësim, formim profesional ose vazhdim arsimi.

Zgjerimi i skemës do të realizohet nën drejtimin e MEI-t si autoriteti menaxhues dhe AKPA-së si institucioni zbatues, në bashkëpunim me AKR-në dhe strukturat vendore, të cilat kanë rol mbështetës në informim dhe aktivizim e të rinjve.

Kjo fazë synon konsolidimin e politikave të punësimit, uljen e papunësisë së të rinjve dhe kontributin në një ekonomi konkurruese e shoqëri gjithëpërfshirëse deri në vitin 2030.

Në vijim, gjatë vitit 2025, AKR-ja ka zhvilluar një sërë aktivitetesh informuese dhe ndërgjegjësuese mbi Garancinë Rinore, duke përfshirë prezantimin e portalit dhe sistemit të

regjistrimit përmes kampeve verore, takimeve fizike dhe *online* me 53 këshilla vendorë rinorë dhe punonjës rinorë pranë bashkive, si dhe pjesëmarrjen në panaire arsimi, edukimi dhe punësimi.

Po ashtu, gjatë vitit 2025 janë miratuar ndryshimet në ligjin për rininë, pas një procesi të gjerë konsultues me mbi 80 përfaqësues nga institucionet shtetërore qendrore dhe vendore, organizatat e shoqërisë civile (OSHC), Këshillin Kombëtar të Rinisë, këshillat vendorë rinorë, organizatat rinore ombrellë, këshillat studentorë, partnerët për zhvillim dhe ekspertë të fushës. Këto ndryshime përmirësojnë mekanizmat institucionalë, vendosin një përkufizim ligjor për NEET, zgjerojnë mandatet e këshillave rinorë për të përfshirë grupet vulnerabël, njohin grupet informale rinore për të drejtën e financimit dhe mandatojnë qendrat rinore shumëfunksionale, si dhe programet kombëtare për punësimin, sipërmarrjen, kulturën dhe angazhimin qytetar, në përputhje me standardet e BE-së. Gjithashtu, është miratuar edhe ligji i ri për vullnetarizmin, pas një procesi të gjatë konsultimesh.

Lidhur me mekanizmat e granteve për të financuar fazën e Kontaktimit, **Agjencia Kombëtare e Rinisë zbaton një skemë grantesh për organizatat rinore dhe për të rinjtë**. Deri më tani janë realizuar 5 thirrje. Këto thirrje kanë parashikuar mbështetjen e organizatave rinore lidhur me informimin e të rinjve mbi mundësitë dhe aktivizmin rinor. Këto projekte nuk kanë si qëllim të drejtpërdrejtë zbatimin e skemës së Garancisë Rinore por janë të lidhura me procesin e kontaktimit të të rinjve NEET, si dhe ndërlidhjen e të rinjve me tregun e punës.

AKR-ja ka vijuar kontaktimin e të rinjve NEET përmes fushatave të rrjeteve sociale.

2. Programi i nxitjes së kodimit

Në kuadër të thirrjes numër pesë të zbatuar nga Agjencia Kombëtare e Rinisë, janë financuar dy projekte që kanë në fokus nxitjen e aftësive në kodim, me konkretisht projekti "*BotBuilders*" zbatuar nga organizata *Metroresearach* dhe projekti "*DigiTours*-Aftësi Digjitale për Turizmin e së Ardhmes", zbatuar nga organizata *Women in Technology Albania*.

Prioritetet për periudhën 2027–2029

1. Databaza e Rinisë

Me miratimin e ligjit nr. 75/2019, "Për rininë", i ndryshuar, në nenin 18 të tij parashikohet ngritja e bazës së të dhënave për rininë, me qëllimin që të sigurojë informacion të përditësuar për të rinjtë në vend, si edhe të mbështesë procesin e planifikimit, mbikëqyrjes, administrimit dhe vlerësimit të politikave rinore, në nivel qendror dhe vendor.

Në vijim është miratuar vendimi nr. 833, datë 24.12.2021, i Këshillit të Ministrave, "Për mënyrën e ngritjes, administrimit, mirëmbajtjes së bazës së të dhënave për rininë, si dhe mënyrën e ndërveprimit të saj me bazat e tjera të të dhënave shtetërore", ku parashikohen rregulla të hollësishme për mënyrën e ngritjes, administrimit, mirëmbajtjes së bazës së të dhënave për rininë, si dhe mënyrën e ndërveprimit të saj me bazat e tjera të të dhënave shtetërore.

Ngritja e bazës së të dhënave për rininë është dhe një ndër masat që duhet të plotësohen, në kuadër të objektivit specifik 1.3, të Strategjisë Kombëtare të Rinisë, "Politika rinore është e koordinuar, e bazuar në analiza dhe e harmonizuar në sektorë të ndryshëm, duke kërkuar kohezionin dhe optimizimin e burimeve dhe duke forcuar si instrument zbatues të këtyre politikave, Agjencinë Kombëtare të Rinisë", miratuar në tetor të vitit 2022.

Krijimi i regjistrit elektronik për rininë do të mundësojë sa më poshtë:

-Sigurojë informacion të përditësuar për të rinjtë dhe organizatat e shoqërisë civile (organizatat rinore/për të rinjtë) në vend dhe në diasporë.

- Përcaktojë listën e organizatave të shoqërisë civile që plotësojnë kriteret ligjore për t'u konsideruar organizatë rinore apo organizatë për të rinjtë dhe që do të përfshihen në konsultimin e politikave, programeve apo nismave rinore dhe përfitimin nga shërbimet publike të digjitalizuara për to, si p.sh. aplikimi në thirrjet vjetore të AKR-së për grantin shtetëror të rinisë.

- Rrisë transparencën dhe llogaridhënien e veprimtarisë në fushën e rinisë të institucioneve shtetërore qendrore dhe vendore përmes vënies në dispozicion të të dhënave të databazës te të rinjtë apo organizatat e shoqërisë civile për të mbështetur kërkime shkencore e statistikore, analiza, vlerësime apo projekte të ndryshme të zbatuara prej tyre.

- Lehtësojë shkëmbimin e informacionit dhe ndërtimin e nismave të përbashkëta në fushën e rinisë.

- Aktualisht kërkohet që regjistri për Rininë të ndërveprojë me bazat e të dhënave shtetërore të përcaktuara më poshtë:

- Bazën e të dhënave për informacion për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse (OJF-ve) – KLGJ / DPT;

- Me regjistrin Tregtar (QKB), për të dhënat e bizneseve;

- Me sistemin e të dhënave të informacionit të planifikimit të integruar – SIPI (SASPAC);

Deri më tani janë vendosur funksionalitet që do të mundësojë databaza, janë përfunduar formularët e aplikimit për regjistrimin në databazë, publikimin e të dhenave të organizatave dhe formulari për kërkesë të dhënash publike. Regjistri Elektronik Rinor do të bëhet i aksesueshëm për të rinjtë dhe organizatat rinore/për të rinjtë me anë të portalit *e-Albania.*

Sistemi RER do të ketë një fushë në faqen rinia.gov.al, ku do të publikohen informacione të organizatave rinore/për të rinjtë që ata kërkojnë të jenë publike.

2. Fuqizimi i strukturave rinore në nivel qendror dhe vendor

Fuqizimi i strukturave rinore në nivel qendror dhe vendor si Këshilli Kombëtar i Rinisë, këshillat vendorë rinorë, këshillat studentorë etj. përbën një element kyç për zbatimin efektiv të politikave rinore dhe garantimin e përfshirjes aktive të të rinjve në jetën socio-ekonomike të vendit. Kjo nënkupton rritjen e kapaciteteve institucionale, përmirësimin e koordinimit ndërinstitucional dhe forcimin e rolit të njësive përgjegjëse për rininë në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e programeve dhe shërbimeve për të rinjtë. Në të njëjtën kohë, fuqizimi i këtyre strukturave synon të sigurojë që politikat dhe masat rinore të jenë më të aksesueshme, më të përshtatura me nevojat lokale dhe më të qëndrueshme, duke kontribuar drejtpërdrejt në zbatimin e politikave rinore

3. Standardizimi i qendrave rinore

Standardizimi i qendrave rinore është thelbësor për garantimin e cilësisë, barazisë dhe efektivitetit të shërbimeve që u ofrohen të rinjve në të gjithë territorin e vendit. Përmes përcaktimit të standardeve të qarta për infrastrukturën, burimet njerëzore, programet dhe mënyrën e funksionimit, sigurohet që çdo qendër rinore të ofrojë shërbime të sigurta, gjithëpërfshirëse dhe të përshtatura me nevojat reale të të rinjve, pavarësisht vendndodhjes. Standardizimi kontribuon gjithashtu në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe monitorimit të performancës së qendrave rinore, duke forcuar besimin e të rinjve dhe të komunitetit, si dhe duke krijuar një bazë të qëndrueshme për zhvillimin e politikave rinore dhe shpërndarjen më efikase të burimeve.

4. Garancia rinore

Bazuar në projekturdhrin e Kryeministrit "Për disa ndryshime dhe shtesa në urdhrin nr. 28, datë 24.2.2022, të kryeministrit "për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës dhe të grupit teknik të punës, për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planit kombëtar të garancisë rinore, si dhe caktimin e koordinatorit kombëtar", Agjencia Kombëtare e Rinisë në programin e garancisë rinore do të menaxhojë mekanizmin e granteve, me qëllim financimin e veprimtarisë së organizatave rinore në kuadër të Rrjetit të Partneritetit Vendor. AKR-ja ka një rol kyç në mbështetjen dhe koordinimin e aktiviteteve rinore në nivel vendor. Ajo përcakton, në bashkëpunim me AKPA-në, kriteret dhe rregullat për përfitimin e granteve që mbështesin aktivitetet e Granteve Rinore gjatë fazës së kontaktimit. Përveç kësaj, AKR-ja zbaton mekanizmin e granteve për të siguruar funksionimin e Rrjetit të Partneritetit Vendor dhe është përgjegjëse për identifikimin dhe regjistrimin e organizatave rinore brenda këtij rrjeti. Ajo

koordinon dhe mbikëqyr procesin e kontraktimit me organizatat rinore, promovon përfshirjen e OSHC-ve në program, menaxhon alokimin e fondeve duke u bazuar në vlerësimin e outputit nga sistemi i monitorimit, dhe mbështet funksionimin e këshillave rinorë vendorë në bashkitë e vendit. Në këtë mënyrë, AKR-ja siguron që aktivitetet rinore të jenë të qëndrueshme, transparente dhe të orientuara drejt nevojave reale të të rinjve.

5. Mbrojtja e natyrës

Arritja e objektivit madhor global "të jetojmë në harmoni me natyrën" deri në 2050, në përputhje me Planin Strategjik Global për biodiversitetin. Transformimi i marrëdhënies së shoqërisë me biodiversitetin, nëpërmjet objektivave konkretë të përcaktuar për periudhën deri në 2030, në strategjinë e re globale "post 2020" për mbrojtjen dhe menaxhimin e natyrës. Përafrimi me legjislacionin e Bashkimit Evropian, kryesisht referuar Direktivave për Habitatet dhe Shpendëve, është një nga prioritetet e Ministrisë e Mjedisit, për sa u takon mbrojtjes së natyrës nivel të avancuar, për të cilën ka filluar procesi për rishikimin dhe përditësimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Biodiversitetin, për periudhën deri në vitin 2030, në linjë me kontekstin global Post 2020 për biodiversitetin, të Konventës së biodiversitetit dhe strategjinë Evropiane post 2020 për Biodiversitetin. Forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve në nivel kombëtar dhe lokal për zbatimin në praktikë të kuadrit ligjor të përditësuar dhe për procesin e ngritjes së rrjetit Natura 2000 në vend, është prioritet i fushës së mbrojtjes së natyrës, si detyrimi kryesor në kuadrin e procesit të integrimit evropian të vendit.

Objektivat e synuar për adresimin e sfidave dhe përmbushjen e vizionit:

Në përputhje me Kuadrin Global për Biodiversitetin post 2020, për adresimin e sfidave te mësipërme objektivat e synuar për periudhën deri në 2030, janë:

Në fushën e mbrojtjes së natyrës:

1. Përditësimi dhe rishikimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Biodiversitetin 2025–2030, në zbatim të Konventës së biodiversitetit;
2. Transpozimi i plotë i *Acquis* së BE-së për natyrën dhe biodiversitetin dhe zbatimi i saj në praktikë;
3. Rritja e sipërfaqes së zonave të mbrojtura në 30% të sipërfaqes tokësore dhe detare të vendit, nëpërmjet zgjerimit të zonave të mbrojtura detare dhe bregdetare në përputhje me objektivat globalë "post 2020", si dhe menaxhimi i integruar i tyre;
4. Zbatimi i parimit të përqasjes së bazuar në ekosistem për të kontribuar në zbutjen dhe adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, dhe për të siguruar që masat adaptuese dhe zbutëse do të shmangin impaktet negative në biodiversitet;
5. Futja e biodiversitetit dhe shërbimeve të ekosistemit në programet arsimore në shkolla të ndryshme dhe nivelet e arsimit të lartë;
6. Ngritja e rrjetit ekologjik "NATURA 2000";
7. Përmirësimi i statusit të ruajtjes për 15 % të llojeve dhe habitateve të kërcënuara për të siguruar menaxhimin e qëndrueshëm të komponentëve të biodiversitetit;
8. Nxitja dhe aplikimi i incentivave ekonomike në fushën e menaxhimit dhe përdorimit të qëndrueshëm të zonave të mbrojtura;
9. Fuqizimi organizativ i strukturave për menaxhimin e territorit brenda njësive të vetëqeverisjes vendore;
10. Përdorimi i burimeve natyrore në mënyrë të qëndrueshme duke e kthyer në element qendror në vlerën e paketës turistike në bregdet, mal, historik e kulturor.

Lidhur me pyjet, në kuadër të procesit të integrimit evropian, është i nevojshëm fillimi i procesit të sensibilizimit të operatorëve, tregtarëve dhe aktorëve të tjerë dhe forcimi i kapaciteteve për t'u përgatitur plotësisht, duke përfshirë, për këta të fundit, ngritjen e sistemit të nevojshëm të kujdesit të duhur, procesit të gjurmueshmërisë, kërkesave për informacion, mbajtjes së të dhënave dhe vlerësimit të rrezikut, në lidhje me mallrat dhe produktet përkatëse, për të përmbushur plotësisht detyrimet e tyre".

1.
2.

KREU V
LISTA UNIKE E PROJEKTEVE ME RËNDËSI KOMBËTARE

Lista Unike e Projekteve me Rëndësi Kombëtare është një instrument prioritizimi strategjik afatmesëm dhe afatgjatë i Qeverisë Shqiptare, i cili shërben për të materializuar Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE), strategjitë sektoriale/ndërsektoriale dhe prioritetet e qeverisë në projekte konkrete në nivel kombëtar dhe rajonal. Kjo listë shërben si referencë për ministrinë përgjegjëse për financat dhe njësitë e qeverisjes qendrore, në kuadër të përfshirjes së projekteve të investimeve publike në Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA) apo buxhetin vjetor.

Projektet e reja të investimeve publike mbi vlerën kufi të përcaktuar me udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 11, datë 28.5.2025, "Për përcaktimin e kufirit financiar të vlerës së plotë të projektit në përputhje me specifikat e sektorit, mbi bazën e të cilit përcaktohet mënyra dhe procedurat e vlerësimit të projektit të investimit publik", klasifikohen si projekte investimi me rëndësi kombëtare dhe i nënshtrohen procesit të vlerësimit për përfshirjen e tyre në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare. Këto projekte investimi përfshihen në PBA-në, apo buxhetin vjetor në përputhje me hapësirën fiskale, vetëm pasi të jenë bërë pjesë e Listës Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare, të rankuar dhe të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

Parimet kryesore, ku bazohen njësitë e qeverisjes qendrore dhe institucioni përgjegjës për programimin strategjik, për vlerësimin dhe prioritizimin e propozimeve të projekteve të investimit në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare janë:

- parimi i vlerësimit të rëndësisë strategjike;
- parimi i vlerësimit mjedisor dhe impaktit klimaterik;
- parimi i vlerësimit të qëndrueshmërisë;
- parimi i vlerësimit gjinor;
- parimi i vlerësimit të menaxhimit të projektit.

Lista Unike e Projekteve me Rëndësi Kombëtare përmban projektet e investimeve publike, të cilat paraqesin rëndësi strategjike për sa i përket zhvillimit ekonomik dhe social të vendit, pavarësisht nga burimi i tyre i financimit. Në këtë listë projektet klasifikohen/rankohen sipas statusit të maturitetit dhe nivelit të prioritetit që paraqesin brenda çdo institucioni projekt-propozues. Renditja e institucioneve në Listën Unike është në rend alfabetik dhe nuk përbën kriter prioritizimi për projektet që janë pjesë e listës.

Çdo projekt në Listën Unike përbëhet nga 10 tregues të cilët paraqiten si më poshtë:

a) Numri rendor: i referohet numrit total të projekteve;

b) Emërtimi: i referohet emërtimit të projektit në përputhje me projektpropozimin gjatë fazës së përfshirjes në listë;

c) Institucioni propozues/përgjegjës: i referohet institucionit i cili paraqet projektpropozimin për përfshirje në listën unike, ose institucionit i cili administron ecurinë e projektit përkatës;

ç) Sektori ekonomik: i referohet sektorit ekonomik në të cilin klasifikohet projekti, në përputhje me përcaktimet e Tabelës nr. 1 "Klasifikimi i projekteve strategjike" në VKM nr. 887, datë 27.12.2022 "Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike", të ndryshuar;

d) Nënsektori: i referohet nënsektorit ekonomik, në përputhje me përcaktimet e Tabelës nr. 1 "Klasifikimi projekteve strategjike" në VKM nr. 887, datë 27.12.2022 "Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike", të ndryshuar;

dh) Vlera indikative: i referohet kostos së përgjithshme të parashikuar për implementimin e projektit.

Ky tregues mund të jetë objekt ndryshimi (kryesisht për projektet në fazë të hershme), për shkak të rivlerësimeve gjatë kryerjes së studimeve teknike;

e) Statusi i maturitetit: i referohet ecurisë së zhvillimit teknik të projektit (që nga faza e konceptimit të projekt idesë deri në fazën e implementimit të tij) dhe përbëhet nga kategoritë, si më poshtë:

I maturuar

- Konsiderohet projekti për të cilin është kryer studimi i fizibilitetit dhe është konsideruar fizibël, ose kur projekti është në fazë të avancuar të përpilimit të dokumenteve teknike.

Pjesërisht i maturuar

- Konsiderohet projekti për të cilin është iniciuar studimi i fizibilitetit, ose kur projekti ka iniciuar një pjesë të dokumenteve teknike.

I pamaturuar

- Konsiderohet projekti i cili është në fazën e konceptimit të projektidesë, ose në fazat fillestare të inicimit të dokumenteve teknike.

ë) Niveli i prioritetit: i referohet prioritetit që ka projekti në nivel institucional dhe përbëhet nga kategoritë si më poshtë:

A - prioritet i lartë;

B - prioritet mesatar;

C - prioritet i ulët.

f) OZHQ: u referohet Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, në të cilat kontribuon projekti për sa i përket arritjes së outputeve të agjendës globale, në përputhje me detajimin në seksionin e legjendës.

g) COFOG: i referohet kodit të klasifikimit funksional të shpenzimeve të qeverisë, i cili identifikon qëllimin funksional të projektit. Ky kod shërben për klasifikimin e shpenzimeve të qeverisë në Sistemin e Llogarive Kombëtare sipas funksionit të përdorimit dhe detajohet në nivel primar dhe sekondar në përputhje me detajimin në seksionin e legjendës.

Projektet e investimit me rëndësi kombëtare të cilat kualifikohen për t'u përfshirë në Listën Unike, do të konsiderohen sipas Aneksit 1 të vendimit nr. 887, datë 27.12.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e menaxhimit të investimeve publike", të ndryshuar, si dhe udhëzimit të ministrit përgjegjës për financat "Për përcaktimin e kufirit financiar të vlerës së plotë në përputhje me specifikat e sektorit, mbi bazën e të cilit përcaktohet mënyra dhe procedura e vlerësimit të projektit të investimit publik", ato projekte të cilat klasifikohen në një nga gjashtë sektorët ekonomikë dhe tejkalojnë kufirin financiar të vlerës së plotë të projekteve si më poshtë:

- Sektori digjital

Infrastruktura digjitale u referohet teknologjive digjitale, të cilat ofrojnë bazën për teknologjinë dhe operacionet e informacionit të një njësie organizative. Do të konsiderohen si pjesë e Sektorit të Infrastrukturës Digjitale të gjitha projektet e investimit, rezultatet e të cilave synohet të kenë ndikim parësor në të paktën një prej nënsektorëve: Ndërlidhja me bazë të gjerë, Infrastruktura e-GOV, Sisteme Informacioni dhe Platformat e Inovacionit.

- Zhvillimi ekonomik

Zhvillimi ekonomik u referohet programeve dhe politikave, apo aktiviteteve ekonomike, të cilat kanë për qëllim të përmirësojnë mirëqenien ekonomike, dhe cilësinë e jetës së burrave dhe grave të komitetit në vend. Do të konsiderohen si pjesë e Sektorit të Zhvillimit Ekonomik të gjitha projektet e investimit, rezultatet e të cilave synojnë të kenë ndikim parësor në të paktën një prej nënsektorëve: agrikultura, zhvillimi i biznesit, infrastruktura bregdetare dhe detare, sipërmarrja, industria, zhvillimi rajonal dhe turizmi.

- Energjia

Energjia u referohet aktiviteteve ekonomike me impakt në prodhim dhe shitjen e energjisë, përfshirë nxjerrjen e karburanteve, përpunimin dhe shpërndarjen e tyre. Do të konsiderohen si pjesë e Sektorit të Energjisë të gjitha projektet e investimit, rezultatet e të cilave synohet të kenë ndikim parësor në të paktën një prej nënsektorëve: eficienca e energjisë, prodhimi i energjisë, trasmetimi i energjisë, gazi, nafta dhe energjia e rinovueshme.

- Mjedisi

Mjedisi u referohet aktiviteteve ekonomike të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e burimeve natyrore. Do të konsiderohen si pjesë e Sektorit të Mjedisit të gjitha projektet e investimit, rezultatet e të cilave synohet të kenë ndikim parësor në të paktën një prej nënsektorëve: menaxhimi i fatkeqësive, mbrojtja nga përmbytjet, zhvillimi i qëndrueshëm, menaxhimin i mbetjeve, landfillet, furnizimi me ujë.

- Social

Sektori Social u referohet programeve dhe politikave, apo aktiviteteve ekonomike, të cilat kanë për qëllim reduktimin e shtrirjes së varfërisë dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës së burrave dhe grave në vend, si dhe adresimin e pabarazive gjinore në përgjithësi. Do të konsiderohen si pjesë e Sektorit Social të gjitha projektet e investimit, rezultatet e të cilave synohet të kenë ndikim parësor në të paktën një prej nënsektorëve: kultura, edukimi dhe sportet, shëndetësia, strehimi, siguria e brendshme, drejtësia, mbrojtja sociale.

- Transporti

Transporti u referohet aktiviteteve ekonomike, të cilat kanë për qëllim zhvillimin apo përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese të transportit të mallrave dhe/ose qyteteve nëpërmjet tokës, ujërave dhe ajrit. Do të konsiderohen si pjesë e këtij sektori të gjitha projektet e investimit, rezultatet e të cilave synohet të kenë ndikim të paktën në një prej nënsektorëve: transporti ajror, transporti në ujërat e brendshme, portet, transporti hekurudhor, transporti rrugor.

Në aneksin 1 paraqitet Lista Unike e Projekteve me Rëndësi Kombëtare.

ANEKS 1

I. PROJEKTE INVESTIMI ME STATUS "I MATURUAR"

NR	EMËRTIMI	INSTITUCIONI PROPOZUES/PËRGJEGJËS	SEKTORI	NËNSEKTORI	VLERA INDIKATIVE	STATUSI I MATURITETIT	NIVELI I PRIORITETIT INSTITUCIONAL	OZHQ	COFOG
1	E-Qeverisja 2.0	AKSHI	DIGJITAL	INFRASTRUKTURA E-GOV	66 000 000 €	I MATURUAR	A	9.1	01.3
2	*Krijimi i Smart Labs – rrjeti i laboratorëve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit për sistemin arsimor parauniversitar	AKSHI	DIGJITAL	INFRASTRUKTURA E-GOV	40 666 000 €	I MATURUAR	A	4.2	09.7
3	Digjitalizimi i Shërbimeve Vendore të Qeverisjes Lokale dhe Sistemi Elektronik i Prokurimit me Inteligjencë Artificiale	AKSHI	DIGJITAL	INFRASTRUKTURA E-GOV	76 900 000 €	I MATURUAR	A	17.6	04.6
4	Përmirësimi i infrastrukturës së IT në burgje	AKSHI	DIGJITAL	INFRASTRUKTURA E-GOV	20 124 964 €	I MATURUAR	B	16.6	03.4

5	**Zgjerimi i rrjetit GovNET (në të gjithë Shqipërinë)	AKSHI	DIGJITAL	INFRASTRUKTURA E-GOV	46 386 271 €	I MATURUAR	B	16.7	01.3
6	Ngritja e Qendrës BCC dhe DRC për sistemet elektronike qeveritare	AKSHI	DIGJITAL	INFRASTRUKTURA E-GOV	43 000 000 €	I MATURUAR	A	9.1	01.3
7	Krijimi i Hartës Bazë në Republikën e Shqipërisë	ASIG	ZHVILLIMI EKONOMIK	ZHVILLIMI RAJONAL	19 374 400 €	I MATURUAR	A	8.9	04.1
8	Kampusi i Univeritetit të Tiranës	BT	SOCIAL	ARSIMI DHE SPORTET	166 050 983 €	I MATURUAR	A	4.3	09.6
9	Nyjet Multimodale të Mobilitetit	FSHZH	TRANSPORTI	TRANSPORTI RRUGOR	100 000 000 €	I MATURUAR	A	9.1	01.6
10	Përmirësimi i rrjetit rrugor dytësor dhe lokal	FSHZH	TRANSPORTI	TRANSPORTI RRUGOR	100 000 000 €	I MATURUAR	A	11.3	04.5
11	Mbështetje për Zhvillimin e Qëndrueshëm Rajonal në zonat me potencial ekonomik në Shqipëri	FSHZH	ZHVILLIMI EKONOMIK	TURIZMI	60 000 000 €	I MATURUAR	A	8.9	04.1
12	Turizmi i integruar rajonal dhe studimi i përmirësimit urban për projektin e portës së Alpeve	FSHZH	ZHVILLIMI EKONOMIK	TURIZMI	100 000 000 €	I MATURUAR	A	15.4	04.9

13	Ngritja e infrastrukturës arsimore të Kolegjit të Evropës	MA/FSHZH	SOCIAL	EDUKIMI DHE SPORTET	21 000 000 €	I MATURUAR	A	17.5	09.8
14	Sistemi i Kamerave në administrim të Policisë Shtetit - Smart City	MPB	SOCIAL	SIGURIA E BRENDSHME	134 408 393 €	I MATURUAR	A	16.6	03.5
15	Identiteti Digjital për Shtetasit Shqiptarë	MPB/IDENTITEK	DIGJITAL	NDËRLIDHJA ME BREZ TË GJERË	50 000 000 €	I MATURUAR	A	9.5	01.5
16	Qëndrushmëria ndaj klimës dhe zhvillimit të bujqësisë	MBZHR	ZHVILLIMI EKONOMIK	BUJQËSIA	64 600 000 €	I MATURUAR	A	2.3	04.2
17	Ekonomia Blu	MBZHR	ZHVILLIMI EKONOMIK	BUJQËSIA	25 000 000 €	I MATURUAR	A	14.1	05.1
18	Instituti i Rehabilitimit dhe Riintegrimit për të Miturit në Konflikt me Ligjin	MD	SOCIAL	DREJTËSIA	22 000 000 €	I MATURUAR	A	16.2	03.4
19	Zona Teknologjike dhe Zhvillimit Ekonomik (TEDA) Koplik	MEI	ZHVILLIMI EKONOMIK	ZHVILLIMI I BIZNESIT	18 000 000 €	I MATURUAR	B	8.2	04.1
20	Lehtësimi i Tregtisë dhe Transportit në Ballkanin Perëndimor 2.0	MEI	ZHVILLIMI EKONOMIK	ZHVILLIMI I BIZNESIT	42 368 050 €	I MATURUAR	A	9.5	09.7
21	Expo Albania	MEI	ZHVILLIMI EKONOMIK	ZHVILLIMI RAJONAL	50 300 000 €	I MATURUAR	A	8.2	04.1

22	Restaurimi, Rindërtimi dhe Muzealizimi i Projektimit të Muzeut Historik Kombëtar	MTKS	SOCIAL	KULTURA	32 222 760 €	I MATURUAR	A	11.4	08.2
23	Ngritja e Auto-Moto Park në Shqipëri	MTKS	ZHVILLIMI EKONOMIK	ZHVILLIMI RAJONAL	188 501 689 €	I MATURUAR	A	8.9	08.1
24	Projekti i Portit të Integruar të Durrësit në Porto Romano	MIE	TRANSPORTI	TRANSPORTI DETAR	390 000 000 €	I MATURUAR	A	9.1	04.5
25	Zhvillimi i projektit ITS	MIE	TRANSPORTI	TRANSPORTI RRUGOR	100 000 000 €	I MATURUAR	A	9.2	04.5
26	Masa mbështetëse për eficencën e energjisë me burime të rinovueshme	MIE	ENERGJIA	PRODHIMI I ENERGJISË	20 000 000 €	I MATURUAR	A	7.2	04.3
27	Rehabilitimi i rrugës Fier-Kthesa e Patosit -Fratar	MIE	TRANSPORTI	TRANSPORTI RRUGOR	40 000 000 €	I MATURUAR	A	6.2	04.5
28	Ndërtimi i aksit rrugor Elbasan-Lekaj, Korridori VIII	MIE	TRANSPORTI	TRANSPORTI RRUGOR	360 000 000 €	I MATURUAR	A	6.2	04.5
29	Ndërtimi i bypass-it të Sarandës	MIE	TRANSPORTI	TRANSPORTI RRUGOR	34 000 000 €	I MATURUAR	A	6.2	04.5
30	Programi infrastrukturor – përmirësimi i lidhjes rajonale	MIE	TRANSPORTI	TRANSPORTI RRUGOR	195 145 000 €	I MATURUAR	C	17.6	04.5
31	*Zhvillimi rajonal i broadbandit-Investim për infrastrukturën broadband në	MIE	DIGJITAL	NDËRLIDHJA ME BREZ TË GJERË	109 220 000 €	I MATURUAR	B	17.6	04.6

	zonat e bardha në 8 qarqe								
32	*Përmirësimi I ITUN Durrës dhe Rehabilitimi i sistemit të kanalizimeve të ujrave të përdorura në zonën historike të qytetit të Durrësit	MIE/AKUK	MJEDISI	FURNIZIMI ME UJË	119 800 000 €	I MATURUAR	A	14.1	05.2
33	**Rehabilitimi i sistemit të kanalizimeve të ujrave të përdorura në zonën rezidenciale të qytetit të Durrësit (Porto Romano, Spitallë, Shkozet)	MIE/AKUK	MJEDISI	FURNIZIMI ME UJË	74 750 000 €	I MATURUAR	B	14.1	05.2
34	Programi kombëtar i modernizimit të sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në Shqipëri	MIE/AKUK	MJEDISI	FURNIZIMI ME UJË	141 300 000 €	I MATURUAR	A	6.4	06.3
35	Ndërtimi i sistemit të kanalizimeve, njësia Administrative Cërravë, Bashkia Pogradec	MIE/AKUK	MJEDISI	ZHVILLIMI I QENDRUESHËM	18 121 000 €	I MATURUAR	A	14.1	05.2
36	Korridori Adriatiko Jonian-Segmenti Milot - Balldren	MIE/ARRSH	TRANSPORTI	TRANSPORTI RRUGOR	213 600 000 €	I MATURUAR	A	11.2	04.5
37	*Ndërtimi i bypass-it Tiranë	MIE/ARRSH	TRANSPORTI	TRANSPORTI RRUGOR	223 000 000 €	I MATURUAR	A	9.1	04.5

38	Projekti për ndërtimin e urave rezistente	MIE/ARRSH	TRANSPORTI	TRANSPORTI RRUGOR	100 000 000 €	I MATURUAR	A	9.1	04.5
39	Zgjerimi i autostradës Tiranë-Durrës	MIE/ARRSH	TRANSPORTI	TRANSPORTI RRUGOR	298 860 000 €	I MATURUAR	A	9.1	04.5
40	Ndërtimi i rrugës Tiranë-Ndroq-Plepa	MIE/ARRSH	TRANSPORTI	TRANSPORTI RRUGOR	87 000 000 €	I MATURUAR	A	9.1	04.5
41	*Rehabilitimi i linjës hekurudhore Durrës-Rrogozhinë	MIE/HSH	TRANSPORTI	TRANSPORTI HEKURUDHOR	122 900 000 €	I MATURUAR	A	9.1	04.5
42	Ndërtimi i bypass-it të Elbasanit	MIE/ARRSH	TRANSPORTI	TRANSPORTI RRUGOR	240 000 000 €	I MATURUAR	A	9.4	04.5
43	*Transporti i Gjelbër në qytetin e Tiranës	MIE/BT	TRANSPORTI	TRANSPORTI RRUGOR	110 370 000 €	I MATURUAR	A	11.6	04.5
44	*Rehabilitimi i hekurudhës Vorë-Hani Hotit	MIE/HSH	TRANSPORTI	TRANSPORTI HEKURUDHOR	308 060 000 €	I MATURUAR	A	9.1	04.5
45	*Elektrifikimi i linjës hekurudhore Tiranë - Durrës dhe lidhja me Aeroportin e Rinasit	MIE/HSH	TRANSPORTI	TRANSPORTI HEKURUDHOR	27 500 000 €	I MATURUAR	A	9.1	04.5
46	Elektrifikimi i linjës hekurudhore Vorë - Hani i Hotit	MIE/HSH	TRANSPORTI	TRANSPORTI HEKURUDHOR	59 910 000 €	I MATURUAR	A	9.1	04.5
47	Instalimi i matësave të zgjuar dhe balancimi në pikat e	MIE/OSHEE	ENERGJIA	EFICENCA E ENERGJISË	330 000 000 €	I MATURUAR	A	7.3	04.3

	transformimit, si dhe sistemi CRM/billing								
48	*Ndërtimi i Impiantit fotovoltaik 50 Mwp në Belsh	MIE/KESH	ENERGJIA	ENERGJIA E RINOVUESHME	40 000 000 €	I MATURUAR	A	7.2	04.3
49	Rehabilitimi elektromekanik i HEC Vau i Dejës	MIE/KESH	ENERGJIA	PRODHIMI I ENERGJISË	110 500 000 €	I MATURUAR	B	7.1	04.3
50	Mbështetje për zhvillimin e sistemit të mbrojtjes civile	MM/AKMC	SOCIAL	MBROJTJA SOCIALE	30 000 000 €	I MATURUAR	A	16.1	03.5
51	Digjitalizimi i sistemit të transmetimit të Shqipërisë	MIE/OST	ENERGJIA	EFICENCA E ENERGJISË	51 500 000 €	I MATURUAR	A	7.1	04.3
52	Programi i Efiçiencës së Energjisë në Sektorin e Transmetimit - ndërtimi i linjës së transmetimit me dy qarqe 220 kV Tiranë – Rrashbull dhe Unaza 110 kV e Tiranës	MIE/OST	ENERGJIA	EFICENCA E ENERGJISË	49 173 745 €	I MATURUAR	A	7.1	04.3
53	Mjedis i pastër dhe me aftësi ripërtëritëse "Deti Blu"	MMjedisit	ZHVILLIMI EKONOMIK	TURIZMI	75 500 000 €	I MATURUAR	A	12.2	05.4
54	Zbatimi i infrastrukturës së menaxhimit të integruar të mbetjeve, zona e mbetjeve Kukës	MMjedisit	MJEDISI	MENAXHIMI I MBETJEVE, LANDFILLET	18 000 000 €	I MATURUAR	A	11.6	05.1

55	Zbatimi i infrastrukturës së menaxhimit të integruar të mbetjeve, zona Jugore Vlorë-Gjirokastër	MMjedisit	MJEDISI	MENAXHIMI I MBETJEVE, LANDFILLET	25 000 000 €	I MATURUAR	A	11.6	05.1
56	Programi për një zhvillim urban rezistent ndaj ndryshimeve klimatike në Shqipëri - ALBAdapt	MMjedisit	MJEDISI	ZHVILLIMI I QENDRUESHËM	34 800 000 €	I MATURUAR	A	13.1	05.6

II. PROJEKTE INVESTIMI ME STATUS "PJESËRISHT I MATURUAR"

NR	EMËRTIMI	INSTITUCIONI PROPOZUES/PËRGJEGJËS	SEKTORI	NËNSEKTORI	VLERA INDIKATIVE	STATUSI I MATURITETIT	NIVELI I PRIORITETIT INSTITUCIONAL	OZHQ	COFOG
57	**Krijimi i një qendre kompjuterike me performancë të lartë dhe krijimi i një rrjeti të sigurtë shkëmbimi informacioni për të mundësuar ndërveprimin rajonal në rajonin e Ballkanit Perëndimor	AKSHI	DIGJITAL	NDËRLIDHJA ME BREZ TË GJERË	15 000 000 €	PJESËRISHT I MATURUAR	B	17.6	04.6
58	Business Intelligence për Administratën Publike	AKSHI	DIGJITAL	PLATFORMAT E INOVACIONIT	24 379 618 €	PJESËRISHT I MATURUAR	B	9.1	01.5

59	**Përmirësimi i infrastrukturës mbrojtëse nga përmbytjet në lumenjtë Erzen-Ishëm, Shkumbin, Seman dhe Vjosë	MBZHR	MJEDISI	MBROJTJA NGA PËRMBYTJET	105 000 000 €	PJESËRISHT I MATURUAR	A	3.1	04.2
60	Ndërtimi i qendrës së Biosimulimit të Universitetit Mjekësisë Tiranë	MA	SOCIAL	SHËNDETËSIA	26 943 982 €	PJESËRISHT I MATURUAR	A	3.8	07.5
61	Përgatitja dhe aftesitë ripërëritëse ndaj ndryshimeve klimatike (AL-PACT)	MPB	MJEDISI	MENAXHIMI I FATKEQËSIVE	99 210 000 €	PJESËRISHT I MATURUAR	A	13.3	10.8
62	**Gazsjellësi Adriatiko Jonian – Seksionet e Malit të Zi dhe Shqipërisë	MIE	ENERGJIA	GAZI	172 500 000 €	PJESËRISHT I MATURUAR	B	17.9	04.3
63	**Rehabilitimi i 431 digave në drejtim të rritjes së sigurisë së digave dhe disponueshmerise së ujit për ujitje	MBZHR	MJEDISI	MBROJTJA NGA PËRMBYTJET	171 500 000 €	PJESËRISHT I MATURUAR	A	15.3	04.2
64	Amfiteatri i Durrësit	MTKS	SOCIAL	KULTURA	38 000 000 €	PJESËRISHT I MATURUAR	A	11.4	08.2
65	Porti i integruar i Durrësit-Faza 2	MIE	TRANSPORTI	TRANSPORTI DETAR	261 000 000 €	PJESËRISHT I MATURUAR	**B**	9.1	04.5
66	Segmenti Rrugor Milot-Reps	MIE	TRANSPORTI	TRANSPORTI RRUGOR	60 000 000 €	PJESËRISHT I MATURUAR	A	9.1	04.5
67	Ndërtim rruga "Bushtricë-Pika Doganore, Korridori VIII"	MIE	TRANSPORTI	TRANSPORTI RRUGOR	176 000 000 €	PJESËRISHT I MATURUAR	A	9.1	04.5

68	Baza autonome detare Porto Romano	MIE	TRANSPORTI	TRANSPORTI DETAR	366 000 000 €	PJESËRISHT I MATURUAR	A	9.1	04.5
69	Hekurudha Porto Romano-Sukth	MIE	TRANSPORTI	TRANSPORTI HEKURUDHOR	29 500 000 €	PJESËRISHT I MATURUAR	A	9.1	04.5
70	Aeroporti i Jugut	MIE	TRANSPORTI	TRANSPORTI RRUGOR	34 000 000 €	PJESËRISHT I MATURUAR	A	9.4	04.5
71	Përmirësimi i sistemit të kanalizimeve për Tiranën e madhe (Faza e II-të Kashar)	MIE	MJEDISI	FURNIZIMI ME UJË	130 000 000 €	PJESËRISHT I MATURUAR	A	6.4	06.3
72	**Gazsjellësi Fier-Vlorë që do të lidhë gazsjellësin TAP me TEC-in e Vlorës	MIE/ALBGAZ	ENERGJIA	GAZI	50 500 000 €	PJESËRISHT I MATURUAR	A	7.1	04.3
73	**Magazinimi nëntokësor i gazit natyror në zonën e Dumresë (UGS Dumrea)	MIE/ALBGAZ	ENERGJIA	GAZI	89 500 000 €	PJESËRISHT I MATURUAR	B	12.2	04.3
74	**Korridori Adriatiko Jonian-Segmenti Murriqan - Lezhë (Balldren)	MIE/ARRSH	TRANSPORTI	TRANSPORTI RRUGOR	469 410 202 €	PJESËRISHT I MATURUAR	A	9.1	04.5
75	Korridori Adriatiko Jonian-Segmenti Gjirokastër-Kakavijë	MIE/ARRSH	TRANSPORTI	TRANSPORTI RRUGOR	138 000 000 €	PJESËRISHT I MATURUAR	A	9.1	04.5
76	Korridori Adriatiko Jonian- Segmenti Pocem – Memaliaj	MIE/ARRSH	TRANSPORTI	TRANSPORTI RRUGOR	597 000 000 €	PJESËRISHT I MATURUAR	A	9.1	04.5
77	Korridori Adriatiko Jonian- Segmenti Memaliaj – Ura e Subashit	MIE/ARRSH	TRANSPORTI	TRANSPORTI RRUGOR	260 000 000 €	PJESËRISHT I MATURUAR	A	9.1	04.5

78	Korridori Adriatiko Jonian-Segmenti Fier Bypass (Levan)-Pocem	MIE/ARRSH	TRANSPORTI	TRANSPORTI RRUGOR	160 000 000 €	PJESËRISHT I MATURUAR	A	9.1	04.5
79	Korridori Adriatiko Jonian - Bypass-i Gjirokastrës	MIE/ARRSH	TRANSPORTI	TRANSPORTI RRUGOR	100 000 000 €	PJESËRISHT I MATURUAR	A	9.1	04.5
80	**Rehabilitimi i hekurudhës "Rrogozhinë-Pogradec/Prrenjas-Rrajcë-kufi me Maqedoninë e Veriut	MIE/HSH	TRANSPORTI	TRANSPORTI HEKURUDHOR	451 000 000 €	PJESËRISHT I MATURUAR	A	9.1	04.5
81	Ndërtimi i linjës hekurudhore Durrës – Prishtinë	MIE/HSH	TRANSPORTI	TRANSPORTI HEKURUDHOR	750 000 000 €	PJESËRISHT I MATURUAR	**A**	9.1	04.5
82	**Ndërtimi i një pompe depozituese "Pump Storage", Koman - Fierzë	MIE/KESH	ENERGJIA	EFICENCA E ENERGJISË	202 670 000 €	PJESËRISHT I MATURUAR	A	7.3	04.3
83	HEC Skavica	MIE/KESH	ENERGJIA	TRANSMETIMI I ENERGJISË	800 050 000 €	PJESËRISHT I MATURUAR	B	7.1	04.3
84	Rindërtimi i linjës 220 kV Vau i Dejës (Shqipëri) - Podgoricë (Mali i Zi) dhe zgjerimi në 400/220 kV i nënstacionit të Vaut të Dejës	MIE/OST	ENERGJIA	TRANSMETIMI I ENERGJISË	70 000 000 €	PJESËRISHT I MATURUAR	B	7.3	04.3
85	**Ndërtimi i një linje të re OHL 400 kV midis Republikës së Shqipërisë dhe	MIE/OST	ENERGJIA	TRANSMETIMI I ENERGJISË	53 600 000 €	PJESËRISHT I MATURUAR	A	17.9	04.3

	Republikës së Greqisë dhe mbyllja e unazës së brendshme 400 kV								
86	Institucioni Mjekësor i Posaçëm për personat me çrregullime të shëndetit mendor me masë mjekësore, Lezhë	MSHMS	SOCIAL	SHËNDETËSIA	20 000 000 €	PJESËRISHT I MATURUAR	A	16.6	10.1
87	Programi i Reformës së QSUT, Faza 3, Spitali Onkologjik	MSHMS	SOCIAL	SHËNDETËSIA	46 729 272 €	PJESËRISHT I MATURUAR	A	16.6	10.1

III. PROJEKTE INVESTIMI ME STATUS " I PAMATURUAR"

NR	EMËRTIMI	INSTITUCIONI PROPOZUES/PËRGJEGJËS	SEKTORI	NËNSEKTORI	VLERA INDIKATIVE	STATUSI I MATURITETIT	NIVELI I PRIORITETIT INSTITUCIONAL	OZHQ	COFOG
88	Park shkencor dhe teknologjik "Technopark Tirana"	BT	ZHVILLIMI EKONOMIK	ZHVILLIMI I BIZNESIT	21 000 000 €	I PAMATURUAR	C	8.9	04.8
89	Ndërtimi I Qendrës Multifunksionale të Stërvitjes për Forcat e Ndërhyrjes së Shpejtë dhe struktura të tjera të Policisë së Shtetit	MPB	SOCIAL	SIGURIA E BRENDSHME	15 000 000 €	I PAMATURUAR	C	16.6	03.5

90	Rehabilitimi i infrastrukturës së ujitjes që shërben një sipërfaqe prej 75 000 ha me ngritje mekanike të ujit kryesisht në zonën bregdetare perëndimore	MBZHR	MJEDISI	MBROJTJA NGA PËRMBYTJET	115 000 000 €	I PAMATURUAR	**A**	14.1	04.2
91	Mbështetje për Skemën Kombëtare dhe linjëzimin me EU-acquis në Sektorin Bujqësor dhe Rural	MBZHR	ZHVILLIMI EKONOMIK	AGRIKULTURA	50 000 000 €	I PAMATURUAR	A	8.1	04.2
92	Ndërtimi i godinës për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë	MD/KLGJ	SOCIAL	DREJTËSIA	15 000 000 €	I PAMATURUAR	B	16.3	03.3
93	Ndërtimi i Prokurorive të Tiranës, Durrësit dhe Fier	MD/PP	SOCIAL	DREJTËSIA	15 000 000 €	I PAMATURUAR	A	16.3	03.3
94	Ndërtimi i Arkivit Dixhital Kombëtar Kulturor	MTKS	DIGJITAL	PLATFORMAT E INOVACIONIT	18 800 000 €	I PAMATURUAR	B	16.1	08.2
95	Sigurimi i strehimit të përshtatshëm dhe të perballueshëm për familjet me të ardhura te ulëta dhe te mesme	MEI	SOCIAL	STREHIMI	15 500 000 €	I PAMATURUAR	A	16.1	10.6
96	**Krijimi i qendrave të Ekselencës dhe Inovacionit në Nanoteknologji dhe Shkenca Biomarine	MEI	ZHVILLIMI EKONOMIK	SIPËRMARRJA	31 000 000 €	I PAMATURUAR	A	9.5	09.7

97	TEC Vlora	MIE/ALBGAZ	ENERGJIA	PRODHIMI I ENERGJISË	250 000 000 €	I PAMATURUAR	A	7.1	04.3
98	Ndërtimi i rrjetit të transmetimit të gazit natyror në qytetin e Korcës	MIE	ENERGJIA	ENERGJIA E RINOVUESHME	17 000 000 €	I PAMATURUAR	A	7.2	04.3
99	Linja e re e interkonjeksionit nënujor HVDC Vlorë (Shqipëri)-Brindisi (Itali)	MIE	ENERGJIA	TRANSMETIMI I ENERGJISË	310 000 000 €	I PAMATURUAR	A	19.9	04.3
100	Digjitalizimi i Kaskadës së Drinit së bashku me rrjedhën e poshtme	MIE	ENERGJIA	EFICENCA E ENERGJISË	80 000 000 €	I PAMATURUAR	B	7.1	04.3
101	Ndërtimi i një centrali të ruajtjes së energjisë elektrike	MIE	ENERGJIA	EFICENCA E ENERGJISË	120 000 000 €	I PAMATURUAR	B	7.3	04.3
102	Ndërtimi i rrugës së karvanit - rruga e lashtë e karvanit, Vlorë-Berat-Voskopojë-Korçë	MIE	TRANSPORTI	TRANSPORTI RRUGOR	118 000 000 €	I PAMATURUAR	C	9.1	04.5
103	Rindërtimi dhe zhvillimi i rrjetit naftësjellës shqiptar (nën administrimin e Albpetrol sh.a)	MIE	ENERGJIA	NAFTA	155 000 000 €	I PAMATURUAR	C	7.3	04.3
104	Përmirësimi dixhital i sistemeve të integruara të energjisë brenda Ballkanit Perëndimor si shtytës kryesor për një epokë të re	MIE	ENERGJIA	TRANSMETIMI I ENERGJISË	50 000 000 €	I PAMATURUAR	C	17.6	04.3

105	Terminali LNG në Vlorë	MIE/ALBGAZ	ENERGJIA	GAZI	120 000 000 €	I PAMATURUAR	B	8.4	04.3
106	**Gazsjellësi i Shqipërisë dhe Kosovës (ALKOGAP)	MIE/ALBGAZ	ENERGJIA	GAZI	195 500 000 €	I PAMATURUAR	C	7.3	04.3
107	Ndërtimi i segmentit rrugor "Berat-Skrapar-Gramsh"	MIE/ARRSH	TRANSPORTI	TRANSPORTI RRUGOR	347 386 346 €	I PAMATURUAR	A	9.1	04.5
108	Rruga hyrje veriore e cila anashkalon Kamzën, duke lidhur autostradat e veriut, drejtpërdrejt me unazën e re të Tiranës	MIE/ARRSH	TRANSPORTI	TRANSPORTI RRUGOR	210 537 179 €	I PAMATURUAR	A	9.1	04.5
109	Rehabilitimi i Linjës hekurudhore Rrogozhinë - Vlorë dhe Lidhja e re me Aeroportin Ndërkombëtar të Vlorës (VIA)	MIE/HSH	TRANSPORTI	TRANSPORTI HEKURUDHOR	220 000 000 €	I PAMATURUAR	A	9.1	01.5
110	Ndërtimi i lidhjes së re hekurudhore Pogradec - Korcë - Kufiri me Greqinë	MIE/HSH	TRANSPORTI	TRANSPORTI HEKURUDHOR	250 000 000 €	I PAMATURUAR	B	9.1	04.5
111	Park Fotovoltaik Belsh 250 Mwp	MIE/KESH	ENERGJIA	ENERGJIA E RINOVUESHME	150 000 000 €	I PAMATURUAR	B	7.3	04.3
112	**Vlerësimi i potencialit të energjisë eolike në Shqipëri për ndërtimin e fermave të erës dhe Ndërtimi i një	MIE/KESH	ENERGJIA	ENERGJIA E RINOVUESHME	100 000 000 €	I PAMATURUAR	B	7.2	04.3

	Centrali Eolik në det (off Shore)								
113	Zgjerimi dhe spostimi i Nënstacionit ekzistues Tirana 1 me nivel tensioni 400 kV	MIE/OST	ENERGJIA	TRANSMETIMI I ENERGJISË	17 000 000 €	I PAMATURUAR	B	7.1	04.3
114	**Digjitalizimi i sistemit të shpërndarjes së energjisë në Shqipëri	MIE/OSHEE	ENERGJIA	EFICENCA E ENERGJISË	118 300 000 €	I PAMATURUAR	A	7.3	04.3
115	**Zgjerimi i Nënstacionit 400 KV të Fierzës dhe interkoneksion i ri 400 KV Shqiperi - Kosovë	MIE/OST	ENERGJIA	TRANSMETIMI I ENERGJISË	55 000 000 €	I PAMATURUAR	A	7.1	04.3
116	Ndërtimi i 8 qendrave të rehabilitimit	MSHMS	SOCIAL	SHËNDETËSIA	21 850 000 €	I PAMATURUAR	A	16.6	07.4
117	Programi për përmirësimin e shërbimeve sociale dhe shëndetësore	MSHMS	SOCIAL	SHËNDETËSIA	52 600 000 €	I PAMATURUAR	A	16.6	07.4
118	Qendrat e rehabilitimit shëndetësor dhe social, të quajtura "Shtëpi mbështetje" për personat me çrregullime të rënda mendore	MSHMS	SOCIAL	SHËNDETËSIA	16 500 000 €	I PAMATURUAR	A	3.4	10.1

Për ndryshimet e reflektuara, vlerat janë konvertuar me kursin e këmbimit të muajit korrik 2026_inforeuro.

** Projekti ka përfituar investim me mbështetje nga WBIF*
*** Projekti ka përfituar asistencë teknike me mbështetje nga WBIF*

AKRONIME DHE SHKURTIME

AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AKMC	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
AKUM	Agjencia Kombëtare Ujësjellës-Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve
ARRSH	Autoriteti Rrugor Shqiptar
ASIG	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
DPAK	Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit
DSHQ	Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare
FSHZH	Fondi Shqiptar i Zhvillimit
KESH	Korporata Elektroenergjetike Shqiptare
KM	Kryeministria
HSH	Hekurudha Shqiptare
MAPA	Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin
MA	Ministria e Arsimit
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MF	Ministria e Financave
MEI	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MM	Ministria e Mbrojtjes
MMjedisit	Ministria e Mjedisit
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
MTKS	Ministria e Turizmit Kulturës dhe Sportit
OSSH	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes
OST	Operatori i Sistemit të Transmetimit

LEGJENDA

Në linkun https://albania.un.org/sq/sdgs do të gjeni të detajuara Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm OZHQ.

Në tabelën e mëposhtme do të gjeni përshkrimin e detajuar të COFOG-ut.

COFOG	**COFOG_3G**	**COFOG Përshkrimi**
01	**010**	Shërbime të përgjithshme publike
01.1	**011**	Organet ekzekutive dhe legjislative, çështjet financiare dhe fiskale, punët e jashtme
01.2	**012**	Ndihma e huaj ekonomike
01.3	**013**	Shërbime të përgjithshme
01.4	**014**	Kërkimi Bazë
01.5	**015**	R&D Shërbime të përgjithshme publike
01.6	**016**	Shërbime të përgjithshme publike n.e.c.
01.7	**017**	Transaksionet të borxhit publik
01.8	**018**	Transfertat me karakter të përgjithshëm ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes
02	**020**	Mbrojtja
02.1	**021**	Mbrojtja ushtarake
02.2	**022**	Mbrojtja civile
02.3	**023**	Ndihma ushtarake e huaj
02.4	**024**	R&D Mbrojtja
02.5	**025**	Mbrojtja n.e.c.
03	**030**	Rendi dhe siguria publike

03.1	**031**	Shërbimet e policisë
03.2	**032**	Shërbime për mbrojtjen nga zjarri
03.3	**033**	Gjykatat Ligjore
03.4	**034**	Burgjet
03.5	**035**	R&D Rendi dhe siguria publike
03.6	**036**	Rendi dhe siguria publike n.e.c.
04	**040**	Çështjet ekonomike
04.1	**041**	Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës
04.2	**042**	Bujqësia, pylltaria, peshkimi dhe gjuetia
04.3	**043**	Karburant dhe energji
04.4	**044**	Miniera, prodhim dhe ndërtim
04.5	**045**	Transporti
04.6	**046**	Komunikimi
04.7	**047**	Industri të tjera
04.8	**048**	R&D Çështjet Ekonomike
04.9	**049**	Çështjet ekonomike n.e.c.
05	**050**	Mbrojtja e mjedisit
05.1	**051**	Menaxhimi i mbetjeve
05.2	**052**	Menaxhimi i ujërave të ndotura
05.3	**053**	Pakësimi i ndotjeve
05.4	**054**	Mbrojtja e biodiversitetit dhe peizazhit
05.5	**055**	R&D Mbrojtje e mjedisit
05.6	**056**	Mbrojtja e mjedisit n.e.c.
06	**060**	Banesat dhe komoditet e komunitetit
06.1	**061**	Zhvillimi i banesave
06.2	**062**	Zhvillimi i komunitetit
06.3	**063**	Furnizimi me ujë
06.4	**064**	Ndriçimi në rrugë
06.5	**065**	R&D Strehimi dhe komoditet e komunitetit
06.6	**066**	Banesat dhe komoditet e komunitetit n.e.c.
07	**070**	Shëndeti
07.1	**071**	Produkte, pajisje dhe pajisje mjekësore
07.2	**072**	Shërbime ambulatore
07.3	**073**	Shërbime spitalore
07.4	**074**	Shërbime të shëndetit publik
07.5	**075**	R&D Shëndetësia
07.6	**076**	Shëndeti n.e.c.
08	**080**	Zbavitje, kultura dhe feja
08.1	**081**	Shërbime rekreative dhe sportive
08.2	**082**	Shërbime kulturore
08.3	**083**	Shërbime të transmetimit dhe botimit
08.4	**084**	Shërbime fetare dhe shërbime të tjera të komunitetit
08.5	**085**	R&D Rekreacioni kultura dhe feja
08.6	**086**	Rekreacioni, kultura dhe feja n.e.c.
09	**090**	Arsimi
09.1	**091**	Arsimi parashkollor dhe fillor
09.2	**092**	Arsimi i mesëm
09.3	**093**	Arsimi pas-sekondar jo-terciar
09.4	**094**	Arsim i lartë
09.5	**095**	Arsimi jo i përcaktueshëm sipas nivelit
09.6	**096**	Shërbime ndihmëse për arsimin
09.7	**097**	R&D Edukimi
09.8	**098**	Arsimi n.e.c.
10	**100**	Mbrojtja sociale
10.1	**101**	Sëmundja dhe paaftësia
10.2	**102**	Mosha e vjetër
10.3	**103**	Të mbijetuarit
10.4	**104**	Familja dhe fëmijët
10.5	**105**	Papunësia
10.6	**106**	Strehimi
10.7	**107**	Përjashtimi social n.e.c.

10.8	**108**	R&D Mbrojtje sociale
10.9	**109**	Mbrojtja sociale n.e.c.